

RAPORTI PËR VITIN 2002

- Nga Avokati i Popullit –

Tiranë, Prill 2003

**Zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Të nderuar deputetë,
Të respektuar përfaqësues të përfaqësive diplomatike dhe të medias,**

Për të tretin vit radhazi kam nderin dhe kënaqësinë që, si Avokat i Popullit i Republikës së Shqipërisë, të paraqes raportin për veprimtarinë e Institucionit që përfaqësoj.

Në harkun e tre vjetëve veprimtari, Avokati i Popullit vjen para këtij Kuvendi me fizionominë e një institucioni modern, mirëfunksionues dhe me integritetin e nevojshëm, sepse në përgjithësi është mirëkuptuar si nga administrata publike, ashtu dhe nga qytetarët shqiptarë, si ndërmjetësues midis tyre.

Dihet tashmë nga të gjithë se ndër prioritetet kryesore që partnerët ndërkombëtarë i kanë vënë vendit tonë, janë “fusha e drejtësisë dhe e punëve të brendshme”. Kjo është e natyrshme sepse problematika e këtyre fushave gjeneron vetvetiu shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri dhe si reaksion zinxhir, jep ndikim negativ edhe përtej vendit tonë. Shqetësimi ndërkombëtar për përhapjen e kriminalitetit me të gjitha format e tij, qoftë të trafikeve, qoftë të prostitucionit, apo qoftë edhe të “zënies së shtetit” përmes korrupsionit, tregon se të tilla fenomene nuk mund të “karantinohen” vetëm në një vend të vetëm.

Por çmimin më të rëndë për rrjedhojat e këtyre fenomeneve, të cilët e largojnë kohën se kur Shqipëria do të bëjë pjesë me të gjitha të drejtat dhe detyrat në Bashkimin Europian, e paguajnë pikërisht shtresat më të varfëra e më të prekshme të shoqërisë, thënë ndryshe, grupet e synuara për t’u mbrojtur nga Avokati i Popullit. Kjo është një arsye më shumë se përse Avokati i Popullit nuk mund të bëjë indiferentin edhe ndaj problematikës së mësipërme.

Avokati i Popullit ndan mendimin se angazhimi i të gjithë spektrit politik dhe Qeverisë në luftën kundër krimit të organizuar, për mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor, ndalimin e trafikeve ilegale, të drogës, armëve, femrave dhe organeve duhet të jetë i njëjlojtë, me angazhimin që të shërbejë për nxitjen e investimeve dhe zhvillimin ekonomik. Kjo, në gjuhën e jetës së përditshme, do të thotë më pak pensionistë që u dridhen duart dhe kockat, më pak fëmijë të kequshqyer, më pak “mish i bardhë” për tregun e trotuareve të Europës, më pak

indiferencë të zyrtarëve përballë qytetarëve dhe si rrjedhojë edhe më pak ankesa dhe kërkesa pranë zyrës së Avokatit të Popullit.

Përballë problematikës, me të cilën ndeshet shteti dhe shoqëria shqiptare, Avokati i Popullit nuk e ndjen veten një zë në shkretëtirë. Duke ushtruar funksionin e tij për të ndikuar në mirëqeverisje, institucioni ynë i ri, me një mënyrë procedimi disi jashtë skemave tradicionale, ka vlerësuar dhe ka marrë në konsideratë çdo analizë dhe kritikë të shprehur nga cilido dhe nga të gjitha anët pa dallim. Kjo sepse, qëllimi ynë është të zgjidhim ankesat e kërkesat e njerëzve të zakonshëm, të cilëve, para së gjithash, u intereson mirëadministrimi i pushtetit dhe rritja e cilësisë së jetës nga shërbimet që ata presin prej atyre që qeverisin vendin.

Duke përfunduar, më lejoni të citoj çfarë ka shkruar kohët e fundit zoti Paddy Ashdown, përfaqësuesi i lartë i komunitetit ndërkombëtar në Bosnjë Hercegovinë, botuar me titull “Çfarë mësova unë në Bosnjë”:

“Në Bosnjë ne menduam se demokracia ishte prioriteti kryesor dhe e matëm atë me numrin e zgjedhjeve që mund të organizonim. Rezultati pas shtatë vjetësh është se populli i Bosnjës është lodhur nga votimet. Për më tepër, fokusimi në zgjedhje ngadalësoi përpjekjet tona për të ndaluar krimin e organizuar dhe korrupsionin, që kanë vënë në rrezik cilësinë e jetës dhe frikësuar investimet e huaja.

Tani që kemi zënë mend pas kuvendit, themi se duhet të kishim ndërtuar të parin shtetin ligjor, pasi çdo gjë tjetër varet nga ai: funksionimi i ekonomisë, sistemi i lirë dhe i drejtë politik, zhvillimi i shoqërisë civile, besimi i publikut ndaj policisë dhe gjykatave... Tani sfida është një qeverisje efektive, stabilizim institucionesh dhe një udhëheqje e ndershme”.

Duke shkruar jam munduar që çfarë thuhet për Bosnjën, ta reflektoj sa më tepër në këtë raport. Prandaj, ju lutem të gjithëve për një moment reflektimi. Në pritje të vlerësimit tuaj, mbetem i hapur për çdo opinion të vlefshëm.

Ju faleminderit

Ermir DOBJANI

Avokati i Popullit

P Ë R M B A J T J A

Mesazhi i Avokatit të Popullit	3
Përmbajtja	5
Hyrje	8
Prezantim i shkurtër i Raportit	13

KREU I PARË

1. E drejta e mirëadministrimit e Bashkimit Evropian, baza ligjore e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.	15
2. Kushtetuta dhe ligji shqiptar “Për Avokatin e Popullit” reflektojnë dhe pasqyrojnë përvojen dhe rekomandimet e këshillat e Komunitetit Ndërkombëtar për këtë Institucion.	18
3. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit	24
4. Krijimi dhe vënia në funksionim e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri.	28
5. Mbështetja ndërkombëtare.	30
6. Buxheti i Institucionit për vitin 2002.	31
7. Vështirësitë e Institucionit dhe shkaqet e tyre.	33
8. Faktorët ku mbështeten arritjet e Institucionit.	36
9. Sfidat, objektivat e Institucionit për vitin 2003 e në vazhdim.	36
10. Strategjia për të ardhmen e Institucionit.	38

KREU I DYTË

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2002.	40
2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë.	44
3. Mendime për korrupsionin dhe antikorrupsionin.	48
4. Marrëdhëniet me Gjykatën Kushtetuese.	54
5. Opinione të përgjithshme rreth situatës të Drejtave të Njeriut në Shqipëri.	68
6. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në marrëdhëniet me publikun.	74
7. Ditët e Hapura, përvojë e re e Institucionit të Avokatit të Popullit.	81
8. Marrëdhëniet me Jashtë	85

7		
9.	Bashkëpunimi me Amnesty International	102
10.	Konferenca Kombëtare “E drejta e Informimit, e Drejtë Themelore e Njeriut”.	103
11.	Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit.	109

KREU I TRETË

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet (rastet), të grupuara sipas institucioneve qeveritare.

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria)	113
2.	Ministria e Drejtësisë	127
3.	Ankesa për Gjykatat	139
4.	Ankesat për Prokurorinë	149
5.	Ministria e Rendit Publik	156
6.	Ministria e Mbrojtjes	195
7.	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	204
8.	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	212
9.	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	221
10.	Ministria e Ekonomisë	233
11.	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	235
12.	Ministria e Financave	242
13.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	246
14.	Ministria e Shendetësisë	249
15.	Ministria e Punëve të Jashtme	250
16.	Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve	255
17.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	259
18.	Ministria e Mjedisit	259
19.	Ministria e Industrisë dhe Energjitikës	261
20.	Shërbimet Sekrete	265
21.	Përgjithësime për marrëdhëniet e punës	267
22.	Konkluzione lidhur me rastet që kanë të bëjnë me Administratën Publike.	271

KREU I KATËRT

- | | |
|---|-----|
| 1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportin Vjetor 2001. | 274 |
| 2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit (“ex officio”) | 276 |

ANEKSE

- | | |
|--|-----|
| 1. Vlerësime të Institucioneve dhe personaliteteve ndërkombëtare për punën e Avokatit të Popullit. | 293 |
| 2. Letra falenderimi nga qytetarët | 296 |
| 3. Grafikët | 301 |

HYRJE

Me një përvojë tashmë prej tre vjetësh, Institucioni i Avokatit të Popullit funksionon në Shqipëri krahas institucioneve të tjera, duke kontribuar në përmirësimin e praktikave të mirëqeverisjes. Ai siguron një mbikqyrje të sjelljes administrative të organeve qeverisëse dhe autoriteteve publike, sa dhe si këta të fundit shërbejnë për taksapaguesit e tyre. Në këtë ndërveprim të përditshëm, objektivi i Avokatit të Popullit është respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit, dhe eventualisht rivendosja e së drejtës së shkelur të tij nga nëpunësi i administratës publike.

Praktika e qeverisjes së mirë dhe ndërveprimi i binomit autoritet publik-taksapagues sigurohen nga funksionimi i mekanizmave të pavarur e të paanshëm për të shqyrtuar mënyrën se si ka vepruar Qeveria. Sistemi i kontrollit dhe balancës sot është një parim bazë i qeverisjes moderne në të gjithë botën.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si instancë kombëtare, garante e demokracisë, përmes mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në vendin tonë u parashikua për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, miratuar më 28 Nëntor 1998, pas 8 viteve të ndryshimeve demokratike. Kjo Kushtetutë, në 5 nene të saj përcakton detyrat, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Në zbatim të saj, në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Sot ka rreth 350 ombudsmanë ose mediatorë në 125 vende, që veprojnë në të gjithë kontinentet. Vetëm Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit, anëtar i të cilit është edhe Avokati i Popullit, ka anëtarë në mbi 111 vende.

Në një shoqëri të shtetit të së drejtës parashikohet se, sistemi gjyqësor i pavarur, luan rolin e mbrojtësit kryesor e të pazevendësueshëm të të drejtave të individit. Ndërkaq, edhe Avokati i Popullit, (Ombudsmani) ka rezultuar i suksesshëm, pavarësisht se është një institucion ekstra-gjyqësor. Ai vepron si një agjenci unike në secilin vend, në ndihmë të qytetarëve, kur këta ndeshin vështirësi me administratën apo autoritetet publike.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ka miratuar institucionin e Avokatit të Popullit, duke përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Ato janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti.

Përpyekjet tona kanë synuar që sa më shpejt të arrihen treguesit dhe standartet që Komuniteti Ndërkombëtar ka përcaktuar dhe kërkon në praktikë për mirëfunksionimin e institucioneve kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sikunder është edhe Avokati i Popullit. Tashmë, pas tre vitesh, me modesti deklarojmë se i kemi zbatuar këto parime, të cilat faktikisht janë edhe standarte të nivelit të lartë, mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i këtij institucioni kudo në botë.

Pas një “boom-i” që shënoi përhapja e këtij institucioni në mbarë botën, veçanërisht pas precedentit të suksesshëm të këtij institucioni në mjaft vende Europiane, Kanada e në Australi, Karta e të Drejtave të Njeriut e Bashkimit Europian, e miratuar në Samitin e Nisës në dhjetor 2000, në nenin 43, ka përcaktuar si kusht për t’u anëtarësuar në të, edhe ekzistencën e Institucionit të Ombudsmanit. Për rrjedhojë, përveçse ndikimit pozitiv në mirëqeverisje, ngritja dhe konsolidimi i Avokatit të Popullit në Shqipëri plotëson një kusht për pranimin në Bashkimin Europian.

Në këndvështrimin e instancave ndërkombetare, Ombudsmani dhe institucione të tjera të ngjashme përbëjnë elementin themelor të infrastrukturës së të drejtave të njeriut në një shoqëri demokratike. Në perspektivën e integritimit të vendit tonë në Bashkimin Europian, legjislacioni i Komunitetit është i detyrueshëm për secilin Shtet Anëtar. Prandaj ky legjislacion, edhe për kushtet e Shqipërisë, është burim reference edhe për institucionin e Avokatit të Popullit, sidomos për argumentimin e rekomandimeve tona dërguar administratës. Objektivi i përhershëm i Avokatit të Popullit është që të realizohet transparencja e Administratës publike, ashtu siç e kërkon ekologjia e demokracisë.

Në këtë drejtim, përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga synimet e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*. Ky nocion përmban administrim të mirë të pronës publike, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike para njerëzve që paguajnë taksa për ta mbajtur atë. Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij, mundohet të edukojë Administratën, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të kuptojë se arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj është të jetë shërbëtoare për t’u shërbyer qytetarëve që të realizojnë të drejtat e tyre.

Shërbimi i Avokatit të Popullit ndihmon që individëve t’u krijohen shanse të barabarta, që të mund të trajtohen si të barabartë në çdo

marrëdhënie me administratën. Kjo arrihet, kryesisht, në bazë të bisedimeve, të paanësisë dhe të standarteve më të gjëra të drejtësisë. Analiza e Ombudsmanit nuk kufizohet vetëm në atë që thonë shpesh dispozitat e thata ligjore. Përtej teknikës legjislative të formulimit të tyre, Ombudsmani shpesh herë shikon edhe qëllimet më të larta të ligjvenësit për të rregulluar raportet mes shtetit dhe individit. Veç kësaj, kjo kërkon edhe një angazhim shpirtëror dhe fisnik të të gjithë stafit të ekspertëve që punojnë me të. Përndryshe, shumë të drejta të shkelura të qytetarit, as nuk do të njiheshin si të tilla, aq më pak të rivendoseshin.

Veçori themelore e institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga qeveria dhe nga çdo ndikim politik, lehtësisë së kontaktimit, shpejtësisë dhe fleksibilitetit në kapjen e problemeve, është sidomos efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij. Theksojmë “forcën e rekomandimeve”, sepse dihet se, kur mungon forca detyruese, ajo që kushtëzon fitoren në çdo rast është forca argumentuese. Është pikërisht kjo “forcë argumentuese” e bazuar në ligj, ajo që e ka bërë shpesh rekomandimin e Avokatit të Popullit, nga formalisht “jo detyrues”, në thelb “bindës për t’u pranuar e për t’u zbatuar”.

Çdo zyrë ombudsmani në botë, sikundër edhe në Shqipëri, faktikisht ndeshet çdo ditë edhe me lloj lloj forme të rezistencës të organeve të administratës apo të autoriteteve publike. Kjo sepse, nga vetë natyra e tij, veprimtaria e Avokatit të Popullit presupozon edhe një lloj kontrolli ligjor. Për këdo tingëllon si diçka bezdisëse edhe kur bën pyetje, jo më kur e kritikon për veprimet e tij. Në kushtet tona, kur institucionet ende rezultojnë jo të mësuarat e të konsoliduara me ndërgjegjen e shtetit të së drejtës, kjo është edhe më e evidente. Por, nëse secili do të udhëhiqet nga parimi demokratik i pushteteve të limituara, mendojmë se ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për njëri tjetrin, ku bashkëpunimi të jetë sa më efikas. Autoritetet publike në nivel qendror dhe vendor duhet të jenë të kujdesshëm dhe kooperues me Institucionin e Avokatit të Popullit. Fakti që ligja i mundëson Avokatit të Popullit ngritjen e problemit si për kryetarin e komunës dhe për ministrin deri në parlament, tregon qartë se instrumenti ynë kryesor, që është Rekomandimi, kur ka brenda argumentin ligjor, ka edhe forcën reale të “imponimit” të butë. Në kushtet kur kjo bëhet me të vetmin qëllim, për të rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit në raport me administratën, rezultati merr edhe më shumë vlerë, sepse para se të jemi shtetarë, policë, prokurorë apo zyrtarë, të gjithë jemi qytetarë.

Si edhe në shumë vende të tjera, edhe administrata shqiptare nuk i ka shpëtuar psikologjisë dhe tendencës për të qënë e mbyllur, për të urdhëruar më tepër se sa për të dëgjuar dhe sqaruar qytetarët. Këtu qëndron një

drejtim tjetër i punës së Avokatit të Popullit, në përpjekje për ta bërë publikun të kuptojë se të drejtat e tij përbëjnë detyrim për administratën publike.

Në këtë mënyrë të funksionuari, edhe vetë fakti i ekzistencës së Institucionit të Avokatit të Popullit ka një ndikim pozitiv në administratë, së paku për një arsye të thjeshtë. Kjo e fundit e di se është një palë e tretë që e vëzhgon kryerjen e detyrës së saj në raport me qytetarin. Nga ana tjetër, ne kemi punuar dhe punojmë sipas një strategjie të veçantë që njerëzit ta dinë se mund të ankohen pranë nesh, përmes një procedure të lehtë dhe pa shpenzime, për ato vendime, veprime apo mosveprime të administratës, që i konsiderojnë të padrejta ose të pafavorshme për ta.

Avokati i Popullit ka deklaruar se nuk është një institucion akuze dhe as gjurmimi ndaj administratës publike në Shqipëri. Kritikata apo kërkesat tona për masa ndëshkuese ndaj punës së administratës apo zyrtarëve të veçantë, nuk përbëjnë qëllim në vetvete. Ne kritikojmë veprimet ose mosveprimet e administratës në rekomandimet dhe raportet tona, sikurse veprojnë ombudsmenët në të gjitha vendet. Qëllimi ynë nuk është për të punuar kundër institucioneve publike, as për të marrë meritat e punës së të tjerëve. Ne, ndoshta, ndikojmë që të tjerët t'i meritojnë këto “dafina”, nëse mund të ketë vend për të shpërndarë sot “dafina” për institucionet apo autoritetet publike në Shqipëri.

Në vendet e tjera është vënë re se si Ombudsmani që ka punuar mirë, ka mundur të ndryshojë pozitivisht imazhin e administratës në publik. Edhe tek ne, ky është objektivi ynë, të ndihmojmë për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësinë e vendimeve të saj dhe për përgjegjësinë ndaj publikut. Të mos harrojmë se qëndrimi që administrata mban ndaj ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj gabimeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t'i riparuar ato.

Jo pa qëllim përsërisim edhe në këtë raport të tretë vjetor se Avokati i Popullit në Shqipëri nuk është dhe nuk do të jetë asnjëherë në Opozitë me Qeverinë, pavarësisht se cilat forca politike do ta kenë atë. Ai është parashikuar të mirëfunksionojë gjithmonë si Oponencë për Mirëqeverisje. Ky është, ka qenë e do të jetë thelbi i filozofisë së funksionimit të këtij institucioni. Prandaj, veprimtaria jonë, ashtu si edhe deri tani, duhet mirëkuptuar e trajtuar me drejtësi nga të gjitha palët që bëjnë politikën në Shqipëri. Për të gjitha palët Ombudsmani është dhe do të jetë gjithmonë një ndihmës, tek i cili ekipet qeverisëse duhet të mbështeten, për të përmirësuar çdo ditë e më mirë qeverisjen që fitojnë përmes rotacionit të pushteteve. Me fuqinë dhe kompetencat që na njohin Kushtetuta dhe Ligji, të provuara

13

tashmë prej tre vjetësh në raportet tona me administratën, kemi krijuar bindjen se hallet e njerëzve, të shprehura në kërkesat dhe ankesat e tyre nuk njohin asnjë ngjyrë politike. Ato duan zgjidhje, që duhet t'u jepet nga të gjithë nëpunësit publikë që punojnë si në komunën më të largët të Shqipërisë e deri këtu në Parlament e në Qeveri.

PREZANTIMI I SHKURTER I RAPORTIT

Sipas nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 të Ligjit nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit paraqet në Kuvend një Raport Vjetor, i cili diskutohet në seancë plenare.

Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit është një ndër mjetet kryesore nëpërmjet të cilit ai mund të ndikojë për funksionimin e shtetit të së drejtës, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, forcimin e demokracisë, mirëadministrimin e punëve nga Administrata Publike dhe formulimin prej saj të politikave të zhvillimit të vendit.

Pas Raportit të parë të paraqitur në mars 2001 për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2000 dhe Raportit të dytë të paraqitur në mars 2002, për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2001, ky është raporti i tretë që përgatit Avokati i Popullit. Në mënyrën se si është konceptuar, mund të merret një informacion i plotë për metodën e përdorur dhe fushat e veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përfshirë dhe të dhëna statistikore. Një vend të veçantë në Raport zenë veprimtaritë e zhvilluara nga Institucioni, mbështetja ndërkombëtare, opinionet për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri si dhe opinione për përmirësimin e mirëadministrimit të çështjeve publike në Shqipëri. Gjithashtu vend të veçantë në Raport zënë dhe marrëdhëniet publike të Institucionit me Mediat. Bashkëpunimin me Mediat e kemi parë si mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik dhe krijimin e individualitetit të domosdoshëm të Institucionit, për ushtrimin e funksionit sipas Kushtetutës dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Ky raport ilustron punën e organeve dhe autoriteteve publike (përfshirë ato qëndrore dhe vendore) në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe prezanton zgjidhjet e rasteve, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfytes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme.

Raporti përmban gjithashtu rekomandime dhe propozime për eliminimin e të metave dhe “padrejtësive”, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit.

Në këtë Raport kemi përfshirë edhe shumë analiza të detajuara për ato raste dhe në ato fusha që sipas këndvështrimit tonë përbëjnë elemente kyç dhe të cilave në të ardhmen do t’u kushtojmë më shumë vëmendje.

KREU I PARË

1. E drejta e mirëadministrimit e Bashkimit European, baza ligjore e rekomandimeve të Avokatit të Popullit

Duke patur parasysh që Shqipëria këtë vit shënoi një arritje, madhore sikunder është hapja e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit me Bashkimin European, është e natyrshme që edhe veprimtaria e Avokatit të Popullit në Shqipëri të fokusohet në krijimin dhe ruajtjen e standarteve të larta të mirëqeverisjes dhe mirëadministrimit të punëve të shtetit.

Dinamikat sociale, politike dhe ekonomike të shtetit tonë në këto vite tranzicioni kanë kaluar nga procesi i Përqasjes Rajonale, që Europa aplikoi ndaj vendeve të Ballkanit, në Paktin e Stabilitetit dhe për të arritur sëfundit në hapjen e negociatave për t'u stabilizuar si vend, e pse jo edhe si rajon, për t'u asociuar deri sa të bëhemi një vend i gatshëm për të aderuar në këtë bashkësi.

Me vizionin se tashmë në demokraci, graviteti i kahjes së mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka ndryshuar nga shteti tek qytetari, Institucioni i Avokatit të Popullit synon që me precedentet e krijuar, qoftë edhe me zgjidhjen e ankesave më të thjeshta, të arrijë të krijojë tek qytetari bindjen se nëpunësi civil apo autoriteti publik tashmë paguhet nga taksat e tij për t'i shërbyer atij, pra qytetarit. Nga ky këndvështrim, sa qytetar, aq edhe politik, pozicioni social dhe mentaliteti i qytetarit shqiptar nuk ka se si të mos ridimensionohet dhe përafrohet me atë të qytetarit European.

Për sa me sipër, garanci janë Kushtetuta e re e vitit 1998, kuadri ligjor që derivon prej saj, përshtatshmëria e tyre me Konventat dhe Kartat Ndërkombëtare. Ngritja dhe funksionimi i institucioneve të reja, krahas atyre ekzistuese, reformimi dhe zhdërvjelltësimi i të cilave është dhe mbetet detyrë e vazhdueshme e çdo ekipi qeverisës, pavarësisht nga ngjyrat partiake.

Ndër hapat e parë është përafrimi i legjislacionit, për të arritur në adoptimin e një tërësie parimesh dhe politikash të traktateve, të legjislacionit parësor dhe dytësor, të detyrimeve ndërkombëtare, që parashikojnë, ndër të tjera, zbatimin e këtij rendi ligjor nga gjykatat

kombëtare, mundësisht sipas precedentëve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, e Strasburgut. Sa më sipër përben atë që quhet “*acquis communautaire*”, çka parakupton realizimet e mësipërme në rreth 34 fusha, sa të politikave të brendshme, aq edhe të asaj të jashtme, ekonomike, sociale e politike, ku në thelb të të cilave, mbetet zhvillimi dhe mbrojtja me përparësi e të drejtave të njeriut.

Kjo do të thotë se procesi i përafrimit me BE-në bashkëshoqërohet natyrshëm me një impakt disaplanesh, që pritet të ndikojë si në përjasjen e detajuar të legjislacionit kombëtar me atë të së drejtës Europiane, ashtu edhe me angazhimin praktik të administratës publike shqiptare për ta zbatuar atë me korrektësi. Dhe kjo vlen për të tre pushtetet, pa përjashtuar edhe marrëdhëniet e këtyre të fundit me institucionet e shoqërisë civile si dhe individët në raport me strukturat e shtetit të tyre.

Korpusi i deritanishëm ligjor në Shqipëri është produkt i angazhimit të juristëve shqiptare dhe asistencës dhe ekspertizës së marrë kryesisht nga vendet anëtare të Bashkimit Europian. Statusi i vendeve anëtare, me të cilat Shqipëria synon të bashkohet kushtëzon që, administrata shqiptare dhe sistemi i drejtësisë të krijojnë dhe respektojnë ato standarte të mirëadministrimit, që do të justifikonin përshtatjen e tyre me sistemin ligjor të BE-së në kushtet e anëtarësimit të plotë. Kjo parakupton që si ligjvënësi, (Kuvendi) ashtu edhe administrata dhe gjyqësori gjatë gjithë veprimtarisë së tyre të kenë parasysh dhe, kur është rasti, të zbatojnë konventat, kartat dhe standartet jo vetëm të Këshillit të Europës, por tashmë edhe të Bashkimit Europian.

Standartet e mirëqeverisjes që Bashkimi Europian ka përcaktuar për t’u arritur, bazohen në parime të tilla si, respektimi i lirisë, demokracisë, shtetit të së drejtës dhe i të drejtave të njeriut. Në pikën 7 të Deklaratës së Kopenhagenit të vitit 1993 kërkohet qartë “ngritja dhe respektimi i institucioneve kombëtare, garante të demokracisë”, sikundër është edhe Institucioni i Avokatit të Popullit (Ombudsmani). Mirëfunksionimi i Avokatit të Popullit parakupton ndikimin në mirëqeverisje, pikësëpari në mbështetje të parimeve që përmendëm më lart. Kjo merr një rëndësi edhe më të madhe, po të kemi parasysh që qëndrimi i administratës publike ndaj këtyre parimeve themelore është kusht si për t’u pranuar, ashtu edhe pezulluar nga të drejtat që të jep statusi i një shteti anëtar i BE-së.

Karta e të Drejtave të Njeriut të vendeve të Bashkimit Europian, e miratuar në Samitin e Nisës në dhjetor 2000 është teksti i parë zyrtar në botë në fushën e të drejtave të njeriut që sanksionoi zyrtarisht të drejtën e mirëadministrimit, si të drejtë themelore të njeriut. Përcaktimi në këtë Kartë i të drejtës së mirëadministrimit (neni 41), të drejtës së aksesit në

dokumentet zyrtare (neni 42), të Institucionit të Ombudsmanit (neni 43), janë një zhvillim i ri dhe i konsiderueshëm në zhvillimin e të drejtave të njeriut në gjirin e Komunitetit European.

Duke qenë pra se, tashmë, e drejta e një populli për t'u mirëqeverisur, konsiderohet si një nga të drejtat e njeriut, në shumë shtete, parimet e mirëadministrimit janë përmbledhur në mënyrë eksplicite në një Kod të Procedurave Administrative. Përmbajtja e këtij Kodi përfshin minimalisht disa parime, si: arsyetimi i vendimeve të marra; procedurat e drejta dhe e drejta e mbrojtjes; mënjanimi i diskriminimit; mbajtja parasyshe e të gjitha konsideratave që kanë lidhje me çështjen dhe përjashtimi i atyre që nuk kanë lidhje; ruajtja dhe mirëmbajtja e dokumenteve; mënjanimi i vonesave të panevojshme; sigurimi i informacionit në formë të qartë e të kuptueshme; dhënia e këshillave korrekte; zbatimi i rregullave dhe procedurave të vendosura; dhënia e informacionit për të drejtën për apelim ndaj një vendimi të pafavorshëm për qytetarin; njohja me, dhe përgjigjet ndaj letrave; dërgimi i letrave (ankesave) pranë organit ose shërbimit kompetent; të kërkuarit ndjesë për gabimet; funksionimi i një sistemi të përshtatshëm për të trajtuar ankesat etj.

Në vendet e Bashkimit European ky quhet Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative, kurse në Shqipëri quhet Kodi i Procedurave Administrative.

Eshtë e kuptueshme se nga zbatimi i këtij Kodi ka përfitime si për administratën, ashtu edhe për qytetarët, për më tepër se, sikundër shihet edhe më lart, ai përmban parime dhe dispozita tejet të sakta dhe konkrete. Duke i njohur zyrtarët ose punonjësit e shërbimit civil me këto parime dhe norma sjelljeje, rritet ndjeshëm cilësia e administrimit dhe shërbimit ndaj qytetarëve si dhe do të ruhet koherenca midis institucioneve të ndryshme. Për sa i përket qytetarëve, ata do të kenë një përparësi tjetër, atë të të bërit transparent të shërbimit publik, që ata gëzojnë të drejtën ta kenë nga kontrata sociale, që kanë nënshkruar me shtetin e tyre.

Sikundër del nga analizat që bëhen për kushtet që duhet të plotësojë Shqipëria në prag të procesit të parapranimit në BE, një ndër to ka qenë dhe mbetet ngritja dhe konsolidimi i Institucionit të Ombudsmanit.

Tashmë ky institucion është ngritur dhe funksionon që nga muaji Qershor 2000. Kjo parakupton ndikimin e tij në rritjen e ndjenjës së përgjegjesise të administrates publike shqiptare. Kjo do të thotë një administratë të hapur ndaj ndryshimit dhe reflektive ndaj rasteve te keqadministrimit, çka në përkufizimin e Ombudsmanit do te thote “mosveprim i organit publik në përputhje me rregullat dhe parimet e detyrueshme për te”. Nga ky kendveshtrim Avokati i Popullit ka detyrë të

futet në dialog me administratën, të bëjë kritikë konstruktive dhe të japë këshilla dhe rekomandime për rritjen e ndjenjës së përgjegjesisë së autoritetit publik.

Në raport me legjislativin, pritet që ky organ të pranojë rekomandimet e Avokatit të Popullit për ndryshime ligjore ose nisma të reja legjislative. Kjo kërkon një kuptim dhe pranim të rolit të Avokatit të Popullit, si nga ana e administratës publike, ashtu edhe nga Kuvendi (legjislativi), gjë që s'mund të arrihet menjëherë, por që ka rëndësi të madhe të kuptohet nga të gjitha palët. Në kushtet kur Institucioni i Avokatit të Popullit është përcaktuar në një farë mënyre si “dorë e zgjatur e Parlamentit”, ky mirëkuptim është edhe më i natyrshëm dhe i domosdoshëm.

Përfundimisht, duke përmendur në këtë raport edhe një konkluzion të Konferencës së 5-të për reformat ligjore në gjyqsorin shqiptar, e cila i zhvilloi punimet në Sarandë, gjatë muajit Shkurt 2003, lidhur me “mbështetjen e rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit për rritjen e aksesit të publikut në fushën e drejtësisë”, mendojmë se standartet që ne kërkojmë nga administrata do të mbeten gjithmonë të larta, pasi një nga burimet e së drejtës, mbi të cilën ne kemi bazuar e do të bazohemi edhe më fort në rekomandimet tona, është pikërisht e Drejta e Mirëadministrimit e Bashkimit Europjan.

2. Kushtetuta dhe ligji shqiptar “Për Avokatin e Popullit” reflektojnë dhe pasqyrojnë përvojën ndërkombëtare dhe Rekomandimet e këshillat e Komunitetit Ndërkombëtar për këtë Institucion.

Këshilli i Europës ka një përvojë afro 20-vjeçare pune me institucionet e Ombudsmanit. Komiteti i Ministrave ka nxjerrë Rekomandime dhe Rezoluta në vitet 1985 dhe 1997, që përmbajnë këto direktiva: Rekomandimi (85) 13 për emërimin e institucionit të ombudsmanit, kompetencat e tij dhe forcimin e pushteteve të ombudsmanit; Rezoluta (85) 8 për bashkëpunimin midis ombudsmanëve të shteteve anëtare dhe midis tyre dhe Këshillit të Europës; Rekomandimi (97) 14 për krijimin e institucioneve të pavarura për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe Rezoluta (97) 11 për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të shteteve anëtare si dhe midis tyre dhe Këshillit të Europës. Këto dokumente të Këshillit të Europës për Ombudsmanin tregojnë rëndësinë e këtij organi, të cilit i kanë dhënë

kompetenca për të shqyrtuar ankesat individuale për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut etj.

Gjatë këtyre 10 vjetëve të fundit, Këshilli i Europës i është përkushtuar tërësisht ngritjes dhe mbështetjes së institucionit të Ombudsmanit në shtetet e reja anëtare. Kjo mbështetje ka të bëjë si me hartimin e legjislacionit përkatës për këto institucione, ashtu edhe me dhënien e ekspertizës dhe të ndihmesës në zyrat e porsahapura. Ndër vendet ku ka dhënë ndihmë konkrete dhe projekte bashkëpunimi përfshihet edhe Shqipëria. Këshilli i Europës sot drejton bashkërendimin e Projekteve të Paktit të Stabilitetit në Europën Juglindore për institucionet kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe institucionin e Avokatit të Popullit në Shqipëri.

Ndër të tjera, Këshilli i Europës ka përcaktuar edhe kushtet e domosdoshme për të përvijuar tiparet kryesore të Institucionit të Avokatit të Popullit (Ombudsmanit).

Ato përbëhen, së pari, nga një bazë ligjore kushtetuese që të parashikojë ngritjen e funksionimin e Institucionit dhe zgjedhjen e kandidatit të përshtatshëm në një mjedis me pikëpamje politike të ndryshme, për t'i garantuar Ombudsmanit si pavarësinë, ashtu edhe patundshmërinë në detyrë, brenda mandatit kohor.

Së dyti, nevoja për ta pajisur Ombudsmanin me burime të mjaftueshme financiare për të kryer mandatin e vet.

Së treti, institucioni i Ombudsmanit nuk zëvendëson gjykatat, pra nuk është zëvendësues i një sistemi gjyqësor që duhet të jetë efektiv dhe i pavarur. Ai përbën një pjesë të makinerisë së të drejtave të njeriut, me të cilën duhet të pajisen të gjitha shtetet demokratike, duke mos mbajtur as anën e administratës e as atë të individit, por duke punuar për kulturën e mirëqeverisjes dhe për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut.

Në një shoqëri, ku funksionon shteti i së drejtës, gjykatat mbeten natyrshëm mjeti kryesor për mbrojtjen e të drejtave të individit. Ombudsmani ose Institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion jogjyqësor, diçka ekstra, që i ndihmon qytetarët, kur këta të fundit ndeshin vështirësi në raportin e tyre me administratën.

Sipas nenit 60 të Kushtetutës dhe nenit 2 të ligjit përkatës, Avokati i Popullit në Shqipëri mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ose të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Pra juridiksioni i tij përfshin Qeverinë, ministritë, institucionet e tjera qëndrore siç janë Komitetet shtetërore të Kthimit të Pronave etj; Shërbimet Sekrete, Bankën Kombëtare dhe Bankat me pjesëmarrje kapitali shtetëror

etj; organet e pushtetit lokal ku përfshihen Prefekturat, Qarqet, Bashkitë dhe Komunat si dhe ato institucione apo autoritete publike që veprojnë për llogari të këtyre organeve të administratës publike dhe institucionet në varësi të tyre në qëndër dhe rrethe. Ashtu si ligjet e mjaft shteteve të tjera që e kanë këtë institucion, edhe ligji shqiptar nuk i ka dhënë Avokatit të Popullit fuqi vendimmarrëse në raport me organet e administratës, por vetëm të drejtën e rekomandimeve përkatëse. Kjo nuk do të thotë se Avokati i Popullit nuk ka mjete për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njerëzve. E drejta e tij për t'i ndjekur çështjet shkallë-shkallë, sipas hierarkisë së administratës, deri në dërgimin e çështjes në Kuvend, si dhe transparenca, në punën e tij, bashkëpunimi i ngushtë me O.J.F.-të dhe Median garantojnë suksesin në detyrën që i është caktuar atij.

Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij. Kjo pavarësi shprehet në disa elemente si: Mospasja e lidhjeve të varësisë me Institucionet e tjera Kushtetuese të vendit si Presidenti, Qeveria, Gjykatat etj; qenia jashtë politikës, jashtë partive dhe veprimtarive të tyre politike, disponimi i një buxheti të veçantë, përzgjedhja prej Avokatit të Popullit e Komisionerëve dhe ndihmësve të tyre brenda një strukture dhe organike të përcaktuar prej atij vetë, përcaktimi i Rregullores së Brendëshme, Kodit Etik etj. Është e rëndësishme dhe vlen të raportohet se kjo pavarësi ka qenë dhe është reale, tipike, për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe pavarësisht nga kritikrat e shprehura apo të pashprehura publike, kjo pavarësi nuk do të lejohet të cënohet nga ndikimi i asnjë force politike apo Institucioni tjetër shtetëror.

Çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare që pretendojnë se të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme, u janë shkelur nga një akt, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës qëndrore e vendore apo të ndonjë organi tjetër të veshur me autoritet publik, mund të paraqesin ankesa, kërkesa apo njoftime tek Avokati i Popullit për shqyrtimin e çështjes. Ai mundet gjithashtu që, për raste të veçanta të bëra publike, të fillojë procedurën e shqyrtimit me nismën e vet, por gjithmonë duhet të marrë më pas pëlqimin e të interesuarit apo të dëmtuarit.

Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga organet e Administratës çdo informacion apo dokument që lidhet me çështjen që ndjek, ose të kryejë hetime të pavarura në vend, të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin e tij, të marrë në pyetje çdo person, që sipas tij, është i lidhur me çështjen në hetim ose të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.

Ai ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste ai është i detyruar të

respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror. Avokati i Popullit s'mund të ndalohej të hyjë në çdo zyrë të organeve të administratës të përmendura më sipër; në burgjet dhe vendet e tjera të paraburgimit ose institute të tjera ku të drejtat e individëve janë të kufizuara. Ai gjithashtu s'mund të ndalohej të bisedojë privatisht me personat që mbahen në këto institute. Këto të drejta dalin nga interpretimi i Kushtetutës dhe ligjit "Për Avokatin e Popullit" si dhe nga praktikat ndërkombëtare të punës së Ombudsmanit, por do të ishte mirë që, në rast të plotësimit të ligjit "Për Avokatin e Popullit", të vendosen shprehimisht në këtë ligj, për të mos ngjallur shfaqjet e keqinterpretimeve dhe vendosjes së kufizimeve të padrejta për Institucionin tonë.

Sipas nenit 22 të ligjit, organi të cilit Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ.

Në rast se Avokati i Popullit nuk i quan të mjaftueshme përgjigjet ose masat e ndërmarra nga organi, ai ka të drejtë ta ndjekë çështjen tek organi më i lartë në hierarki. Në rastet e përsëritura, si dhe kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet edhe Kuvendit me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legjislative, është një mjet shumë i rëndësishëm dhe efektiv për të ndaluar shkeljen e të drejtave të njeriut.

Kur Avokati i Popullit vëren, se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ai ka të drejtë:

- t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;
- t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore;
- t'i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla.

Institucioni i Avokatit të Popullit i jep rëndësi të veçantë kontakteve me ankuesit, pasi ai është krijuar për të ndihmuar në zgjidhjen e nevojave të individëve. Detyra e tij është të parandalojë apo të zbulojë shkeljet e të drejtave dhe lirive të individit, me qëllim ndreqjen e pasojave që rrjedhin

nga e drejta e shkelur. Megjithatë është shumë e rëndësishme që ky Institucion të jetë i hapur dhe i gatshëm për këdo që kërkon ndihmë nga ai. Çdo qytetar shqiptar ose i huaj mund të vijë në çdo kohë gjatë orarit zyrtar nga ora 8⁰⁰ deri 16⁰⁰ dhe të kontaktojë me një punonjës të Zyrës, i cili merr dhe jep informacion. Avokati i Popullit dhe Komisionerët organizojnë takime me të interesuarit, sipas rastit. Për ankesa, kërkesa, shpjegime, këshilla dhe informacion në fushën që paraqitet ankimi tashme është vendosur një linjë telefonike pa pagesë, duke ua mundësuar këtë sidomos të burgosurve, të ndaluarve apo të arrestuarve.

Qytetarët mund t'i drejtohen Avokatit të Popullit në mënyra të ndryshme. Sipas procedurës që kemi caktuar, ankesa i paraqitet Avokatit të Popullit me shkrim. Në raste urgjente, ankesa mund të bëhet dhe me telefon por, shumë shpejt ajo duhet të paraqitet edhe me shkrim, pasi në të kundërt procedura për shqyrtimin e çështjes ndërpritet. Nuk pranohen ankesa ose kërkesa anonime.

Në rastet, kur ankesa e paraqitur nuk është e plotë, pasi i mungojnë dokumentet e nevojshme, Avokati i Popullit kërkon që ajo të plotësohet ose bën kërkitime të drejtpërdrejta tek organi, ndaj të cilit është bërë ankesa, kur një gjë e tillë është e dukshme në ankesë. Në shumë raste, biseda me ankuesin është e nevojshme për t'a paraqitur siç duhet rastin që shqyrtohet, veçanërisht kur ai është i komplikuar dhe kërkon shumë shpjegime.

Avokati i Popullit dhe stafi i tij zhvillojnë takime edhe jashtë zyrës së tij, në rrethe të ndryshme të vendit. Emërimi i përfaqësuesve të Avokatit të Popullit nëpër rrethe është një mundësi, që ne kemi planifikuar ta realizojmë këtë vit në Shkoder dhe në një rreth tjetër.

Disa nga ankesat e paraqitura mund të mos jenë në juridiksionin e Avokatit të Popullit, ose mund të mos përmbushin kushtet për t'u trajtuar nga zyra e Avokatit të Popullit. Në raste të tilla, ankuesi do të marrë përgjigjen e Avokatit të Popullit sa më shpejt që të jetë e mundur, brenda afatit 1 muaj, duke e këshilluar atë se çfarë lipset të bëjë, cilat janë mundësitë që i kanë mbetur akoma, ose cilat janë mjetet ligjore që duhet të përdoren përpara se ankesa të trajtohet nga Avokati i Popullit.

Si rregull, fillimisht Avokati i Popullit u dërgon organeve përkatëse një përshkrim të shkurtër të problemit të ngritur, dhe kërkon shpjegime të hollësishme rreth tij. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit fikson dhe afatin, brenda të cilit pret përgjigje nga organi të cilit i është drejtuar kërkesa. Ky afat varet nga urgjenca e problemit dhe nga shkalla e vështirësisë së tij. Megjithatë, afati nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë. Nganjëherë, kur natyra e problemit të paraqitur është e tillë, sa afati kohor

nuk mund të zgjasë shumë, Avokati i Popullit mund të bëjë verifikimet e tij nëpërmjet telefonit ose faxit.

Pas kryerjes së hetimit për një çështje të caktuar, Avokati i Popullit përpilon një raport për çështjet dhe konkluzionet e arritura, dhe mund t'ua paraqesë atë palëve që kanë të bëjnë me çështjen. Ky raport përmban gjykimin e Avokatit të Popullit mbi faktet dhe rrethanat e çdo rasti, duke treguar se cilat nga të drejtat dhe liritë e individit janë shkelur, si janë shkelur ato dhe cilat janë personat përgjegjës që kanë kryer shkeljet. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit mund të propozojë rrugën për të rivendosur të drejtën e shkelur. Ai, gjithashtu, mund të propozojë kompensime përkatëse për dëmin e shkaktuar individit nga shkelja e së drejtës që i është bërë. Avokati i Popullit mund të kërkojë që, organi që ka kryer shkeljen e së drejtës së individit, t'i kërkojë këtij të fundit falje për veprimin e kryer.

Avokati i Popullit i paraqet çdo vit Kuvendit një raport vjetor për punën e tij. Një kopje e këtij raporti i dërgohet Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave. Ky raport që keni në duar përmban veprimtarinë e Institutionit tonë nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor 2002.

Raporti vjetor dhe raportet e veçanta bëhen publike dhe duhet të botohen jo më vonë se një muaj nga data e diskutimit në Kuvend. Një kopje e tij në Anglisht publikohet dhe u shpërndahet nga zyra e Avokatit të Popullit institucioneve homologe të vendeve të huaja si dhe institucioneve ndërkombëtare që kanë lidhje me këtë Institution.

Duke patur parasysh se çfarë parashikon legjislacioni shqiptar, duke patur parasysh edhe përputhshmërinë e këtij të fundit me legjislacionin European, duke patur parasysh edhe angazhimet e marra nga Shqipëria për t'u asociuar dhe integruar në Bashkimin European, Avokati i Popullit gjen rastin të rikujtojë si gjithmonë obligimin e administrates publike shqiptare për të bashkëpunuar dhe mirëkuptuar çdo rekomandim të Avokatit të Popullit, tek i cili individët mund të drejtohen me ankesat e tyre, zgjidhja e drejtë e të cilave, në fund të fundit, rrit besimin e qytetarit tek shteti i tyre.

Vëmë në dukje se kohët e fundit ka praktika për të përmirësuar më tej legjislacionin në drejtim të forcimit të rolit të Ombudsmanit, si institucion garant për demokracinë, sidomos në vendet ish socialiste, ku edhe problemet për shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë më të rënda. Institucioni ynë po i studjon këto praktika dhe legjislacionet përkatëse, me synimin që çdo gjë pozitive që i shërben veprimtarisë së tij, të implementohet edhe në Shqipëri.

3. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit

Parimi i pavarësisë është një nga parimet bazë të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit. Prandaj vetë ligji “Për Avokatin e Popullit”, i jep Ombudsmanit të drejtën e përcaktimit të strukturës, numrit të personelit, cilësitë specifike të stafit të tij si dhe shpërblimin e tyre brenda buxhetit vjetor të miratuar nga Parlamenti.

Zyra e Avokatit të Popullit funksion me tre seksione të specializuara, sipas përcaktimit që ka bërë neni 31 i ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Seksioni i parë merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe drejtohet nga z. Agron Çausi.

Seksioni i dytë merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor dhe drejtohet nga z. Jorgo Dhrami.

Seksioni i tretë, ose seksioni i përgjithshëm, trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky drejtohet nga zj. Florina Nuni.

Veç këtyre tre seksioneve, hallkë tjetër e rëndësishme e strukturës është edhe Kabineti në përbërje të të cilit janë shefi i kabinetit dhe 2 këshilltarë. Kabineti është në vartësi dhe ndihmon direkt Avokatin e Popullit për të kryer si duhet detyrat e tij të shumta. Hallkat ndihmëse që ndihmojnë për realizimin e detyrave kryesore të Institucionit janë drejtoria e personelit dhe e administratës, drejtoria e marrëdhënieve me jashtë, sektori i pritjes dhe regjistrimit të ankesave, sektori i administratës, sektori i financës, sektori i informatikës, sektori i sekretarisë dhe arkivës, të cilat janë në vartësi të Sekretarit të Përgjithshëm z. Gëzim Lleshi.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka gjithësej 47 punonjës, numër ky i miratuar nga vetë Avokati i Popullit në zbatim të nenit 35 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”. Nga këta 20 juristë përfshirë edhe vetë Avokatin e Popullit, merren direkt me zgjidhjen e ankesave. Duke patur parasysh numrin e madh të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve 4675 të ardhura gjatë vitit 2002, në raport me 2826 në vitin 2001, është fakt se i gjithë stafi ka patur mbingarkesë në punë. Në qoftë se edhe gjatë vitit 2003 do të ketë rritje të numrit të ankesave dhe kërkesave, del si domosdoshmëri që në buxhetin e vitit 2004 të kërkojmë rritje të fondit të pagave, me qëllim që të rritim numrin e specialistëve që bëjnë këtë detyrë. Sidoqoftë kjo kërkesë do të bëhet e studjuar dhe e argumentuar, pasi të kemi krijuar bindje të plotë se

nuk do të ketë rrugëzgjdhje të tjera për të përballuar volumin e punës me cilësi të lartë. Kemi konstatuar se për vitin 2002 por edhe për vitin 2003 Ministria e Financave, pa të drejtë i ka propozuar Qeverisë që në Vendimin e saj që përcakton numrin e gjithë punonjësve buxhetorë të shtetit, për Institucionin tonë të shënojë 45 veta. Kjo është shkelje e nenit 35 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, plotësuar me ligjin nr.8600, datë 10.04.2000 “Për Avokatin e Popullit” ku thuhet se: “Struktura dhe organika e zyrës së Avokatit të Popullit editohet nga Avokati i Popullit”. Prandaj ka mundësi që këtë problem ta bëjmë çështje në Gjykatën Kushtetuese sepse cënon parimin kushtetues të pavarësisë së Avokatit të Popullit.


Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të zyrës sonë, vemë në dukje se Avokati i Popullit mban titullin Profesor i Asociuar dhe Doktor, kurse Komisioneri Jorgo Dhrami mban gradën “Doktor i Shkencave Juridike”. Veç këtyre, 4 të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë apo në Shkollën e Magjistraturës.

Nga 34 specialistë me arsim të lartë që ka Institucioni, disa prej tyre kanë kryer studimet pasuniversitare në Perëndim, kurse 20 prej tyre zotërojnë dhe përdorin lirshëm një ose më shumë gjuhë të huaja. Kjo ka krijuar mundësinë që Institucioni ynë të ketë mundësi për të përfituar më shumë nga përvoja bashkëkohore gjithnjë e në rritje.

Megjithatë nga shtatori 2002 deri në korrik 2003 vazhdon kursi i gjuhës angleze, i cili zhvillohet jashtë orarit zyrtar për nivelin fillestar dhe dhe të mesëm për të gjithë punonjësit e Institucionit që nuk dijnë anglisht, përfshirë edhe personelin e mesëm. Krahas kursit të gjuhës angleze, zhvillohet edhe ai i gjuhës frënge me dëshirën dhe shpenzimet e të interesuarve.

Në sajë të mundësive që ka krijuar Këshilli i Europës, projekti i qeverisë Daneze Danida, qeveria Suedeze dhe ajo Franceze, institucioni ynë ka përfituar nga trajnimet e ndryshme të stafit gjatë vitit 2002, për të cilat flitet me hollësi në kapitullin e marrëdhënieve me jashtë të Institucionit tonë.

STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT



ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
I.	AVOKATI I POPULLIT	(1)
II.	KABINETI Shefi i Kabinetit Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	(4) 1 2 1
III.	SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	(6) 1 4 1
IV.	SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(8) 1 6 1
V.	SEKSIONI I PËRGJITHSHËM Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(6) 1 4 1
VI.	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	(1)
VII.	DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË Drejtor Përgjegjës i sektorit të përkthimit dhe bibliotekës	(2) 1 1
VIII.	DREJTORIA E PERSONELIT DHE ADMINISTRATËS Drejtor Shef Sektori Shofer Pastrues	(11) 1 1 7 2
IX.	SEKTORI I FINANCËS Shef Sektori Llogaritar i parë, Arkëtar Magaznier	(3) 1 1 1
X.	SEKTORI I PRITJES SE POPULLIT Shef Sektori Ndihmeskomisioner	(2) 1 1
XI.	SEKTORI I INFORMATIKES Shef Sektori	(1) 1
XII.	SEKTORI I SEKRETARISE DHE ARKIVIT Shef Sektori Arkivist+sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	(2) 1 1

Punonjës gjithsej të Institucionit të Avokatit të Popullit janë 47 veta.

4. Krijimi dhe vënia në funksionim e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri

Në zbatim të Rekomandimeve të Këshillit të Europës dhe sipas modelit të mjaft shteteve Europiane, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, parashikoi krijimin e një Institucioni të veçantë që do të merrej me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve – Avokatin e Popullit. Roli dhe funksioni i tij u përcaktuan në Ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Në 16 shkurt 2000, Parlamenti Shqiptar, zgjodhi Avokatin e Popullit, z. Ermir Dobjani. Prej tij u propozuan 3 komisionerët. Në datën 30 mars 2000 u zgjodhën si komisionerë Agron Çausi, Florina Nuni dhe Jorgo Dhrami. Më datën 10 Prill 2000, Kuvendi miratoi një shtesë në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”, me anë të së cilës, Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë strukturën dhe organikën e institucionit. Kjo shtesë e ligjit i shërbeu forcimit të pavarësisë së Institucionit. Pas kësaj, për vënien në funksion të Institucionit, u përcaktua struktura dhe organika. Në përputhje me Ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, në Qershor-Korrik të vitit 2000 u organizua dhe përfundoi konkursi dhe procesi për marrjen në punë të specialistëve, që quhen ndihmëskomisionerë si dhe personelit tjetër ndihmës.

Me qëllim që Institucioni të ndërtohej e funksiononte mbi baza ligjore, u hartuan dhe u miratuan Rregullorja e Brendshme dhe Kodi Etik i Institucionit të Avokatit të Popullit. Ndonëse fillimisht kushtet dhe ambientet e punës ishin të pamjaftueshme e të papërshtatshme, nisëm nga puna në Qershor 2000, për verifikimin dhe zgjidhjen e ankesave. Mbi bazën e një strategjie të saktë, mbasi identifikuam nevojat, pa humbur kohë u bë rehabilitimi fizik i ambienteve, i cili filloi në fund të nëntorit 2000 dhe përfundoi në shkurt të vitit 2001.

Krahas rehabilitimit dhe paisjeve të zyrave, u mendua dhe për ngritjen, stabilizimin dhe konsolidimin e sistemeve administrative e menaxhuese të institucionit, vendosjen e politikave e procedurave lidhur me shërbimin kundrejt ankuesve, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kualifikimin e tyre të mëtejshëm. Në këtë kuadër, në Zyrën tonë ka përfunduar implementimi i një sistemi modern menaxhimi të rasteve (DOCULIVE), nëpërmjet të cilit mundësohet që informacioni i nevojshëm për çështjet e ankuesve, të regjistrohet në kompjuter. Sipas një procedure që nënkupton një soft të caktuar, informacioni i regjistruar nga personat në

proces, ka mundësi të shkëmbehet, kontrollohet e raportohet nëpërmjet kompjuterave.

Me anë të këtij sistemi të punës, në vitet në vazhdim, do të jetë i mundur një menaxhim efektiv i kohës së punës, lehtësim dhe orientim i drejtpërdrejtë në morinë e madhe të çështjeve të ankuesve të paraqitura në Zyrën tonë. Ky sistem i vendosur ka siguruar një mirëfunksionim të Institucionit dhe garanton një nivel në rritje të shërbimeve ndaj ankuesve nga Zyra.

Në vijimësi punohet për hartimin pjesë pjesë të një manuali të politikave dhe procedurave të Zyrës, në të cilin përshkruhet misioni i Institucionit, strukturat përkatëse organizative, menaxhuese e administrative, termat e referencës së tyre, politikat e Zyrës për personelin, trajnimet e përfitimet përkatëse, politikat në lidhje me ankuesit, standartet e përgatitjes së dokumentacioneve përkatëse, procedurat e përdorimit të teknologjisë së Zyrës etj. Proçesi zgjat në kohë për shkak të kolaudimit të tij me praktikat e reja që dalin çdo ditë para zyrës, si dhe konsulencës së huaj.

Krahas kësaj, për të bërë të mundur njohjen në shoqërinë shqiptare të rolit të Avokatit të Popullit, për të bërë publik informacionin e grumbulluar, dhe për të analizuar zgjidhjet e rekomandimet përkatëse si dhe për gjetjen e mënyrave e mjeteve të duhura për promovimin e përmirësimeve në legjislacion, është hartuar dhe po zbatohet me sukses një strategji e marrëdhënieve me publikun (marketing & lobbying). Po kështu, u hartuan dhe strategjitë lidhur me veprimtari të tjera me karakter edukues për komunitetin dhe politika të influencimit, duke përfunduar fazën e ngritjes dhe forcimit të Institucionit. Në funksion të kësaj u konceptua dhe realizua një rrjet promocional që përfshin një komunikim viziv të ri, me qëllim që të zgjerohet kapaciteti i përfitimit të njohurive të publikut të gjerë në lidhje me rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Kështu bëhet më i mundur krijimi i një kontakti më të ngushtë të Institucionit të Avokatit të Popullit me Administratën dhe publikun, në një kuadër reciprok. Në vijim të këtij qëllimi, gjatë vitit 2002, u organizuan “ditët e hapura” në shumë qytete të vendit.

Institucioni ynë synon që të shërbejë për një zgjidhje profesionale, të shpejtë e objektive të ankesave që parashtrihen tek ai. Kështu që përveç ngritjes, stabilizimit, forcimit e menaxhimit efektiv të kapaciteteve administrative në Institucion, vëmendje prioritare i është kushtuar rritjes së besimit të tij në popull nëpërmjet shërbimit që ofrojmë.

5. Mbështetja ndërkombëtare

Një rëndësi të veçantë ka patur mbështetja ndërkombëtare e Institucionit, i cili ka qenë nën mbikqyrjen e afërt dhe koordinuese të OSBE, me asistencën e vazhdueshme të Këshillit të Europës, Grupit të Miqve të Avokatit të Popullit si dhe nën mbështetjen financiare të Mbretërisë së Danimarkës. Kjo mbështetje ka qenë konkrete, tepër e pranishme dhe mjaft efiçente. Në grupin e quajtur Miqtë e Avokatit të Popullit, bëjnë pjesë Përfaqësitë e Këshillit të Europës dhe të OSBE në Tiranë, Ambasadat e Mbretërisë së Danimarkës dhe të SHBA, organizata si USAID, Banka Botërore, ABA-CEELI, CAFOD, QSHDNj etj.

Grupi i Miqve të Avokatit të Popullit, në mënyrë periodike është mbledhur në zyrën e Avokatit të Popullit dhe qysh nga fillimi ka ndjekur hap pas hapi ngritjen, forcimin, konsolidimin dhe veprimtarinë praktike të Institucionit, duke dhënë një ndihmë e kontribut të çmuar për mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore si dhe forcimin e demokracisë në vendin tonë. E themi këtë, sepse duke ndihmuar Institucionin tonë, në mënyrë direkte ata, institucionet dhe shtetet që përfaqësojnë, kanë ndihmuar proceset demokratike dhe institucionet e reja që janë garante të demokracisë.

Këshilli i Europës, si me anë të personelit të zyrës së tij në Shqipëri, ashtu edhe direkt ka dhënë një kontribut të madh, nëpërmjet ftesave për të marrë pjesë në aktivitete të organizuara me temë të drejtat e njeriut, dërgimit të ekspertëve për ekspertiza, mbështetjes financiare etj. Kontribut në këtë drejtim ka dhënë edhe Aba Celli, si dhe Ambasada Amerikane, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Grupin e Miqve. Natyrisht, mbështetjen më të madhe financiare e ka dhënë dhe vazhdon ta japë Mbretëria e Danimarkës. Kontribut të madh ka dhënë Këshilltari i Ambasadës Daneze, zoti Soren Knudsen. Zyra e Ombudsmanit Danez ka gjithashtu kontributin më të madh në asistencën e saj për dhënien e përvojës dhe trajnimin e stafit tonë.

Kemi përmendur edhe në raportet e viteve të kaluara ndihmën vendimtare të Ambasadës së Mbretërisë së Danimarkës në vendin tonë, e cila nëpërmjet projektit Danida, në kuadër të marrëveshjes së dy qeverive tona, të nënshkruar në Kopenhagen në korrik 1999, ka përballuar një pjesë të madhe të kostos financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri. Këshilli i Europës, nga ana e tij ka vazhduar të shprehë angazhimin e vet për mbështetjen financiare dhe me ekspertize të institucionit tonë.

Grupi i Miqve ka luajtur rolin e tij mjaft pozitiv, edhe në planin politik, për të ndihmuar, monitoruar dhe vlerësuar institucionin tonë qysh në hapat e para, rol i cili është mirëpritur dhe vlerësohet nga ana jonë. Tashmë me konsolidimin e Institucionit nevoja e Grupit ndjehet shumë më pak, prandaj edhe mbledhjet e tij kanë qënë më të ralla.

6. Buxheti i Institucionit për vitin 2002

Për të krijuar dhe funksionuar me efikasitet një institucion i ri siç është Avokati i Popullit, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale, potenciale njerëzore, por dhe mbështetje financiare.

Nga kjo pikëpamje, mbështetja financiare për Institucionin tonë nga Komuniteti Ndërkombëtar dhe pikërisht nga qeveria Daneze nëpërmjet projektit Danida ka qënë prezente, konkrete dhe mjaft efektive. Kjo ndihmë ka mundësuar ngritjen dhe forcimin e Institucionit dhe krijuar mundësite për realizimin e detyrave. Por, në këtë veshtrim një konceptim i drejtë është shprehur edhe nga shteti Shqiptar. Për vitin 2001 na është dhënë nga buxheti i shtetit shuma 83.567.000 lekë ose 584.385 USD, ndërsa për vitin 2002 na është dhënë nga buxheti shuma 85.194.000 lekë ose 608.528 USD. Ky buxhet për vitin 2002 objekt raportimi është konsumuar në masën 95%.

Nr. Llog.	Emërtimi	Plan lekë	Realizim lekë	Realiz. %
600	Pagat	39.000.000	38.999.798	100 %
601	Sigurim shoqëror	5.994.000	5.843.433	97.5 %
602	Shp operative	31.000.000	30.621.953	98.7 %
605	Kuotë anëtarësie	200.000	178.129	89 %
231	Investime	9.000.000	5.169.826	57.4 %
	Totali	85.194.000	80.812.222	95 %

Përsa i përket shpenzimeve të buxhetit ato janë përdorur për paga punonjësish, dieta brenda dhe jashtë vendit, blerje kancelerie, karburanti, riparim automjetesh, shpenzime për energji elektrike, impulse telefoni, pritje të delegacioneve të huaja etj.

Në lidhje me kuotat e anëtarësisë ne bëjmë pagesën në Institutin Europian të Ombudsmanëve (EOI), Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), Shoqatën e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë (SHOMF). Kjo pagesë në total është 1.232 USD në vit ose 178.129 lekë.

Nëpërmjet financimeve të projektit Danida të Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës gjatë vitit 2000 dhe 2001, institucioni i Avokatit të Popullit ka përfunduar rikonstruksionin e zyrave, blerjen e pajisjeve për zyrat dhe ato kompjuterike, blerjes së sistemit DOCULIVE si dhe ka përballuar specializime tekniko profesionale të stafit. Vlera totale e ndihmës Daneze deri në fund të vitit 2001 ka qënë rreth 400.000 USD.

Gjatë vitit 2002 e në vazhdim projekti Danida ze vlerën 119.000 USD. Kjo shumë është përdorur për organizimin e Konferencave Kombëtare, seminareve të ndryshme, trajnime profesionale të stafit, materiale propagandistike (kalendare, postera, fletë palosje), botimi i raportit vjetor 2001, pagesa të internetit, mirëmbajtje të pajisjeve elektronike etj. Financimet e projektit Danida përfundojnë në fund të vitit 2003.

Për vitin 2003 na është miratuar buxheti në shumën totale 86.889.000 lekë ose rreth 665.000 USD.

Por në këtë buxhet nuk na u plotësua një kërkesë e rëndësishme. Siç jeni në dijeni, nga raportimet që kemi bërë para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në mars 2001 dhe mars 2002, kemi synuar si zgjidhje pozitive, për t'ju afruar sa më tepër qytetarëve që kanë nevojë, edhe caktimin e përfaqësuesve tonë vendore në Shkodër e Gjirokastrë. Këtë inisiativë e kemi të bazuar ligjërisht në nenet 32 dhe 35 të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Për vitin 2002 kjo inisiativë nuk u realizua si për mungesë të fondit të pages, ashtu edhe për mos korrektesë të pushtetit vendor në këto qytete, të cilët nuk plotësuan detyrimin që kanë sipas ligjit për të na venë zyrë në dispozicion për përfaqësuesit që ne do caktojmë.

Në dhjetor 2002, gjatë diskutimeve në komisionin e Financave dhe në komisionin e Ligjeve të Kuvendit për projektbuxhetin e vitit 2003 besuam se problemi i buxhetit të nevojshëm për pagat e përfaqësuesve vendore, rreth 3.6 milionë lekë, u zgjidh. Kjo përshtypje u krijua pas diskutimeve në komisionet e mësipërme, sepse u votua nga deputetet (anëtare të komisioneve) dhe ju tha z. Gjergj Teneqexhiu dhe zj. Mimoza Dhembë (përfaqësuesve më të lartë të Ministrisë së Financave) që ishin të pranishëm që të bëjnë ndryshimet përkatëse për t'u shtuar në projektin e paraqitur prej tyre kjo shumë.

Për çudi, në janar 2003 na vjen nga Ministria e Financave buxheti i miratuar, ku jo vetëm nuk është bërë shtesa prej 3,6 milion lekë, por ishin shkurtuar edhe 3,790 milion lekë nga zeri i mallrave dhe shërbimeve.

Situata e mësipërme, të krijon përshtypjen se nuk vendosin përfaqësuesit e popullit, por aparatçikët e Ministrisë së Financave. Prandaj

më lejoni t'ju informojmë se inisiativa jonë nuk mund të zbatohet pa fondin e nevojshëm të pages. Një zgjidhje mbase mund të jetë në qoftë se nga Komisionet tuaja do t'i rekomandohet Ministrise se Financave që të përgatitë një projektvendim, me qëllim që Qeveria të akordojë buxhetin e kërkuar nga fondi i saj rezerve. Në strategjinë e të gjitha institucioneve ndërkombëtare që japin ndihma theksohet qartë se në këto ndihma nuk përfshihen pagesa në formë page për personelet e institucioneve shtetërore. Kështu që, pavarësisht nga ndihma e madhe financiare që ka dhënë e mbase do vazhdojë të jape komuniteti ndërkombëtar për Institucionin tonë, përjashtohet mundësia e pagesës së shtesave të personelit nga donatorët e huaj.

7. Vështirësitë e Institucionit dhe shkaqet e tyre

Në kushtet e pastabilitetit relativ institucional në vendin tonë, edhe Zyra e Avokatit të Popullit, është e kuptueshme, që ndeshet me vështirësitë e veta. Këto vështirësi janë të kushtëzuara sa nga mungesa e përvojës së mëparshme institucionale, aq edhe me problemet që lindin nga përvoja jonë e cila synon të ndikojë në përmirësimin e skemave të vjetra të performancës administrative në institucionet tradicionale.

Fakti i të qenit në një farë mase sfidues të vendimeve të administratës publike kushtëzon një vështirësi tjetër për efikasitetin tonë në mireqeverisje. Në këto kushte, jo vetëm zyra e Avokatit të Popullit në Shqipëri, por çdo zyrë Ombudsmani në botë, herë pas here ndeshet me vështirësi e me një farë rezistence nga ana e organeve të administratës publike.

Por si dhe ku shfaqen këto vështirësi?

1. Rritja e besimit të publikut tek institucioni i Avokatit të Popullit nuk është në përpjestim të drejtë me rritjen e ndërgjegjësimit të administratës publike për rëndësinë që ka në vetvete zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Rrjedhimisht, kemi një rritje të ndjeshme të numrit të rasteve, kur organe apo autoritete të administratës publike, sidomos ato lokale kanë hezitur ose janë vonuar në kthimin e përgjigjes për ne.

2. Rritja e ngarkesës së punës vetvetiu ka pakësuar kohën e nevojshme fizike të investimit profesional të stafit tonë mbi një rast të vetëm. Kjo mbart në vetvete rrezikun e formalizimit në trajtimin e rasteve si dhe një mosndjekje të tyre me përkushtim deri në fund.

3. Fanatizmi juridiksional nga disa segmente të administratës publike, që shfaqet në mosbashkëpunimin e pritshëm të tyre me ekspertët e Avokatit të Popullit.
4. Mosndërgjegjësimi sa duhet i Administratës Publike Shqiptare për t'u angazhuar seriozisht në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.
5. Mungesa e familjarizimit të Institucioneve Shtetërore tradicionale ekzistuese me praninë dhe veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, si organ kontrolli të jashtëm, në rastet e shkeljes së të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Shqipëri.
6. Mosvendosjen e kontakteve të rregullta të bashkëpunimit ndërmjet hallkave përkatëse të të gjitha niveleve të Zyrës së Avokatit të Popullit me disa zyra të organeve dhe autoriteteve publike.
7. Dinamika e përsosjes së legjislacionit nuk kushtëzohet nga niveli ekzistues i mentalitetit për zbatimin e tij. Kjo ka bërë që të ketë vështirësi në implementimin e ligjeve të reja, ku do të veçonim Ligjin nr. 8485 dt. 05.12.1999 “Për Kodin e Procedurave Administrative”, Ligjin nr. 8549 dt. 11.11.1999, “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, Ligjin nr. 8503, dt. 30.06.1999, “Për të Drejtën e Informimit me dokumentet zyrtare”, apo ligjit “Për ruajtjen e të dhënave personale”.
8. Konfuzioni i përgjithshëm në zbatimin e rregullimit ligjor të pronës dhe kompensimit të saj në praktikë. Kjo çështje prek një numër të madh të qytetarëve.
9. Boshllëqet ligjore, që pengojnë Avokatin e Popullit, në zgjerimin e sferës së juridiksionit të tij, fjala vjen, mungesa e së drejtës për të kryer inspektime në vende ku të drejtat e njeriut çënohen eventualisht më shumë, si burgje, komisariate policie, spitale psikiatrike etj.
10. Mungesa e amendamenteve përkatëse në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”, të cilat do të sanksiononin detyrimin ligjor të organeve të administratës për të respektuar afatin për kthimin e përgjigjeve në Institucionit tonë.
11. Mungesa e ambienteve (zyrave) të mjaftueshme për zhvillimin normal të veprimtarisë sonë. Përmbajtja e kërkesës tone, drejtuar më datën 17 shtator 2002 Kryeministrit, z.Fatos Nano, ndër të tjera vijon:

“... Por është fakt që në korrik të vitit 2000, kur Qeveria caktoi për ne ambientet (10 zyra), akoma nuk ishin të qarta nevojat që do të kishte Institucioni ynë, për të përmbushur detyrat që ka caktuar Kushtetuta, shoqëria shqiptare si dhe faktori ndërkombëtar.

Tashmë, kur kanë kaluar mbi dy vjet dhe rezulton se si faktorët e brendshëm, ashtu dhe Komuniteti Ndërkombëtar janë të kënaqur nga

veprimtaria e deritanishme e Avokatit të Popullit, ka lindur si nevojë urgjente shtesa për ambiente pune. Kështu ne nuk kemi ambiente për Arkivin që shtohet çdo ditë, ambiente pune për takime me ankuesit si dhe për mbledhje apo takime me stafin, bibliotekë, zyra për komisionerët (zëvendësit e Avokatit të Popullit, zyra për këshilltarët dhe ekspertët) etj. Bashkëlidhur kemi paraqitur edhe skicat për zyrat që kemi në dispozicion si dhe për nevojat tona me rreth 20 zyra të tjera.

Na lejoni të vëmë në vëmendjen tuaj se në ish ndërtesën e Komitetit Qëndror, ku ndodhemi aktualisht, ndodhen edhe zyrat e Institucioneve të tilla si Agjensia Kombëtare e Privatizimit, Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë, gazeta Liria, organizata joqeveritare e invalidëve të punës si dhe klube kafe (në bodrum) të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të Ministrisë së Kulturës.

Kemi mendimin se institucionet e sipërpërmendura shtetërore ose joqeveritare ose klubet nuk është mirë të jenë në këtë ndërtesë, por mund të sistemohen në godina të tjera shtetërore siç janë ish fabrika e uzina, ish reparte ushtarake etj, që faktikisht në Tiranë nuk mungojnë, por që indiferenca apo interesat e personave kompetente për t'i dhënë me qera kanë shkaktuar mungesa të zyrave për institucione serioze të shtetit tone. Duke patur parasysh planimetrinë dhe numrin e zyrave të Agjensisë Kombëtare të Privatizimit, e cila ndodhet përballë dhe në të njëjtin kat me ne, mendojmë se transferimi i saj në ambiente të tjera përmbush në mënyrë të plotë nevojat tona. Por të njëjtën planimetri ka edhe Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë, por një kat më poshtë. Ky Institut mund të sistemohet fare mirë në ndërtesën e shoqatës së të përndjekurve politikë, në rrugën e Elbasanit.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj, theksojmë se donatori ynë kryesor, projekti danez Danida është i gatshëm të kontribuojë për rehabilitimin e zyrave që shpresojmë të na akordoni”.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave ka treguar shenja interesimi për këtë kërkesë, por ne kërkojmë vëmendjen e Kuvendit për këtë çështje me rëndësi themelore për Institucionin tonë, prandaj dhe e kemi vënë kërkesën e mësipërme në këtë raport.

8. Faktorët ku mbështeten arritjet e Institucionit

Arritjet e institucionit mbështeten në:

1. Pavarësinë e garantuar nga Kushtetuta dhe në implementimin e parimeve ndërkombëtare të punës së Ombudsmanit.

2. Paanësia në ushtrimin e funksioneve të Avokatit të Popullit ka qenë vendimtare që është rritur besueshmëria si para publikut, ashtu edhe tek autoritetet e Administratës Publike Shqiptare.

3. Mirëkuptimin e deritanishëm nga Institucionet Qeveritare Shqiptare për nevojat dhe veprimtarinë e Institucionit tonë. Ato janë të ndërgjegjësuar për faktin se një nga kushtet e Kartës së Kopenhagenit për anëtarësim ose pezullim nga Bashkimi Europian është “respektimi dhe stabiliteti i institucioneve garantuese të demokracisë, të sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së pakicave”. Është kuptuar drejtë se Avokati i Popullit është një institucion që garanton demokracinë, pasi ai ndihmon për forcimin e konceptit të një shteti të së drejtës.

4. Përkrahjen ndërkombëtare që ka patur dhe vazhdon ta ketë institucioni ynë, e cila është një faktor me peshë të madhe.

5. Cilësitë profesionale të stafit, kërkesat në rritje për standarte më të larta në punën tonë, përkushtimin total për të treguar se edhe ne shqiptarët “dijmë të ndërtojmë një institucion demokratik nga fillimi”.

6. Përvojën e fituar gjatë këtyre viteve, përmes trajnimeve në vazhdimësi si dhe motivimin e vazhdueshëm të stafit gjatë punës me një problematikë të larmishme.

9. Sfidat, objektivat e Institucionit për vitin 2003 e në vazhdim

Që në fillim të ushtrimit të veprimtarisë sonë, kemi synuar të ngrejmë një institucion të pavarur shërbimi për qytetarët, të drejtat e të cilëve janë shkelur nga Administrata Publike Shqiptare. Duke ndjekur çështjet rast pas rasti, ne kemi rekomanduar masa administrative dhe dhënë opinione për parandalimin e shkeljeve nga Administrata Publike në të ardhmen. Disa nga drejtimet e punës që ne kemi zbatuar për të realizuar sa më sipër kanë qenë: dhënia e ndihmës ligjore nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillave në rastet e konflikteve midis administratës dhe publikut, zbulimi i defekteve të administratës, denoncimi i sjelljeve të këqia të nëpunësve kundrejt qytetarëve, presioni për ndryshimin e procedurave të rënduara dhe të paqarta të Administratës Publike, krijimi i kushteve që qytetarët të gëzojnë të drejtat e tyre në marrjen e informacioneve të

nevojshme nga Administrata Publike, si dhe nxitja e transparencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e saj.

Në funksion të sfidave për të ardhmen, do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë ndër të tjera këtyre objektivave:

1-Konsolidimit të arritjeve të deritanishme, me synim rritjen e shifrës së efektshmërisë së ndërhyrjeve të Institucionit tonë për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve.

2-Bashkëpunimit më efikas me Parlamentin për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore, që do të sillnin një efektivitet më të madh të Zyrës së Avokatit të Popullit.

3-Vendosjes së kontakteve më të rregullta dhe më të ngushta me nëpunësit e Administratës Qëndrore dhe Vendore. Caktimi i përfaqësuesve vendorë të Avokatit të Popullit duhet të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur.

4-Vazhdimin të organizimit të ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, duke zbatuar edhe forma të tjera për t'ju afruar sa më shumë publikut.

5-Kërkimit dhe justifikimit të vazhdimësisë së mbështetjes, si financiare, ashtu dhe politike, përmes lobimit nga ana e Grupit të Miqve të Avokatit të Popullit, pranë instancave më të larta të shtetit shqiptar.

6-Ndikimit më të madh për respektimin dhe stabilitetin e institucioneve shqiptare, që sigurojnë demokracinë dhe prosperitetin, sidomos të organeve të pushtetit gjyqësor dhe të prokurorisë.

7- Bërjes publike më mirë e më shumë të problemeve kryesore të evidentuara në fushën e të drejtave të njeriut nga shkeljet e Administratës Publike, si dhe ushtrimin të një "presioni pozitiv" ndaj Qeverisë e Parlamentit Shqiptar për përmirësime të legjisllacionit dhe zbatimit më të mirë të tij.

8- Vazhdimin të programit për forcimin e kapaciteteve të zyrës, ku përfshihet kualifikimi i mëtejshëm i stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

9- Qëndresa organizative besojmë se do të ruhet në kushtet kur asistenca e DANIDA-s do të mund të zëvendësohet me një emër tjetër. Rritja e volumit të punës do të kërkojë edhe një rritje në drejtim të racionalitetit të shpërndarjes dhe menaxhimit të saj. Ne kemi planifikuar të zbatojmë më mirë e më shumë elementin e mediacionit në punën tonë, duke krijuar mbase një njesi të veçantë pranë stafit për këtë qëllim. Kjo do të kushtëzohet si nga shtesa në numrin e stafit të ekspertëve, që do t'ia kërkojmë autoriteteve shqiptare për të na e miratuar, ashtu edhe nga trajnimi i kësaj njësie në zyra të tjera homologe që e aplikojnë këtë teknikë

të re për ne. Në fund të fundit, përderisa Avokati i Popullit është një zyrë e re, kjo presupozon edhe një process dinamik, në varësi të sfidave në rritje të së ardhmen.

10- Qëndresa teknike është e kushtëzuar deri diku edhe nga ajo financiare. Rrjeti i sistemit informativ kushtëzon mirëmbajtje të vazhdueshme. Rritja e ngarkesës së punës ka bërë të domosdoshme nevojën për shtesën e ambjenteve përkatëse për krijimin e Arkivit të Institucionit, për risistemimin e Zyrës së Pritjes së Popullit si dhe për një akomodim më të mirë të stafit të ekspertëve që duhet të rritet.

11-Qëndresa financiare mund të vihet në pikëpyetje, pasi shteti shqiptar është i detyruar të ndjekë një politikë të rreptë fiskale, përmes shkurtimit të buxhetit. Ritmet e deritanishme të suksesit, veç përkushtimit të stafit drejtues dhe të specilistëve, janë kushtëzuar në një masë thelbësore edhe nga frekuenca e trajnimeve që ne kemi realizuar, si duke shkuar në zyra homologe, ashtu edhe duke ftuar ekspertë të huaj në Shqipëri. Por në buxhetin e akorduar nga shteti, ne nuk shikojmë të jemi prioritarë në krahasim me institucionet e tjera shtetërore buxhetore.

Si përfundim do të përmbledhim se sfidat tona në të ardhmen në përputhje me prioritetet e Procesit të Stabilizim Asocimit me BE-në, konkretisht për forcimin e administratës publike, të çështjeve të drejtësisë dhe ligjit e të tjera drejtime do të jenë:

Avokati i Popullit do të rrisë efikasitetin e tij duke:

- Rritur standartet e punës së tij në menaxhimin e rasteve.
- Rritur bashkëpunimin dhe autoritetin e tij si interaktiv me institucionet e tjera publike.
- Forcuar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë.

10. Strategjia për të ardhmen e Institucionit

Deri tani ne konstatojmë se ka ekzistuar dhe ekziston mirëkuptimi dhe angazhimi konkret i Kuvendit dhe Qeverisë Shqiptare për të mbështetur Avokatin e Popullit, si një institucion i tipit modern, që luan një rol të rëndësishëm në proceset demokratike në vend.

Gjatë tre viteve të veprimtarisë nuk kemi konstatuar të ketë patur kritika të drejta për njëanësi partiake. Me profesionalizëm të lartë dhe vlerat etike që kemi manifestuar, ne do vazhdojmë në të njëjtën linjë, duke ruajtur ekuilibrin dhe paanësinë politike në çdo rast.

Është e dukshme se është rritur shumë në vitin 2002 numri i njerëzve që kanë kërkuar shërbimin e Avokatit të Popullit. Praktikrat pozitive dhe mesazhet e mira të shpërndara në popull, kanë krijuar atmosferën dhe

ndërgjegjësimin e nevojshëm, që qytetarët shqiptarë të përdorin institucionin tonë për mbrojtjen e të drejtave të tyre nga shkeljet e Administratës Publike.

Me anë të dialogut midis Institucionit të Avokatit të Popullit, organizatave të të drejtave të njeriut dhe Parlamentit e Qeverisë e Shqiptare, ne do vazhdojmë të inkurajojmë autoritetet për të vazhduar përmirësimet të legjislacionit dhe forcuar zbatimin e tij. Gjithashtu do të mundohemi të bindim Kuvendin për përmirësimet në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”, me qëllim që t’i vijmë më tepër në ndihmë publikut.

Duke nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm të Avokatit të Popullit në fushën e transformimeve demokratike ne justifikojmë nevojën për ekzistencën e një institucioni të tillë për një kohë të gjatë.

Strategjia për jetëgjatësinë bën pjesë në procesin e forcimit dhe rritjes së Institucionit, të rolit e impakteve të tij në shoqëri. Mirëmbajtja e burimeve të brendshme, përdorimi i tyre në bazë kriteresh të drejta, kujdesi për trajnimin e vazhdueshëm e motivimin e stafit si dhe mirëadministrimi i burimeve materiale e njerëzore formojnë një bazë të mirë për jetëgjatësinë dhe suksesin e Institucionit.

Natyrisht, jemi të vetëdijshëm se kemi edhe mjaft të meta e mangësi, se punojmë në fushën e të drejtave të njeriut, që është relativisht e re për Shqipërinë, pasi nuk kemi përvojë të mëparshme në Shqipëri. Prandaj do të përpiqemi vazhdimisht të përmirësojmë metodën e veprimtarisë, të dëgjojmë me kujdes vërejtjet e sugjerimet që do të na bëhen, për të zgjidhur sa më drejt ankesat dhe kërkesat e njerëzve, për të mbrojtur kështu të drejtat dhe liritë e tyre themelore.

Krahas objektivave që kemi prezantuar dhe në Raportet e mëparshme, të cilat janë afatgjatë, vëmendja dhe burimet intelektuale të Zyrës sonë, do të përqendrohen më mirë e më shumë tek disa strategji preventive, ndër të cilat më efektivet janë edukimi dhe trajnimi në fushën e të drejtave të njeriut. Kjo shprehet në një sërë veprimesh që ne kemi bërë e do të bëjmë si: përhapje informacioni, zbatim programesh trajnimi, seminare me grupe të ndryshme të interesit, si dhe me përfaqësues të administratës, OJF-ve. Njëkohësisht, nuk do të lëmë mënjanë dhe zhvillimin e strategjive praktike për një edukim efektiv në sfera të tilla kritike, siç janë trajnimet për policinë, burgjet, forcat ushtarake etj. Të gjitha këto do të bëhen pa harruar për asnjë çast se detyra jonë kryesore kushtetuese është të mbrojmë të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve duke zgjidhur ankesat dhe kërkesat e tyre ndaj administratës publike shqiptare.

KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2002

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Institucioni i Avokatit të Popullit, po tenton drejt realizimit sa më të mirë të administrimit publik nga këndvështrimi i qytetarëve, i detyrave kushtetuese të sanksionuara në kuadrin e mbrojtjes sa më efektive të drejtave të njeriut.

Ndonëse në dukje nuk ka një lidhje të drejtëpërdrejtë, çështja e statistikave është e lidhur ngushtë me kontrollin e zbatimit të ligjit dhe me ndikimin që Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të ushtrojë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, si një element bazë i shtetit të së drejtës. Numri i përgjithshëm i ankesave është i lidhur ngushtë me numrin e të drejtave të shkelura apo dhe me mënyrën se si individët i konceptojnë të drejtat e tyre. E rëndësishme në këtë pikë, ka qenë evidentimi nga ne i numrit të ankesave të bazuara dhe numri i ankesave të pabazuara, çka na ka lejuar të krijojmë mendimin tonë mbi masën e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe mënyrën e perceptimit të këtyre shkeljeve si nga ana e qytetarëve ashtu dhe ana e Administratës Publike Shqiptare.

Ashtu sikundër është thënë dhe më parë, për Avokatin e Popullit ka qenë e rëndësishme të ndërtojë brenda Institucionit një sistem të tillë, që të jetë i gatshëm të presë në çdo kohë e pa pengesa qytetarët që vijnë për ankesat apo kërkesat e tyre dhe t'i bëjë ata të ndjehen të mirëpritur, si dhe të përfitojnë prej nesh më shpejt ato çfarë ne u ofrojmë për t'i ndihmuar. Për këtë që në Qershor të vitit 2001 ka filluar funksionimi i Zyrës së Pritjes së Popullit, ku qytetarët në çdo orë të ditës, gjatë orarit zyrtar, mund të paraqesin ankesat apo kërkesat e tyre dhe të marrin sqarimet e nevojshme nga një ekspert i zyrës. Veç kësaj gjatë vitit 2002 kemi zbatuar “ditët e hapura” për publikun, ku kemi shkuar në 32 qytete, kemi pritur me qindra njerëz, por kemi regjistruar vetëm 603 ankesa dhe kërkesa që për momentin janë konsideruar brenda juridiksionit tonë.

Nga statistikat tona kemi nxjerrë raportin midis çështjeve të cilat janë në juridiksionin tonë, me çështjet të cilat janë jashtë këtij juridiksioni. Raporti ka treguar se akoma ka shumë individë që nuk e kanë të qartë sferën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, çka na ka nxitur të hartojmë programe konkrete për njohjen në masën e njerëzve të Institucionit të Avokatit të Popullit, rolit dhe kompetencave tona. Kjo ka qenë një nga arsyet që kemi realizuar “ditët e hapura” në shumë qytete të vendit, që ka bërë të mundur që të ndjehemi më pranë problemeve të shtetasve, duke ju dhënë më shumë ndihmë për zgjidhjen e ankesave të tyre ose duke i këshilluar për veprimet që duhet të ndërmerren. Takimeve tona nëpër rrethe në “ditët e hapura” u kanë paraprirë bisedat në televizionet lokale me ekspertë të Zyrës së Avokatit të Popullit, për t’i bërë të ditur publikut, kompetencat dhe rolin e Avokatit të Popullit, me qëllim që ai të jetë sa më ndihmues për qytetarët.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2002 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit 4675 ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga 4675 ankesa, 435 kanë qenë të mbartura nga viti 2001 dhe janë raportuar si të tilla në Raportin Vjetor 2001. Ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qenë 3263. Nga këto, 767 ankesa ose 24% e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2003. Duke krahasuar numrin e ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të ardhura në vitin 2001, ka një rritje rreth 1.6 herë, kurse krahasuar me vitin 2000 rritja është rreth 5 herë.

Nga trajtimi i ankesave ka rezultuar se 1100 ankesa, ose 45% e tyre kanë qenë jashtë juridiksionit. Por për ato është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. Nga ankesat që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit, 759 ose 30% e ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse 556 ose 22% e tyre janë zgjidhur në favor. Nga 556 ankesat e drejta, për 190 prej tyre janë bërë edhe rekomandimet përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë, ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për

ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në raport me vitin 2001, kur kishim 432 ankesa të zgjidhura në favor ose rreth 25 %, ulja prej 3 % është relative, sepse në fakt kemi 124 ankesa më shumë në favor se sa viti i kaluar.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitin e kaluar, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2002, të ndara sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

1. Këshilli i Ministrave	198 , nga të cilat për:
a. Grupin Mbikqyrës të Firmave Piramidale	15
b. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	88
c. Komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave	59
ç. Instituti i Integritimit të ish të Përndjekurve politikë	8
d. Agjensia Kombëtare e Privatizimit	28
2. Ministria e Drejtësisë	358 , nga të cilat për:
a. Burgjet	220
b. Zyrat e Përmbarimit	138
3. Organet e pushtetit gjyqësor	
a. Gjykatat	405
4. Prokuroria	196
5. Ministria e Rendit Publik	283
6. Ministria e Mbrojtjes	236
7. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	457 , nga të cilat për:
Vetë ministrinë	21
<i>Organet e pushtetit vendor</i>	
a. Komunat	22
b. Bashkite	367

43	
c. Prefekturat	44
Të tjera	3
8. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	290 , nga të cilat për:
a. Institutin e Sigurimeve Shoqërore	174
b. Administrata e Ndhmës Sociale	116
9. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	157 , nga të cilat për:
a. Vetë Ministrinë	26
b. Ndërtimet pa leje	126
c. Ujësjetës kanalizime	5
10. Ministria e Ekonomisë	9
11. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	79
12. Ministria e Financave	35
13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës	78
14. Ministria e Shëndetësisë	25
15. Ministria e Punëve të Jashtme	21
16. Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve	50 , nga të cilat për:
a. Vetë Ministrinë	10
b. Telekom-in	40
17. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	12
18. Ministria e Mjedisit	15
19. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës	80 , nga të cilat për:
a. Vetë Ministrinë	16
b. Korporatën Elektroenergjetike	64
20. Shërbimet Sekrete	11
Të tjera	268
<u>TOTALI</u>	<u>3263 ankesa</u>

2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Avokati i Popullit e ka të qartë pozitën e tij se si Institucion është krijuar me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë dhe që si person (individ), është zgjedhur po nga ky Kuvend. Por, njëkohësisht e ndjen veten, "... krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit".

Institucioni i Avokatit të Popullit që nga krijimi i tij dhe në vazhdimësi ka ndjerë kujdesin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për forcimin dhe konsolidimin e tij.

Avokati i Popullit ka informuar herë pas here me shkrim Kryesinë e Kuvendit, apo dhe komisionet parlamentare përkatëse për veprimtarinë e tij ose për çështje të veçanta si rastet e keqtrajtimit nga policia në shtator dhe dhjetor 2002, etj. Gjithashtu, në dhjetor 2002 ju kemi dërguar 140 deputetëve të Kuvendit konkluzionet e Konferencës Kombëtare për të drejtën e informimit, të shoqëruar edhe me një kalendar që përmban dispozitën kushtetuese dhe ligjin për të drejtën e informimit. Kemi marrë pjesë në diskutime të projektligjeve të ndryshme, si dhe kemi dërguar edhe rekomandime për çështje të ndryshme, duke sugjeruar që deputetët në komisionet parlamentare jo vetëm të informohen për veprimtarinë e opinionet tona, por edhe që të ndërmarrin inisiativën legislative për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve, kur i vlerësojnë me vend Rekomandimet tona.

Kryesia e Kuvendit është treguar e gatshme dhe në çdo rast ka pritur homologët e Avokatit të Popullit që kanë zhvilluar vizita zyrtare tek ne, si dhe ka shprehur opinionet pozitive të Kuvendit për veprimtarinë tonë. Gjithashtu edhe kryetarët e komisioneve të Ligjeve, të Financës dhe të Drejtave të Njeriut apo deputetë të pozitës dhe opozitës, janë takuar me Ombudsmanin e Mbretërisë së Danimarkës, z.Hans Gammeltoft Hansen si dhe Komisionerin e Lartë për të drejtat e njeriut në Këshillin e Europës, z.Alvaro Gil Robles, nga ku kanë dëgjuar për përvojat e tyre, por dhe kanë shprehur opinionet e tyre për Institucionin tonë. Komisioni i Financës ka mirëkuptuar kërkesat tona për akordimin e buxhetit financiar që të garantojë funksionimin normal të veprimtarisë sonë. Por vëmë në dukje se deri tani nuk kemi gjetur zgjidhje për inisiativën tonë për të caktuar përfaqësues vendor në Shkodër e Gjirokastër, ashtu siç kemi shpjeguar me hollësi kur flasim për buxhetin e Institucionit.

a- Në Raportin vjetor të vitit 2001, ne i bëmë të ditur Kuvendit se në tre raste i kemi rekomanduar Qeverisë që të marrë masa për të përgatitur

ligje e akte të tjera për të plotësuar detyrime që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë por të cilat nuk janë plotësuar:

1.Për zbatimin e nenit 181/1 të Kushtetutës për rregullimin e drejtë të çështjeve që lidhen me pronat. Për këtë çështje, në shtator 2002 i bëmë një kujtesë Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit. Siç dihet, në muajin tetor Kuvendi ka miratuar një Rezolutë për çështjen e pronave, e cila tashmë ndodhet për zgjidhje para Kuvendit. Në zbatim edhe të detyrës që ka vënë Komisioni Europian, në kuadrin e hapjes së negociatave për marrëveshjen e Asocim-Stabilizimit me Bashkimin Europian, përmendim një letër të datës 15 janar 2003, në të cilën z.Kristofer Paten, anëtar i Komisionit Europian në Bruksel shkruan: “Përfitoj nga rasti t’ju përsëris se një afrim i suksesshëm i Shqipërisë ndaj Bashkimit Europian do të jetë i mundshëm vetëm në rast se do të ruhen si duhet të drejtat themelore të popullsisë shqiptare, siç janë të drejtat e tyre të pronësisë”.

2.Për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, siç kërkon neni 10 i Kushtetutës. Nga informacioni zyrtar që kemi nga Kryetari i Komitetit të Kulteve pranë Këshillit të Ministrave, nga ky Komitet, është përgatitur projekti i marrëveshjes tip me bashkësitë fetare dhe është depozituar për shqyrtim e miratim nga Qeveria. Për nxitjen e këtij procesi, në dhjetor 2002 ja kemi kujtuar zotit Kryeministër detyrimin e plotësimit të detyrës që rrjedh nga neni 10 i Kushtetutës. Do të nënvizonim se plotësimi i këtij detyrimi duhet shpejtuar, me qëllim që të parandalohen në kohë edhe disa fenomene negative të vërejtura kohët e fundit të devijimit të riteve tradicionale të fesë islame në zona të prapambetura, çka për të ardhmen mund të përbëjë një rrezik për traditën shqiptare të harmonisë fetare.

3.Për nxjerrjen e ligjit për rehabilitimin apo zhdëmtimin nga aktet apo veprimet e paligjshme të organeve shtetërore, siç i kërkon neni 44 i Kushtetutës. Qeveria ja ka ngarkuar si detyrë Ministrisë së Drejtësisë që të përgatitë projektligjin gjatë vitit 2003.

b-Gjatë vitit 2002, pas Rekomandimeve tona janë bërë rregullimet përkatëse në dy ligje:

1-Kryetari i Komisionit Parlamentar i Mbrojtjes, deputeti Dashamir Shehi, në vitin 2001 pranoi Rekomandimin e Avokatit të Popullit dhe pati inicuar ndryshimin e Ligjit nr.8087 datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve...”. Tashmë, Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.8948 datë 3.10.2002, në të cilin është rregulluar plotësisht çështja sipas Rekomandimit të Avokatit të Popullit.

2-Më datën 10.10.2002 Kuvendi miratoi Ligjin nr. 8950 “Për Gjendjen Civile”. Mbi bazën e Rekomandimit tonë drejtuar Kryeministrit, zotit Fatos Nano, është përfshirë në nenin 51 të ligjit të mësipërm e drejta e

Zyrës së Gjendjes Civile për të kërkuar ç’regjistrimin nga regjistrat e saj, nëpërmjet gjykatës, për personat që kanë vdekur, por për të cilët nuk interesohet asnjëri.

c-Gjatë vitit 2002, i kemi nisur direkt Kuvendit edhe këto Rekomandime për përmirësimin e ligjeve:

1-Disa mendime lidhur me Ligjin nr.8306 datë 14.03.1998 “Për Strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” për të forcuar kontrollin dhe pjesëmarrjen e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e privatizimit të pronës shtetërore.

2-Duke qenë se ligji për mbledhjen e armëve që ndodhen në duart e popullsisë civile, nuk ka dhënë rezultatet e duhura, në vitin 2002 i kemi paraqitur Qeverisë idenë që të ndryshohet konceptimi i këtij ligji, me qëllim që fillimisht armët të deklarohen e të legalizohen dhe, pas një periudhe kohe të mëvonshme, ato të mbledhen. Kjo ide nuk është marrë parasysh nga Qeveria në projektligjin e paraqitur prej saj në Kuvend dhe as është parashtruar në Relacionin përkatës. Prandaj ja kemi parashtruar Kryesisë së Kuvendit dhe Komisionit të Rendit dhe atij të Ligjeve propozimin tonë. Projektligji është në diskutim në komisionet parlamentare dhe Kuvendi natyrisht që do të vendosë atë që do ta gjykojë më të dobishme për situatën në të cilën ndodhet sot Shqipëria, ku numri i armëve në duart e popullsisë civile, jashtë çdo kontrolli, është i madh.

3-Komisionit Parlamentar të Rendit dhe Shërbimit Informativ, Komisionit të të Drejtave të Njeriut dhe Komisionit të Ligjeve u është dërguar Rekomandimi për të marrë inisiativën ligjvënëse për përmirësimin e nenit 4 të Ligjit nr.8292 datë 25.2.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”, sepse ky nen pengon vënien para ligjit të policëve kur shkelin rëndë të drejtat e njeriut.

4-Komisionit Parlamentar të Ligjeve dhe Komisionit të të Drejtave të Njeriut u është dërguar Rekomandimi për të marrë inisiativën ligjvënëse për plotësimin e Ligjit nr.8328 datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, me qëllim që të parashikohet e drejta e Avokatit të Popullit për të kryer inspektime në burgje.

Sipas informacionit që kemi, deputetët Vangjel Dule, Pjetër Arbnori, Shpëtim Kateshi dhe Ligoraq Karamelo kanë marrë inisiativën legislative dhe kanë futur dy rekomandimet e fundit në procedurën legislative.

Më hollësisht, për këto çështje flitet edhe në pjesët përkatëse të këtij Raporti.

Megjithatë, për të ardhmen kemi caktuar si detyrë që, të informojmë më tepër Kuvendin për veprimtarinë tonë, për gjendjen e ligjshmërisë dhe të zbatimit të të drejtave të njeriut nga ana e Administratës Publike

Shqiptare. Gjithashtu, të shfrytëzojmë më tepër mundësinë për të rekomanduar direkt në komisionet parlamentare marrjen e inisiativës së tyre legjislative, në interes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri.

Nevoja e përmirësimeve të ligjit “Për Avokatin e Popullit”

Gjatë punës praktike të Zyrës së Avokatit të Popullit, ashtu siç kemi evidentuar edhe në Raportet e mëparshme, kanë dalë disa probleme që bëjnë të nevojshme dhe të domosdoshme disa shtesa e ndryshime në Ligjin “Për Avokatin e Popullit”.

Kështu duhet rregulluar me ligj të shprehur e drejta e Avokatit të Popullit të hyjë pa autorizim paraprak në vendet ku ka të dhëna se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave të njeriut, si në burgje, spitale psiqiatrike, reparte ushtarake, etj. Po kështu, kjo e drejtë është e nevojshme në raste studimesh apo inspektimesh. Vënia e afateve për përgjigjet që duhet t’i jepen Avokatit të Popullit apo pezullimi i akteve në rast se rekomandimet e tij nuk merren në shqyrtim, forcojnë pozitën e Avokatit të Popullit dhe bëjnë më të qartë detyrimin që kanë organet e administratës karshi rekomandimeve të tij. Gjithashtu është i nevojshëm edhe caktimi i masave ndëshkimore konkrete kur nxirren pengesa për veprimtarinë e Avokatit të Popullit. Mbase me ligj mund të rregullohet edhe afati i paraqitjes së Raportit Vjetor në Kuvend nga Avokati i Popullit, etj.

Këto ndryshime të domosdoshme janë bazuar tek legjislacionet dhe praktikat e punës së Ombudsmanit në Danimarkë, Slloveni, Portugali, Kosovë, Maqedoni, Hungari, etj, dhe janë të nevojshme për të forcuar punën e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njerëzve. Deri tani nuk ka qenë e mundur inisiativa për këto ndryshime.

Marrëdhëniet e Avokati të Popullit me Kuvendin e Shqipërisë do të vazhdojnë të mbeten prioriteti ynë. Ne besojmë se, ashtu siç kemi konstatuar deri tani, veprimtaria jonë do të vazhdojë të vlerësohet objektivisht si një veprimtari e paanshme, profesionale dhe në dobi të të gjithë atyre njerëzve që kanë nevojë, por edhe në funksion të mirëadministrimit të punëve të shtetit.

3. Mendime për korrupsionin dhe antikorrupsionin

Tranzicioni i shpejtë politik, ekonomik dhe social, të cilën po kalon shoqëria dhe vendi ynë, pa dyshim që lindi dhe zhvilloi disa faktorë lehtësues për përhapjen e korrupsionit. Korrupsioni është pengesë serioze, jo vetëm për zhvillimin dhe prosperitetin ekonomik të çdo vendi, pavarësisht nga shkalla e zhvillimit ekonomik të tij, por sidomos për garantimin dhe sigurimin e të drejtave dhe lirive themelore të të gjithë qytetarëve. Prandaj, nuk është e çuditshme që korrupsion ka dhe luftohet edhe në vendet më të zhvilluara të botës.

Në vendin tonë, në njëfarë mase, korrupsionin e favorizojnë kushte objektive dhe subjektive. Gjendja e dobët ekonomike, në të cilën paraqitet vendi ynë, mospagimi i punës për një numër jo të vogël qytetarësh, paga e ulët e mjaft personave të punësuar si dhe lakmia për t'u pasuruar brenda një kohe sa më të shkurtër, janë faktorë kryesorë që kultivojnë dhe zhvillojnë në mënyrë të pandërprerë korrupsionin.

Por tendencë e korrupsionit tek ne është përpjekja për t'u kthyer në normë. Rreziku i madh që paraqet kjo, konsiston në faktin e krijimit tek populli të opinionit shkatërrues për organet shtetërore, se problemet dhe hallet e qytetarit “zgjidhen vetëm në rrugën e ryshfetit”. Pra, sipas këtij opinionit, që mund ta përqafojnë edhe zyrtarë të veçantë, “paraja bën gjithçka, pa korrupsion nuk ecet”. Korrupsioni, mishërimin e vet e gjen në qëndrimin që mbajnë disa zyrtarë ndaj kryerjes apo moskryerjes së detyrës të caktuar me ligj para qytetarëve që paraqiten para tyre për të zgjidhur ankesat apo kërkesat e tyre.

Konsiderohet korrupsion kur autoritetet publikë ose nëpunësit e tjerë, duke qenë në detyrë, me të drejtat që ju jep pushteti apo vendi i punës, në mënyrë të hapur apo të fshehur, i krijojnë qytetarit të thjeshtë pengesa të tilla, për t'a detyruar që si rrugëzgjidhje të ankesës apo kërkesës së tij, të gjejë përdorimin e rryshfetit. Ndërsa, qytetarëve të tjerë, që janë të fortë nga ana ekonomike, ose përpiqen që shpesh t'u krijojnë kushte e lehtësi për bizneset e tyre, në dëm të atyre që janë më pak të dobët ose jua vështirësojnë punën përsëri për t'u marrë para.

Në Shqipëri strukturat e parashikuara për luftën kundër korrupsionit janë të caktuara me ligj, sikundër është Prokuroria, gjykatat, policia dhe Shërbimet inteligjente, kurse Avokati i Popullit ka një rol tjetër. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk është institucion i ngritur posaçërisht për të zbuluar, hetuar dhe dënuar korrupsionin apo zyrtarët që bëjnë korrupsion. Detyra jonë, ndër të tjera, është që të vlerësojmë në se institucionet e

posaçme po e luajnë me efektivitet rolin e tyre edhe t'i nxisim ato në këtë drejtim.

Prandaj, nisur nga roli ynë si nxitës i precedentit të mirëqeverisjes, është e kuptueshme se ndihma jonë më tepër ka qenë dhe do të jetë institucionale në këtë drejtim. Në rastet kur shqyrtojmë ankesat dhe konsiderojmë se ka premisa apo dyshime të bazuara për korrupsion, ne ja dërgojmë çështjet Prokurorisë, Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, apo organeve të tjera kompetente. Por më të rëndësishme ne konsiderojmë rekomandimet tona për t'i mbyllur rrugët në mënyrë institucionale korrupsionit.

Disa nga rekomandimet tona konkrete janë:

1. Propozimet për ndryshimin dhe përmirësimin e 3-4 ligjeve për privatizimet e mëdha që pritet të bëhen. Ideja jonë vazhdon të jetë që Parlamenti të ketë diskrecion më të madh në kushtet e kontratave që do të bëhen në rastin e këtyre privatizimeve.

Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe shkresa jonë e datës 14.05.2002, drejtuar ish Kryeministrit Majko, ish Ministres së Ekonomisë, zj.Meksi dhe për të cilat është vënë në dijeni edhe Kryetari i Kuvendit, me qëllim që t'ja përcjellë edhe komisioneve të Financës dhe Privatizimeve, si dhe atij të Ligjeve.

Shkresa titullohet: “Disa mendime lidhur me Ligjin nr.8306, datë 14.03.1998 “Për Strategjinë e Privatizimit të Sektorëve me Rëndësi të Veçantë”, ndryshuar me Ligjin nr.8459, datë 11.02.1999 dhe Ligjin nr.8582, datë 23.02.2000, për të forcuar kontrollin dhe pjesëmarrjen e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e privatizimit të pronës shtetërore” dhe ndër të tjera ka këtë përmbajtje:

“Duke patur parasysh interesin e shfaqur nga Ju personalisht në emër të Qeverisë Shqiptare në takimet që kemi patur, si dhe nevojën për të rritur kontrollin dhe transparencën ndaj publikut por, në veçanti dhe ndaj Kuvendit të Shqipërisë, në thellim dhe të Rekomandimit tonë të shprehur në Raportin Vjetor të paraqitur në Mars 2002, kemi studjuar ligjet përkatëse lidhur me privatizimin e sektorëve strategjikë.

Kështu, pasi studjuam Ligjin nr.8306, datë 14.03.1998, “Për Strategjinë e Privatizimit të Sektorëve me Rëndësi të Veçantë”, me ndryshimet përkatëse, Ligjin nr.8433, datë 21.12.1998 “Për Përcaktimin e Formës dhe të Strukturës së Formulës së Privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare, sh.a.”, Ligjin nr.8515, datë 21.07.1999 “Për privatizimin e shoqërisë anonime”, “Albanian Mobile Communication (AMC)”, Ligjin nr.8563, datë 22.12.1999 “Për Përcaktimin e Formës dhe të Strukturës së Formulës së Privatizimit të Bankës së Kursimeve, sh.a.”, Ligjin nr.8810,

datë 17.05.2001 “Për Përcaktimin e Formës dhe Formulës së Privatizimit të sh.a. “Albtelekom””, si dhe projektligjin “Për Përcaktimin e Formës dhe Formulës së Privatizimit të INSIG, sh.a.”, ju parashtrojmë mendimet tona si më poshtë:

Në nenin 7 të Ligjit nr.8306, datë 14.03.1998 “Për Strategjinë e Privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ndryshuar me Ligjin nr.8459, datë 11.02.1999 dhe Ligjin nr.8582, datë 23.02.2000, thuhet që kriteret e përcaktimit dhe procedurat e zgjedhjes së investitorëve strategjikë përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Ne mendojmë se këto duhet të parashikohen në ligjin e veçantë që bëhet për çdo objekt që privatizohet.

Po kështu dhe formula e privatizimit, e cila shpreh përqindjen e kapitalit të shoqërisë që do të mbahet nga shteti, nga investitorët strategjikë apo investitorët e tjerë dhe kufiri i mundshëm i pjesëmarrjes së letrave me vlerë në privatizim, parashikuar nga neni 9 i ligjit të sipërcituar, duhet të rregullohen në ligjin e veçantë. Me fjalë të tjera, çështjet e nenit 7 dhe 9 të përfshihen në nenin 5 të Ligjit nr.8306, datë 14.03.1998.

Gjithashtu, mendojmë se në këtë ligj duhet shtuar një dispozitë që të përcaktojë se mënyra e pagesës dhe koha e shlyerjes së saj duhet të parashikohen në ligjin e veçantë.

Ne insistojmë se afati dhe mënyra e pagesës duhet bërë me ligjin përkatës, përpara se të jetë përcaktuar blerësi. Ky rregullim është i rëndësishëm, pasi kuptohet se kur ke të bësh me objekte të tilla shumë fitimprurëse, vonesa e pagesës për 6 muaj ose më tepër, në fakt do të thotë zbritje e çmimit të blerjes për fitimet që realizohen nga blerësi gjatë kohës së pagesës së vonuar.

Veç ndryshimit të Ligjit nr.8306, datë 14.03.1998, për sa më sipër, për të siguruar transparencën e nevojshme dhe për të mbyllur çdo shteg për abuzime, përderisa për këto objekte, procesi i privatizimit sapo ka nisur, është mirë dhe duhet që të bëhen ndryshimet e propozuara më sipër edhe në Ligjin “Për Përcaktimin e Formës dhe të Formulës së Privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.”, Ligjin “Për Përcaktimin e Formës dhe Formulës së Privatizimit të sh.a. “Albtelekom””, si dhe në projektligjin “Për Përcaktimin e Formës dhe të Formulës së Privatizimit të INSIG, sh.a.”, që aktualisht ndodhet për diskutim në Kuvend. Në këto ligje si dhe projektligjin “Për privatizimin e INSIG-ut”, mendojmë se duhet përcaktuar shprehimisht me ligj nga Kuvendi edhe mënyra se si do të përdoren të ardhurat nga privatizimi i tyre dhe të mos lihet që një gjë e tillë, e rëndësishme të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj, shpresojmë se mendimet e mësipërme do të përbëjnë një kontribut për rritjen e transparencës në

procesin e privatizimeve të mëdha dhe luftën institucionale për kufizimin e hapësirave ligjore, nga ku mund të lindin abuzime dhe premisa për korrupsion”.

Idetë tona juridike janë dhënë gjithmonë në funksion të mirëadministrimit dhe mirëqeverisjes dhe kjo nuk do të thotë se nga ana jonë ka ndonjë të dhënë apo akuzë konkrete për korrupsion për këto privatizime që do të bëhen.

2. Rekomandimi lidhur me fitimin e të drejtës së studimit në shkollat e larta. Këtë vit u arrit që Qeveria, sikundër edhe Ministria e Arsimit të mos kenë diskrecion absolut në shtesat në listat e studentëve. Mosfutja në shkollat e larta të studentëve që nuk kanë konkuruar, apo respektimi i listës rendore shtesë sipas pikëve të fituara, mbylli një shteg shumë të mundshëm abuziv, e për pasojë, një mundësi potenciale korruptive të nëpunësve që përpilonin këto lista.

3. Avokati i Popullit është investuar, duke mbyllur një shteg abuziv edhe në rastin, kur KESH vendos t’u ndërpresë qytetarëve energjinë elektrike, në forma të penalizimit kolektiv. Përmendim këtu si arritje edhe formulimin e kontratës së re tip të pagesës së energjisë elektrike.

4. Avokati i Popullit ka rekomanduar për përmirësimin e Ligjit të ri “Për Gjendjen Civile”, pasi në rregjistrat e listave të Gjendjes Civile u ndeshën shumë raste që figuronin ende edhe persona të vdekur prej vitesh. Rregullimi i ligjit për ç’rregjistrimin e tyre, synon të parandalojë edhe korrupsionin që mund të jetë i dyfishtë: Edhe financiar, duke patur parasysh fryrjet e listave të personave që përfitojnë ndihmë ekonomike; edhe politike, pasi me të njëjtat lista, mundësohet që edhe të vdekurit të llogariten në numrin e votuesve ose të “hedhin” të tjerë votat për ta, sipas interesave të kandidatëve partiakë.

5. Institucioni ynë është përpjekur të godasë mentalitetin korruptiv edhe në drejtim të jetës së përditshme të qytetarëve, në raportet e këtyre të fundit edhe me policin më të thjeshtë. Publiciteti dhe precedenti penalizues që u përpoqëm të krijojmë, teksa një taksisti i rivendosëm të drejtën e shkelur nga një polic i pandërgjegjshëm, që kishte vendosur një gjobë të padrejtë, synonte të godiste pikërisht mentalitetin që ushqen sjelljen korruptive në jetën e përditshme. Të mos harrojmë se korrupsioni i “vogël” në qëndrimet e përditshme të qytetarëve nga nëpunësit e shtetit, ndikon drejtpërdrejt në armiqësimin e shtetasve me shtetin e tyre, pra kompromenton dhe ndryshk mekanizmat e shtetit, që pretendon të jetë në shërbim të qytetarëve.

6. Vazhdojmë të kemi mjaft ankesa lidhur me abuzimet e KKK të Pronave, sidomos për fallsifikimet e dokumenteve në këtë fushë, të cilët

janë raste të pastra korruptive, por që nuk mund të ndiqen penalisht se janë amnistuar dhe as prokuroria nuk ka se çfarë të bëjë në këto raste. Në aspektin teknik, ndër të tjera, kemi ndërhyrë për përmirësimin e kushteve të punës për Komisionin e Kthimit të Pronave të Kryeqytetit, duke e konsideruar mirëfunksionimin e tij si ndihmë të drejtpërdrejtë në parandalimin e abuzimit me pronat e qytetarëve.

7. Vetë organizimi i Konferencës Kombëtare për të Drejtën e Informimit në dhjetor 2002 tregon se Avokati i Popullit synon ta ngrejë në nivelet më të larta ndërgjegjësimin e zyrtarëve për të qeverisur me transparencë në punën e përditshme. Duke theksuar faktin se mirëinformimi është transparencë dhe, kjo e fundit edhe një element thelbësor në luftën kundër korrupsionit, ne nuk pretendojmë se e bëmë detyrën tonë dhe kaq. Përkundrazi, gjithçka që diskutuam në këtë konferencë, si dhe konkluzionet e saj, ne synojmë që të bëhen elemente të mentalitetit të gjithësecilit që shërben në Administratën Publike Shqiptare, për të kontribuar në mirëqeverisje. Ato janë thjesht një bazë reference edhe për në punën tonë, për të demaskuar sjelljet abuzive dhe korruptive të nëpunësve civilë, vis a vis qytetarëve.

Gjatë veprimtarisë tonë, ne kemi bërë edhe rekomandime për fillim të çështjeve penale ose procedimeve disiplinore, si më poshtë:

1. Rekomandimi drejtuar prokurorit të rrethit Korçë, për ndjekjen penale të punonjësit të komisarariatit të policisë së këtij rrethi, Njazi Zite, për veprën penale të marrjes së mitës. Rekomandimi, u pranua dhe pasi u kryen hetimet e nevojshme nga prokuroria, çështja i ka kaluar gjykatës për gjykim.

2. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për kallëzimin penal të qytetarit B.B. ndaj kryetarit të komunës Gurrë e Madhe për ndjekjen penale të tij, për vjedhje dhe shkatërrime të bëra në shkollën 8-vjeçare të kësaj komune, meqenëse prokuroria e rrethit Mat nuk e merri në konsideratë këtë kallëzim. Rekomandimi u pranua.

3. Rekomandimi drejtuar Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarës I.Maneku në Fier për zhdukje të dokumentave të një pale në një gjykim civil.

4. Rekomandim drejtuar Ministrit të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve B.Shehu në Korçë dhe A.Broci në Tiranë për zvarritje të pajustificuara në gjykimin e një çështje civile.

Për rastet që përmendëm më sipër, kurrsesi nuk mund të shprehemi se veprimet e kryera nga ana e këtyre personave, përmbajnë në vetvehte elementet e veprës penale të korrupsionit. Kjo për faktin se, përfundimi i verifikimit tonë nuk është i barabartë me fajësinë e tyre. Një përfundim i

tillë, është e drejtë e vetme e gjykatës, të shprehur me një vendim të formës së prerë.

Avokati i Popullit, në kuadrin e aleancës antikorrupsion të sponsorizuar nga USAID, si dhe duke marrë pjesë në rolin e vëzhguesit në grupin e monitorimit antikorrupsion, pranë qeverisë shqiptare, ka dhënë një kontribut modest edhe në këtë aspekt. Po kështu, edhe pranë njësisë permanente antikorrupsion, kemi kontribuar për çështjet e legjislacionit, institucioneve, mekanizmave, parandalimit, luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore etj, të shprehura në pyetësonin e grupit të monitorimit antikorrupsion, të përgatitur në kuadrin e GRECO-s (Grupit të shteteve kundër korrupsionit, në kuadrin e Këshillit të Europës).

Aktualisht Parlamenti gradualisht ka plotësuar legjislacionin përkatës, për ta frenuar dhe luftuar korrupsionin, por ky fenomen negativ që ka përfshirë jo pak shoqërinë dhe Administratën Publike Shqiptare, paraqet gjithmonë dhe në çdo rast një rrezik imediat për të kalbëzuar sistemin tonë demokratik.

Por, a mundet të zhduket korrupsioni? Megjithëse, eliminimi i korrupsionit është një veprimtari e vështirë, e rëndësishme është që nëpërmjet një lufte të ashpër, t'i ndërpritet atij hovi. Si hap i rëndësishëm në këtë drejtim, mendojmë se do të ishte njohja sa më shumë e njerëzve me të drejtat e tyre, si dhe me detyrimet e Administratës Publike për t'i zbatuar ato. Kjo, edhe do t'i bëjë ata të ndërgjegjshëm për të luftuar me konsekuencë dhe besim për të mbrojtur e realizuar këto të drejta, pa u "dorëzuar", përpara zyrtarëve të korruptuar. Ndërgjegjësimi i publikut, informimi i tij dhe presioni për zbatimin e ligjit, ngushton hapësirat për korrupsion.

Korrupsioni, nuk mund të zbulohet e zhduket menjëherë, brenda një dite. Të gjitha përpjekjet që bëhen kundër tij, kanë si qëllim për ta minimizuar atë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, është i përfshirë plotësisht në këtë betejë dhe me kompetencat që i ka dhënë ligji, do të rrisë përditë përpjekjet për të dhënë kontributin e tij modest edhe në këtë drejtim.

4. Marrëdhëniet me Gjykatën Kushtetuese

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Por, sipas nenit 134 të Kushtetutës, subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe: në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte, që mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim, del nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 134 të Kushtetutës dhe në këtë kategori subjektësh që mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të kushtëzuar, përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Përcaktimi nëpërmjet interpretimit të rrethit të çështjeve që përbëjnë “interesa të Avokatit të Popullit”, në momentin kur sapo filluam punën, paraqiste rëndësi për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Prandaj në muajin qershor 2000 ju drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për të bërë interpretimin se çfarë kuptohet me “çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit”.

Në përputhje me kompetencat e saj, Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.49, dt.31.07.2000, vendosi që “Avokati i Popullit ka të drejtë të parashtojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, për pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, dhe për interpretimin e Kushtetutës, gjithnjë kur çështja lidhet me interesat e tij. Gjithashtu Avokati i Popullit mund të bëjë kërkesë për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cënuar rregullat kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e institucionit të tij”. Ne jemi të kënaqur me vendimin e mësipërm të Gjykatës Kushtetuese sepse siç interpretohet lehtë, nuk e kufizon të drejtën tonë për të realizuar detyrën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut.

Të drejtën për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese e parashikon edhe gërma “c” e nenit 24 të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, e cila përcakton se:

“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për

shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, Avokati i Popullit ka të drejtë:....

c) T'i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla”.

Ne e kemi zbatuar të drejtën tonë në katër raste për të bërë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Rasti i çështjes së mëposhtme, është pasqyruar në Raportet e vitit 2000 dhe vitit 2001.

1. Një shtetas shqiptar, ish pronar trualli, me anë të letrës së tij, është ankuar se Vendimi i Qeverisë nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ka kufizuar atij dhe ish pronarëve të tjerë, në kushte të barabarta me të, një nga të drejtat themelore të njeriut, atë të ushtrimit të së drejtës së pronës së tij të ligjshme.

Gjykata Kushtetuese, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë, me vendimin nr.26, datë 24.04.2001, vendosi pranimin e kërkesës sonë dhe shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1, shkronja “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët jo strategjikë”, si dhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare”, vetëm për pjesët ku ato shprehen: E para, “dhe çmimit të truallit të përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994” dhe e dyta, “... në përpjestime që i përgjigjen çmimit të truallit të njohur në bazë të Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994”.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është përshëndetur nga opinioni publik, sidomos nga ana e ish pronarëve të trojeve ku janë ngritur objektet shtetërore që po privatizohen. Nga ana tjetër, ky vendim ka rëndësi sepse përbën një bazë kushtetuese për gjithë legjisllacionin që duhet të ndryshohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të pikës 1 të nenit 181 të Kushtetutës, e cila e detyron Kuvendin që “brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, të nxjerrë ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41”. (Garancitë për mbrojtjen e të drejtës së pronës private). Prandaj këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, ndonëse është botuar në Fletoret Zyrtare në vitin 2001, ja dërguam në muajin tetor 2002 si kujtesë komisionit parlamentar të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë për përgatitjen e ligjit të ri për Kthimin dhe Kompensimin e ish pronarëve si dhe Komisionit të përhershëm parlamentar për ligjet dhe Çështjet Kushtetuese.

Shpresojmë që projektligjet që do të shqyrtojë Kuvendi në zbatim të nenit 181/1 të Kushtetutës të miratohen, duke patur parasysh këtë frymë për respektimin deri në fund të të gjitha të drejtave themelore të asaj shtrese të madhe të njerëzve që përbëjnë ish pronarët.

2. Në vitin 2001, ne paraqitëm një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të shfuqizuar si antikushtetues një pjesë të ligjit nr.8377, datë 22.07.1998 “Për shpalljen e moratoriumit për detyrimet e pashlyera të ish ndërmarrjeve të Tregëtisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt kreditorëve të huaj”.

Për fat të keq, Gjykata Kushtetuese nuk ju fut themelit të çështjes, për të shqyrtuar pretendimin tonë se ky ligj shkel të drejtat e subjekteve juridike (që vlejné njëlloj si për ato të njerëzve, për aq sa përputhen, sipas nenit 16/2 të Kushtetutës sonë). Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.178 datë 08.11.2001 nuk pranoi kërkesën tonë për “mungesë legjitimiteti”. Në këtë vendim arsyetohet se: “Avokati i Popullit kërkon shfuqizimin e një ligji që dihet se nuk është akt i organeve të administratës publike. Prandaj Gjykata Kushtetuese duke iu referuar përmbajtjes së nenit 134, pika 2 dhe nenit 60 të Kushtetutës dhe duke i interpretuar këto dispozita të lidhura me njëra tjetrën arrin në përfundimin se në kushtet kur objekt i kësaj kërkesë është shfuqizimi i një ligji për të cilin Avokati i Popullit nuk ka interes dhe jo shfuqizimi i një akti të organeve të administratës publike, atij i mungon legjitimiteti sepse nuk ka cilësitë e subjekteve që kanë të drejtë ta vënë atë në lëvizje”.

Në Raportin e vitit 2001 të paraqitur në Kuvend, ne theksuam e theksojmë se Avokati i Popullit i zbaton dhe do t’i zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Por kjo edukatë e bindjes ndaj Kushtetutës dhe ligjeve nuk na heq të drejtën që të shfaqim mendimet tona për elementet juridike të çfarëdolloj ligji apo vendimi gjyqësor, në kuadrin e diskutimeve akademike. Këto opinione ne vlerësojmë se duhet t’i bëjmë edhe në zbatim të Rekomandimit nr. R(85) 13 të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtarë të Këshillit të Europës “Mbi institucionin e Ombudsmanit”, i cili “duke marrë në konsideratë që opinionet e ombudsmanit mund të bëhen një faktor kryesor në evolucionin e parimeve dhe rregullave të përgjithshme që rregullojnë funksionimin e administratës dhe sjelljen e punonjësve publikë, u Rekomandon qeverive të shteteve anëtare, (b) të marrin në konsideratë, kur është rasti, veshjen e Ombudsmanit me kompetencat, brenda kompetencës së tij të përgjithshme, për t’u dhënë konsiderata të veçanta çështjeve të të drejtave të njeriut, nën vëzhgim të tij dhe, të fillojë hetime dhe të japë opinione kur kemi një përfshirje të problemeve mbi këto çështje.... dhe (c) të marrin në konsideratë zgjerimin dhe forcimin e

pushteteve të ombudsmanit në mënyra të tjera që të inkurajojnë një vëzhgim efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në funksionimin e administratës”.

Pra, opinioni ynë është se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.178 datë 8.11.2001 ka vepruar në kundërshtim edhe me vendimin e saj nr.49, datë 31.07.2000 me anë të të cilit ka interpretuar pikën 2 të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Siç kemi theksuar edhe më parë, Vendimi nr.49, datë 31.07.2000 është përshëndetur për hapësirat që krijoi për Avokatin e Popullit që të kryejë realisht detyrën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri, të cilat kanë përbërë dhe përbëjnë thelbin e interesave të këtij Institucioni. Edhe konkluzionet e Konferencës së Lubjanës, të mbajtur në nëntor 2001 të organizuar nga Këshilli i Europës me institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut theksojnë ndër të tjera për vendet në tranzicion se “... është e rëndësishme për ombudsmanët që të kenë aftësinë të parashtrojnë një vlerësim të aspektit ligjor dhe kushtetues të rregullave dhe ligjeve përpara Gjykatës Kushtetuese”. Këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese e ka kritikuar edhe organizata prestigjioze e të drejtave të njeriut, Human Rights Watch. Në Raportin botëror për ngjarjet e vitit 2002, publikuar në janar 2003 për Shqipërinë, ndër të tjera pasi përmendën rezultatet pozitive të Avokatit të Popullit, nënvizohet se: “... një vendim shqetësues i Gjykatës Kushtetuese, (i shpallur në nëntor 2001), duket se e ka kufizuar në një masë të madhe kompetencën e Avokatit të Popullit për të inicuar shqyrtimin e Kushtetutshmërisë së legjislacionit”.

3. Gjykata Kushtetuese ka në shqyrtim një kërkesë tjetër të Avokatit të Popullit, për shfuqizimin si antikushtetuese të pikave 3 dhe 5 të nenit 289 të Kodit Doganor, të cilat sipas mendimit tonë, shkelin nenin 13 të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut dhe nenin 8 të Deklaratës Universale të të drejtave të njeriut “Për një ankim efektiv”.

Kjo kërkesë është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese që në muajin nëntor 2001. Bashkë me Avokatin e Popullit është bashkuar si subjekt i interesuar edhe Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë të Tiranës, e cila sipas pikës “f” të nenit 134 të Kushtetutës ka të drejtë të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesat e saj. (Në fakt kjo është një paradoks, sepse Dhoma e Tregëtisë është vënë nga Kushtetuta në pozitë të njëjlojtë me Avokatin e Popullit).

Më datën 24 janar 2002 në Gjykatën Kushtetuese u zhvillua seanca e shqyrtimit të çështjes, në të cilën Avokati i Popullit paraqiti arsyet përse duhej të pranohej kërkesa jonë. Për shkak të rëndësisë së çështjes, këtë

argumentim po e paraqesim si pjesë përbërëse të Raportit tonë vjetor për vitin 2002.

I nderuar zoti Kryetar

Të nderuar zotërinj anëtarë të Gjykatës Kushtetuese

Më lejoni që me anë të kësaj note verbale para jush të ndalem në dy momentet kryesore që kanë lidhje me kërkesën e paraqitur para jush për shqyrtim.

Së pari; për themelin e kërkesës që shqyrtohet:

Argumentet që përmban kërkesa për karakterin antikushtetues të pikave 3 dhe 5 të nenit 289, të Ligjit nr.8449, dt.27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” janë të plota dhe kanë referencat përkatëse për të drejtën e individit për një ankim efektiv, përpara gjykatës. Veçse më lejoni të theksoj edhe se:

a. Nga zbatimi në praktikë i pikave 3 dhe 5 të nenit 289 të Kodit Doganor shkelja e të drejtave të njeriut është e dukshme dhe arbitrare. Kjo sepse:

- Kur detyrimi që i caktohet subjektit së bashku me gjobën është i konsiderueshëm (siç është edhe rasti i ankuesit tonë), dhe subjekti nuk ka mundësi reale për ta paguar, ai nuk mund t’i drejtohet dot gjykatës. Në këtë mënyrë atij i dhunohet e drejta më elementare që ka çdo individ për të bërë padi në gjykatë, parim ky i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën Europiane dhe Deklaratën Universale të të drejtave të Njeriut. Pra ky ndalim ka pasojë direkte, duke shkelur pikën 2 të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se “kushdo për mbrojtjen e të drejtave....., ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik...”. Kjo e drejtë parashikohet njëlloj edhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Theksoj se në shqyrtimin e kësaj çështje të mbahet parasysh edhe kjo shtesë e bazës ligjore mbi të cilën kam mbështetur kërkesën që po shqyrtohet sot.

b. Duke ju hequr subjektit në mënyrë caq të hapur dhe të dhunshme kjo e drejtë, duke iu kërkuar pagesë e menjëhershme apo kur arbitrariteti i administratës doganore shkon deri në bllokim të veprimtarisë së subjektit, pasoja është e pariparueshme. Ky i fundit shkon drejt falimentimit, pavarësisht se gjykata pas 3-4 vjetësh mund të vendosë në favor të tij, sepse vendimi praktikisht nuk ka më asnjë vlerë për personin e dëmtuar padrejtësisht që falimenton. Faktikisht kjo i ka ndodhur edhe ankuesit,

shoqërisë “Ismaili shpk”. Por pavarësisht se si ka përfunduar çështja në Gjykatën e Tiranës, ankuesi tek ne ka ngritur çështjen e pakushtetutshmërisë së nenit 289 të Kodit Doganor dhe jo çështje për keqzbatimin e tij nga administrata Doganore. Prandaj në bazë të nenit 14 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” që thotë se “Avokati i Popullit mund të mos e fillojë ose ndërpret hetimin në qoftë se e njëjta çështje është vendosur ose është në shqyrtim nga prokuroria ose gjykata”, duke patur të drejtën e diskrecionit, ne e kemi vazhduar këtë çështje duke paraqitur kërkesën tek ju.

c. Dua të sjell në vëmendjen e Gjykatës Kushtetuese edhe faktin e pakontestueshëm juridik se problemin e mosmarrëveshjeve administrative e zgjidh Kodi i Procedurës Civile nga neni 325 e në vijim (325, 326, 328, 329), si dhe Kodi i Procedurës Administrative, të cilët siç e pranojmë besoj të gjithë, nuk ka asnjë kufizim të tillë, siç parashikojnë pikat e kundërshtuara të nenit 289 të Kodit Doganor. Duke shqyrtuar nenin 17 të Kushtetutës sonë, mendoj se kufizimi i vënë në nenin 289, të Kodit Doganor cënon thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Këto kufizime nuk justifikojnë “asnjë interes publik ose ndonjë shkak tjetër për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”.

Së dyti; duke patur parasysh dy kërkesa të Avokatit të Popullit dhe dy vendime të Gjykatës Kushtetuese; atë me nr.49 datë 31.07.2000, me objekt: “Interpretimin e pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës për shprehjen “interesa të Avokatit të Popullit” dhe vendimin nr.178 dt.08.11.2001 me objekt “Antikushtetutshmërinë e ligjit nr.8377, datë 22.07.1998 “Për shpalljen e moratoriumit...” del nevoja e sqarimeve mbi legjitimitetin e Avokatit të Popullit për të bërë kërkesa të tilla si kjo që është sot objekt shqyrtimi.

Pyetja e ngritur për këtë çështje ka qenë dhe është e qartë: Nëse Avokati i Popullit mund të ngrerë në Gjykatën Kushtetuese kërkesa për antikushtetutshmëri të ligjeve apo të akteve normative, kur nga ushtrimi i detyrave kushtetuese të tij ka dalë se shkak i shkeljes së të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve nga administratën publike është bërë përmbajtja e këtyre ligjeve apo akteve normative. Në fakt në praktikë janë vërtetuar dy qëndrime në dy vendime të ndryshme të Gjykatës Kushtetuese, të cilat në analizë të fundit kishin objekt pakushtetut-shmërinë e akteve me karakter normative (një rast në trajtën e Vendimit të Qeverisë dhe një rast tjetër në trajtën e ligjit).

Në radhë të parë duhet të përmend se në bazë e për zbatim të Kushtetutës, ligji organik i Gjykatës Kushtetuese i jep të drejta Avokatit të

Popullit që për çështje që lidhen me interesat e tij (si institucion) të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmërinë e ligjeve ose akteve të tjera normative me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare (neni 49), për shqyrtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit (neni 52) dhe për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (neni 71).

Problem i pasqaruar në Kushtetutë dhe me ligj është ai se çfarë duhej kuptuar me “çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit”. Pikërisht për këtë arsye, Avokati i Popullit qysh në fillim të veprimtarisë së tij në qershor 2000 kërkoi para jush interpretimin e pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës.

Ne mendojmë se problemi u zgjidh përfundimisht me interpretimin që bëri Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.49, datë 31.07.2000, interpretim që për nga pikëpamja doktrinare përbën pjesë integrale në vetë dispozitat e Kushtetutës.

Dispozitivi sintezë e këtij vendimi duhet kuptuar i lidhur ngushtë me pjesën arsyetuese të tij, ku me detaje zërthehet nocioni kushtetues “interes”. Sipas vendimit të mësipërm, të cilin po e citojmë fjalë për fjalë çështje me interes për Avokatin e Popullit, do të jenë “pikërisht ato çështje, kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, e aktit normative nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike këto interesa janë cënuar duke shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, shkelje këto, të konstatuara në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij”.

Pra, me të drejtë në këtë vendim interpretues është pranuar që shkeljet në administratën publike mund të vinë jo vetëm nga zbatimi i ligjit, por edhe i aktit nënligjor, kur nuk janë në përputhje me Kushtetutën. Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr.26 dt.24.04.2001 ku është evidentuar se të drejtat e individit ishin shkelur nga zbatimi i një akti normativ e nënligjor (Vendimi i Qeverisë) që binte ndesh me Kushtetutën, çështje e cila u paraqit në Gjykatë nga Avokati i Popullit.

Lidhur me problemin që po trajtoj po ju parashtroj edhe një argument tjetër: Në bazë të nenit 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka si objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Nëse të drejtat shkelen nga veprimet e administratës që zbatojnë një ligj antikushtetues, a mund të ketë pengesë për Avokatin e Popullit për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese kur veprimi nuk është në kuptimin e ngushtë literal (i kundraligjshëm, por është

antikushtetues), sepse bazohet në dispozita antikushtetuese. Do të mendoja se koncepti paligjshmëri i përmendur nga Kushtetuta nuk përjashton antikushtetut-shmërinë, përkundrazi e nënkupton atë e për pasojë, Avokati i Popullit nuk ka se si të mos reagojë kur administrata publike, mbështetur në dispozita antikushtetuese (pra duke vepruar në mënyrë antikushtetuese) çënon të drejtat e interesat e ligjshme të qytetarëve.

Por për fat të keq, në çështjen e ngritur nga Avokati i Popullit për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.8377, datë 22.07.1998, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.178, datë 08.11.2001 ka bërë një interpretim tjetër të interesave të Avokatit të Popullit, duke kufizuar të drejtën tonë për të ngritur çështje para saj vetëm kur të drejtat e individëve që ankohen pranë nesh janë shkelur si rrjedhojë e përmbajtjes së akteve me karakter normative të administratës publike dhe jo prej vetë ligjit.

1. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.178, datë 08.11.2001 del se nuk është i qartë nocioni modern i termit “Administratë publike”. Në shkencën juridike bashkëkohore të vendeve me demokraci të zhvilluar me këtë term kuptohen të gjitha organet, institucionet dhe autoritetet (personat), të cilët financohen dhe paguhen nga buxheti i shtetit si dhe ato ente publike që janë bashkime të interesave pasurore të personave privatë me ato shtetërorë.

Pra, në këtë kuptim, sot me administratë publike kuptohet jo vetëm ekzekutivi (Qeveria), siç ka qenë përkufizuar administrata shtetërore në shkencën juridike të Shqipërisë para vitit 1990, por edhe Parlamenti, Presidenti, Gjykatat, Prokuroria, Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Forcat e Armatosura etj. Por ky përcaktim modern i administratës publike nuk mohon apo nuk përjashton parimin e ndarjes së 3 pushteteve; ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor që përcakton edhe neni 7 i Kushtetutës sonë. Në të kundërt do të dëshiroja që në kuadrin e teorizimeve juridike të drejtoja pyetjen:

Në cilin nga këto tre pushtete bëjnë pjesë Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, Prokuroria, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë etj? Përgjigja ime është se të gjitha këto organe dhe institucione, bashkë me Parlamentin, Qeverinë dhe gjykatat, bëjnë pjesë në Administratën Publike (jo private) të Republikës së Shqipërisë dhe financohen nga i njëjti buxhet i shtetit, që mbushet nga taksapaguesit shqiptarë.

2. Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.49 datë 31.07.2000 e ka bërë një herë në mënyrë pozitive interpretimin e neneve 60 dhe 134, pika 2 të Kushtetutës, lidhur me interesat e Avokatit të Popullit. Duke lexuar vendimin tjetër nr.178, dt.08.11.2001 kjo Gjykatë shprehet se:

“Gjykata Kushtetuese duke iu referuar përmbajtjes së nenit 134 të pikës 2 dhe nenit 60 të Kushtetutës dhe duke i interpretuar këto dispozita të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, arrin në përfundimin se në kushtet kur objekt i kësaj kërkesë është shfuqizimi i një ligji për të cilin Avokati i Popullit nuk ka interes dhe joshfuqizimi i një akti të organeve të administratës publike, atij i mungon legjitimiteti sepse nuk ka cilësitë e subjekteve që kanë të drejtë të venë atë në lëvizje”.

Duke bërë këtë interpretim të ri, Gjykata Kushtetuese mendojmë se:

a. Nuk ka zbatuar mirë pikën 1 të nenit 48 të ligjit nr.8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se: “Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të”. Në rastin konkret të vendimit të sipërcituar, objekt kërkesë, nuk ka qenë interpretimi i Kushtetutës, por antikushtetutshmëria e ligjit nr.8377 datë 22.07.1998.

b. Sipas nenit 124 të Kushtetutës dhe nenit 21 të ligjit organik nr.8577 të Gjykatës Kushtetuese ajo bën interpretimin përfundimtar të saj. Në pikën 4 të vendimit nr.49 datë 31.07.2000 në lidhje me kërkesën tonë për interpretimin e pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës thuhet se: “Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe ka fuqi nga miratimi i Kushtetutës”.

Unë nuk di që të ketë patur ndonjë kërkesë apo të jemi njoftuar nga Gjykata Kushtetuese për të marrë pjesë në ndonjë seancë plenare që të ketë patur si objekt interpretimin apo plotësimin e vendimit të saj nr.49 datë 31.07.2000. Pra në këtë aspekt vërejmë edhe mospërputhje me nenin 80 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

c. Duke shqyrtuar pikën 3 të nenit 31 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese del se legjitimiteti i subjektit për të paraqitur kërkesën tek ajo shqyrtohet në Kolegj prej 3 gjyqtarësh. Përderisa kërkesa për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.8377 u muar në shqyrtim nga mbledhja e gjyqtarëve për zgjidhjen në themel të saj mendojmë se nuk kishte vend që kjo mbledhje, me vendimin nr.178 dt.08.11.2001 të rrëzonte kërkesën tonë për mungesë legjitimiteti.

d. Në vendimin nr.178, datë 08.11.2001 thuhet se “Avokati i Popullit nuk e ka të drejtën për të kundërshtuar aktet e pushtetit legjislativ në Gjykatën Kushtetuese (pra të ligjeve)”, kurse po në vijim shprehet se “Në këto raste, Avokati i Popullit edhe në bazë të nenit 24 të ligjit të tij organik ka vetëm të drejtën e rekomandimit dhe jo të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese... Në bazë të nenit 60 të Kushtetutës funksionin e tij për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, ai

mund ta ushtrojë pa kufizim. Kur këto vlera shkelen ose çënohen nga veprimet dhe mosveprimet e parregullta ose të paligjshme të organeve të administratës publike, qofshin ato akte me karakter normativ, ai ka të drejtë t'i kundërvihet këtyre edhe duke ngritur kërkesa në Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e akteve të tilla si antikushtetuese”.

Nga analiza për sa është shkruar më sipër del:

1. Në termin “akte me karakter normative” nuk mbahet parasysh pika 1 e nenit 116 të Kushtetutës që shprehet se: “Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet dhe aktet normative të Këshillit të Ministrave”. Pra akt normativ nuk është vetëm Vendimi i Qeverisë, por është edhe ligji.

2. Lind pyetja: Pse duhet bërë dallimi i interesit të Avokatit të Popullit në rastet kur shkelja e të drejtave të njeriut ka ardhur nga përmbajtja e një ligji dhe në këtë rast ai nuk legjitimohet, kurse në rastin kur shkelja ka ardhur nga përmbajtja e një akti të Këshillit të Ministrave, Avokati i Popullit legjitimohet të bëjë kërkesë?

3. Neni 134, gërma “dh” e Kushtetutës e ka përcaktuar qartë se Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Lidhur me emrin që do ketë akti juridik me të cilin Avokati i Popullit do të parashtrijë çështjen në këtë gjykatë theksojmë se: Neni 24 i ligjit organik nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ka përcaktuar qartë të drejtën e Avokatit të Popullit për të bërë rekomandime legjislativë. Është e vërtetë se pika “c” e tij shprehet se Avokati i Popullit ka të drejtë “t'i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla” (është fjala për ligjet dhe aktet e tjera normative). Por duke u bazuar në nenin 134 të Kushtetutës ky rekomandim i tillë nuk mund të quhet veçse kërkesë. Pra pavarësisht nga emri që do të ketë akti juridik i Avokatit të Popullit (Rekomandim apo kërkesë), e rëndësishme është që ligji ynë organik na jep të drejtën që: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e akteve të tilla”. Në këtë rast nuk mendoj se është i rëndësishëm emri Rekomandim apo Kërkesë. Megjithatë kur të përgatitim propozimet për ndryshime në ligjin tonë organik, do t'ja parashtrijmë Kuvendit këtë problem, me qëllim që të mos lindin keqkuptime.

Me këtë rast dëshiroj që të shpreh disa mendime në lidhje me rolin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe gjykatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe dallimet ndërmjet tyre. Të dy këto institucione

janë garante të demokracisë dhe të zbatimit të ligjit, të parashikuara për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Por ndërsa gjykata vepron mbi bazën e procedurave të ndërlikuara civile ose penale, proceset zgjatin jo pak në kohë dhe kanë shpenzime për njerëzit, Avokati i Popullit vepron me procedura të thjeshta, të shpejta dhe pa asnjë shpenzim për individët.

Natyrisht Gjykata jep vendime të detyrueshme për zbatim nga të gjitha institucionet dhe personat që ju drejtohen, por që ekzekutimi i tyre shpeshherë në praktikë has vështirësi të panumërta. Ndërsa Rekomandimi, kërkesa apo propozimi i Avokatit të Popullit për të vënë në vend të drejtën e shkelur, ndonëse nuk ka fuqi detyruese, ka lehtësinë dhe oportunitetin që, në emër të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të bëhet objekt sensibilizimi për gjithë shoqërinë dhe gjithë elementet përbërës të saj, përfshirë institucionet dhe shoqërinë civile, duke siguruar shpesh herë një ekzekutim vullnetar të Rekomandimit të Avokatit të Popullit.

Dhe së fundi, dëshiroj që të vë në dukje se në mjaft vende parashikohet nevoja dhe mundësia e paraqitjes së kërkesave të Ombudsmanit (Avokatit të Popullit) para Gjykatave Kushtetuese. Kjo është theksuar edhe në konkluzionet e konferencës së organizuar nga Këshilli i Europës në Ljubjanë në 12-13 nëntor 2001 me temë “Marëdhëniet ndërmjet Ombudsmanit dhe organeve gjyqësore”. Në pikën 7 të këtyre konkluzioneve thuhet se: “Në vendet me tranzicion, të cilat mund të përballen me rregullore (ligje) të vjetërsuara, të mangëta ose të paharmonizuara, si dhe në vendet me demokraci të fortë, është e rëndësishme që ombudsmani të mund të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin e rendit ligjor. Për këtë arsye është e rëndësishme për ombudsmanët që të kenë aftësinë të propozojnë një vlerësim të aspektit ligjor dhe kushtetues të rregullave (ligjeve) përpara Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë ombudsmanët mund të ndihmojnë në eliminimin e mangësive në ligje, mangësi, të cilat mund të ndikojnë negativisht apo madje të shkelin të drejtat e individëve”.

Në disa vënde si Polonia, Sllovenia, Portugalia etj, Ombudsmani ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar antikushtetutshmërinë e ligjeve, kur përmbajtja e tyre krijon premisa për shkeljen e të drejtave të njeriut.

Siç shihet kufizimi i të drejtave të Avokatit të Popullit për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese vetëm kur ligji prek strukturën organizative të institucionit, statusin e drejtuesit apo punonjësve apo kur ligji pengon ushtrimin e kompetencave të këtij organi, mbetet i paargumentuar.

Për më tej, nëse do të pranohej një kufizim i tillë, ai do të dëmtonte rëndë interesat e individëve të prekur nga ligjet antikushtetuese, (të cilat siç dihet, vetë ata nuk mund t'i godasin para Gjykatës Kushtetuese).

Në kushtet kur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (neni 15 i Kushtetutës) do të ishte “non sens” që këto të drejta apo liri të mos garantoreshin realisht apo të garantoreshin vetëm në pikëpamje formale. Dhe dihet gjithashtu që krijimi i institucionit të Avokatit të Popullit është në funksion të garancisë reale të këtyre të drejtave dhe lirive themelore”.

Ndonëse kanë kaluar rreth 14 muaj, akoma Gjykata jonë Kushtetuese nuk ka mundur të shpallë vendimin e saj. Sidoqoftë për mungesë legjitimiteti, kërkesën nuk mund ta rrëzojë për shkakun e thjeshtë se me Avokatin e Popullit është bashkuar edhe Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë, të cilën e ka legjitimuar Kushtetuta të mbrojë interesat e anëtarëve të saj.

Të shpresojmë se Gjykata Kushtetuese në këtë çështje do t'i ketë në konsideratë argumentet e Avokatit të Popullit, por edhe kritikën e Human Rights Watch dhe të mos e ngushtojë me argumente të pabazuara formalo juridikë hapësirën e Avokatit të Popullit për të kërkuar shfuqizimin e ligjeve që krijojnë kushte apo mundësi për shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri.

4. Avokati i Popullit, së bashku me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë në dhjetor 2002 paraqitën në Gjykatën Kushtetuese kërkesën me objekt: “Shfuqizimin si të papajtuëshëm me kushtetutën dhe ligjin, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.441 dt.26.09.2002 “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve”.

Në këtë kërkesë u parashtrua çështja si vijon:

“Në Institucionin e Avokatit të Popullit, ka paraqitur ankesë një shtetas, Administrator i Shoqërisë “Eurovini” sh.p.k, duke parashtruar se megjithëse disponon licensë të rregullt dhe është pronar i truallit ku ka vendosur impiantet e thyerjes e të fraksionimit të zhavorrit, Policia e Ndërtimit Tiranë, pa marrë parasysh ligjin, nëpërmjet dy shkresave, ka urdhëruar pezullimin e veprimtarisë së subjektit dhe çmontimin e menjëhershëm të impiantit të thyerjes dhe fraksionimit të zhavorrit.

Po kështu, pranë Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, janë të shumta ankesat e anëtarëve të saj si subjekte të liçensuara që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e inerteve, të cilët pretendojnë se në kundërshtim me ligjin u është pezulluar veprimtaria dhe janë urdhëruar të çmontojnë impiantet e thyerjes dhe fraksionimit të zhavorrit.

Duke marrë shkas nga këto pretendime, pasi bëmë verifikimet e nevojshme na rezultoi se Policia e Ndërtimit Tiranë ka vepruar në zbatim të VKM Nr .441 dt.26/09/2002. Ne mendojme se:

Vendimi i mësipërm i Qeverisë, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sepse nuk ka pasur aspak parasysh ligjin Nr.8093 dt.21/03/1996 “Per rezervat ujore”, i cili në nenin 6 të tij përcakton mjaft qartë se: “Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror- vendimor për administrimin e rezervave ujore. Këshilli Kombëtar i Ujit drejtohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave”. Pra organi që mund të marrë vendime dhe që duhet të administrojë rezervat ujore është përcaktuar nga ligji dhe është Këshilli Kombëtar i Ujit dhe jo Qeveria.

Ky tejkalim kompetence nga pikëpamja procedurale është shoqëruar dhe me shkelje të rënda kushtetuese e ligjore edhe në përmbajtjen e Vendimit Nr.441 dt.26/09/2002, pika 1 dhe 2 e më konkretisht:

Pika 1 përcakton: “Ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e të gjithë lumenjve”.

Ne vlerësojme se shtrirja pa kufizim e këtij ndalimi për të gjithë subjektet pa dallim, si në kohe, ashtu edhe në objekt (të gjithë lumenjve) dëmton edhe ato subjekte që janë të licensuara, që kanë shfrytëzuar shtretërit e lumenjve për prodhimin e rërës dhe zhavorrit sipas parametrave shkencor dhe kur nga ky shfrytëzim nuk ka ardhur ndonjë pasojë konkrete. Thënë më shkurt, ky ndalim “En block” penalizon pa të drejtë të gjithë subjektet, pa bërë dallim, në një kohë që është deklaruar dhe vërtetuar shkencërisht se shfrytëzimi i disa lumenjeve nuk krijon asnjë pasojë të dëmshme, por e kundërta.

Pika 2 përcakton: “Çmontimin e të gjitha impianteve të thyerjes dhe fraksionimit të zhavorrit që nxirret nga shtretërit e lumenjeve, deri më dt.31/12/2002”.

Urdhërimi në këtë formë mendojmë se vjen në kundërshtim me Kushtetutën tonë, neni 11 dhe 44/1 dhe nuk përputhet as me legjislacionin tonë civil. Kemi mjaft raste, siç është edhe ai i palës së interesuar firmës “Eurovini” sh.p.k. në këtë kërkesë, që subjektet prodhuese të inerteve i kanë instaluar makineritë apo linjat e prodhimit në tokën ose truallin që kanë në pronësi të tyre. Pra vendimi, objekt kundërshtimi, cënon rëndë të drejtat e pronësisë të pronarit të ligjshëm të cilat mbrohen edhe me disa nene në Kushtetuten tone.

Në vijim të argumentave tona e gjejmë me vend të parashtrijmë faktin se këta pronarë të ligjshëm të tokave dhe makinerive do të vazhdojnë veprimtarinë me ato makineri, duke shfrytëzuar gurin gelqeror, (dhe jo

shtretërit e lumenjeve, për aq kohë sa gjykohet shkencërisht e ndaluar), ashtu siç parashikon edhe pika 3 e VKM Nr .441 dt.26/09/2002.

Duke ju referuar edhe një herë Kushtetutës na lejoni të citojmë nenin 11/3 që thotë se: “Kufizime të veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike”. Në rastin konkret janë vendosur jo me ligj, por me një vendim qeverie jo kufizime, por bllokim dhe ndalim të veprimtarisë ekonomike.

Po kështu në ligjin Nr.8093 dt.21/03/1996, në nenet 22 dhe 23/2 është parashikuar organi që vendos rishikimin, anulimin, pezullimin ose kufizimin e lejeve, autorizimeve dhe koncesioneve për raste të përcaktuara qartë në ligj. Gjithashtu ne kërkuesit e gjejmë me vend t’ju informojmë se përpara kësaj kërkesë që ju kemi drejtuar Ju të nderuar gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, kemi konsumuar të drejten tonë morale dhe ligjore që na jep ligji Nr.8454 dt.4/02/1999 “Për Avokatin e Popullit” neni 24/b dhe i kemi rekomanduar Këshillit të Ministrave të ndryshonte VKM Nr .441 dt.26/09/2002.

Në përgjigjen me Nr.3992 prot, dt.14/11/2002, që na dërgon Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, na thuhet se u janë dhënë shpjegimet e duhura të gjitha institucioneve shtetërore, organizmave të huaja, subjekteve private dhe individëve që kanë patur vërejtje në lidhje me VKM Nr.441 dt.26/09/2002, por nuk na thuhet asnjë argument ligjor kundërshtues për sa i kemi parashtruar.

Në këto kushte dhe nisur nga sa parashtruam më lart, në mbështetje të nenit 134 gërma “dh” e “f” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 24 gërma “c” të ligjit Nr.8454 dt.4/02/1999 “Per Avokatin e Popullit”

K E R K O J M E

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të VKM Nr.441 dt.26/09/2002 “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve”.

Në seancat e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese në datat 15 dhe 29 janar 2003 përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave nuk u paraqit, megjithëse ishte njoftuar zyrtarisht. Por para shqyrtimit të çështjes Sekretari i Përgjithshëm kërkoi takim me Avokatin e Popullit dhe e vuri në dijeni se ishte nxituar në përgjigjen zyrtare që kishte dërguar dhe se Këshilli i Ministrave ishte duke përgatitur një vendim të ri, i cili plotësonte kërkesat tona. Kështu që, para datës 29 janar 2003, na dërgoi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.19 datë 10.01.2003 “Për disa ndryshime në

vendimin nr.441 datë 26.09.2002 të Këshillit të Ministrave “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorreve në shtretërit e lumenjve”. Sipas këtij vendimi pikat 1 dhe 2 ndryshohen si vijon:

“1. Veprimtaria e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorreve në shtretërit e lumenjve zhvillohet në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin nr.1 datë 09.01.2003 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërërave në shtretërit e lumenjve”.

2. Çmontimin e të gjitha impianteve të thyerjes dhe të fraksionit të zhavorit që nxirret nga shtretërit e lumenjve, të cilat nuk kanë leje ndërtimi”.

Siç konstatohet më lart, kërkesa jonë drejtuar Gjykatës Kushtetuese është plotësuar, nga Qeveria duke ndryshuar ajo vetë vendimin. Kështu që më datën 29.01.2003 i kërkuam Gjykatës Kushtetuese pushimin e shqyrtimit të çështjes prej saj, kërkesë të cilën ajo e mori parasysh.

Pra në thelb, kërkesa jonë ishte e drejtë dhe çështja u zgjidh në favorin e subjektit “Eurovini” sh.p.k. dhe të gjithë shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë.

5. Opinione të përgjithshme rreth situatës së të Drejtave të Njeriut në Shqipëri

Tashmë është e njohur nga të gjithë që, një nga qëllimet kryesore të procesit të shndërrimit të shoqërisë shqiptare, nga sistemi socialist në një sistem thellësisht demokratik në Shqipëri, ka qenë ndër të tjera dhe krijimi i një sistemi të fortë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Kuadri i ri ligjor ka pasqyruar të gjitha rregullat bazë të instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe ka futur ndryshime pozitive në raport me regjimin paraekzistues të tyre. Ai ka zgjeruar në mënyre të jashtëzakonshme listën e këtyre të drejtave dhe lirive themelore.

Kushtetuta e vitit 1998 është akti themeltar për garancitë ligjore dhe kushtetuese në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Kapitulli kushtetues mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përbën një katalog të përpunuar të të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat bazohen në standartet më të larta ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Kjo kushtetutë ka përcaktuar qartë që “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të patjetërsueshme dhe i takojnë çdo njeriu me lindjen e tij”.

Ajo gjithashtu parashikon që “njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është detyrë e shtetit”.

Duke qenë një akt me vlera të padiskutueshme në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Kushtetuta ka ndryshuar dhe pozicionin e shtetit në lidhje me sferën e të drejtave të njeriut të parashikuara në të. Pra, shteti nga një ndërhyrës aktiv dhe kontrollues i të drejtave individuale, kalon në një pozicion më pasiv, në të cilin, ai iu njeh në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë të drejtat dhe liritë individuale të gjithë qytetarëve pa dallim dhe heq të drejtën pa kufi për të ndërhyrë në sferën e ushtrimit të tyre. Ndërhyrja e shtetit justifikohet vetëm në rastet kur ka një interes publik të njohur, që çënohet nga veprimet e individëve, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Të njëjtat standarte janë vendosur dhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Karta e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit European (Konventa e Nisës).

Por, hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t’i zbatuar ato mirë është një element po aq thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Dhe në drejtim të aplikimit me efikasitet të këtij kuadri ligjor hasen një sërë problemesh dhe fenomenesh negative serioze që kërkojnë zgjidhje. Ndër to, mund të përmendim ndryshimet e shpeshta ligjore e të strukturave shtetërore, pavendosmëria e institucioneve shtetërore në disa raste për zbatimin e ligjeve, shkaktuar nga faktorë të ndryshëm të karakterit kryesisht subjektiv, si dhe mungesa e koordinimit në nivelet e kërkuara midis tyre. E gjitha kjo ka sjellë si pasojë që në disa fusha të ketë një veprimtari të zbehur të organeve shtetërore, të cilat në mjaft raste nuk arrijnë të kryejnë veprimtarinë e tyre sipas ligjit. Në këto kushte kanë marrë jetë mjaft fenomene negative, që në thelb janë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Duke u bazuar në rekomandimin nr. (85) 13 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës, mbi institucionin e Ombudsmanit, ne përfitojmë nga rasti për të dhënë konsiderata të veçanta për çeshtje të të drejtave të njeriut. Në lidhje me gjendjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri jemi shprehur edhe gjatë këtij raporti, kur kemi analizuar fusha të caktuara, por për disa probleme që do të prezantojmë më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet e publikuara në Mediat shqiptare, si dhe në raportet e organizmave dhe institucioneve prestigjioze kur flasim për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë ato të Bashkimit European, Këshillit të Europës,

Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Human Rights Watch etj.

E drejta e jetës është e drejtë themelore e njeriut, por ajo vazhdon të jetë e rrezikuar për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontroll në duart e popullsisë civile dhe të marrin jetë njerëzish. Ashtu siç e kemi prezantuar dhe në Raportin Vjetor 2001, ligji për mbledhjen e armëve nuk ka dhënë rezultatet e pritshme. Ne kemi propozuar që, mbase do të ishte më mirë që fillimisht armët të deklarohen dhe legalizohen dhe pas një kohe të mëvonshme, ato të mblidhen, duke nxjerrë një ligj të ri.

E drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut ka qenë në qendër të Konferencës Kombëtare që Avokati i Popullit organizoi në Dhjetorin e vitit 2001. Synimi i saj ishte inicimi i një strategjie kombëtare të përbashkët nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj konference u prezantuan vjet dhe u publikuan. Por këto rekomandime, nuk rezultojnë të jenë zbatuar deri tani nga të gjitha autoritetet, të cilave ato u janë drejtuar. Veç Ministrisë së Rendit Publik, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Arsimit dhe Shkencës nuk kemi dijeni që të kenë bërë ndonjë gjë për këtë çështje.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria e ndërgjegjes dhe e fesë, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësisë e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa apo dhe mbrojtje të tyre me anë të proceseve gjyqësore. Por mendimi ynë, ashtu sikundër është thënë dhe më parë, është se këto të drejta dhe liri përgjithësisht respektohen. Janë ndëshkuar shkaktarët, kur janë vërtetuar shkelje të tyre të kryera nga autoritete publike, apo nga individë të veçantë që ju kanë cënuar këto të drejta individëve që janë ankuar, qoftë në organet gjyqësore, qoftë tek Avokati i Popullit.

Për lirinë e shtypit, medias e televizionit, duhet thënë se ka patur raste kur kjo liri është shkelur, por më tepër raste kur ajo është tejkaluar. Mediat tona nuk e konsiderojnë shkelje të japin me hollësi të dhëna personale që shkelin të drejtën e privacisë, të rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 8517, datë 22.07.1999, "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Më e theksuar është kjo kur ka akuza për vepra penale dhe, aq më tepër, kur janë të akuzuar dhe të dëmtuar të miturit apo femrat e shfrytëzuara për trafikë të paligjshme.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit dhe tubimit, janë të garantuara me ligj dhe në përgjithësi respektohen. Këtë opinion ne kemi dhënë dhe në raportin e vitit të kaluar. Avokati i Popullit është shprehur dhe përshendet masat legjislative për të zbatuar Rekomandimet e ODIHR-it, për respektimin e të drejtës themelore të votës së lirë për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, për të mos lejuar asnjë mundësi manipulimi.

Konstatohet se mjaft të drejta dhe liri të tjera themelore shkelen apo nuk realizohen. Shumë nga problemet që ne kemi konstatuar dhe prezantuar shpesh herë, mbeten të njëjta. Puna e fëmijëve vazhdon të jetë e përhapur; kërkesat për arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar, nuk merren parasysh; numri i fëmijëve që kanë braktisur shkollën është rritur dhe cilësia e arsimit shqetëson si prindërit, ashtu dhe specialistët e fushës së arsimit. Lëvizja e popullsisë, gjithmonë në rritje dhe e paplanifikuar nga zonat më pak të zhvilluara, drejt qyteteve kryesore dhe kryeqytetit ka krijuar vështirësi në shërbimet shëndetësore dhe në ato të arsimit, ndërsa cilësia e këtyre shërbimeve në zonat rurale është në rënie. Sipas njoftimeve të publikuara, ka fshatra dhe krahina të tëra, ku shumë fëmijë, të nxitur nga shkaqet ekonomike, braktisin shkollat. Veç kësaj ka mjaft raste kur fëmijët përdoren si “skllever” për të lypur apo prostitucion. Fëmijët që janë më shumë në rrezik jete apo shëndeti, janë ata të familjeve që banojnë në zonat më të varfra, siç është rasti i familjes Zyberi nga Kukësi, tashmë i bërë publik. Shpesh gjithë këto familje jetojnë në varësi të fëmijëve të tyre, të cilët punojnë jashtë shtetit për të fituar bukën e gojës. Nga shifrat e publikuara në një raport të vitit 2002 të “Save the Children” rezulton që Shqipëria vazhdon të mbetet përsëri një vend burimi i trafikimit të qenieve njerëzore. Në veri të vendit ka shumë fëmijë që janë të rrezikuar nga gjakmarrja dhe si rrjedhojë të përjashtuar edhe nga edukimi, prandaj gjendja e tyre është vërtetë e mjerueshme. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, është ratifikuar nga vendi ynë, me dekret të Presidentit në vitin 1992. Të 54 nenet e kësaj konvente përbëjnë një tekst themeltar të të drejtave të fëmijëve në shkallë botërore. Kjo marrëveshje ndërkombëtare për ligj të drejtat e fëmijëve dhe i jep fuqi detyruese mbrojtjes juridike të fëmijëve. Neni 44 i kësaj konvente u kërkon shprehimisht shteteve që e pranojnë atë të paraqesin një raport mbi ecurinë e zbatimit të saj, brenda dy vjetësh nga data e miratimit. Në vitin 1994, shteti ynë, në bazë të kësaj Konvente, ishte i detyruar të paraqiste pranë Komitetit për të drejtat e fëmijëve në O.K.B. një raport për gjendjen e të drejtave të fëmijëve, raport i cili duhet të përgatitet çdo 5 vjet. Deri tani, nuk rezulton të jetë paraqitur ndonjë raport zyrtar. Ky raport do të bënte të mundur që shteti shqiptar të

vlerësojë progresin e bërë dhe të përkushtohet në ato fusha, ku detyrimet e tij ndaj fëmijëve nuk janë përmbushur plotësisht.

Hartimi i një ligji të posaçëm për të drejtat e fëmijëve, mendojmë se është i domosdoshëm. Po kështu, akoma nuk funksionon një sistem gjyqësor dhe penitenciar, i veçantë për minorenët. Vlen të përmendet si moskrijimi i qendrës për edukimin e minorenëve, ashtu dhe mungesa e burgut të veçantë për minorenët. Duke patur parasysh edhe debatin që ka nxitur rasti i fëmijëve të familjes Zyberi, ndoshta ka ardhur koha të mendojmë për krijimin e një autoriteti shtetëror të fortë që të jetë nxitës i instancave dhe institucioneve të ndryshme, për zhvillimin dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve. Deri tani promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve janë realizuar përgjithësisht nga organizatat jofitimprurëse dhe jo nga autoritetet shtetërore.

Të rënda janë dhe shkeljet e të drejtave të Grave. Nuk ka shifra të sakta për numrin e femrave viktime të trafikut për qëllim shfrytëzim prostitucioni. Ashtu sikundër kemi thënë në Raportin Vjetor 2001, është i rëndësishëm forcimi i legjislacionit, miratimi i programeve dhe politikave, por dhe monitorimi i këtij procesi nga organizmat përkatëse, të përcaktuara në strukturat qeveritare, enkas për këtë drejtim pune. Duket që kohët e fundit, krimi i organizuar është përqendruar më shumë në rekrutimin e grave të huaja, të cilat kalojnë tranzit nëpër Shqipëri për në Europën Perëndimore, sesa në trafikun e grave shqiptare. Kjo ka ardhur dhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuese të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Paraqitja e raportit kombëtar periodik fillestar dhe të parë për zbatimin e Konventës së OKB-së “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”, është një hap shumë i rëndësishëm i shtetit shqiptar, ndaj plotësimit të detyrimeve që ai ka me nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Çështje që kanë të bëjnë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave janë publikuar shpesh në shtyp. Situata mbetet e njëjtë lidhur me Kodin e ri të Familjes, i cili rezulton i pamiruar akoma, duke pritur rradhën në Qeveri apo në Kuvendin e Shqipërisë. Komiteti për Mundësi të Barabarta, me një personel prej 13 personash, i cili ka pothuajse aq ekspertë sa ka dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, mendojmë se duhet ristrukturuar për të mos qenë një organizëm që bën vetëm studime dhe propozon politika, por të ketë mjete efektive për të ndikuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave.

Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, megjithë përmirësimet nga viti në vit, paraqet ankesa dhe probleme. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në

spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues. Problemet janë publikuar edhe në Raportet tona të vitit 2000 dhe 2001. Është mjaft pozitive që Qeveria Shqiptare dha lejen për bërjen publike të dy raporteve të Komitetit European për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit ç'njerëzor dhe poshtëruës (CPT). Në këto raporte, të përgatitura pas dy inspektimeve në Shqipëri në vitet 1998 dhe 2001, janë përcaktuar si shkeljet, ashtu dhe rekomandimet përkatëse. Besojmë që Kuvendi dhe Qeveria Shqiptare do të punojë seriozisht për zbatimin e këtyre rekomandimeve, ndaj të cilave edhe ne reagojmë vazhdimisht.

Kujdesi shëndetësor, ndihma dhe përkrahja sociale janë akoma në nivele të ulta, jo vetëm për shkak të mungesës financiare në buxhet, por edhe për shkak të abuzimeve dhe shfaqjeve korruptive. Vlen për t'u përhëndetur ratifikimi nga Kuvendi i Shqipërisë në Tetor 2002 i Kartës Europiane Sociale të ndryshuar. Tashmë është e rëndësishme që edhe kjo Kartë të zbatohet në praktikë.

Kuptohet që jo të gjitha të drejtat ekonomike dhe sociale mund të garantohen plotësisht. Por Qeveria duhet të lëvizë drejt realizimit të tyre dhe jo të shkojë mbrapa. Ndonëse mund të jetë e pamundur për çdo njeri të ketë një punë, Qeveria duhet të përpiqet maksimalisht për të krijuar mundësira punësimi, shanse të barabarta dhe një mjedis të përshtatshëm për të punuar.

Korrupsioni është i përhapur gjerësisht si në administratë, ashtu edhe në gjyqësor. Për këtë aspekt, në Raport kemi bërë disa konstatime dhe Rekomandime të veçanta. Por si për policinë, për gjyqësorin dhe prokurorinë do theksojmë se jo rrallë kemi patur ankesa për veprime që shkelin të drejtat e njeriut. Siç theksoi dhe Konferenca e pestë organizuar në Sarandë nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European për reformat në gjyqësor, duhet vazhduar puna për përmirësimin e cilësisë së normave ligjore, pra përmirësimin e teknikave të hartimit të ligjeve, nga baza deri në Parlament; lufta kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; nevoja e përmirësimit të punës të inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; zbatimi pa ekuivok i vendimeve gjyqësore; reforma për përjasjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, në veçanti për probleme të tilla si pastrimi i parave, korrupsioni, terrorizmi dhe mbrojtja e dëshmitarit; përmirësimi i marrëdhënieve midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave, lufta kundër krimit të organizuar; riorganizimi i Dhomës së Avokatëve, pas miratimit të një ligji të ri për avokatinë etj.

Si përfundim theksojmë se, nga ana e Parlamentit dhe Qeverisë kërkohet një përkushtim për të siguruar krijimin e sistemeve të duhura për të monitoruar dhe vlerësuar efektivisht rezultatet e programeve të

përcaktuara për t'u zbatuar, në funksion edhe të Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit.

Në vendin tonë, nocioni i mbrojtjes me transparencë të të drejtave të individëve, nga fuqia e abuzimit të shtetit është relativisht i ri. Përmirësimi i mëtejshëm i gjëndjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, varet gjerësisht nga njohja dhe respektimi i shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Siç është e qartë për të gjithë, përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo vend janë Parlamenti dhe Qeveritë që dalin prej tij. Në këtë kuadër, secili duhet të bëjë punën e tij. Avokati i Popullit e ka të qartë rolin dhe ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë vetëm detyrën e tij kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

6. Veprimtaria e Avokatit të Popullit në Marrëdhëniet me Publikun

Marrëdhëniet publike të Avokatit të Popullit shprehen në performancën e tërë kontakteve të përfaqësuesve të Institucionit tonë me individin, administratën dhe publikun në tërësi. Rezultatja e tyre krijon imazhin institucional, duke reflektuar kompetencat dhe juridiksionin që atij i njeh Kushtetuta dhe Ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Marrëdhëniet publike fillojnë që nga elementet etike në kontaktet e para me ankuesit, deri tek ato institucionale me zyrtarët e shtetit, pavarësisht nga hierarkia. Natyrisht që dimensionin e tyre më të plotë, marrëdhëniet publike e fitojnë përmes marrëdhënieve me pushtetin e katërt, pra me shtypin e shkruar dhe median në tërësi.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rritim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se **sukses**i arrihet duke u bazuar në dy shtylla, të cilat janë zgjidhjet me **kompetencë** profesionale dhe transparenca në punën tonë. Por ne jemi munduar që të mënjanojmë çdo element demagogjik në marrëdhëniet me median. Ne mendojmë se këtë e kemi arritur, duke zbatuar një strategji disi të veçantë të informimit për punën tonë. Kemi dhënë materiale Mediave, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. Por jemi munduar të bëjmë edhe përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparencë nga ekspertët tanë.

Në raportimet tona vjetore para Kuvendit, ne bëjmë evidentimin e çdo informacioni në shtyp nga ne dhe për ne. Këtë nuk e kemi parë thjesht

si element teknik. Tabelat përkatëse të mbulimit mediatik pasqyrojnë praktikën tonë njëvjeçare, duke evidentuar problematikën që ne kemi bërë publike në Media. Tregues tjetër është intensiteti dhe frekuenca e pranisë sonë në Mediat. Sipas monitorimit që kemi mundur të bëjmë, rezulton se Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2002, ka qënë 243 herë i pranishëm në Median e shkruar, dhe 90 herë në Median elektronike. Në krahasim me vitin 2001 është rreth dy herë më shumë. Por kryesore është që këtë rritje sasiore, në krahasim me një vit më parë, ne nuk e shohim si qëllim në vetvete. Kjo është diçka e ndryshueshme nga viti në vit, pa mohuar këtu edhe pamundësinë objektive dhe subjektive të evidentimit në masën njëqind përqind të të gjithë paraqitjeve në Mediat. Por tregues cilësor është zgjerimi i gjeografisë dhe shumëllojshmërisë tematike të këtij mbulimi mediatik.

Përmes Medias ne jemi njohur edhe me ankimet e mjaft njërëzve, por dhe me prioritetet e Qeverisë shqiptare. Në këtë mënyrë, fokusin e punës tonë e kemi drejtuar për të krijuar precedentë në ato sektorë të qeverisjes, tek të cilët kërkohet krijimi dhe rritja e standarteve për shërbimet publike, zbatimin e të drejtës së informimit, përmirësimin të legjislacionit për pronësinë, lufta kundër korrupsioni, kundër abuzimeve të zyrtarëve si dhe fusha të tjera që janë pasqyruar në kreun përkatës sipas rasteve.

Bashkëpunimi me Mediat na ka mundësuar aksesin e nevojshëm në publik si dhe krijimin e integritetit të domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të parashikuar, si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Duke përqafuar vlerësimin se gazetarët janë “rojtarë publikë”, bashkëpunimin me ta e kemi parë si mjetin, pa të cilin edhe publiku nuk do të dinte si të na drejtohej, sikunder edhe zyrtarët nuk do të njiheshin me forcën praktike të instrumentit tonë të vetëm, që është Rekomandimi i bazuar në ligj dhe i përpiluar me fuqinë më të madhe të mundshme argumentuese. Veçoria e rekomandimit të Avokatit të Popullit është se për të arritur deri tek ai kërkohet dhe mundësohet një kohë më e madhe fizike dhe intelektuale, për më tepër kur operohet nga një këndvështrim edhe më i gjerë, sikundër është mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Gazetarëve u jemi ofruar jo vetëm për t’u dhënë informacionin e prodhuar prej zyrës sonë, por edhe për t’i ndihmuar të marrin informacion nga zyra të tjera, nëpunësit e të cilave ende nuk janë qartësuar sa duhet për ekzistencën e një ligji për të drejtën e informimit. Kontaktet me ta janë të përditshme, mjaft që informacioni të jetë i gatshëm për t’u servirur. Organeve të medias, qysh në fillim, u kemi dërguar një ftesë, duke u

kërkuar të caktojnë një gazetar(e) për të patur raporte të përhershme me institucionin e Avokatit të Popullit. Për këtë, komisionerët përgatisin herë pas here statistika për punën e secilit seksion. Me porosi të Avokatit të Popullit, këto të dhëna vihen në dispozicion të Zëdhënësit, për t'i pasqyruar më pas në shtyp, sipas rastit. Në praktikën tonë kemi përdorur metodën e kontaktimit të gazetarëve me, së paku, tre persona të stafit tonë. Kjo, për të sqaruar më mirë problemin që do të trajtohet në shtyp, si dhe për të transmetuar në media atë ide, që në synojmë të përcjellim tek publiku, me synim edukimin e tij me praktikat e drejta ligjore.

Larmia e problematikës, që është pasqyruar në Mediat është pasqyruar pa komente në tabelat përkatëse me statistikat e mbulimit mediatik. Në një farë mënyre, duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacioneve nga ne dhe për ne, bëhet e qartë edhe veprimtaria që kemi kryer dhe sa kemi mundur ta bëjme të njohur atë për publikun.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje edhe me iniciativë, parashikuar nga neni 13-te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. I gjithë spektri i shtypit të përditshëm, atij periodik shqiptar si dhe sherbimi i plotë i ATSH-se, filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë.

Informacionet që paraqesin interes për objektin e punës sonë, u shpërndahen seksioneve, sipas problematikës, të cilët më pas bëjnë verifikimet përkatëse dhe, sipas rastit, ose nisin investigimin ose i mbajnë në evidencë për arsye studimore.

Në strategjinë e mbulimit mediatik janë patur parasysh si ndërgjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit. Kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në Mediat të të gjitha rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar, duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit. Veç kësaj, Mediat na kanë ndihmuar edhe me rolin e tyre si mjet presioni, qoftë mbi ne, qoftë mbi administratën apo personat e veshur me autoritet publik, kur këta të fundit e kanë bërë veshin të shurdhër përballë halleve të njerëzve dhe rekomandimeve tona të radhës.

Mjetet që kemi përdorur kanë qënë ato të parashikuara në strategjinë që kemi formuluar që në fillim të veprimtarisë sonë njohëse dhe sqaruese për grupe të ndryshme të komunitetit. Vitin e kaluar ne vazhduam të shpërndajmë pesë fletëpalosje për grupe të ndryshme interesi, përmes të cilave shpjegojmë rolin, kompetencat dhe rrugët si mund t'i drejtohen Avokatit të Popullit. Dokumentari njohës dhe promovues për Institucionin e Avokatit të Popullit tashmë është transmetuar në shumicën e televizioneve lokale dhe kombëtare. Një kalendar me tematikë nga Konferenca Kombëtare me temë “E drejta e informimit, e drejtë themelore

e njeriut”, u është shpërndarë thuajse te gjitha organeve të pushtetit qëndror edhe vendor, si dhe gjithë deputetëve. Të disponueshme kanë qënë broshura në gjuhën shqipe dhe angleze, sikundër edhe pesë spotet televizive që informojnë publikun për shërbimet që ne ofrojmë dhe rrugët e përfitimit të këtyre shërbimeve. Instalimi i teknologjisë informative na ka mundësuar që tashmë të kemi edhe faqen tonë në Internet, ku të interesuarit mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo. Mbulimi mediatik ka qënë gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni ka kryer.

Avokati i Popullit ka patur gjithmonë vizionin se Marrëdhëniet Publike nënkuptojnë jo vetëm komunikimin përmes medias me publikun, por edhe transparencën për raportet institucionale mes tij dhe Parlamentit, Qeverisë, Pushtetit Lokal, OJF-ve, pra gjithçka që institucioni krijon dhe realizon në fushëveprimin e juridiksionit të tij, duke përdorur kompetencat që i njeh ligji.

Duke bërë herë pas here një analizë të secilit seksion për punën e kryer, ne kemi punuar paralelisht edhe për zbatimin e pikave bazë të strategjisë sonë në fushën e marrëdhënieve me publikun, sidomos përmes Medias. Në tërësinë e saj, kjo **Strategji** e mbulimit mediatik, si pjesa thelbësore e **Marrëdhënieve me Publikun** është formuluar që në vitin 2000 dhe është publikuar edhe në Raportin e vitit të kaluar. Por për vetë rëndësinë që ajo paraqet kemi menduar që ta rikujtojmë, duke e paraqitur si vijon:

Objektivi ka qënë dhe mbetet njohja dhe promovimi i mëtejshëm në Media i rolit, detyrave dhe funksionimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, me synim ndërgjegjësimin e publikut, ruajtjen e kontaktit të rregullt me publikun, njohjen e administrates me ankesat e qytetarëve, ushtrimin e presionit dhe stimulimin e administratës publike për të pranuar rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Tematika bazë që ka përshkruar veprimtarinë tonë ka qënë:

a-Roli i Avokatit të Popullit, të drejtat dhe detyrat e tij kushtetuese.

b-Procedimi me kërkesat dhe ankesat e qytetarëve ndaj shkeljeve të administratës shtetërore në të gjitha nivelet.

c-Raporti që krijon ky Institucion me organet e tjera të shtetit.

ç-Përparësitë e adresimit të ankesave të njerëzve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit.

d-Raporti i Shoqërisë Civile me shtetin e së drejtës, dhe si kontribuon Avokati i Popullit në ruajtjen e kohezionit të atyre

institucioneve që përbëjnë alternativa vetrregulluese brenda shtetit demokratik.

dh-Si depozitohen kërkesat dhe ankesat pranë Avokatit të Popullit. Afatet e shqyrtimit të ankesave për të drejtën e shkelur, shkallët e angazhimit të këtij institucioni për rivendosjen e kësaj të drejte. Cili është çmimi që paguan administrata për moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me shkeljet e së drejtës së qytetarit ose nëpunësit.

Grupi i synuar ka qënë dhe mbetet opinioni publik, administrata publike, përfaqësuesit e OJF-ve, si dhe Shoqëria Civile në tërësi.

Vizioni është se bashkëpunimin me Mediat e konsiderojme bazën e marrëdhënieve publike dhe mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik si dhe krijimin e integritetit të domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të parashikuar nga ligji kushtetues. Transparenca dhe Media kanë qënë, janë dhe do jenë aleatët e shpallur dhe të sigurtë të Avokatit të Popullit.

Mjetet e realizimit:

a-Media elektronike dhe e shkruar.

b-Takimet njohëse dhe sqaruese me grupe të ndryshme të komunitetit.

c-Hapja e një faqe Interneti.

ç-Botimi i fletëpalosjeve, posterave, kalendarëve dhe broshurave.

d-Prodhimi i spoteve televizive dhe dokumentarëve, duke siguruar shpërndarjen e tyre, si përmes Medias elektronike, ashtu edhe nëpër institucione të ndryshme, si zyra, shkolla etj, në zona të ndryshme të vendit.

dh-Prodhimi i materialeve të ndryshme promocionale, si stema, statueta etj, me logon e institucionit.

e-Kontaktet e përditshme me shtypin si dhe njoftimet apo deklaratat për shtyp për çështje të rëndësishme me impakt të gjerë në mirëqeverisje.

A. Kontakti me Mediat është realizuar me:

1.Intervista (të programuara ose jo të programuara).

2.Biseda-show, pyetje – përgjigje direkte.

3.Njoftime për shtypin.

4.Kontakte të drejtpërdrejta me gazetarët për t'i njohur me rastet tona, duke filluar nga eksperti, zëdhënësi, komisioneri deri tek Avokati i Popullit.

5.Fushata promocionale (video klipe 10-20 sek) në TV dhe në Radio, duke zgjedhur si logo, fjali goditëse si p.sh. “E drejta juaj – misioni ynë”, “Avokati i Popullit – Një derë e hapur për Ju” etj.

6. Cikël emisionesh televizive dhe radiofonike sipas problematikës së ankesave pranë Avokatit të Popullit.

B. Takimet me popullin janë të rëndësishme, pasi vendosin kontaktin fizik me zyrën dhe e bëjnë atë më të prekshme. Kjo realizohet duke kryer:

1-Biseda në shkolla dhe universitete.

2-Biseda në qytete të ndryshme.

3-Biseda me administratën, sipas sektorëve që ne mbulojmë.

4-Seminare me përfaqësues të administratës, gjyqësorit, legjislativit dhe shoqërisë civile.

C. Faqe Interneti dhe sigurim i lidhjeve me institucionet e ndryshme, sidomos me qëndra të tjera për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, brenda dhe jashtë vendit. Faqja jonë e Internetit është hapur në fund të vitit 2002. Me vetëdijen se e tanishmja dhe e ardhmja i përket gjithmonë e më shumë botës së informacionit dhe internetit, kemi parashikuar që faqja jonë në Internet përmban:

1- Pjesët e Kushtetutës dhe Ligjin “Për Avokatin e Popullit”.

2- Strukturën e Zyrës së Avokatit të Popullit.

3- Biografi profesionale e Avokatit të Popullit dhe Komisionerëve.

4- Mesazh-logo nga Avokati i Popullit.

5- Informacion mbi veprimtaritë e Zyrës, raportet vjetore ose specifike të saj.

6- Formularin tip për ankesat e qytetarëve.

7- Adresë e-maili për të kontaktuar me Avokatin e Popullit.

8- Adresa postare dhe telefonike.

Ç. Fletëpalosje për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, te cilat shpjegojnë si funksionon, si kontaktohet dhe çfarë realizon ai:

E. Zëdhënësi i është drejtuar Mediave për probleme të ndryshme, për të shpallur qëndrime apo statistika, apo për të sqaruar opinionin për raste të caktuara apo për të publikuar përmbajtjen e bisedave të zhvilluara gjatë takimeve të Avokatit të Popullit me homologë të tij, brenda apo jashtë vendit, me autoritetet më të larta të shtetit tonë etj.

Format dhe mënyrat e realizimit në Radio e Televizion kanë qënë:

a. Biseda të drejtpërdrejta, kohëzgjatja e të cilave ka qënë rreth një orë në studio.

b. Intervista të regjistruara në ambiente të caktuara, duke biseduar me gazetarin intervistues; biseda të përgjithshme nga 15-20 minuta dhe më pas lidhje telefonike me shikuesit.

c. Pyetje-përgjigje të përgatitura nga vetë ekspertet, komisionerët dhe Zëdhënësi. Këto mund të transmetohen një herë në javë në një cikël “Të njohim Institucionin e Avokatit të Popullit”.

d. Biseda të drejtpërdrejta në radio të titullarëve ose edhe të ekspertëve lidhur me çështje konkrete dhe spontane të ngritura nga dëgjuesit.

Metodologjia.

a. Intensiteti i prononcimit është në progresion të ngritjes shkallë-shkallë. Ideja është të ruhet një farë hierarkie, në kuptimin që interesi për atë që flet më pas të vijë në rritje dhe jo në zvogëlim. Fillimisht në shtyp dilet me ndonjë shkrim të përgjithshëm, jo drejtpërdrejt, por duke iu referuar apo cituar Zëdhënësit apo ndihmëskomisionerëve. Më pas angazhohen drejtpërdrejt dhe njëri pas tjetrit Komisionerët, deri sa ngrihet shkalla e prononcimit me Avokatin e Popullit. Zëdhënësi mund të prononcohet për çështje nga më të ndryshmet dhe sa herë që Titullari gjykon nëse duhet dhe si mund të reagojmë për një çështje të caktuar, duke shprehur qëndrimin zyrtar të Institucionit.

b. Takimet dhe vizitat e ndryshme zyrtare dhe protokollare, apo edhe aktivitetet e Zyrës si seminare apo konferenca shtypi shpesh bëhen publike sipas rastit, përmes njoftimeve me shkrim, dërguar ATSH-së dhe gjithë televizioneve si dhe organeve të ndryshme të shtypit.

Mjetet për realizimin janë shfrytëzimi i Teknologjisë Informative dhe softet përkatëse të sistemit internet dhe intranet, skaner, diktofon, aparat fotografik, kamera.

Krijimi i aftësive po arrihet përmes pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për t'u përditësuar me problematikat dhe stilin e punës, si dhe për t'u trajnuar dhe shkëmbyer eksperiencë.

Burimi i financimit janë buxheti i institucionit ose donacionet e huaja (në rastin tonë programi DANIDA, apo Këshilli i Europës), mbi bazën e projekteve që miratohen sipas kriterëve profesionale dhe rregullave administrative e financiare të shtetit shqiptar. Fondet alokohen sipas projekteve të ofruara nga grupe të ndryshme prodhuese.

Sa më sipër është një proces i vazhdueshëm e si i tillë mbetet objekt ndryshimesh dhe përmirësimesh, sipas angazhimit të personave konkretë, mundësive financiare që Zyra ka patur apo do të ketë në dispozicion apo kushteve të tjera të paparashikueshme.

Në mënyrë më të detajuar, strategjia e mësipërme u është bërë e njohur edhe përfaqësuesve të faktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë që veprojnë në Shqipëri. Ata e kanë vlerësuar dhe janë shprehur të gatshëm për të mundësuar financiarisht të gjitha aktivitetet tona në këtë drejtim. Po kështu kjo strategji dhe realizimet e saj u janë paraqitur edhe homologëve

tanë që na kanë vizituar si dhe në seminarin e organizuar posaçërisht në Sarajevo më 25 janar 2003. Kjo strategji është vlerësuar mjaft pozitivisht.

Sidoqoftë, aktivitetet bazë, pavarësisht nga koha e realizimit të tyre, kanë qënë dhe mbeten intervistat dhe bisedat njohëse dhe tematike në Radio-televizionet kombëtare dhe lokale, me të cilat Zyra tashmë ka vendosur marrëdhënie të rregullta.

Këto veprimtari të përcaktuara në Strategjinë e Marrëdhënieve Publike, janë një proces që kryhet në vazhdimësi.

Ne kemi konkluduar se veprimtaria jonë në fushën e Marrëdhënieve Publike ka ndikuar që të rritet ngarkesa e punës, gjë e cila vlerësohet edhe nga publiku shqiptar dhe partnerët e huaj. Sfidë për të ardhmen mbetet informimi dhe edukimi i grupeve të synuara, me qëllim që të mundësojmë sa të jetë e mundur racionalizimin dhe lehtësimin e ngarkesës së punës.

7. Ditët e Hapura, përvojë e re e Institucionit të Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2002 filloi të zbatojë një formë të re të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, që e quajmë “Ditët e hapura”. Kjo formë e takimeve të drejtpërdrejta me publikun lindi nga vizioni ynë se qytetarët duhet ta ndjejnë kudo mirëqeverisjen e shtetit të tyre. Në kushtet e një decentralizimi gjithnjë e në rritje në favor të kompetencave të qeverisjes vendore, Avokati i Popullit mendon se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku lindin dhe me personat që, me dashje apo nga padituria, ua krijojnë atyre këto probleme. Çdo autoritet vendor, qysh kur kandidon për t’u zgjedhur, angazhohet që, përmes mirëqeverisjes, ta bëjë fshatin, komunën, apo qytetin ku zgjidhet apo caktohet për të qeverisur, një vend më të mirë për të jetuar.

Kjo praktikë e zbatuar, në 32 qytete, mendojmë se është efikase për një njohje të gjerë e të thellë spektrale të problematikës që fle poshtë sipërfaqes së shoqërisë. Kjo praktikë shkurton së tepërmi procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, e pse jo, edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve. Nëse procedurat zbatohen me korrektesë, qytetari nis të rrisë besimin tek shteti i vet, tek institucionet dhe ligji. Nga ana tjetër, kjo synon të ndryshojë gradualisht qëndrimin e qytetarit ndaj shtetit, duke mos e parë atë thjesht si “gogol” detyrimesh, që tund para tij vetëm ashpërsinë formale të ligjeve e taksave, por edhe as si “prind” që të merr për dore për të treguar ta gjitha ato që ti dëshiron të bësh.

Praktikisht kemi proceduar në këtë mënyrë:

Fillimisht është bërë njoftimi i qytetarëve përmes Mediave lokale një ditë më parë, kurse organet e pushtetit vendor janë njoftuar disa ditë më parë. Atje ku ka qënë e mundur, një natë më parë është bërë edhe një bisedë në televizionin lokal. Grupet e punës, të përbërë nga dy-tre vete, kanë shpjeguar qëllimin e vizitës në rrethin përkatës si dhe kanë shpjeguar rolin, funksionin, kompetencat dhe juridiksionin e Avokatit të Popullit. Dita tjetër ka vijuar me pritjen e qytetarëve në një nga ambjentet e bashkive përkatëse. Nëse ankesat ka qënë e mundur të zgjidhen në vend, kjo është bërë brenda ditës, përmes kontakteve tona me autoritetet lokale. Nëse ka patur vende për trajtim të mëtejshëm nga ana e ekspertëve të Avokatit të Popullit, ankesat janë marrë me vete, janë regjistruar pranë zyrës tonë dhe më pas ka filluar procesi i investigimit.

Konkretisht, deri në fund të muajit tetor 2002, grupet e punës së Avokatit të Popullit kanë zhvilluar ditë të hapura në 32 rrethe të vendit, duke regjistruar gjithsej rreth 600 ankesa me shkrim, të cilat janë bërë objekt i investigimit nga ana e eksperteve tanë. (*Shih pasqyrën informative bashkëngjitur*).

Sqarojmë se numri i njerëzve të kontaktuar, të cilët janë sqaruar në vend, ose ankesat e të cilëve janë gjetur të pabazuara ose jashtë juridiksionit, ka qënë shumë më i madh se sa numri i ankesave të rregjistruara në pasqyrën përkatëse.

Problematika ka qënë thuajse e njëjtë me atë të ankesave që ne presim në zyren tonë në Tiranë. Kështu, ankesat e tyre kanë patur të bëjnë me keqfunksionimin, sipas tyre, të sistemit të drejtësisë, me vendimet e gjykatave, vendime që krijojnë jo rrallë konflikte sociale, me mosekzekutimin e këtyre vendimeve, me arrogancën dhe indiferentizmin e pushtetarëve lokalë karshi problemeve jetike të qytetarëve si dritat, uji, rrugët, kanalizimet, ndërtimet, punësimi etj.

Duke shprehur një konsideratë të përgjithshme, mendojmë se me një minimum ndjeshmërie, dhjetra probleme të qytetarëve të thjeshtë mund të ishin zgjidhur shumë mirë nga organet e pushtetit vendor dhe nga shërbimet që ato duhet të ofrojnë.

Në përgjithësi mendojmë se pjesa më e madhe e ankuesve kanë mbetur të kënaqur nga shërbimi që ne u kemi ofruar, qoftë duke u zgjidhur pozitivisht problemin, qoftë duke u ofruar atyre një konsultë ligjore profesionale, duke u treguar rrugët për ndjekjen e tyre. Një pjesë tjetër tregohen skeptike, nisur nga fakti i kompetencave të kufizuara të Avokatit të Popullit, sidomos lidhur me pamundësinë tonë për vendimmarrje, apo

83

pse ne nuk kemi të drejtë të paktën që të kërkojmë prishjen e vendimeve gjyqësore të padrejta.

Ne kemi menduar që shërbimin tonë ta ofrojmë në mënyrë permanente, fillimisht në pesë rrethe në skajet e largëta të vendit. Për këtë është përgatitur edhe një projekt i cili ndodhet në fazën e gjetjes së donatorëve.

**Pasqyra mbi ditët e hapura, organizuar nga Institucioni i
Avokatit të Popullit në 32 qytete të Shqipërise**

Nr.	Data	Qyteti	Nr. i ankesave të rregjistruara	Pasqyruar në Mediat lokale
1	08.04.2002	Kavajë	37	
2	06.05.2002	Kukës	24	+
3	09.05.2002	Korçë	60	+
4	10.05.2002	Pogradec	60	+
5	13.05.2002	Vlore	50	+
6	14.05.2002	Fier	25	
7	15.05.2002	Lushnjë	15	
8	17 - 19.06.2002	Burrel	18	+
9	20.06.2002	Puke	9	+
10	20 - 21.06.2002	Rrëshen	10	
11	24 - 25.06.2002	Tropoje	8	+
12	25.06.2002	Kruje	6	
13	03.07.2002	Lezhe	24	+
14	04.07.2002	Laç	8	+
15	05.07.2002	Librazhd	28	
16	08.07.2002	Gramsh	10	
17	08.07.2002	Elbasan	48	+
18	08.07.2002	Tepelenë	5	
19	09.07.2002	Delvinë	2	
20	09.07.2002	Përmet	16	
21	10.07.2002	Sarande	5	
22	10.07.2002	Gjirokastër	28	+
23	11.07.2002	Himare	2	
24	23.07.2002	Skrapar	3	
25	24.07.2002	Kuçove	4	
26	25.07.2002	Berat	25	
27	23-27.09.2002	Bilisht	3	
28	24.09.2002	Erseke	3	
29	26.09.2002	Durrës	35	+
30	27.09.2002	Shijak	1	+
31	11.10.2002	Peqin	11	+
32	17.10.2002	Rrogozhinë	20	+
	Gjithsej	32 qytete	603	

8. Marrëdhëniet me Jashtë

Duke qenë një institucion i ri, i cili nuk ka homologë apo të ngjashëm në vëndin tonë, por veçse jashtë tij, ne i kushtojmë një vënd të rëndësishëm marrëdhënieve me jashtë. Si pjesëtar i familjes së madhe të Ombudsmanëve, në aktivitetet ndërkombëtare dhe në tryezat shumëpalëshe gjatë vitit 2002 Avokati i Popullit, ka bërë të njohur përvojën e tij si dhe ka shkëmbyer mendime me interes të gjerë për punën tonë. Gjithë takimet e organizuara jashtë dhe brenda vëndit kanë patur si qëllim rritjen e efikasitetit të punës si dhe kanë ndihmuar për zgjerimin dhe forcimin e marrëdhënieve me zyrat e homologëve të tanë.

Të gjithë e dimë se sa e rëndësishme është marrja e informacionit, dhe për këtë mjeti më i shpejtë është Interneti. Megjithatë, ne mendojmë se kontaktet e drejtpërdrejta dhe shkëmbimi i lirshëm i mendimeve dhe përvojave reciproke, janë dhe do të mbeten diçka e pazëvendësueshme. Kjo është një arsye tjetër, që ne e vlerësojmë mjaft pjesëmarrjen në aktivitetet dhe organizatat ndërkombëtare.

Aktiviteti i marrëdhënieve me jashtë të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2002 është realizuar në disa forma: pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, vizita studimore e trajnime. Në krahasim me vitin 2001 aktivitetet tona ndërkombëtare kanë patur rritje cilësore.

I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Europës:

a) Konferenca e 4-të “Mbi Reformën në Drejtësinë Shqiptare” Strasburg, 28-30 Janar 2002.

Konferenca u organizua nga Këshilli i Europës dhe Komisioni European, në kuadrin e Planit të Dytë të Veprimit mbi funksionimin e reformës në drejtësi në Shqipëri. Avokati i Popullit dha një informacion mbi punën e bërë për ngritjen dhe konsolidimin e këtij Institucioni në Shqipëri. Gjithashtu Avokati i Popullit sugjeroi ndryshimet që mund të bëhen në Kodet e Procedures Penale dhe Civile sikurse dhe masa të tjera që do të ndikojnë në parandalimin e akuzave ndaj gjyqtarëve për korrupsion si dhe në rritjen e cilësisë së punës së prokurorëve dhe gjyqtarve.

Pjesëmarrësit vunë në dukje se Avokati i Popullit ka zhvilluar një bashkëpunim konstruktiv me autoritetet shtetërore. Ata e përshëndeten mënyrën konstruktive nëpërmjet të cilës Avokati i Popullit ka ngritur çështje të rëndësishme duke kërkuar të vërë në veprim shtetin.

Shefi i Prezences së OSBE-së në Shqipëri, Z. Gert Ahrens, midis të tjerash theksoi se “Bashkëpunimi i suksesshëm ndërkombëtar i pasqyruar në krijimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të institucionit të Avokatit të Popullit, veçanërisht gjatë vitit të kaluar, tregon se mund të bëhet ndryshim i vërtetë në Shqipëri dhe se institucionet demokratike mund të ndërtohen nga fillimi”.

b) Seminari mbi “Parimet e mos-diskriminimit dhe mbrojtja nga Administrata Publike e të drejtave, etnike, fetare dhe linguistike të minoriteteve” në Trieste – Itali.

Në kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Europën jug-lindore, Komisioni i Venecias organizoi më 28 janar-2 shkurt 2002 seminarin e mësipërm.

Komisioni i Venecias ka luajtur një rol të rëndësishëm në adaptimin e Kushtetutave dhe mjaft ligjeve të vendeve të Europës Lindore konform standarteve konstitucionale europiane. Ky Komision ka një bashkëpunim të ngushtë edhe me Shqipërinë dhe ka marrë pjesë në hartimin e Kushtetutës shqiptare.

Një nga temat mjaft të diskutuara në këtë seminar ishte shqyrtimi i ligjeve elektorale, nëse janë bazuar në principet e barazisë dhe mos-diskriminimit, sipas standarteve ndërkombëtare.

c) Takimi i Ombudsmanëve European në Vilnius, Lithuanë, me temë: “Roli i Ombudsmanit në Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut”

Kjo konferencë u mbajt në Vilnius, të Lituanisë, më 5-6 Prill 2002, me inisiativë të Komisionerit të Lartë të Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut Z. Alvaro Gil - Robles. Pjesëmarrësit shkëmbyen pikëpamjet e tyre lidhur me çështjet e prezantuara për diskutim.

Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit në fjalën e tij theksoi këmbënguljen tonë në rekomandimet dërguar administratës publike shqiptare që çdo nëpunës i administratës të njohë Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin për të drejtën e informimit për t’i patur ato udhërrëfyes në punën e tyre të përditshme.

ç) Tavolina e Dytë e Rrumbullaket me Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, organizuar nga Këshilli i Europës në Belfast dhe Dublin

Kjo konferencë, u mbajt më 14-16 nëntor 2002 dhe synonte shkëmbimin e mendimeve dhe eksperiencave për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për çështje të interesit të përbashkët. Temat e trajtuara në këtë takim kishin të bënin me:

1. Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe tensioneve.

Në bazë të diskutimeve të kësaj teme pjesëmarrësit dolën me rekomandimet e mëposhtme:

a) Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut duhet të jenë në dijeni të dimensionit për parandalimin e konfliktit, gjë që mund të jetë pjesë e punës që ata kanë marrë përsipër të kryejnë gjatë mandatit të tyre si dhe të sigurojnë që ky dimension është marrë në konsideratë psh. në aktivitetet edukuese dhe trajnuese që ata kryejnë.

b) Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut duhet të kenë parasysh nëse mundësitë dhe strukturat e tyre të brendshme janë adekuate dhe nëse ky dimension mund të artikullohet në mënyrë të dobishme në deklaratimet dhe planifikimet e tyre.

c) Këshilli i Europës është i ftuar të mendojë për organizimin e një workshopi në të ardhmen ku të mund të eksplorojmë ide të tjera të mëtejshme për rolin potencial të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në parandalimin, menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve.

ç) Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut janë të ftuara individualisht të mendojnë nëse ato mund të luajnë rol në zgjidhjen e konfliktit, deri në çfarë mase munden, duke patur parasysh egzistencën e ndonjë mekanizmi përkatës në vendet anëtare si dhe mandatet e tyre në veçanti.

2. Bashkëpunimi midis vetë Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, midis tyre dhe Këshillit të Europës dhe Organizatave të tjera Nderkombëtare.

U riafirmua edhe njëherë nevoja e forcimit të bashkëpunimit të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, midis tyre dhe Këshillit të Europës dhe Organizatave të tjera Nderkombëtare.

U theksua se vendet anëtare të Këshillit të Europës duhet të krijojnë, zhvillojnë dhe forcojnë institucionet kombëtare të pavarura sipas Parimeve të Parisit dhe Rekomandimit të Këshillit të Europës të vitit 1997.

Avokati i Popullit në fjalën e tij përshendeti Këshillin e Europës për vendimin që ka marrë që në vitin 2003 e vazhdim të gjitha aktivitetet ndërmjet Këshillit të Europës dhe të gjithë Ombudsmanëve apo Mediatoreve kombëtarë do të koordinohen nga Komisioneri i Lartë i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu ai shprehu

mendimin që Këshilli i Europës të promovojë iniciativën për krijimin e një rrjeti bashkëpunimi si dhe të lidhjeve bilaterale midis vëndeve tona, me qëllim zgjidhjen e ankesave të qytetarëve tanë respektivë, residentë legal apo jo, në vendet e njëri-tjetrit.

Avokati i Popullit hodhi edhe idenë e hartimit të një ligji tip, me qëllim që statusi, juridiksioni dhe kompetencat e Ombudsmanit të jenë të njëjta për çdo vend anëtar të Këshillit të Europës dhe t'i rekomandohet miratimi i këtij ligji të gjitha qeverive përkatëse. Në këtë mënyrë do të mund të mbrohen më mirë të drejtat e individit, rrjeti do të funksionojë më me efikasitet dhe për rrjedhojë shkëmbimi i eksperiencave do të jetë me efektiv.

II Aktivitete të organizuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB):

a) Sesioni i 58-të i Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, Gjenevë 18-20 Prill 2002.

Në Sesionin e 58-të të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, që u mbajt në Gjenevë 18-20 Prill 2002, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit me cilesinë e vëzhguesit u njohën nga afër me aktivitetin e këtij Komisioni dhe strategjinë e tij për konsolidimin e institucioneve kombëtare, koordinimin e punës e tyre si dhe format e mbështetjes institucionale që ushtron ky organizëm ndaj institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në fjalën e tyre Znj. Mary Robinson, Komisionere e Lartë e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe Z. Alvaro Gil Robles, Komisioner për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, u ndalen në rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe në punën e madhe që duhet të bëjnë ato për të ndërgjegjësuar shtetet palë të konventave për respektimin e parimeve të gjithëpranuara.

Nga përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u shpreh gadishmëria jo vetëm për të vazhduar më tej bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtare, por edhe që institucioni i Avokatit të Popullit të bëhet anëtar me të drejta të plota i Komitetit të Koordinimit. Për këtë anëtarësim kemi aplikuar zyrtarisht dhe presim përgjigje nga organizmat miratues përkatës.

III. Konferenca te tjera ndërkombëtare:

a) Konferenca e 6-të e Ombudsmanit Europian në Krakov të Polonisë.

Konferenca e 6-të e Institutit Europian të Ombudsmanit u organizua në Krakov të Polonisë, nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave Civile të Republikës së Polonisë dhe Instituti i Ombudsmanit Europian (EOI) me 22-24 Maj 2002. Konferenca diskutoi për “Rolin e Ombudsmanit në fillim të Shekullit XXI”, sidomos për rolin e Ombudsmanit në rrethana ekstreme dhe të jashtëzakonshme. Zoti Marek A. Nowicki, Ombudspersoni i Kosovës solli shembuj të ndryshëm në rrethanat e një vendi ku urrejtjet dhe konfliktet etnike janë ende të ndezura. Ai shpjegoi rolin e Ombudsmanit si mediator jo vetëm midis autoriteteve dhe qytetarëve, por edhe ndërmjet etnive të ndryshme, me qëllim ndërtimin e një të ardhme më të mirë në krahinë.

Kurse përfaqësuesja e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës dënoi praktikën në disa vende, ku të huajt keqtrajtohen vetëm se nuk kanë leje hyrje për në vendet e BE. Ajo theksoi që Ombudsmani duhet të lejohet të hyjë e të inspektojë në zonat e ndalimit të njerëzve si nëpër aeroporte dhe pika të tjera kufitare, sikurse theksoi dhe rolin e Ombudsmanit për përmirësimin e legjislacionin lidhur me të huajt.

Në Konferencë gjithashtu u nënvizua rëndësia e pavarësisë së Ombudsmanit, shkalla e përgjegjësisë dhe e aksesit sikurse dhe rëndësia e të qenit proaktiv dhe jo reaktiv. Kjo do të thotë se Ombudsmani duhet të studjojë situatat dhe të parandalojë shkeljet e të drejtave të njeriut dhe jo të presë që ato të ndodhin e pastaj të reagojë.

Konferenca zgjodhi organet drejtuese të Institutit Europian të Ombudsmanit (EOI) ku Avokati i Popullit është anëtar me të drejta të plota që nga viti 2000.

b) Konferenca e 18-të Vjetore e Ombudsmanëve Amerikanë (TOA).

Konferenca e 18-të Vjetore e Ombudsmanëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës u mbajt në Arlington, Virginia, më 20-23 Maj 2002. Tema ishte “Puna e Ombudsmanit: Inspirimi, Qytetërimi dhe Respekti në kohë sfidash”. Ishte hera e parë që Avokati i Popullit mori pjesë në një aktivitet të Ombudsmanëve amerikanë. Në Konferencë u njohëm me modelin e ombudsmanit amerikan, i cili ndryshon mjaft nga modeli tradicional i ombudsmanit europian. Përvoja e fituar dhe lidhjet e

reja që krijuam na ndihmojnë për të konceptuar më mirë veprimtarinë tonë për të ardhmen.

Gjatë qëndrimit në SHBA, Avokati i Popullit u takua me:

- Avokatin e Popullit të qytetit të New Yorkut, Znj. Betsy Gotbaum, ku patëm mundësinë të njihemi me strukturën dhe funksionet e kësaj Zyre si dhe Procedurat që ndiqeshin për zgjidhjen e ankesave që paraqesnin qytetarët.

- Nën Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së për çështjet Ligjore, Z. Hans Corell. Pasi prezantua Institucionin e Avokatit të Popullit të Shqipërisë, bazën ligjore të krijimit të këtij Institucioni, si dhe punën e kryer në vitet 2000-2001, theksua rëndësinë e madhe që ka ky institucion për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri si dhe sfidat me të cilat përballlet. Nënvizuam gjithashtu bashkëpunimin e mirë që kemi me homologet e vëndeve të tjera duke mos lënë mënjanë edhe mbështetjen që i jep këtij institucioni Parlamenti dhe Qeveria Shqiptare.

- Z. Corell, nga ana e tij, vlerësoi punën e Ombudsmanit shqiptar dhe u shpreh se ky është një hap përpara në drejtim të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ai theksoi rëndësinë që ka institucioni i Ombudsmanit si në hartimin e legjislacionit ashtu dhe për vënien e tij në zbatim nga institucionet shtetërore. Gjithashtu theksoi domosdoshmërinë e kontrollit të Ombudsmanit mbi veprimtarinë Procedurale të organeve gjyqësore sipas traditës suedeze. Suedia është vendi i origjinës së Ombudsmanit, por edhe i zotit Corell.

- Drejtorin e Zyrës së Komisioneres së Lartë për të Drejtat e Njeriut në New York, Z. Bacre Waly Ndiaye. Ne bëmë një paraqitje të shkurtër të punës së institucionit dhe theksuam bashkëpunimin gjithmonë në rritje të tij me Parlamentin dhe me Qeverinë Shqiptare. Z. Ndiaye, pasi vlerësoi krijimin dhe funksionimin me sukses të Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri, theksoi se rekomandimet që i paraqiten institucioneve qeveritare nga zyra e Ombudsmanit duhet t'u përmbahen parametrave të instrumentave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, pasi në këtë mënyrë ato do të kenë bazë me të fortë për zbatimin e tyre. Gjithashtu ai nënvizoi se krijimi dhe funksionimi i Institucionit të Ombudsmanit rrit kredibilitetin e vetë institucioneve shtetërore. Në fund të takimit Z. Ndiaye vlerësoi dorezimin në OKB të raportit të parë të Shqipërisë për Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të gjitha llojeve të Diskriminimit ndaj Gruas.

Në Washington DC, Avokati i Popullit zhvilloi takime në Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me:

- Zv/Drejtorin e parë për Europën Qëndrore e Jugore, Z. Jonathan Benton, si dhe përgjegjësen e Zyrës për Shqipërinë Znj. Michele Siders
- Zv/Drejtorin për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut Z. Ralph Anske.

Zyrtarët amerikanë u shprehën se e njihnin mirë veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit si edhe situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ata na inkurajuan për punën tonë dhe sugjeruan që Avokati i Popullit të investonte e të kontribuonte më tepër në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut në fushën e pronësisë private, dhunimeve nga policia, trafikeve dhe luftën kundër korrupsionit, çka përbënin edhe shqetësimet e tyre kryesore.

Gjithashtu u takua me:

- Drejtorin për Europen Qëndrore dhe Lindore të Programit në Shqipëri dhe Maqedoni të ABA/CEEL-it, zotin Scott Carlson si dhe përfaqësuesin e Human Rights Watch z. Dorian Pavli.

Në fund të takimeve, Avokati i Popullit dha një intervistë për Zërin e Amerikës në gjuhën shqipe.

c) Konferenca ndërkombëtare mbi të Drejtën Administrative.

Konferenca ndërkombëtare mbi të Drejtën Administrative, u organizua nga Këshilli i Gjykatave Administrative të Kanadasë, (CCAT) në Ottawa, nga 2-4 Qershor 2002. Tema e Konferencës ishte: “Maturimi i Sistemit Ligjor Administrativ të Kanadasë”. Eshtë viti i dytë që Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në një konferencë të këtij organizmi Kanadez. Në konferencë u diskutuan çështje të rëndësishme për funksionimin e gjykatave administrative dhe na u dha mundësia për zgjerimin e kontakteve profesionale dhe ndër institucionale me gjykatat administrative kanadeze sepse objekti i punës sonë është i njëjtë, zgjidhja e ankesave të njerëzve.

Gjatë qëndrimit të tij në Kanada, Avokati i Popullit pati mundësinë të bënte takime zyrtare në Asamblenë Legjislative të provincës së Ontarios, ku në bazë të një programi hartuar prej tyre u njoh me Strukturat Administrative dhe Legjislative të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Ontarios, me politikat e zhvillimit, shërbimet ligjore dhe me Procedurat për shqyrtimin e ankesave, investigimin e tyre dhe mediacionin.

Avokati i Popullit pati takime në Ottawa edhe me Sekretarin e Përgjithshëm të Komisionit Federal për të Drejtat e Njeriut z. John Hucker, Drejtorin e Politikave Ndërkombëtare të këtij Komisioni znj. Kerry Buck dhe në Toronto me Kryetarin e Parlamentit të Provincës së Ontarios z.

Garry Carr, Kryekomisionerin për të Drejtat e Njeriut të Ontarios z. Keith Norton etj.

Në takimet e zhvilluara u evidentua rëndësia e vizitës, si e para e këtij lloji dhe niveli në Kanada, për t'i kontribuar zgjerimit të marrëdhënieve mes Institucionit të Avokatit të Popullit dhe institucioneve homologe kanadeze. Avokati i Popullit theksoi faktin se Zyra e Avokatit të Popullit në Shqipëri, duke qenë një institucion relativisht i ri, kishte nevojë për marrjen e përvojës nga vende me demokraci të zhvilluar si Kanadaja. Mikpritësit kanadezë shfaqën interesimin e tyre të veçantë dhe premtuan për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit, sidomos për të ndihmuar në trajnimin e Stafit të zyrës së Avokatit të Popullit.

ç) Konferenca Nderkombëtare mbi “Standartet Europiane dhe Institucionet e Ombudsmanit në Europën Juglindore”.

Kjo Konferencë u organizua nga Zyra Rajonale e Fondacionit publik gjerman “Friedrich Ebert” në Sofie, me 6-8 Qershor 2002.

Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga zyrat homologe të Avokatit të Popullit nga të gjitha vëndet e Ballkanit. U evidentuan vështirësitë në punën e tyre për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në këto vënde. Një nga arsyet e konferencës ishte që Fondacioni të hartojë programe mbështetëse për Ombudsmanët e vendeve të Europës Juglindore.

d) Mbledhja vjetore e OSBE-së dhe ODHIR-it mbi Zbatimin e Dimensionit Njerezor.

Me 9-19 Shtator 2002 u mbajt në Varshave të Polonisë mbledhja vjetore e OSBE-së dhe ODHIR-it për zbatimin e dimensionit njerëzor. Ajo përbënte një forum unik për një diskutim të hapur për çështje lidhur me të drejtat e njeriut nga pjesëmarrës me të drejta të barabarta, organizata jo qeveritare, delegacione qeveritare si dhe institucionet e të drejtave të njeriut.

Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, prezantoi arritjet kryesore të këtij institucioni në dy vjet e gjysëm veprimtari dhe objektivat për të ndihmuar në rritjen e standarteve të mirëqëverisjes nga administrata publike shqiptare.

dh) Mbledhja vjetore e Ombudsmanëve të Rajonit European, anëtarë të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI).

Avokati i Popullit është anëtar me të drejta të plota të organizatës së Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit, me qendër në Kanada, që nga viti 2000.

Mbledhja e radhës u mbajt në Ljubljana të Sllovenisë me 5-7 dhjetor 2002, me inisiativë të Ombudsmanit të Sllovenisë, i cili është zgjedhur dhe Drejtor i Institutit të Ombudsmanit Ndërkombëtar për Europën, Z. Matjash Hanzek. Tema kryesore e mbledhjes ishte “Pavarësia e Ombudsmanit”.

Në këtë mbledhje u diskutuan çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me rritjen e pavarësisë institucionale e financiare, si elementë shumë të rëndësishëm të veprimtarisë së institucioneve të Ombudsmanit.

Në këtë mbledhje u theksua ndër të tjera se “pavarësia institucionale përjashton, para së gjithash varësinë si nga Institucionet e tjera kushtetuese, por kërkon edhe mospërfshirjen në lojën politike. I së njëjtës rëndësi është edhe buxheti me vete si dhe propozimi i strukturës dhe personelit përkatës brenda kompetencave nga vetë Ombudsmani. Ngritja dhe funksionimi efikas i Institutit të Ombudsmanit kërkojnë jo vetëm mbështetje politike dhe institucionale, por edhe vullnet për ta mbështetur këtë institucion financiarisht dhe me infrastrukturen e nevojshme për kryerjen sa më mirë të funksionit të tij”.

IV. Vizitat e Ombudsmanëve të shteteve të tjera në Shqipëri

Institucioni i Ombudsmanit, duke qenë unik në secilin vend, i kushton rëndësi edhe kontakteve me homologet ndërkombëtarë të tij.

Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me jashtë paraqiten me një seri kontaktesh nga Ballkani në Europë, e prej këndej në SHBA e Kanada. Por ajo që ka rëndësi është se këto kontakte kanë qënë jo vetëm një-drejtimshe, sepse jo vetëm kemi vizituar, por edhe na kanë vizituar reciprokisht. Zyra jonë deri tani ka vendosur kontakte zyrtare dhe shkëmbyer përvoja me 12 zyra homologësh.

Gjatë vizitave të disa homologëve të Avokatit të Popullit, të realizuara me ftesë nga zyra jonë, gjatë vitit 2002, përveç solidaritetit e gadishmerisë për bashkëpunim është shprehur edhe impresioni i tyre pozitiv mbi sukseset dhe mbarëvajtjen e këtij Institucioni të ri në Shqipëri. Pothuajse të gjithë homologët e Avokatit të Popullit që na vizituan gjatë vitit 2002 patën takime me personalitetet më të larta të shtetit tonë si Presidenti i Republikës, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm etj, ku patën mundësitë të shprehin jo vetëm idetë dhe vlerësimet e tyre për veprimtarinë e Avokatit të Popullit, por edhe dëgjuan vlerësimet e autoriteteve tona për Institucionin tonë.

1. Me 21-24 mars 2002 ishte për një vizitë zyrtare në Shqipëri Z. Bernard Stasi, Mediatori i Republikës së Francës dhe Kryetar i Shoqatës së

Ombudsmanëve dhe Mediatoreve të vëndeve të Frankofonisë. Z. Stasi u njoh me veprimtarinë e kryer nga Institucioni i Avokatit të Popullit, mori pjesë në seminarin për një Proces të rregullt ligjor, organizuar nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata e Lartë, me pjesëmarrje të juristëve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Z. Stasi prezantoi në seminar punën e Mediatorit të Francës për një proces të rregullt ligjor mbi gjykatat administrative në Francë.

Në fund të vizitës së tij Z. Stasi, pasi dha përshtypjet e tij shumë pozitive mbi zhvillimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, u shpreh i gatshëm për vazhdimin e bashkëpunimit me ne.

Shumë shpejt mbas kësaj vizite Z. Stasi ftoi për një vizitë zyrtare në Francë Avokatin e Popullit, dhe në nëntor të vitit 2002 Zyra e Mediatorit të Francës ofroi bursa 1 mujore në Paris, për trajnimin e dy ekspertëve ligjore të zyrës sonë.

2. Në datën 3-5 prill 2002, erdhi në Tiranë Krye Ombusmani Parlamentar i Suedisë, Z. Claes Eklundh. Z. Eklundh mori pjesë në Seminarin e organizuar nga Avokati i Popullit me temë “Avokati i Popullit dhe marrëdhëniet e tij me Sistemin Gjyqësor”. Me eksperiencën e tij shumëvjeçare si Ombudsman dhe me backgroundin e tij të pasur në sistemin e drejtësisë suedeze, ai bëri një referat interesant mbi marrëdhëniet e Ombudsmanit me sistemin gjyqësor në Suedi.

Duke shprehur gadishmerinë e tij për të ofruar mundësinë e një trajnimi profesional, pesë ekspertë të zyrës sonë u ftuan më pas për trajnim një javor në zyrën e tij, ku u njohën nga afër me praktikat e punës së përditshme të zyrës së Ombudsmanit Suedez.

3. Më 26-29 qershor 2002, Ombudsmani Parlamentar i Danimarkës, Z. Hans Gammeltoft-Hansën, me një eksperiencë 17 vjeçare si Ombudsman i Mbretërisë së Danimarkës, erdhi për herë të tretë në Shqipëri si i ftuar special i Avokatit të Popullit. Ai është mbështetës kryesor për ndertimin dhe mirëfunksionimin profesional të Institucionit tonë. U konfirmua edhe njëherë bashkëpunimi në vazhdim për vitin 2002 si dhe për vitin 2003. U shpreh gadishmeria e Ombudsmanit Danez për të ofruar asistencë konkrete profesionale për zyrat e reja të Avokatit të Popullit kur ato të hapen. Specialistët e zyrës së Ombudsmanit Danez do të jenë të gatshëm dhe të pranishëm për çdo kërkesë nga ana e Zyrës sonë. Ombudsmani danez takoi edhe kryetarët e Komisioneve Parlamentare për Ligjet, për të Drejtat e Njeriut dhe për Financat në Kuvendin e Shqipërisë. Ai theksoi domosdoshmërinë e respektimit të parimit të pavarësisë në veprimtarinë e Avokatit të Popullit dhe domosdoshmërinë e plotësimin të kërkesave financiare për të garantuar mirëfunksionimin tonë. Gjithashtu

zoti Gammeltoft Hansen vizitoi edhe organet e pushtetit vendor në Gjirokastrë e Sarandë nga ku mori opinionet e tyre në lidhje me bashkëpunimin me Avokatin e Popullit.

4. Me 8-10 korrik 2002 vizitoi zyrën tonë, Z. Nikolaus Schwarzler, Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Institutit European të Ombudsmanit me qendër në Insbruk, Austri. Z. Schwarzler u njoh nga afer me Institucionin tonë dhe aktivitetin e kryer gjatë periudhs 2 vjeçare të veprimtarisë së tij. Në takimet e zhvilluara, Z. Schwarzler konfirmoi edhe njëher mundesinë në vazhdim për të na informuar dhe ofruar trajnime profesionale të vlefshme për stafin e zyrës sonë.

5. Ombudsmani për të Drejtat e Njeriut të Bosnjës dhe Hercegovinës, ish- Ombudsmani kundër diskriminimit etnik të Mbretërisë së Suedisë, Z. Frank Orton, erdhi në Shqipëri më 17-22 korrik 2002. Z. Orton, që ka një eksperiencë të gjatë në gjyqësorin Suedez dhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut solli përvojën e tij si Ombudsman, në seminarin e organizuar në Zyrën e Avokatit të Popullit me temë “Metodika e pritjes, verifikimit dhe përfundimit të një kërkesë apo ankese. Rekomandimi si mjet kryesor i reagimit të Ombudsmanit”. Përvoja e tij u prit me shumë interes nga stafi ynë. Në fund të vizitës së tij Z. Orton u shpreh shumë pozitivisht për arritjet e institucionit tonë duke nënvizuar që përfitimet nga kjo vizitë kishin qënë të ndërsjellta për vetë idetë e reja dhe të mirëaplikuara nga ne.

6. Më 30 korrik- 2 gusht 2002, ishte në Tiranë Z. Oleg Orestovich Mironov, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Federatës Ruse. Z. Mironov erdhi direkt pas një mbledhje të zhvilluar në Bordin drejtues të Institutit European të Ombudsmanit me qendër në Insbruk. Ai na beri të njohur se në atë mbledhje ishte diskutuar dhe shprehur opinionin tepër pozitiv për Institucionin tonë.

Ndër të tjera Z. Mironov hodhi idenë që Ombudsmanët e vendeve ish socialiste të krijojnë një shoqate të veçantë, për shkak të veçorive që paraqesin vendet tona në tranzicion. Ai sugjeroi që Avokati i Popullit të Shqipërisë të ishte inisiator i kësaj ideje dhe siguroi që kjo ide do të përkrahej nga mjaft Ombudsmanë të vendeve që kanë qënë nën influencën sovjetike.

Avokati i Popullit e studioi këtë ide dhe i bëri të njohur se strategjia e institucionit tonë është të inspirojë dhe punojë për të qënë brenda apo sa me afër strukturave euroatlantike, pa qënë nevoja të krijojmë organizma të tjera, veç atyre ku bëjmë pjesë, që janë Instituti European dhe Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit si dhe Shoqata e Ombudsmanëve si dhe Mediatorëve të Frankofonisë.

7. Me 20-22 tetor 2002, me ftesë të Avokatit të Popullit, erdhi në Shqipëri për një vizitë zyrtare Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, Z. Alvaro Gil-Robles. Sipas axhendës së përgatitur me këtë rast, në takimet e tij me autoritetet më të larta të vendit, me deputetët e opozitës, etj. Z. Robles ju dha mundësia të informohet drejtpërdrejt mbi masat e marra për çështje të ndryshme si dhe për të krijuar një ide mbi situatën në Shqipëri. Dy temat kryesore që ai u përqëndrua kryesisht ishin: a) trafiku i qënieve njerëzore dhe b) të drejtat e grave, dhuna në familje, të drejtat sociale etj.

Z. Gil Robles u shpreh se deri tani e kish njohur Shqipërinë përmes dosjeve, ndërsa pas tre vjetësh nga zgjedhja e tij, tashmë do ta njihnte me drejtpërdrejt, duke kontaktuar me përfaqësuesit e qeverisë, të opozitës dhe të shoqërisë civile shqiptare.

Pasi u njoh me ngarkesën e madhe të punës së Avokatit të Popullit, me një numer ankesash të shumëfishuar që nga viti i parë (2000), Z. Robles e vlerësoi shumë përkushtimin në punë si dhe nevojën që kjo zyrë ka për t'u përkrahur me tej për kërkesat që parashtron zhvillimi i saj i mëtejshëm.

Në takimin me Zv/Kryeministrin dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Z. Ilir Meta, ky i fundit përmendi bashkëpunimin e mirë me Avokatin e Popullit, sidomos për botimin dhe shpërndarjen e një broshure, përmes së ciles të burgosurit shqiptare jashtë vendit, do të njihen me të drejtat e njeriut dhe rrugët për mbrojtjen e tyre.

Zoti Robles u shpreh se Këshilli i Europës nuk mendon se në Shqipëri ka probleme të rëndësishme që të tregojnë për shkelje të të drejtave të minoriteteve dhe se Shqipëria në përgjithësi ka zbatuar detyrimet e saj që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Europës për Minoritetet. Gjithashtu z. Robles u shpreh për aktivitete të përbashkëta, sikunder është një studim për emigrimin dhe një mbledhje që do të mbahet në Mars ose Prill të vitit 2003 në Athinë, në të cilën do të mirëpritej edhe kontributi i Shqipërisë. Kësaj ftese Z. Meta ju përgjigj pozitivisht, duke theksuar nevojën e rritjes së bashkëpunimit me Këshillin e Europës.

Në takimin me Ministren e Punës dhe Çështjeve Sociale, Znj. Valentina Leskaj, Z. Robles u interesua për shanset e gruas në punësim, për rritjen e përqindjes së grave police, për viktimat e dhunës në familje, për romët, për të sëmurët mendorë dhe të moshuarit etj. Ai propozoi organizimin e një seminari të përbashkët mes tij, Avokatit të Popullit, OJF-ve dhe Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për sensibilizimin në përgjithësi për probleme të dhunës në familje, duke e parë këtë si fenomen ballkanik. Ky projekt u mirëprit nga zj. Leskaj dhe janë vënë në lidhje direkte për realizimin e tij.

Z. Luan Rama, Ministër i Rendit Publik, në takimin me Z. Robles u fokusua në bashkëpunimin me shoqërinë civile për krimet e gjakmarrjes dhe hakmarrjes, duke shprehur impenjimin për një punë më të mirë të policisë në këtë drejtim. Gjithashtu z. Rama trajtoi probleme të bashkëpunimit me Avokatin e Popullit, për zbatimin e rekomandimeve të tij si dhe për kushtet në dhomat e paraburgimit dhe masa të tjera që po merren për ta lehtësuar këtë problem. Në përgjigje të një propozimi të z. Robles, u ra dakort edhe për një aktivitet të përbashkët në nivel rajonal. Z. Rama shprehu gadishmerinë e tij për të qënë bashkëorganizator me Komisararin e Lartë të Këshillit të Europës.

Z. Spiro Peçi, Ministër i Drejtësisë, në takimin me Z. Gil Robles u përqëndrua në punën për rritjen e cilesisë së hetimit dhe gjyqimit të çështjeve dhe forcimin e kontrollit mbi gjykatat. Zoti Robles theksoi domosdoshmërinë e forcimit të gjyqësorit shqiptar në luftë sidomos kundër korrupsionit, për rëndësinë e trajnimeve të gjyqtarëve dhe oficerëve të policisë dhe të burgjeve etj.

Në takimin me kryeministrin, zotin Fatos Nano, zoti Robles sugjeroi që institucioni i Avokatit të Popullit dhe rekomandimet e tij të përkraheshin nga Qeveria, që të mos pengojë juridiksioni i Avokatit të Popullit mbi gjyqësorin, e prokurorinë si një ndihmë për këto organe për të luftuar pa kompromis kundër të gjitha llojeve të trafikëve dhe korrupsionit.

V. Vizitat e Avokatit të Popullit në zyrat e Ombudsmanve të vendeve të tjera

Në kuadrin e bashkëpunimit bilateral si edhe të projektit të Paktit të Stabilitetit për shkëmbim eksperiencash Avokati i Popullit, me ftesë të homologeve të tij ka bërë vizita zyrtare në disa vende të ndryshme.

1. Më 10-13 Prill 2002 me ftesë të Ombudsmanit të Republikës së Greqisë, Z. Nikiforis Diamandouros, Avokati i Popullit beri një vizitë zyrtare pranë Zyrës së Ombudsmanit Grek në Athinë. Objektivi i vizitës dhe temat e bisedimeve u përqëndruan kryesisht i) në njohjen me strukturën dhe metodat e punës në zyrën e Ombudsmanit të Greqisë, dhe ii) në mënyrën se si ndihmohen emigrantët shqiptarë nga zyra e Ombudsmanit grek në rast ankesash. Në fakt numri i ketyre ankesave nuk ishte i lartë. Ankesat e shqiptarëve zinin vetëm 9.3% të të gjithë ankesave të të huajve që depozitoheshin në zyrën e Ombudsmanit grek. Ombudsmani grek bëri të njohur se i kish kërkuar Parlamentit grek një shtesë në ligjin për emigrantët dhe shpejtimin e procedurave për legalizimin e tyre, gjë që faktikisht u realizua nga Qeveria greke në prill 2002. Gjatë bisedimeve u ra dakort për

vazhdimesinë e bashkëpunimit midis të dy zyrave, për të dërguar ankesat reciproke tek njëri tjetri si dhe për shkëmbim eksperience të stafëve përkatëse.

Gjatë qëndrimit në Athinë u takuam me Zv/Ministrin e Brendshëm të Administratës Publike dhe Decentralizimit të Republikës së Greqisë, si dhe me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Rendit Publik. Këtyre zyrtarëve të lartë Grekë ju paraqitëm shqetësimet e shtetasve shqiptarë që punojnë e jetojnë në Greqi, duke sugjeruar që autoritetet e administratës publike greke të respektojnë të drejtat e liritë themelore të njeriut, ashtu siç i zbatojnë edhe shtetete tjera anëtare të Bashkimit Europian. U takuam edhe me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Athinë dhe dëgjuam çfarë problemesh kanë emigrantët tanë në Greqi.

2. Me ftesë të Ombudspersonit të Kosovës, Z. Marek Antoni Nowicki një delegacion i kryesuar nga Avokati i Popullit bëri një vizitë zyrtare në Prishtinë, me 2-5 Maj 2002. Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër e punës që kryen Zyra e Ombudspersonit të Kosovës, si thellimi i bashkëpunimit midis të dy zyrave tona nëpërmjet shkëmbimit të përvojave, trajnimeve profesionale, seminareve etj.

Z. Nowicki, falenderoi publikisht Avokatin e Popullit për mundësimin e dërgimit të të gjithë stafit të tij në Tiranë për vizita studimore dhe u shpreh se Zyra e Avokatit të Popullit të Shqipërisë është zyra që ka ndihmuar në mënyrë të shkëlqyer zyrën homologe në Prishtinë më shumë se çdo zyrë tjetër jo vetëm në Rajon, por edhe në Europë.

Të dy Ombudsmanët ranë dakort që bashkëpunimi do të vazhdojë edhe më i ngushtë, nëpërmjet seminareve, botimeve të përbashkëta, trajnimeve, shkëmbimit të praktikave të punës etj. Me këtë rast u ftuan për vizita studimore në Tiranë edhe anëtarët e stafit me kombësi serbe që punojnë në zyrën e Ombudspersonit të Kosovës. Këto vizita tashmë janë realizuar.

Shkëmbimi i eksperiencave ka sjellë përfitime të ndërsjellta. Kështu, duke marrë shkas nga përvoja e Ombudspersonit të Kosovës, Avokati i Popullit ka filluar praktiken e “ditëve të hapura”, të vajtjes një apo dy ditë në qytete të ndryshme të Shqipërisë për të pritur në vend ankesat e mundshme të qytetarëve ndaj administratës tonë publike.

Gjatë vizitës në Kosovë u bënë edhe takime e aktivitete të tjera.

Avokati i Popullit u takua zyrtarisht me Kryeministrin e Kosovës Z. Bajram Rexhepi, të cilin e njohu me veprimtarinë e zyrës sonë dhe u shpreh shumë pozitivisht për punën e bërë nga Z. Nowicki që, më shumë se njëherë, ka sfiduar veprimet e administratës së UNMIK-ut në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të popullit të Kosovës.

Në takimin e Avokatit të Popullit me anëtarin e Kryesisë të Parlamentit të Kosovës, Z. Fatmir Sejdiu, vizita u cilëua si një formë re e komunikimit midis institucioneve shqiptare dhe kosovare, si dhe u inkurajua që bashkëpunimi ndërmjet zyrave tona të thellohet më tej.

Avokati i Popullit zhvilloi takime të tjera përkatësisht me Kryetarin e Gjykatës Supreme, me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, me Kryetarin e Këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky i fundit bëri një ekspozitë të veprimtarisë 13 vjeçare të këaj organizate joqeveritare, e cila është një arkiv i gjallë i shkeljeve më të rënda të të drejtave të kosovarëve gjatë 10-vjeçarit të fundit nga shteti i Serbisë. Këto shkelje të rënda determinuan ndërhyrjen ushtarake të NATO-s kundër Serbisë.

Në vazhdim të takimeve, Avokati i Popullit pati mundësinë të takohet me personalitete të tjera të pushtetit vendor të Kosovës, si Kryetarët e komunave të Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës. Në të gjitha këto takime u shpreh gatishmeria dhe dëshira e tyre për t'u lidhur dhe bashkëpunuar me Bashkitë dhe Komunat e Shqipërisë si dhe për nevojën e ndërtimit të rrugës Durrës-Prishtinë. Kjo gatishmëri dhe dëshirë e pushtetarëve vendorë i është transmetuar zyrtarisht Kryetarit të Shoqatës së Kryetarëve të bashkive të Shqipërisë, zotit Edi Rama si kur ka qenë rasti, edhe kryetarëve të tjerë të bashkive shqiptare.

Me 5 Maj, Ditën e Dëshmoreve të Shqipërisë, delegacioni ynë vizitoi edhe Kompleksin Përkujtimor të heroit Adem Jashari në Prekaz të Drenicës.

Vizita e Avokatit të Popullit të Shqipërisë në Kosovë u pasqyrua nga i gjithë spektri i shtypit kosovar si dhe nga kanalet televizive të Kosovës. Ajo u konsiderua si një vizitë e suksesshme dhe u vlerësua si një hap përpara në bashkëpunimin e institucioneve të reja të Kosovës me ato të Shqipërisë.

3. Më 11-15 Korrik 2002, me ftesë të Mediatorit të Republikës së Francës, Z. Bernard Stasi, në vijim të një bashkëpunimi të filluar midis dy institucioneve tona, Avokati i Popullit dhe disa bashkëpunëtorë të tij bënë një vizitë pranë Zyrës së tij. Kjo vizitë, e sponsorizuar nga Këshilli i Europës, ishte planifikuar të bëhej në vitin 2000, qysh në fillim të veprimtarisë së Avokatit të Popullit.

Gjatë vizitës në Zyrën e Mediatorit të Francës, delegacioni i Avokatit të Popullit u njoh në mënyrë të veçantë me teknikat e ndërmjetësimit që zyra në fjalë realizonte me administratën publike. Një element i ri që u mësua nga përvoja franceze, ishte përcaktimi i pikave të kontaktit që kishin gjithë ministrinë dhe institucionet qendrore me Mediatorin e Francës, për të lehtësuar bashkëpunimin e tyre. Tashmë kjo përvojë pozitive franceze është

realizuar nga Zyra jonë me të gjitha ministrinë dhe institucionet kryesore të administratës publike shqiptare.

Gjithashtu u qartësua se Mediatori francez zakonisht shqyrton kërkesat apo ankesat e qytetarëve që i dërgohen atij jo direkt, por nëpërmjet deputetëve të Parlamentit francez.

Po kështu, për të bërë të njohur veprimtarinë e tij, ai botonte çdo 3 muaj një buletin, të cilin ja dërgonte gjithë deputetëve francezë. Këto përvoja franceze po studjohen nga ne, me synim për t'i aplikuar kur të krijohen kushtet.

4. Më 20-24 korrik 2002, me ftesë të Ombudsmanit të Provincës Autonome të Bolzanos, në Itali Z. Werner Palla, Avokati i Popullit bëri një vizitë zyrtare pranë zyrës së tij. Zoti Palla në maj 2002 u zgjodh në detyrën e kryetarit të Institutit European të Ombudsmanit. Qëllimi i kësaj vizite ishte shkëmbimi i eksperiencave dhe forcimi i marrëdhënieve midis dy zyrave tona. Në dhjetor 2001 zoti Palla ishte për vizitë në zyrën tonë.

Avokati i Popullit pati takim edhe me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Provincën Autonome të Bolzanos si dhe me kryetaren e Këshillit të kësaj Province.

5. Me 24-30 Shtator, me ftesë të Z. Hans Gammeltoft-Hansen, delegacioni i kryesuar nga Avokati i Popullit bëri një vizitë studimore pranë zyrës se homologut Danez.

Vizita pati si qëllim të përfitonim nga eksperiencia dhe praktika e përditshme e punës të Ombudsmanit Danez, sidomos nga mënyra konkrete e drejtimit të zyrës prej tij.

Gjatë inspektimit në burgun shtetëror Jyderup u duk qartë pushteti, besimi dhe respekti që gëzonte Ombudsmani Danez nga autoritetet e burgut dhe vetë të burgosurit. Komunikimi profesional i përfaqësuesit të zyrës së Ombudsmanit Danez nxori shpejt në pah ndonjë parregullsi që u vlerësua se duhej rregulluar.

Në takimin që pati me Prefektin e qytetit Arhus, Z. Peter Christensen, delegacionit të Avokatit të Popullit iu dha mundësia të mësonte mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në Danimarkë si dhe të kuptonte lidhjen e punës së tyre me Ombudsmanin për ankesat që ata merrnin nga qytetarët.

VI. Vizitat për shkëmbim eksperiencë dhe trajnime të stafit të zyrës së Avokatit të Popullit pranë zyrave homologe

1. Sipas planit të miratuar që në vitin 2001, në vijim të trajnimeve profesionale të një viti me pare pranë Zyrës së Ombudsmanit Parlamentar

të Danimarkës, Grupi i katërt i përbërë nga punonjësit e administratës, shkoi për një vizitë studimore në Kopenhagen në Mars 2002, ku u njoh me praktikat e punës së përditshme të kesaj zyre.

2. Më 22 Prill –3 Maj 2002, Dokumentalistja e zyrës sonë beri një trajnim në Strasburg dhe Gjeneve mbi organizimin dhe mirembajtjen e bibliotekës sonë, sponsorizuar nga Këshilli i Europës.

3. Më 27 Maj-14 Qershor sikurse dhe 7-25 tetor 2002, dy ndihmës komisionerë të zyrës sonë moren pjesë në trajnimet e organizuara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Nderkombëtar (SIDA) në Stokholm.

4. Më 7-14 shtator 2002, 5 ndihmës komisionerë të zyrës sonë shkuan për trajnim një javor pranë Zyrës së Ombudsmanit Parlamentar të Suedisë.

5. Me 4-29 Nëntor 2002 dy ndihmes komisionere të zyrës sonë morën pjesë në trajnimin një mujor të organizuar nga Mediatori Francez në Paris.

VII. Vizitat për shkëmbim eksperience dhe trajnime në Institucionin e Avokatit të Popullit të ekspertëve të huaj

1. Gjatë muajit maj 2002, dy grupe ekspertësh shqiptare nga Zyra e Ombudspersonit të Kosovës erdhën në Zyrën tonë për trajnime profesionale një javore.

2. Në 30 shtator - 5 tetor 2002, në vijim të bashkëpunimit me zyrën e Ombudspersonit të Kosovës erdhi në Zyrën tonë një grup ekspertësh serbë për trajnim profesional një javor.

3. Në 18-22 shtator në zyrën e Avokatit të Popullit erdhën për shkëmbim eksperience tre ekspertë nga zyra e Ombudsmanit të Republikës së Greqisë.

4. Më 12-14 Dhjetor erdhën në Zyrën tonë për të marrë eksperiencë dy ekspertë të Zyrës së Ombudspersonit të Kosovës për sistemin kompjuterik Doculive të instaluar në Zyrën tonë në fund të vitit 2001, mbi bazën e projektit Danida të Qeverisë Daneze.

VIII. Ekspertët e huaj në zyrën e Avokatit të Popullit

1. Në Janar 2002 kanë qenë në Zyrën tonë krye eksperti danez Z. Jens Olsen dhe specialisti i sistemit kompjuterik Z. Christian Moller nga Zyra e Ombudsmanit Parlamentar të Danimarkës.

2. Në shkurt dhe nëntor 2002 kemi patur të pranishme dy punonjëse të zyrës së regjistrimit të ankesave nga Zyra e Ombudsmanit Parlamentar të Danimarkës që kanë dhënë eksperiencën e tyre lidhur me regjistrimin e ankesave nëpërmjet sistemit kompjuterik.

9. Bashkëpunimi me Amnesty International

Gjatë vitit 2002 Institucioni i Avokatit të Popullit, sikurse edhe një vit më parë, ka vazhduar të ketë raporte shumë të mira bashkëpunimi me Amnesty International.

Numri i përgjithshëm i çështjeve ku ka patur bashkëpunim është rritur. Kontaktet janë mbajtur edhe me grupe të Amnesty International që veprojnë jo vetëm në Angli, por edhe në shtete të tjera të Europës, në Austri, Norvegji e Itali.

Numri i përgjithshëm i letrave të marra prej Amnesty International është 21 letra. Në 14 prej tyre kërkohet ndërhyrja e drejtëpërdrejtë e Avokatit të Popullit dhe në 7 raste të tjera letrat janë dërguar për njoftim.

Në përgjithësi natyra e shkeljes për të cilën Amnesty International ka kërkuar bashkëpunimin e Avokatit të Popullit është keqtrajtimi i shtetasve nga Policia.

Nga përmbledhja e këtyre letrave mund të përmendim çështjen e keqtrajtimit të të miturit E.Sh. të shtëpisë së fëmijës në Sarandë, për të cilin në vitin 2000 me rekomandimin e Avokatit të Popullit nga Ministria e Rendit u muar masa e largimit nga detyra të ish oficerit të Policisë Rrapo Xhavera. Prokuroria e Sarandës e pushoi ndjekjen penale ndaj tij, por pas insistimit të Avokatit të Popullit pranë ish Presidentit të Republikës, zotit Rexhep Meidani, ish Prokurori i Përgjithshëm, Arben Rakipi, rifilloi ndjekjen penale. Përfundimisht në verë 2002 gjykata e Sarandës e ka dënuar Rrapo Xhavarën me kusht. Por kryetari i Bashkisë së Sarandës, ashtu siç ka konstatuar edhe Raporti i Human Rights Watch në Janar 2003, e ka punësuar Rrapo Xhavarën si shef të policisë bashkiake të Sarandës.

Nga letërkembimet me grupin e Amnesty International të Norvegjisë, ky grup ka kërkuar informacion me të zgjeruar në lidhje me përfundimin e hetimit të çështjes së zotit Azgan Haklaj, shtëpia e të cilit u shkatërrua nga një bombe në qytetin Bajram Curri, si dhe për keqtrajtimin e tij dhe familjes së tij në Janar 2001 nga policia.

Mbi këtë çështje grupi është njoftuar se Avokati i Popullit i ka bërë rekomandim Prokurorit të Përgjithshëm që të merren të gjitha masat që çështja të përfundojë sa më shpejt, kurse ndaj prokurorit që ka zvarritur çështjen të merren masa disiplinore.

Në letrat e marra nga grupet e Amnesty International, gjithnjë ka qënë i pranishëm shqetësimi që për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të cilat kryesisht kanë qënë rrahje të qytetarëve nga punonjësit e policisë, të merren masat e duhura për ndjekje penale të të akuzuarve apo për dëmshpërblim të viktimave. Grupet e Amnesty International insistojnë që organet e drejtësisë në Shqipëri nuk kanë qënë efikase në këtë drejtim.

Nuk është e rastit që kopje të letrave dërguar Prokurorit të Përgjithshëm apo Gjykatave në rrethe i janë dërguar gjithashtu Avokatit të Popullit, duke kërkuar bashkëpunimin e tij mbi çështjet e përmendura në këto letra.

Theksojme se për të gjitha shkeljet flagrante të të drejtave të njeriut që janë vërtetuar, Avokati i Popullit ka bërë rekomandimet përkatëse ndaj organit të Prokurorisë për ndjekjen e çështjes apo shpejtimin e hetimit të saj.

Bashkëpunimet me Amnesty International kanë qënë dhe do të jenë të mirëpritura edhe për të ardhmen.

10. Konferenca Kombëtare “E drejta e informimit, e drejtë themelore e njeriut”

Përmirësimi i efektivitetit dhe kompletimi i një sistemi të ri administrativ brenda procesit të integritimit me Europën e Bashkuar, është një nga detyrat kryesore të shtetit shqiptar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të individëve në marrëdhënie me administratën. Neni 23 i Kushtetutës sonë përcakton se: *“E drejta e Informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë në përputhje me ligjin të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”*. Për këtë qëllim janë miratuar Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare” dhe Ligji nr.8485, datë 12.05.1999, “Për Kodin e Procedurave Administrative”, ligje të cilat janë brenda standarteve të legjislacionit të vendeve të Bashkimit Europian. Por për fat të keq, nga shqyrtimi i ankesave të qytetareve të depozituara pranë nesh, kemi venë re se, ndonësë kanë kaluar rreth tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve, ato njihen shume pak si nga publiku, ashtu dhe nga administrata publike shqiptare, kurse zbatimi i tyre has në pengesa të shumta.

Sipas nenit 30, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, ky Institucion në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një here në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të

ketij detyrimi, më datën 12 Dhjetor 2002, u zhvillua Konferenca Kombëtare “E drejta e informimit, e drejtë themelore e njeriut”, nën kujdesin e Presidentit të Republikës. Konferenca u organizua nga Institucioni ynë në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit pranë Kryeministrit dhe me Institutin e Studimeve Publike dhe Ligjore (OJF).

Për përgatitjen e Konferencës u punua gjatë gjithë vitit 2002, duke kryer vëzhgime mbi administratën, shqyrtuar ankesat që lidhen me të drejtën e informimit, u bënë sondazhe nga pedagogë dhe studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale etj.

Konferenca synoi të rrisë ndergjegjësimin e administratës publike të të dyja niveleve lidhur me të drejtat e detyrimet e saj gjatë kryerjes së funksioneve të njohura me ligj, me qëllim që puna e nëpunësve civil të orientohet drejt dhe t’i garantoje palëve pjesëmarrëse në procedurat administrative jo vetëm shërbim të kualifikuar, por dhe një qëndrim korrekt, që qytetarët të realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme.

Përfundimet e Konferencës ishin:

1. Duke patur parasysh që shoqëria shqiptare dhe shteti ynë ndodhet pranë një objektivi madhor, sikundër është nënshkrimi i Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit me Bashkimin Europian, është e natyrshme që edhe veprimtaria e Administratës Publike Shqiptare dhe Avokatit të Popullit në Shqipëri të fokusohen në krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e standarteve të larta të mirëqeverisjes dhe mirëadministrimit të punëve të shtetit.

Standartet e mirëqeverisjes që Bashkimi Europian ka përcaktuar për t’u arritur, bazohen në parime të tilla si, respektimi i lirisë, demokracisë, shtetit të së drejtës dhe i të drejtave të njeriut. Pjesë e pandarë e këtyre të drejtave janë edhe e drejta e mirëadministrimit si dhe e drejta për informim dhe akses në dokumentet zyrtare.

2. Nisma për organizimin e kësaj Konferencë Kombëtare, në kuadrin e të drejtave themelore Kushtetuese të qytetarëve shqiptarë është një veprimtari e zhvilluar në kohën dhe mjedisin e duhur, me qëllim jo vetëm për të bërë më të njohur të drejtat e mirëqeverisjes dhe të informimit, por sidomos për sensibilizimin e të gjithëve institucioneve, individëve, Mediave dhe Shoqërisë civile për këto të drejta.

3. Lidhja mes demokracisë dhe të drejtave të njeriut që parakupton ajo, sikundër është e drejta për informim, është themelore. Si e tillë kjo është parashikuar si në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ashtu dhe në Ligjin “Për të drejtën e informimit”, që përcakton dhe vendos rregulla për mirëfunksionimin dhe transparencën e administratës publike në

veprimtarinë e saj të përditshme, si ndaj publikut të gjerë, ashtu edhe ndaj Medias dhe shoqërisë civile.

Shqipëria ka miratuar ligje mjaft të mira, që po të zbatohen me korrektësi garantojnë pjesëmarrjen në qeverisje të taksa paguesve dhe transparencën e plotë të administratës publike ndaj tyre. Por konstatohet se zbatimi i këtyre ligjeve të mira çalon në praktikë. S'janë të pakta ankesat e individëve, grupeve të individëve ose edhe të Medias për mungesë të transparencës dhe shkelje të Procedurave Administrative në veprimtarinë e të gjithë segmenteve të piramidës që quhet administratë publike e një shteti. Natyrisht këto mangësi për një shtet në tranzicion janë të justifikueshme, por tashmë kur jemi në vitin e tretë të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit dhe Kodit të Procedurave Administrative, situata duhet ndrequr.

4. Shteti shqiptar në të gjitha nivelet e tij ka detyrim ligjor për të pranuar dhe trajtuar me seriozitet të plotë të gjitha ankesat e qytetarëve. Por shumica e institucioneve kryesore ose nuk kanë ndërtuar zyra funksionale, ose i kanë shkrirë ato, duke preferuar më shumë shtimin e zëdhënësve të tyre sesa të specialistëve që duhet të merren me ankesat e qytetarëve. Edhe në rastet e zyrave ekzistuese, shumica e ankesave trajtohen formalisht, pa ndjekje konkrete të problemeve dhe vëzhgim të zgjidhjes së tyre.

5. Ndër shumë arsye që krijojnë pengesa për zbatimin e së drejtës së informimit për dokumentet zyrtare, si për individin e thjeshtë, ashtu edhe për gazetarët, mund të evidentohen si më kryesore:

a) Zyrtarët përgjegjës, për të dhënë informacion dhe dokumente zyrtare, nuk rezultojnë posaçërisht të mësuar dhe të trajnuar për të menaxhuar me transparencë përgjegjësitë e tyre në këtë sistem demokratik të qeverisjes.

Në përshkrimet e detyrës së çdo nënpunësi (job discription), nuk thuhet asnjë fjalë për detyrimin e tij për të dhënë informacion sipas ligjit.

b) Qëndrimi personal i tyre nuk përputhet me frymën e ligjeve. Jo rrallë prej tyre në biseda private mund të dëgjosh informacion që shkon deri në cënimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, apo qoftë edhe të informacionit të klasifikuar sekret. Ndërkohë në zyrat e institucioneve, zyrtari i druhet zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit jo vetëm ndaj gazetarëve, por edhe ndaj individit të thjeshtë që interesohet drejtpërdrejtë për interesat e tij.

6. Në programet e qeverive është theksuar domosdoshmëria e transparencës gjatë veprimtarisë së administratës publike, në funksion të një mirëqeverisjeje sa më transparente dhe të hapur për publikun. Por mjaft organe dhe autoritete të administratës publike në veprimtarinë e tyre nuk janë treguar të gatshëm dhe nuk zbatojnë këto direktiva të Qeverisë. Veç të

tjerave ka mjaft akte nënligjore që nuk janë botuar e nuk njihen nga publiku.

Edhe autoritetet e pushtetit vendor rezultojnë se akoma nuk e kanë bërë pjesë të pandarë të metodës së punës së tyre jo vetëm zbatimin e të drejtës për informim, por edhe Kodin e Procedurës Administrative, i cili gjithashtu është një ligj mjaft i rëndësishëm që garanton transparencën e Administratës.

7. Avokati i Popullit qysh në fillimet e tij, në vitin 2000, i ka kushtuar një rëndësi të madhe zbatimit të Ligjit për të drejtën e informimit. I veshur me cilësinë e kujdestarit të këtij ligji, Avokati i Popullit u ka dërguar një rekomandim të gjitha organeve të administratës qendrore dhe vendore, përmes të cilit kërkon nxjerrjen dhe afishimin e rregulloreve përkatëse, në zbatim të Ligjit për të Drejtën e Informimit.

Avokati i Popullit disa herë ka kërkuar publikisht dhe institucionalisht që ligje të tilla si Ligji për Informim dhe Kodi i Procedurave Administrative lipset të jenë Bibla në punën e përditshme të administratës shqiptare. Çdo sistem antikorrptiv s'mund të konceptohet ndryshe, veçse mbi bazën dhe duke kërkuar për zbatim këto dy ligje.

8. Problemi i Transparencës dhe implementimi në praktikë të ligjit për të drejtën e informimit dhe Kodit të Procedurave Administrative ka qënë disa herë objekt i sondazheve, seminareve dhe aktiviteteve të tjera të shoqërisë civile (disa organizatave jo qeveritare). Kjo veprimtari e tyre vlen të përshëndetet dhe inkurajohet për të vijuar edhe në të ardhmen.

Mbi bazën e përfundimeve të mësipërme nga Konferenca dolën këto rekomandime:

1. Procesi i përafrimit me BE-në duhet të shoqërohet natyrshëm edhe me angazhimin praktik të administratës publike shqiptare për të zbatuar standartet e BE me korrektësi. Kjo parakupton që si ligjvënësi, (Kuvendi), ashtu edhe administrata dhe gjyqësori gjatë gjithë veprimtarisë së tyre të kenë parasysh dhe, kur është rasti, të zbatojnë konventat, kartat dhe standartet jo vetëm të Këshillit të Europës, por tashmë edhe të Bashkimit European, të cilat kanë përcaktuar si të drejta themelore të njeriut të drejtën për t'u informuar dhe për akses në administratën publike si dhe të drejtën e mirëqeverisjes. Çdo veprim i paqartë dhe jo transparent në diskrecionin e tre pushteteve, përbën veçse një ndryshk korruptiv në mekanizmat e tyre administrative në raport me qytetarin. Ligjet dhe aktet normative duhet të bëhen duke marrë më tepër mendimin e shoqërisë civile dhe komuniteteve përkatëse, sidomos komunitetit të biznesit, i cili deri tani ka vërejtje themelore në këtë drejtim si dhe për arbitraritetet e administratave tatimore e doganore.

2. Gjithë administrata publike shqiptare, në qendër dhe në bazë, duhet të kenë si prioritet kujdesin për zbatimin sa më efikas në praktikë të Ligjit “Për të Drejtën e Informimit me dokumentat zyrtarë” dhe “Kodin e Procedurave Administrative”. Këto janë dy ligje të rëndësishëm që plotësojnë njëri tjetrin, sepse mundësojnë që qytetari të ndërgjegjësohet për shërbimet që pret nga administrata, sikundër kjo e fundit ndërgjegjësohet se e ka për detyrë dhe madje shkel ligjin, nëse nuk ja ofron ato qytetarit. Rekrutimi i nëpunësve si nga Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave, ashtu edhe në pushtetin vendor të vazhdojë të bëhet mbi bazën e njohjes së thellë të këtyre dy ligjeve, si dhe me më Transparencë.

3. Të gjitha organet e administratës publike, çdo komunë, bashki, ministri apo organ tjetër në qendër e në bazë, duhet të afishojë e promovojë pa asnjë rezervë shërbimet që ato u ofrojnë njerëzve. Rregulloret që janë nxjerrë dhe Manualët ekzistues duhen studjuar dhe mbi bazën e përvojës së përfituar të shihet jo vetëm përputhja e tyre me ligjin, por edhe sa ato janë aplikuar drejtë në praktikë.

4. Nëpunësit civile duhet të jenë të vetëdijshëm që, si rregull, dosjet dhe dokumentet zyrtare, mund t’u bëhen të ditura çdokujt, mjaft që të mos shkelin të drejtën e palës tjetër, apo të sekretit shtetëror, kur ky cilësohet shkresërisht si i tillë. Transparenca duhet të hedhë dritë mbi çdo veprim administrativ e financiar nga çdo zyrë apo zyrtar.

5. Gjithë organet e administratës publike t’u mundësojnë qytetarëve të jenë më afër e të marrin pjesë në Procesin e vendim-marrjes, sepse kjo përmirëson dhe siguron mbështetje për institucionet publike. Të synohet në rritjen e interesit të qytetarëve për pjesëmarrje në vendim-marrje.

Kjo mënyrë funksionimi e gjërave në demokraci kërkon që edhe qytetarët të jenë të vetëdijshëm për ushtrimin e kontrollit mbi administratën, me qëllim që të nxisin eficientë e saj dhe parandalojnë edhe shanset e korrupsionit.

6. Siç sugjeroi Presidenti i Republikës, zoti Alfred Moisiu, ligjvënësit dhe Qeveria duhet të marrin në konsideratë studimin e strukturave të emërtuara “Zyra të pritjes së ankesave” pranë gjithë institucioneve publike, me qëllim të përmirësimit themelor të veprimtarisë së tyre. Kjo mund të arrihet duke bërë reformime të plota në sistemin e tanishëm qeveritar të trajtimit të ankesave të qytetarëve ose duke hartuar dhe miratuar një ligj të ri.

7. Nga Transparenca nuk përjashtohen edhe organet e gjyqësorit dhe ato të shërbimeve të lira publike, si noteria, prandaj duhet thelluar si kontrolli shtetëror, sipas ligjeve përkatëse mbi këto fusha, ashtu edhe

përmirësimi i ligjeve të tyre themelore, tarifave të tyre etj, në funksion të vënies efektive në shërbim të popullit.

8. Projekte të caktuara që i janë dhënë ose i jepen Shqipërisë nga Komuniteti Ndërkombëtar duhet të bëhen më tepër publike dhe të menaxhohen në mënyrë sa më transparente e me efektivitet nga institucionet apo autoritetet publike, duke bërë një ndryshim themelor për të ardhmen edhe në këtë fushë.

9. Punës njohëse dhe edukuese të publikut për njohjen e të drejtës së tyre për informim dhe Procedurave administrative që përdor administrata publike duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë. Roli i OJF-ve në këtë rast është i pa zëvendësueshëm. Pa njohje të ligjit, nuk do të kemi presion të publikut ndaj administratës për përmirësimin e mirëqeverisjes.

10. Misioni i Avokatit të Popullit është të ndikojë që Administrata Publike të bëhet sa më transparente, sikundër e kërkon ekologjia e demokracisë. Ndërkaq, roli i Avokatit të Popullit (Ombudsmanit) nuk duhet të kufizohet thjesht tek mbrojtja e të drejtave të qytetarëve në raport me padrejtësitë dhe abuzimet e administratës ose të nëpunësit publik. Për shkak të shumë mangësive që vijnë nga zbatimi i ligjit në praktikë, Avokati i Popullit mund dhe duhet të thellohet edhe më tej, në funksion të rolit të “mësuesit që vlerëson administratën”, duke respektuar njëkohësisht autoritetet legjitime dhe ndihmuar në realizimin e politikave prioritare të shtetit në tërësi.

Në këtë, kuptim përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut një nga objektivat e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet kultura e qeverisjes së mirë. Kjo do të thotë administrim i mirë, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike para njerëzve që paguajnë taksa për ta mbajtur atë. Avokati i Popullit, përmes rekomandimeve të tij të synojë të edukojë Administratën, duke e bërë atë të kuptojë rolin e saj të vërtetë ndaj qytetarëve, pra të përqëndrohet te arsyeja e vërtetë e ekzistencës së saj, jo si pronare dorështrënguar e të drejtave të qytetarëve, por si shërbëtoare e paguar prej tyre. Avokati i Popullit të studjojë tarifën që aplikohen në institucionet shtetërore për dhënie të informacionit, në mënyrë që të mos lejojë që ato të jenë më shumë se vlera e shërbimit, ashtu siç e kërkon edhe ligji. Të forcohet më tej roli garantues i Avokatit të Popullit për zbatimin e Transparencës, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien para ligjit të atyre nëpunësve që shkelin ligjet në këtë fushë.

Zhvillimi i kësaj Konference nën kujdesin e Presidentit të Republikës dhe pjesëmarrja e tij, deputetëve, drejtuesve të disa ministrive kryesore, krerëve të gjyqësorit shqiptar dhe mjaft drejtuesve të organeve të pushtetit vendor nga gjithë vendi si dhe fjalimet, problemet dhe sugjerimet e tyre, për çështjet e trajtuara në Konferencë, janë një tregues shumë pozitiv që premtojnë për një ndryshim pozitiv të administratës publike shqiptare.

Sipas mendimit të përgjithshëm, të shprehur nëpërmjet përshtetjeve, fjalimeve, kumtesave dhe diskutimeve të pjesëmarrësve, Konferenca ia arriti qëllimit të caktuar për sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të të gjitha organeve dhe autoriteteve të administratës publike shqiptare për zbatimin e të drejtës së informimit dhe rekomandimeve të kësaj Konferencë.

Konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, që dolën gjatë punimeve të saj, i janë dërguar Presidentit të Republikës, Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, dhe gjithë deputetëve, Kryeministrit, gjithë Ministrave si dhe të gjithë Prefekturave, Bashkive, Qarqeve dhe Komunave të Shqipërisë, të shoqëruar me një kalendar të vitit 2003 i cili në çdo fletë të tij ka një nen të ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Të shpresojmë se rekomandimet e kësaj Konference do të vlerësohen me seriozitet dhe do fillojnë të zbatohen nga gjithë administrata publike shqiptare.

11. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2002

Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme, për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij kanë marrë pjesë, duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Kjo ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për tu investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Meqenëse kontributet e Avokatit të Popullit dhe të përfaqësuesve të tij në këto aktivitete mund të përbëjnë një objekt botimi më vete, më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e tyre, duke menduar të paraqesim edhe grupet e interesit, të synuara prej tyre.

1. Seminar me temë: “Avokati i Popullit dhe marrëdhëniet e tij me sistemin gjyqësor” organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, me pjesëmarrjen e Ombudsmanit të Suedisë Z. Claes Eklundh, Prill 2002.

2. Seminar me temë: “Mbi trajtimin e rasteve dhe politikat e zyrës së Ombudsmanit”, organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit i ftuar Ombudsmani i Bosnje Herzegovinës Z. Frank Orton, Korrik 2002.

3. Seminar me temë: “Mbi sigurinë njerëzore dhe kontrollin e Armatimit në Shqipëri” organizuar nga Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara dhe Shoqata Shqiptare e Atlantikut, Janar 2002.

4. Seminar me temë “Mbi korrupsionin në Drejtësi” organizuar nga Shoqata e Grave Juriste, Mars 2002.

5. Seminar me temë “Mbi të drejtat dhe liritë e njeriut” organizuar nga Qendra Shqiptare e të drejtave të njeriut”, Prill 2002

6. Seminar me temë: “Mbi Shërbimin Informativ”, organizuar nga Qendra e të drejtave të njeriut, Prill 2002.

7. Seminar me temë: “Njohja e respektimi i të drejtave të njeriut, deklarata universale dhe Konventa Europiane” organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Maj 2002.

8. Seminar me temë: “Puna e fëmijëve dhe format më të rënda të saj. Ndal punës së fëmijëve në Shqipëri” organizuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Maj 2002.

9. Seminar me temë: “Mbi kartën sociale Europiane të rishikuar” organizuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Qershor 2002.

10. Seminar me temë: “Zbatimi i Kodit të Proçedurave Administrative” organizuar nga Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave në bashkëpunim me ABA-CEELI, Tetor 2002.

11. Seminar me temë: “Zyra e përmbartimit dhe ekzekutimi vendimeve gjyqësore” i organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Europës, Tetor 2002.

12. Seminar me temë: “Neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut për një zhvillim të rregullt të procesit gjyqësor” organizuar nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese, Tetor 2002.

13. Tryezë e rumbullaket me temë: “Bashkëpunimi mes Parlamentit dhe Shoqërisë Civile në Procesin Legjislativ në Shqipëri”, Tetor 2002.

14. Seminar me temë: “Projekt ligji për deklarimin e pasurive”, organizuar nga Komisioni Juridik i Parlamentit, Tetor 2002.

15. Seminar me temë: “Konventa Kuadër për mbrojtjen e minoriteteve Kombëtare dhe legjislacioni shqiptar” organizuar nga Institucioni i

Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Shtator, Tetor 2002.

16.Seminar me temë: “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Legjislacioni Shqiptar” organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Tetor, Nëntor 2002.

17.Seminar me temë: “Të drejtat e të paraburgosurve” organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Komiteti Hollandez i Helsinkit, Tetor 2002.

18.Seminar me temë: “Për funksionimin e Gjykatës Europiane për të drejtat e njeriut në Strasburg” organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Qendrën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Nëntor 2002.

19.Seminar me temë: “E drejta e Informimit për dokumentat zyrtare”, organizuar nga Grupi Shqiptar për të drejtat e njeriut dhe Shoqata “Artikulli 19”, Nëntor 2002.

20.Seminar me temë: “Mbi popullsinë dhe zhvillimin familjar” organizuar nga Shoqata e grave, Nëntor 2002.

21.Seminar me temë: “Të drejtat e Invalidit të punës” organizuar nga Shoqata e Invalidëve të punës, Nëntor 2002.

22.Seminar me temë: “Eksperti Kontabël” i organizuar nga I.E.K.A. Nëntor 2002.

23.Konferencë me rastin e 10-të vjetorit të Gjykatës Kushtetuese, Nëntor 2002.

24.Konferencë shkencore Ndërkombëtare dhe ndërarkiviste. Promovim i “Acta Albaniae I-II” organizuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave të Shtetit, Nëntor 2002.

25.Tryezë e rrumbullakët me temë: “Policia Shqiptare dhe vizioni i saj për të ardhmen” organizuar nga Ministria e Rendit Publik dhe Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Nëntor 2002.

26.Seminar me temë: “Alternativat e dënimit me burgim” i organizuar nga Këshilli i Europës, Dhjetor 2002.

27.Konventa Ushtarake - Ministria e Mbrojtjes, Dhjetor 2002.

28.Konferenca Gjyqësore Kombëtare, Dhjetor 2002.

29.Komiteti Shqiptar i Helsinkit “Vlerësim i situatës të të drejtave të njeriut në disa rrethe të vendit”, Dhjetor 2002.

30.Aktivi i Shoqatës të ndërtuesve të Shqipërisë. Dhjetor 2002.

31.Katër seminare për edukimin e policisë me të Drejtat e Njeriut dhe shkeljet e konstatuara nga Avokati i Popullit, organizuar nga Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut me Drejtorinë e Policisë Qarkut Dibër dhe

me Komisaritet e Policisë Peshkopi, Bulqizë e Burrel. Nëntor-Dhjetor 2002.

Në të gjitha këto aktivitete, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohemi, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të jetë përparësi e punës tonë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës të të tre pushteteve, si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për mprehjen e mëtejshme të vizionit tonë, si instancë kombëtare, mbikqyrëse e respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha dimensionet e tyre.

KREU I TRETË

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet (rastet), të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)

Gjatë vitit 2002, për aparatin e Këshillit të Ministrave dhe institucionet administrative në vartësi direkte të tij, si Grupi Mbikqyrës i firmave piramidale, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë, Agjensia Kombëtare e Privatizimit, kanë ardhur gjithsej 198 ankesa dhe kërkesa.

Duke realizuar detyrën e tij kryesore, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, Avokati i Popullit në të njëjtën kohë, ka informuar, rekomanduar apo i ka bërë propozime Kryeministrit dhe ministrave për të gjitha çështjet kryesore që kanë dalë gjatë punës së tij. Pavarësisht nga forma në të cilën janë paraqitur opinionet e Avokatit të Popullit, mendojmë se, në njërën ose tjetrën mënyrë, ato kanë ndikuar në rritjen e standarteve të mirëqeverisjes. Konkretisht, gjatë vitit 2001, nga ana jonë i janë dërguar zyrtarisht ish Kryeministrit Ilir Meta këto rekomandime, kërkesa apo njoftime:

1-Për nevojën e një fondi për strehimin e familjes së Gjin Markut (mars 2001). Çështja është zgjidhur përfundimisht në vitin 2002.

2-Informacion për pengesat që nxjerr A.K.P., për regjistrimin e pasurive të paluajtshme që u ka shitur shtetasve (14.05.2001). Problemi u zgjidh sepse Qeveria miratoi një Vendim me anë të të cilit autorizonte A.K.P. për të bërë pagesat për taksat e regjistrimit për pasuritë e paluajtshme që ajo u kishte shitur të tretëve.

3-Referim për të caktuar Ministrinë përgjegjëse për zgjidhjen e disa ankesave për Basenin e Bovillës (25.05.2001) dhe rikujtuar më (01.10.2001). Në shkurt 2002, ish- Kryeministri Pandeli Majko ngriti një grup pune të përbërë nga Ministri i Mjedisit, Ministri i Punëve Publike dhe Ministri i Shëndetësisë. Problemi i pastrimit të ujit u zgjidh, por largimi i

rreth 40 familjeve që banojnë brenda zonës së liqenit të Bovillës dhe përbëjnë rrezik të vazhdueshëm, si dhe mosrrethimi i basenit, vazhdojnë të jenë çështje të pazgjidhura.

4-Mbi ankesën e 168 familjeve nga Komuna Bicaj-Kukës (27.05.2001). Nuk u muar parasysh nga Qeveria për mungesë fondesh.

5-Propozim për ndryshime në Ligjin nr.7665, datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin” (12.10.2001). Problemi është pezulluar në vartësi me ligjin që do të dalë për kthimin e kompensimin e pronave.

6-Informacion për problemet e fshatit Lazarat në rrethin e Gjirokastrës (12.10.2001). Gjendja aktuale në këtë fshat është e qetë.

7-Rekomandim për nxjerrjen e disa akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit nr.8606, datë 27.04.2000 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut” (18.10.2001). Aktet nënligjore janë nxjerrë.

8-Rekomandim për përgatitjen e ligjit për zhdëmtimin e personave të dëmtuar, në zbatim të nenit 44, të Kushtetutës (24.12.2001). Ministria e Drejtësisë e ka vënë në planin e saj të punës përgatitjen e projektligjit për vitin 2003.

9-Konkluzione dhe rekomandime nga Konferenca Kombëtare për të drejtën e jetës (26.12.2001). Këto i janë ridërguar në vitin 2002 ish Kryeministrit Majko, si dhe Kryeministrit Nano, si kujtesë. Ka reaguar pozitivisht vetëm Ministri i Rendit Publik, zoti Luan Rama, kurse Qeveria apo institucione të tjera nuk na kanë vënë në dijeni për masa apo veprime konkrete për vënien në zbatim të rekomandimeve.

10-Propozime për marrjen e nismës ligjvënëse, lidhur me përmirësimin e ndryshimeve të akteve ligjore e nënligjore për përfundimin e procesit të rivlerësimit e rishpërndarjes së pasurisë së ish-kooperativave bujqësore, si edhe ndryshime në Ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” (26.12.2001). Nuk kemi përgjigje zyrtare.

Gjatë vitit 2002, Qeverisë, të kryesuar nga zoti Majko deri në korrik 2002 dhe më pas Kryeministrit, zotit Fatos Nano i janë dërguar zyrtarisht këto rekomandime, mendime, propozime, apo njoftime:

1-Rekomandim për ndryshimin e ligjit për armët. Kemi shpjeguar në çështjet drejtuar Kuvendit (datë 16.04.2002).

2-Informacion për problemet e shërbimeve jetësore me KESH, Telekom dhe Ujësjellës (datë 30.04.2002).

3-Rekomandim për plotësimin e Ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat e trajtimit e të dënuarve” (datë 13.05.2002). Ministria e Drejtësisë po punon për përgatitjen e projektligjit përkatës.

4-Rekomandim për plotësimin e kërkesave të Ligjit nr.8092, datë 03.02.1996 “Për shëndetin mendor”, për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilat gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar” (datë 13.05.2002). Nuk kemi njoftime.

5-Rekomandim për plotësimin e Ligjit “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” (datë 13.05.2002). Nga Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë jemi njoftuar se po punojnë për përgatitjen e projektligjit përkatës.

6-Lidhur me Ligjin nr.8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” për të forcuar kontrollin dhe pjesëmarrjen e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e privatizimit të pronës shtetërore (datë 14.05.2002). Faktikisht nuk kemi patur ndonjë përgjigje zyrtare për këto propozime.

7-Kërkesë për bashkëpunim për Konferencën Kombëtare për të Drejtën e Informimit (datë 23.09.2002) Kryeministri ngarkoi Ministrin e Shtetit, zotin Blendi Klosi për të bashkëpunuar dhe Konferenca u zhvillua më datën 12.12.2002.

8-Propozime për masat që duhen marrë për zbatimin e neneve 41 dhe 181 të Kushtetutës (datë 19.09.2002). Kuvendi miratoi Rezolutën që ka pezulluar të gjitha veprimet me pronat e paluajtshme deri në nxjerrjen e ligjit të ri.

9-Rekomandim për marrjen e masave për parandalimin e rasteve të keqtrajtimit nga organet e policisë së shtetit (datë 24.09.2002). Nuk kemi marrë përgjigje.

10-Rekomandim për planifikimin e fondit të nevojshëm në buxhetin e shtetit për vitin 2003, për të përfunduar brenda vitit 2005 ekzekutimin e të gjitha vendimeve gjyqësore, ku debitor është shteti, sipas angazhimit të marrë në programin e Qeverisë në korrik 2002 (datë 15.10.2002).

Nga Ministria e Financave jemi njoftuar se për këtë qëllim në buxhetin e vitit 2003 janë planifikuar 150 milion lekë.

11-Për forcimin e kontrollit mbi firmat që konfeksionojnë e shesin ujë të pijshëm (tetor 2002). Kryeministri ngriti një grup pune dhe vuri në lëvizje Ministrinë e Bujqësisë e Ushqimit dhe Ministrinë e Shëndetësisë për forcimin e kontrollit sipas propozimeve tona.

12-Rekomandim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 552 datë 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës” (datë 06.12.2002), Kryeministri ka ngarkuar Ministrinë e Rendit të shqyrtojë problemin.

Kryeministri është informuar rast pas rasti dhe në lidhje me problemet me interes për Qeverinë që kemi diskutuar me homologët gjatë takimeve në Shqipëri, apo vizitave tona jashtë shtetit.

a. Grupi Mbikqyrës i Firmave Piramidale pranë Këshillit të Ministrave

Ndërsa për vitin 2001 ka patur 17 ankesa, në vitin 2002 ka patur 15 ankesa, lidhur me veprimtarinë e Grupit Mbikqyrës të Firmave Piramidale pranë Këshillit të Ministrave. Nga këto ankesa 13 kanë përfunduar, ndërsa 2 ankesa janë akoma në shqyrtim nga ana jonë.

Problematika e nxjerrë në ankesat e ardhura për vitin 2002, ka një ngjashmëri me atë të vitit të mëparshëm, por ka edhe specifikën e vet, të shfaqur më konkretisht, në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të detyrueshme për pagimin e vlerave të caktuara monetare nga ana e Grupit Mbikqyrës ndaj subjekteve të caktuara tregtare.

Problemet e parashtruara në ankesat e trajtuara, kanë qenë:

1.Për kundërshtim të veprimeve të bëra nga Grupi Mbikqyrës apo administratorët e caktuar për administrimin e ish firmave piramidale, në lidhje me pasurinë e individëve të caktuar, si p.sh. sekuestrim, bllokim të pasurisë, apo detyrime për të paguar shuma të caktuara monetare.

2.Për mosderdhje të kontribucioneve të sigurimeve shoqërore nga ana e ish firmave piramidale për punonjësit e tyre apo edhe administratorët aktualë të këtyre firmave në administrim, për punonjësit që kanë punuar me kontrata për ta.

3.Për mënyrën e administrimit të firmave piramidale nga ana e administratorëve të pavarur dhe për ecurinë e procesit të transparencës.

4.Për zvarritje në procesin e kthimit të parave kreditorëve të ish firmave piramidale nga ana e Grupit Mbikqyrës.

5.Për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore nga ana e Grupit Mbikqyrës, vendime në të cilat vendoset detyrimi i shlyerjes së një detyrimi në të holla, ndaj subjekteve të ndryshme tregtare.

E veçanta këtë vit është se ankuesit për një numër të caktuar çështjesh, për të cilat paraprakisht duhej t'i ishin drejtuar vetë Grupit Mbikqyrës për sqarime, na janë drejtuar ne si institucion, pa kaluar kështu paraprakisht shkallën e domosdoshme të ankimit administrativ, që do të mundësonte më pas shqyrtimin nga ana jonë. Ky fakt ka sjellë për pasojë përcjelljen e këtyre ankesave për kompetencë trajtimi pranë këtij institucioni. Por në të njëjtën kohë këto ankesa janë edhe tregues i faktit se transparenca e vërtetë në veprimtarinë e këtij organi ka munguar, moment i cili është konstatuar edhe në raportin tonë vjetor të vitit 2001.

Edhe në Konferencën Kombëtare “E drejta e informimit, e drejtë themelore e njeriut”, organizuar në datën 12.12.2002, diskutantë të ndryshëm e kanë cilësuar veprimtarinë e Grupit Mbikqyrës si model hermetizimi të një institucioni shtetëror. Por nga ana institucionale komunikimet mes nesh si institucion dhe Grupit Mbikqyrës, kanë qenë më korrekte sesa në vitin 2001.

Problem shumë i mprehtë që mbetet në veprimtarinë e këtij organi të administratës publike është mospërfundimi i plotë i procesit të transparencës dhe mospërcaktimi i afateve konkrete të përfundimit dhe të procesit të kthimit të parave ndaj kreditorëve të firmave piramidale. Duke qenë koshient lidhur me kohën e nevojshme të mbarimit të procedurave administrative dhe gjyqësore dhe marrjes së një vendimi përfundimtar, mendojmë se ndaj publikut duhet mbajtur një qëndrim më i hapur, tepër transparent në sqarim të këtyre fakteve.

Në shumë çështje vërehet se me procesin e transparencës, ndërthuren edhe procese gjyqësore, kundër veprimeve të Grupit Mbikqyrës apo të administratorëve të caktuar për administrimin e ish firmave piramidale. Problemi ka të bëjë me mosekzekutimin e disa vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat i ngarkojnë Grupit Mbikqyrës, shlyerjen e detyrimeve financiare. Por dhe pas rekomandimeve të bëra nga ana jonë, rezultojnë me një mosveprim real apo veprim të pjesshëm të pajustificuar, pavarësisht se shkelet parimi kushtetues për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet e administratës. Lidhur me këtë fakt po paraqesim dy raste tipike:

Shtetasi E.A. si përfaqësues i subjektit tregtar “A”, në ankesën e tij drejtuar institucionit tonë shpreh shqetësimin në lidhje me mosekzekutimin e plotë nga ana e Grupit Mbikqyrës, të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr.2557 datë 16.07.1999, i cili është kthyer në titull ekzekutiv dhe që detyron institucionin e sipërcituar, t’i paguaj ankuesit shumën përkatëse prej 25.052.222 lekë. Sikundër shkruan ankuesi, Grupi Mbikqyrës (administratorët përkatës) duke e pranuar këtë vendim, ka bërë deri në momentin e paraqitjes së ankesës, dy pagesa në favor të tij, ndërkohë që nuk ka shlyer përfundimisht detyrimin financiar të përcaktuar në vendimin gjyqësor.

Pagesa e pjesës tjetër të detyrimit po zvarritet pa arsye, ndërkohë që ankuesi është në vështirësi financiare, siç shprehet në letrën e tij.

Pas marrjes në shqyrtim të kësaj ankese dhe shpjegimeve të ardhura nga Grupi Mbikqyrës (administratorët e shoqërisë “M.Leka” sh.p.k.), jemi vënë në dijeni për vendimin nr.68 datë 21.03.2002, të marrë nga ana e administratores së firmës piramidale “M.Leka” sh.p.k., në administrim. Në

këtë vendim, shprehet se në bazë të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë Tiranë me nr.2340 datë 21.03.2002, është vendosur detyrimi i shoqërisë “M.Leka”, të paguajë në favor të shoqërisë “A”, shumën prej 25.611.664 lekë (Pas ndreqjes së gabimit ngelet shuma 25.052.222 lekë).

Pas një likujdimi të pjesshëm që i është bërë shoqërisë “A”, nga ana e administratorëve të firmës “M.Leka”, sipas Zyrës së Përmbartimit, urdhërohen këta të fundit për pagimin e detyrimit për shumën 17.575.062 lekë. Megjithatë, pavarësisht nga këto vendime gjyqësore, administratorja përkatëse ka vendosur që shlyerja e detyrimit të bëhet pjesor në masën 34 %, ose i shprehur në vleftë në shumën 5.975.520 lekë.

Duke ju referuar edhe një herë vendimeve përkatëse gjyqësore, ne e kemi vlerësuar si të paligjshëm dhe absolutisht të pavlefshëm, njohjen e detyrimit pjesor ndaj shoqërisë “A”, në masën 34 %, ndërkohë që titulli ekzekutiv përcakton detyrimin për administratorët e shoqërisë “M.Leka” sh.p.k. në administrim, në shumën 25.052.222 lekë, detyrim që duke i zbritur likujdimin e mëparshëm pjesor të bërë nga po këta administratorë, reduktohet në shumën prej 17.575.062 lekë. Shlyerja e detyrimit në fjalë, nuk ka pse t’i referohet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.610 datë 21.12.1999, përderisa për çështjen civile në fjalë ka një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Duke i kujtuar edhe një herë institucionit të Grupit Mbikqyrës, parimin bazë të ndarjes së pushteteve, sanksionuar në nenin 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”, nga ana jonë i është rekomanduar Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave shlyerja e detyrimit ndaj shoqërisë “A”, në masën 100 % të saj. Aktualisht rekomandimi është pranuar, por nga ana e Grupit Mbikqyrës, kjo shlyerje është parë e lidhur me procesin e shitjes së aseteve të shoqërisë “M.Leka” sh.p.k. në administrim dhe me një proces gjyqësor në vazhdim, pavarësisht se realisht nga shumat e depozituara faktike në Bankën e Kursimeve të Shqipërisë, shuma e detyrimit të tij financiar, mund të jetë plotësisht e shlyeshme dhe e pavarur nga momentet e lartpërmendura. Prandaj puna jonë po vazhdon me verifikimin e mundësisë së shlyerjes direkte, në bazë të depozitave faktike monetare që janë në bankën e sipërcituar për shoqërinë “M.Leka” sh.p.k. në administrim.

E të njëjtës natyrë është edhe ankesa e shtetasit P.V. nga Tirana. Prandaj kohët e fundit i jemi drejtuar Kryeministrit, zotit Fatos Nano që me cilësinë e tij si Kryetar i Komisionit të Posaçëm për Shpërndarjen e

Pasurive të ish Fondacioneve, të urdhërojë zbatimin e këtyre vendimeve gjyqësore nga Kryetari i Grupit Mbikqyrës, zoti Farudin Arapi.

b. Ankesa për Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Për Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme gjatë vitit 2002 në Institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur gjithsej 88 ankime, nga 31 një vit më parë. Janë përfunduar 60 çështje, nga të cilat 7 në favor të ankuesve. 51 ankesat e tjera kanë qenë jashtë juridiksionit ose kanë rezultuar si të pabazuara.

Shumica e ankimeve të vlerësuara jashtë juridiksionit kanë të bëjnë me mosrregjistrimin e pronave nga këto Zyra për shkak të mbivendosjes të tyre. Kjo ka ardhur si pasojë e trajtimit të të njëjtave sipërfaqe toke, truall ose tokë bujqësore, si nga Komisionet e Tokave, ashtu edhe nga Komisionet e Kthimit e Kompensimit të Pronave, apo vendimeve të marra nga këto të fundit pa u konsultuar me hartat përkatëse, pa verifikuar faktin në se përputhen kufijtë e vjetër me ato aktuale, në se është i lirë ose jo trualli i pretenduar, etj. Në këto raste ju është sugjeruar qytetarëve t'i drejtohen gjykatës për zgjidhjen gjyqësisht të këtyre shqetësimeve sepse ndodhen para një konflikti pronësie. Këtu ka një problem që është vështirë të pranohet nga ana e pjesës dërrmuese të ankuesve. Shtetasit, për shumë arsye, përfshi edhe mungesën e një kulture minimale juridike për mënyrën ligjore të mbrojtjes së pronës së cënuar, në rastin konkret, nga mbivendosja me pronën e një personi tjetër, nuk pranojnë dhe nuk binden se çështja mund të zgjidhet vetëm në rrugë gjyqësore. Ata këmbëngulin shpesh herë duke pretenduar për punonjësit e këtyre Zyrave se veprojnë në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës së tyre.

Nga ana tjetër, rezultojnë të bazuara ankimet që kanë të bëjnë me zvarritje kohore të pajustificuara nga ZRPP për shumicën e veprimeve që kryejnë në marrëdhëniet e tyre me publikun si dhe për faktin se shërbimi ndaj qytetarëve lë shumë për të dëshiruar. Personelit në Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i mungon në mënyrë të theksuar kultura qytetare, mungojnë sportelet për t'ju përgjigjur fluksit të madh të qytetarëve, duke i bërë këta të fundit të dyshojnë për veprime korruptive. Kundrejt gatishmërisë së qytetarëve për të paguar pa hezitim të gjitha detyrimet fiskale për aplikime të ndryshme, ka nëpunësa që, në shumë raste, ju mungon ndjenja minimale e përgjegjësisë, pa i akuzuar se ato bëhen nxitës për afera korruptive.

Megjithatë bashkëpunimi ynë me ZRPP në vazhdimësi ka qenë i frutshëm dhe rezultativ. Në të gjitha rastet kur nga ana jonë ju është

sugjeruar të bëhen veprimet konkrete të rregjistrimit ose të lëshimit të çertifikatës së pronësisë, sepse ankuesit kanë patur të drejtë në pretendimet e tyre, kanë reaguar pozitivisht. Duhet përmendur për zgjidhjen e tyre pozitive për vetë vështirësitë që përmbanin në vetvete, ankimet e shtetasve S.B. banues në Tiranë, V.G. banues në Berat dhe A.B. banues në Korçë, nga ZRPP të rretheve përkatëse.

c. Ankesat për Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve (KKKP)

Për vitin 2002, kanë ardhur 59 ankesa ndaj Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të të gjitha niveleve, nga të cilat janë përfunduar 49, ndërsa 10 janë mbartur në vitin 2003 për shqyrtim të mëtejshëm. Janë zgjidhur në favor 2 ankesa. Ankuesit kanë marrë vendimet nga KKK e Pronave pranë Prefekturave Tiranë dhe Durrës, me ndërhyrjen tonë, pas disa vjet të dorëzimit të kërkesave dhe dokumentacionit për njohjen dhe kthimin e pronave si ish-pronarë.

Ndër ankesat e tjera, një grup kishin të bënin me kundërshtimin e vendimeve të këtyre Komisioneve, në rastet kur nuk ju është kthyer fizikisht trualli me argumentin se është vlerësuar i zënë me ndërtime të përhershme, kurse grupi tjetër, që është edhe më i madhi, ankesat kanë qenë të pabazuara për faktin se dokumentacioni i tyre pranë Zyrate të KKK të Pronave kishte qenë me mangësi dhe i paplotë. Të parëve, ankimet e të cilave janë jashtë juridiksionit tonë, ju është sugjeruar kundërshtimi i vendimit të KKK të Pronave në gjykatën e rrethit ku ndodhet prona, në bazë të nenit 27/a të Ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Ndërsa grupit të dytë, lidhur me ankesat e tyre të pabazuara, i kemi këshilluar të paraqiten në KKK të Pronave për të mundësuar plotësimin e kërkesave konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sidoqoftë në këto raste ka vend për të evidentuar mungesën e transparencës, sepse KKK të Pronave nuk i njoftojnë kërkuarit për shkaqet se përse nuk u jepen vendimet që kërkojnë, duke shkelur kështu Kodin e Procedurave Administrative.

Nga shqyrtimi i të gjitha ankesave lidhur me procesin e kthimit të pronave në tërë kompleksitetin e tij, konstatojmë se mjaft nga problemet e ngritura në Raportin tonë Vjetor 2001, vazhdojnë të ekzistojnë ende.

Është pranuar nga të gjithë se Ligji nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij kanë boshllëqe dhe mangësi që duhen ndrequr me seriozitetin më të madh, përfshirë edhe plotësimin e standarteve europiane

të trajtimit të pronësisë, si kusht paraprak i integritit të vendit tonë në Bashkimin Europian. Megjithatë afatet e përcaktuara në nenin 181 të Kushtetutës kanë mbi një vit që kanë përfunduar. Vonesat në trajtimin përfundimtar të çështjes së pronave, janë reflektuar në ngadalësinë e veprimtarisë së KKK të Pronave. Në zyrat e tyre ka shumë dosje që nuk shqyrtohen prej vitesh, ka hezitime në shumë raste për të dhënë vendime negative në rastet kur prona e pretenduar ju është dhënë në pronësi personave të tjerë, etj. Këto fenomene janë të pranishme thuajse në të gjitha KKK të Pronave.

Problem i veçantë është edhe fakti se shumë autoritete publike të organeve të pushtetit vendor në Bashki, Komuna dhe institucione të ndryshme, sidomos në Drejtoritë e Shërbimit Pyjor në rrethe, për mosnjohje të ligjit, kanë qëndrim mospërfillës ndaj vendimeve të KKK të Pronave, duke mos i ekzekutuar ato, kur kanë detyrim të bëjnë dorëzimin e sipërfaqeve të trojeve apo të pyjeve.

Avokati i Popullit i ka ndjekur me vëmendjen e duhur të gjitha problemet e ngritura nga shtetas dhe shoqata të ish-pronarëve lidhur me problemin kardinal të garantimit dhe mbrojtjes së pronës private, si një nga të drejtat themelore të njeriut. Të njëjtin qëndrim, Avokati i Popullit, ka mbajtur edhe në mbrojtje të pronës shtetërore në të gjitha rastet kur janë konstatuar abuzime në fitimin e pronësisë së saj nga persona të veçantë, apo për të ndihmuar zhvillimin e veprimtarisë së komisioneve. Për të ilustruar këtë veprimtari po paraqesim letrën e falenderimit të datës 25.10.2002 që na ka dërguar Kryetari i KKK të Pronave të Qarkut Tiranë, zoti Robert Kreçi: “Me shkresat Tuaja të vazhdueshme, Ju Avokati i Popullit, drejtuar Instancave më të larta Shtetërore, arrihet të ndikoni në krijimin e kushteve më të mira të punës të Komisionit të KKP pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë. Kështu ju informoj se nga Kryeministri na janë vënë në dispozicion 4 (katër) kompjutera e ndoshta më vonë edhe një fotokopje. Me këtë shkresë të parë, të shtypur me këto kompjutera, ne si Komision i KKP Tiranë, ju jemi mirënjohës Ju dhe Institucionit që Ju drejtoni. Duke shpresuar në një bashkëpunim më të ngushtë për zgjidhjen e problemeve, unë si Kryetar i KKKP Tiranë Ju falenderoj personalisht duke ju uruar suksese në punën dhe misionin Tuaj”.

Përveç rekomandimeve e sugjerimeve të bëra Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave, Institucioni ynë ju ka paraqitur Komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë, mendime për ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore që trajtojnë problemin e pronave. Besojmë se duke qenë të argumentuara, edhe këto mendime kanë ndikuar në nxjerrjen nga Kuvendi të Rezolutës për bllokimin e përkohshëm të ndarjes së pronave

nga ana e shtetit, sidomos atyre në bregdet. Gjithashtu përshëndetim çdo nismë të kohëve të fundit, të ndërmarrë për realizimin jo vetëm të urdhërimeve të nenit 181 të Kushtetutës, por edhe për rivendosjen në vend të padrejtësive të së kaluarës së afërt ndaj të gjithë pronarëve të pasurive të paluajtshme.

Shpresojmë se së shpejti mund të gjendet konsensusi i duhur midis palëve që kanë obligimet e tyre në këtë çështje tepër të prekshme, për t'i dhënë fund procesit të kthimit të pronave e për të filluar ai i kompensimit. Institucioni ynë e ka shprehur dhe e gjen me vend të bëjë edhe një herë publike impenjimin për dhënien e ndihmesës së tij profesionale, në kuadrin e të drejtave të njeriut, për zgjidhje sa më të pranueshme për realitetin shqiptar të këtij problemi madhor.

ç. Instituti i Integritit të të Përndjekurve

Numri i ankesave ndaj Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP) është 8, nga të cilat 2 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 3 janë të pabazuara ose jashtë juridiksionit dhe 3 janë në shqyrtim. Në vitin 2002 kemi patur vetëm 2 ankesa të pabazuara.

Problematika e ankesave mund të shprehet për çështje të mospërfitimit të statusit të ish të përndjekurit, mosdhënia e dëmshpërblimit për vitet e vuajtjes në periudhën e diktaturës dhe problemi i mosstrehimit të ish të përndjekurve të pastrehë.

Nga ankesa e shtetasit K.L., rezulton se megjithëse ishte dënuar me 15 vjet burg për agjitacion dhe propagandë, ende nuk ka arritur të marrë statusin e të përndjekurit politik, si dhe shpërblimin përkatës. Meqenëse ankuesi nuk figuronte i rregjistruar si i dënuar politik, por ordiner, pas verifikimit të problemit pranë Degës së Arkivit të Ministrisë së Rendit Publik, u arrit në nxjerrjen e vërtetimit të dënimit politik të ankuesit, gjë që i hap rrugën e marrjes së statusit të të përndjekurit politik. Por lidhur me problemin e përfitimit të Statusit të të Përndjekurit Politik, vërejmë se ligjërisht procedurat janë të hapura, por praktikisht ka 5 vite që Komisionit Shtetëror 3-Palësh i caktimit të Statusit, i cili ka të drejtën ekskluzive të dhënies së Statusit, nuk është mbledhur. Kjo ka bërë që një numër i konsiderueshëm kërkesash të ligjshme për këtë qëllim, të mos gjejnë ende zgjidhje. Nga ana e IIPP është konkluduar nevoja e rregullimeve përkatëse ligjore e nënligjore për mbledhjen e Komisionit Shtetëror 3-palësh. Zyra jonë do të ndërmjetësojë për përshpejtimin e këtij procesi.

Problem tjetër i kësaj kategorie personash, të cilët i janë drejtuar me ankesë Zyrës sonë, është problemi i strehimit. Ekziston një kuadër ligjor

për një kategori të caktuar të përndjekurish politikë të pastrehë, të cilët përfitojnë strehim falas (VKM nr.476 datë 10.10.1994 “Për procedurat e strehimit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”). Ankesa e familjes së Gjin Markut, tashmë rezulton e zgjidhur në favor, sepse pas Rekomandimit tonë, në bazë të Ligjit nr.7748 dt.29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, u nxor VKM nr.335 dt.11.07.2002 “Për blerjen e një apartamenti nga EKB për strehimin e familjes së zj.Natalia Marku”. Kjo familje përfitoi strehim falas. Jemi informuar nga ana e Institutit që megjithëse ekziston një numër mjaft i madh kërkesash nga të përndjekurit që duhet të përfitojnë banesa falas nga shteti, dhe se nga IIPP çdo vit janë kërkuar fonde strehimi për këtë kategori personash, kjo gjë nuk është realizuar për mungesë buxheti.

d. Agjensia Kombëtare e Privatizimit

Kjo Agjensi është akoma në varësi të Këshillit të Ministrave, por problematika e çështjeve që trajton është e lidhur me Ministrinë e Ekonomisë.

Ndërsa për vitin 2001 kanë qenë 20 ankesa, për vitin 2002 ka patur 28 ankesa ndaj kësaj Agjensie. Nga këto 4 kanë përfunduar me zgjidhje në favor të ankuesve, 16 të pabazuara ose jashtë juridiksionit, kurse 8 janë ende në fazën e shqyrtimit.

Theksojmë se për 16 ankesat që kanë rezultuar të pabazuara ose jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, ankuesve ju janë sqaruar dispozitat përkatëse ligjore, sidomos pretendimet nga ish-pronarët e trojeve lidhur me shkeljen e të drejtës së parablerjes së objekteve. Ne i kemi sqaruar ish pronarët e trojeve, se për zhvillimin e ankandit për shitjen e objekteve të ndërtuara mbi to, nuk bëhet njoftim i veçantë nga AKP për datën dhe vendin e zhvillimit të tij. Është detyrë e të interesuarve, që nga afishimet e këtyre të dhënave në shtypin e përditshëm dhe në degët e AKP-ve në rrethe, të vihen në dijeni për to. Për të krijuar një ide për ankesat e zgjidhura në favor, po japim dy shembujt e mëposhtëm:

1-Përfaqësuesi i Human Rights Watch D.P. u ankua për mosinformimin nga AKP (në bazë të dy kërkesave të paraqitura prej tij), përsa i përket dokumentave të procedurës së tenderimit të kryer nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit, gjatë muajit Tetor 2001, për botimet në gazetat e përditshme. Në dy përgjigjet zyrtare që i janë dhënë ankuesit nga AKP, pa ju dërguar apo bërë e disponueshme kopja e këtij dokumentacioni, i është cilësuar kërkesa si jolegjitime. Baza ligjore për refuzimin që i është

bërë ankuesit, është pika 14 e VKM nr.335, datë 23.06.2000 “Për rregullat e prokurimit publik”, ku përcaktohet detyrimi i AKP, si ent prokurues për ruajtjen dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të tenderave për organet e kontrollit.

Në një këndvështrim më të gjerë të trajtimit të problemit, ne konkluduar se e drejta e informimit është e garantuar në nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku në pikën 2 të tij, thuhet shprehimisht se: “Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”. Në vazhdim të këtij trajtimi, në nenin 3 të Ligjit nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktohet se: “Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”. Në nenin 4 të Ligjit të sipërcituar, përcaktohet rasti se kur mund të kufizohet dhënia e këtyre dokumenteve dhe më konkretisht: “Nëse informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i lëshon kërkuar një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund ta kërkojë atë. Nëse kufizimi është vetëm për një pjesë të të dhënave të dokumentit zyrtar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuar”.

Nga parashikimet e legjislacionit specifik për këtë rast (neni 10 dhe neni 33/1 i Ligjit nr.7971 datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik”), kemi arritur në konkluzionin se informacioni i kërkuar, referuar përcaktimit të bërë nga ana e ankuesit në kërkesën e dytë, nuk mund të konsiderohet i fshehtë në kuptimin e të drejtës së informimit për të. Pika 14 e VKM nr.355, datë 23.06.2000, nuk kufizon dhënien e informacionit të kërkuar nga ankuesi, por bën një rregullim tjetër funksional për organin përkatës, funksion që lidhet me arkivimin apo aksesin e kontrollit që kanë organet përkatëse të kontrollit për këto dokumenta. Dokumentacioni i kërkuar nga kërkuar, nuk përbënte informacion që kufizohej në dhënie për publikun.

Gjithashtu kemi theksuar edhe faktin se AKP, në bazë të kërkesës së personit të interesuar, e cila fillimisht nuk ka qenë e saktë në formulim përse i përket grupimit të dokumentacionit të kërkuar, nuk ka reaguar sipas mënyrës së përcaktuar në ligj (neni 4 i Ligjit nr.8503, datë 30.06.1999).

Në këtë rast kërkuar të dokumentacionit duhet t’i tregoheshin rregullat në bazë të të cilave ai mund të kërkonte atë, ose më saktë, t’i

shpjegohej se për cilën pjesë të dokumentacionit kishte akses. Edhe pse ky moment ka qenë ezauruar nga vetë kërkuesi, me përcaktimin e saktë të llojit të dokumentacionit që ai kërkonte në kërkesën e dytë të tij, AKP-ja ka mbajtur qëndrim refuzues.

Pasi arritëm në konkluzionin se kemi të bëjmë me shkelje të të drejtës së këtij individi për t'u informuar me dokumentet përkatëse zyrtare të kërkuara prej tij, i rekomanduam AKP Tiranë informimin dhe dhënien e dokumentacionit të kërkuar nga ankuesi D.P.

Rekomandimi është pranuar nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit dhe ankuesit i është vënë në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të cilin ai e shfrytëzoi për raportin e Human Rights Watch, publikuar në Korrik 2002 për lirinë e informacionit në Shqipëri.

2-Në ankesën e tyre shtetaset K.G. dhe M.G, paraqesnin një historik të shkurtër të privatizimit të objektit Bar Lulishte "1 Maji" Pogradec dhe kanë pretenduar se ky privatizim është bërë në mënyrë të parregullt. Pasi u bënë verifikimet paraprake për këtë ankesë nga Zyra jonë rezultoi se:

Në vitin 1993, AKP publikon në listën e ankandeve privatizimin e këtij objekti. Në këtë publikim sipërfaqja e truallit funksional nën objekt figuron 467 m². Fituesi i ankandit A.B. në kontratën e përpiluar me NTAN Pogradec dhe AKP, dega Pogradec, njihet pronar i objektit në fjalë. Më pas ky objekt i shitet dy pronarëve të rinj dhe dega e AKP Pogradec lëshon autorizimin për shitjen e truallit, i cili figuron çuditërisht në sipërfaqe 1967 m², pra rreth 4 herë më e madhe.

Në vitin 1994, me anë të Vendimit Nr.55, dt.07.02.1994 të KKKP Pogradec, ankueset e lartpërmendura njihen pronare të një sipërfaqe trualli prej 462 m² për pjesën anësore të objektit Bar Lulishte "1 Maji", duke mos cënuar aspak hapësirat funksionale të këtij objekti. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi bëhet e kuptueshme se sipërfaqja prej 462 m² nuk është shpallur në ankand dhe si pasojë ajo rezulton e lirë. Ky vendim në pjesën arsyetuese të tij shprehet edhe për marrëdhëniet e qerasë që duhet të krijohen midis pronarëve të truallit të pistës me sipërfaqe 462 m² dhe të pronarit të objektit, i cili ka vënë në përdorim të aktivitetit të tij edhe këtë sipërfaqe. Në pikën 2 të këtij vendimi të KKKP Pogradec sanksionohet kjo pjesë e arsyetimit duke i hapur kështu rrugë vazhdimit të marrëdhënieve kontraktore të qerasë midis palëve.

Ankueset kanë njohur gjyqësisht të drejtën e parablerjes së objektit për pjesën e truallit. Duke e parë që këto vendime gjyqësore nuk mund të viheshin në zbatim, pasi privatizimi ishte kryer që në vitin 1993 dhe kontrata e shitjes së truallit ishte kryer që në vitin 1994, ankueset kanë

hapur një proces të ri gjyqësor me objekt padi pavlefshmëri të pjesshme kontratë shitje trualli. Kjo kërkesë është pranuar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Pogradec dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë. Në këto kushte vendimet e gjykatave të mëparshme mbeten të pacënueshme dhe duhet të viheshin në ekzekutim nga palët nënshkruese të kontratës së shitjes së truallit.

Nga Ministria e Ekonomisë (ku problemi ishte dërguar për shqyrtim nga AKP) është konkluduar se nuk mund të kryejë procedura për vlerësimin e truallit të parashikuar në kontratë, pasi drejtoritë përkatëse të saj marrin dhe vlerësojnë vetëm sipërfaqe të objekteve në privatizim. Por ne për zgjidhjen e problemit, i kemi rekomanduar AKP përsheptimin e procedurave administrative për vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore, si organ epror i degës së AKP Pogradec, për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, në mënyrë që të rivihen në vend menjëherë të gjitha të drejtat mbi pronësinë e mohuar ndaj ankuesëve.

Nga ana e AKP është pranuar Rekomandimi ynë, pra është bërë zgjidhja e ankesës në favor të ankuesëve.

2. Ministria e Drejtësisë

Gjatë vitit 2002 janë trajtuar gjithësej 358 ankesa e kërkesa që kanë të bëjnë me autoritete në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, e konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të zyrave të Përmbarimit.

Qysh në fillim nënvizojmë se gjatë vitit 2002 bashkëpunimi me këtë ministri ka qenë shumë më efektiv dhe cilësor, në raport me dy vitet e kaluara. Kjo i dedikohet edhe koncepteve të drejta të ministrit aktual të Drejtësisë, zotit Spiro Peçi dhe veprimtarisë së tij për vlerësimin e çështjeve të drejtave të njeriut dhe të rolit të institucionit të Avokatit të Popullit.

a. Ankesat për burgjet dhe administratën e burgjeve

Deri në fund të vitit 2002 ka patur 1780 të burgosur në burgje dhe 272 të dënuar që mbahen në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë. Gjithashtu ka patur rreth 1220 persona të paraburgosur sepse akoma nuk ka përfunduar hetimi apo gjykimi i tyre. Pra kanë qenë gjithsej rreth 3000 persona të privuar nga liria, nga 2650 persona që ishin në fund të vitit 2001. Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur mjaft ankesa. Burgjet janë institucione të mbyllura dhe liria në të gjitha shprehjet e saj është e kufizuar dhe mund të shkelen më lehtë të drejtat e të burgosurve. Prandaj nga ana jonë, ankesave nga këta persona ju është kushtuar dhe do t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Prandaj gjatë vitit 2002 punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar pothuajse të gjitha burgjet që janë në efikasitet si dhe dhomat e izolimit të komisariateve të policisë në rrethe ku qëndrojnë të burgosur, për të cilët vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë si dhe të paraburgosurit që presin të gjykohen.

Gjatë vizitave në këto institucione kemi takuar personalisht 125 të dënuar apo të paraburgosur. Në 220 raste ankesat e të dënuarve janë bërë me shkrim. Gjithësej janë ankuar 345 persona, ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgut që kanë aplikuar në zyrën tonë për çështje që lidhen me administratën gjyqësore, të prokurorisë dhe burgjeve.

Janë ankuar 107 persona më shumë se në vitin 2001.

Si veçori të vitit 2002 për burgjet mund të përmendim se ka një rritje të konsiderueshme të ankesave që janë paraqitur nga të burgosurit pranë zyrës sonë, organizimi i disa inspektimeve në burgje dhe dhoma izolimi nga personeli i zyrës sonë si dhe sepse të burgosurve ju është shtuar edhe një mundësi tjetër për të bërë ankesat e tyre. Ata në 12 raste (që janë

përfshirë në numrin e përgjithshëm) ankesat e tyre i kanë paraqitur nëpërmjet telefonit që është vendosur në dispozicion të tyre. Kjo tregon për një hapje akoma më të madhe të burgjeve shqiptare dhe është një arritje në drejtimin e duhur të institucionit të Avokatit të Popullit.

Të burgosurit që kanë bërë ankesa me shkrim kanë qënë gjithsej 168 persona. Të ndarë sipas burgjeve gjendja paraqitet si më poshtë:

1. Nga burgu 313 Tiranë	janë ankuar	19
2. Nga burgu 302 Tiranë	janë ankuar	21
3. Nga burgu 325 Tiranë	janë ankuar	7
4. Nga burgu i Lushnjës	janë ankuar	26
5. Nga burgu i Tepelenës	janë ankuar	11
6. Nga burgu i Burrelit	janë ankuar	28
7. Nga burgu i Vaqarrit	janë ankuar	14
8. Nga Spitali burgjeve	janë ankuar	21
9. Nga burgu Rrogozhinës	janë ankuar	7
10. Nga burgu i Krujes	është ankuar	1
11. Nga paraburgimi	janë ankuar	13

Gjithashtu kanë paraqitur ankesa apo kërkesa me shkrim 44 familjarë të të burgosurve si dhe 8 kërkesa janë paraqitur nga drejtoritë e burgjeve apo komisaritet e policisë në rrethe. Të ndarë sipas gjinisë në 194 raste kanë bërë ankesë burrat dhe në 19 raste gratë.

Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:

Janë përfunduar 209 ankesa apo kërkesa, nga 220 të ardhura, ndërsa janë në shqyrtim 11 çeshtje. 21 ankesat e mbartura nga viti 2001 në muajt e parë të vitit 2002 janë përfunduar të gjitha.

Në rastet e përfunduara 81 ose 38 % prej tyre janë zgjidhur në favor, 96 ose 45% janë dërguar për kompetence në organet e tjera, 33 ose 17% janë konsideruar si të pabazuara në ligj dhe janë refuzuar si të padrejta.

Duke bërë grupimin e natyrës së ankesave rezultojnë:

1. Mjaft të burgosur janë ankuar se mbahen padrejtësisht në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë, në të njëjtën kohë kur vendimet e Gjykatave kanë kohë që kanë marrë formën e prerë.

Ata kanë pretenduar se ju është shkëlur e drejta e njohur nga neni 462 i K.Pr.Penale që urdheron ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të gjykatës që ka marrë formën e prerë.

Numri i ankesave të kësaj natyre për vitin që raportojmë ka një rritje të konsiderueshme. Prandaj Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmoi një proces inspektimi në përfundim të të cilit rezultoi se ende në dhomat e

izolimit pranë komisariateve të policisë në rrethe, kishte dhe vazhdon të ketë një numër jo të vogël të dënuarish, të cilët qëndrojnë padrejtësisht në këto dhoma.

Për rastet konkrete të të dënuarve që kanë bërë ankesa, ne kemi ndërhyrë nëpërmjet rekomandimeve që ata të dërgohen sa më parë në burgje.

Në përgjigje të rekomandimit tonë me shkresën e datës 26.12.2002 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me gjithë situatën e mbipopullimit të burgjeve, duke njohur detyrimin ligjor të administrimit të kontigjentit të dënuar me vendim të formës së prerë, ka marrë masa për zhvendosjen e këtyre të dënuarve nga dhomat e izolimit në burgje.

Ashtu si edhe më parë problemi i të dënuarve që mbahen në dhomat e izolimit pa të drejtë ka qënë dhe do të mbetet një nga drejtimit kryesore të punës sonë. Siç është bërë e ditur, në muajin prill të vitit 2001 Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një proces hetimi për të parë gjendjen dhe shkaqet që kanë çuar në mbajtjen e të dënuarve në dhomat e izolimit pa i zhvendosur në burgje. Në përfundim ju rekomandua Ministrisë së Drejtësisë të merrte masa për ndërprerjen e shkeljes së ligjit.

Në përgjigje të rekomandimit tonë Ministria e Drejtësisë u angazhua se me përfundimin e burgjeve në Rrogozhinë dhe në Lezhë do të zgjidhej përfundimisht ky problem. Me ndërtimin e burgut të Rrogozhinës dhe shpalljes së ligjit nr. 8895, datë 16.05.2002 “Për Dhënie Amnistie”, numri i të dënuarve në dhomat e izolimit u ul vetëm në 160 të burgosur. Aktualisht numri i të dënuarve në dhomat e izolimit është i madh. (Me datë 07.01.2003 ishte 272).

Në raste të veçanta, veçanërisht për të miturit, dhe ata që kanë kohë shumë të gjata në paraburgim, jemi mirëkuptuar gjithmonë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të bërë zhvendosjen e tyre.

Në takimet e herëpashershme me drejtuesit e Ministrisë së Rendit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë është kërkuar të merren masa që të fillojë kalimi gradual i dhomave të izolimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kështu në takimin e muajit Prill të vitit 2002, ata u angazhuan se do të fillojë ky proces me kalimin e dhomave të izolimit të Durrësit dhe Vlorës, por këto pretime nuk janë bërë realitet. Kohët e fundit jemi informuar se me urdhër të Kryeministrit brenda tremujorit të parë të vitit 2003, dhomat e izolimit pranë Komisariateve të Policisë në rrethe, do të kalojnë në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Institucioni ynë do të vazhdojë të kërkojë që të mbahen angazhimet e marra për të hapur burgjet e reja në Peqin dhe Lezhë. Por mendimi ynë është se problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet thjesht

vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Mbi të gjitha, më shumë rëndësi duhet t'i jepet në radhë të parë punës parandaluese që duhet të bëjë gjithë shoqëria dhe shteti shqiptar, dhe së dyti, prokuroritë dhe gjykatat duhet të bëjnë një politikë më të drejtë në zbatimin e masave të tjera të sigurimit. Duhet aplikuar më tepër masa të tilla, si garancia pasurore apo arresti në shtëpi, si dhe duhet aplikuar edhe lloje të tjera dënimi dhe jo vetëm dënimi me burgim. Mohimi i lirisë është një masë ekstreme, e cila duhet të jepet dhe përdoret vetëm nëse masa të tjera alternative do të ishin pa vend për shkak të rrezikshmërisë së madhe të veprës penale të kryer dhe të autorit të saj.

2. Të sëmure mendore që mbahen ende padrejtësisht në spitalin e burgut.

Gjatë vitit 2002 Institucioni i Avokatit të Popullit ka organizuar një inspektim në Spitalin e Burgjeve për të parë gjendjen e të sëmureve mendore për të cilët gjykatat kanë marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar dhe padrejtësisht mbahen në kushte burgimi.

Nga inspektimi doli se këta persona ndonëse nuk janë të dënuar, mbahen ende brenda sistemit të burgjeve. Nga hetimet e ndërmara nga ana jonë, veç të tjerash pengesë për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi ishte edhe mosplotësimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të akteve nënligjore për ruajtjen e këtyre personave. Për këtë kemi bërë rekomandimin e datës 13.05.2002 për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8092, dt.03.02.1996 "Për Shëndetin Mendor", për të nxjerrë rregulloren "Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar". Rekomandimi i është drejtuar njëkohësisht Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe ish Kryeministrit Majko, me këtë përmbajtje:

Në Institucionin e Avokatit të Popullit familjarët e personave që kanë kryer një vepër penale dhe që trajtohen si të dënuar, kanë depozituar ankesat e tyre me anën e të cilave kërkojnë zhvendosjen e tyre në një institut mjekësor, siç e përcakton neni 45 i ligjit nr.8331 dt.21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me mjekim të detyruar", i cili thotë: "Masa mjeksore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit".

Neni 42 i ligjit Nr.8092 dt.03.02.1996 "Për Shëndetin Mendor", thotë: "Masat e sigurimit për personat e përmendur në nenin 41 merren nga organet e ngarkuara për ruajtjen e tyre, sipas Rregullores së miratuar nga Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë".

Pra me këtë dispozitë ligji përcakton detyrimin e Ministrit të Drejtësisë, e Ministrit të Shëndetësisë për të miratuar Rregulloren e masave të sigurimit për personat që kanë kryer një vepër penale dhe janë dënuar nga gjykata të vuajnë dënimin në Institucione psikiatrike. Por megjithëse kanë kaluar rreth 6 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për shëndetin mendor”, një rregullore e tillë ende nuk ka dalë. Aktualisht të gjithë të dënuarit me mjekim të detyruar qëndrojnë në kundërshtim flagrant me ligjin në Spitalin e Burgut dhe në ndonjë komisariat policie. Ky qëndrim ka sjellë moszbatimin e nenit 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se çdo person i tillë ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij dhe ka lënë shteg për të abuzuar në drejtim të kërkesave ligjore për të drejtat e liritë e këtyre personave, duke i dëmtuar edhe më tepër nga ana mendore.

Avokati i Popullit duke parë se mospërgatitja dhe mosnxjerrja e rregullores që urdhëron neni 42 i ligjit të sipërpërmendur është shkaku që krijon premisa për shkelje të të drejtave të të burgosurve, ka rekomanduar që të përgatitet e miratohet sa më parë Rregullorja “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjekësore të mjekimit të detyruar”. Nuk kemi marrë përgjigje për këtë rekomandim.

Në realitet ish spitali i Krujës, për të cilin ishte planifikuar të bëhej institut për të sëmurët mendorë, funksionon si burg dhe jo si institut mjekësor. Në kushtet kur ligji ndalon sistemimin e këtyre personave brenda sistemit të burgjeve, behet i pamundur sistemimi i tyre në këtë burg.

Kjo çështje do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet tona për vitin 2003.

3. Ushtrim dhune apo shkelje të tjera nga Policia e burgjeve

Mbi ankesën e disa të dënuarve nga burgu i Burrelit, Avokati i Popullit ka nisur një proces hetimi. Në fillim kemi marrë takim me të dënuarit, kemi bërë ekzaminimin mjeko-ligjor të tyre nëse kanë patur shenja dhune, por në përfundim vetë ankuesit pretenduan se këto keqtrajtime kanë ndodhur shumë kohë më parë, dhe nuk mund të provohej dhuna. Por me qëllim që të merren masa për të mos lejuar në të ardhmen shkelje të kësaj natyre ne ndërhyëm me anën e rekomandimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Bugjeve.

Nga përgjigja, e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve rezultoi se ka qënë i vërtetë konstatimi ynë që brenda burgut të Burrelit i dënuari F.N. kishte krijuar një grup që përdorte dhunë fizike ndaj të dënuarve të tjerë dhe se ishte i drejtë rekomandimi ynë për të marrë masa për rregullimin e gjendjes. Prandaj janë marrë masat e nevojshme duke e transferuar këtë të dënuar nga burgu i Burrelit në një Burg tjetër.

N.T e ashtuquajtura Nikoleta është ankuar se keqtrajtohet nga policia gjatë shoqërimit për në gjykatë. Nga verifikimet tona doli se ajo fyhej nga policia për shkak se është hermafrodite. Prandaj u ndërhy pranë drejtorit të burgut 313 dhe më pas nuk u përsëritën më veprime të kësaj natyre.

Të dënuarit A.P, Gj.K, F.B.etj, janë ankuar për mungesë të ujit gjatë 24 orëve, se bisedat telefonike behen në prani të policisë, se shërbimi shëndetësor lë shumë për të dëshiruar, nuk ju krijohen kushte për ushtrimin e riteve fetare etj.

Sa më sipër ju kërkuan shpjegime Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Mbi këtë bazë është ngritur një grup pune për të verifikuar gjendjen dhe të marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin.

4. Ka patur 7 ankesa të të dënuarve me sëmundje të rënda, të pa shpresë për shërim, të paralizuar dhe të pa aftë për të kryer vetë veprimet jetësore. Ata kanë kërkuar që të shkojnë të vdesin në shtëpi të tyre para se të vdesin në burg, siç ka ndodhur me dy të dënuar të tjerë.

Vetë Avokati i Popullit i vizitoi ata në spitalin e burgut, pa gjendjen e tyre faktike, dëgjoji mjekët e Spitalit dhe personelin e burgut, të cilët konfirmuan se këta persona ishin drejt vdekjes pa asnjë shpresë.

Për këto ankesa Avokati i Popullit dërgoi rekomandimin për nevojën e lirit të të dënuarve me sëmundje të rënda. Ne ju drejtuam Ministrit të Drejtësisë, duke përmendur se:

“...Nisur nga gjendja aktuale e tyre, e cila sa vjen dhe rëndohet, duke shkuar drejtë vdekjes së tyre, siç ka ndodhur me dy të dënuarit Xh. S. dhe S. Gj., që ishin në të njëjtat kushte, ne mendojmë se lirimi i tyre nuk paraqet ndonjë rrezik për shoqërinë. Lirimi i tyre nga burgu, do të ishte mirëpritur edhe për anën humane, mbasi ata pavarësisht se kanë kryer krime janë qenie njerëzore dhe duhen trajtuar si të tillë. Veç kësaj buxheti i shtetit lirohet nga një barrë e rëndë. Prandaj në kuadrin e amicus curiae (mikut të gjykatës) sugjerojmë të ndërmerren inisiativa në bazë të nenit 478 të K.Pr. Penale dhe të kërkohet pranë gjykatave të rretheve lirimi i tyre nga burgu”. Kjo kërkesë është mirëpritur dhe janë filluar procedurat përkatëse për lirin nga burgu të ankuesve.

5. Disa të dënuar janë ankuar duke pretenduar se ju janë shkelur të drejtat që ju ka njohur ligji për amnistinë në vitin 1997 dhe në vitin 2002.

Janë paraqitur 10 ankesa dhe në të gjitha këto raste është marrë takim ose me të dënuarit ose me familjarë të tyre. Atyre ju janë sqaruar kriteret e zbatimit të ligjit, duke ju treguar rrugët ligjore që duhet të ndjekin për të kërkuar të drejtën e pretenduar. Në rastet e paraqitura nuk është gjetur ndonjë rast që amnistia të jetë zbatuar gabim.

6. Kërkesa të burgosurve kundër vendimeve të gjykatave.

Janë 64 raste kur të dënuarit i kanë kaluar të gjitha shkallët e gjyqimit dhe pretendojnë se gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt provat dhe rrethanat e veprave penale, për të cilat janë dënuar. Ata kërkojnë ndihmë juridike për të paraqitur kërkesën për rishikim të vendimeve gjyqësore. Njëkohësisht, ata kanë paraqitur pamundësinë e tyre financiare për të paguar avokatë privatë. Në këto raste, ne ju kemi bërë të qartë të burgosurve se vendimet e gjykatave nuk janë në juridiksionin e Avokatit të Popullit. Por kërkesat e tyre për ndihmë juridike falas ja kemi dërguar fondacioneve të krijuara për këtë qëllim dhe kemi njoftuar edhe ankuesit.

7. Grevat e urisë

Në katër raste që jemi vënë në dijeni nga administratat e burgjeve për hyrjen në greva urie të të dënuarve, kemi qënë ndërmjetës midis tyre dhe të burgosurve. Në disa nga këto raste, të dënuarit kanë ndërprerë greven e urisë, pasi ju janë plotësuar më parë ato kërkesa për të cilat ata kanë patur të drejtë. Ndërsa, në rastet kur ata kanë përdorur këtë mjet si presion për ndryshimin e vendimit të gjykatës, ju është bërë e qartë se ankesa nuk ishte në juridiksionin tonë dhe se çështja nuk zgjidhej me greve urie, por duke apeluar në organet më të larta të gjyqësorit.

8. Ankesa për mungesa në dosjet personale të të dënuarve.

Pesë të dënuar janë ankuar se në dokumentat e tyre personale që mban administrata e burgjeve mungojnë akte që vërtetojnë se të dhënat e kryerjes së dënimit janë ndryshe nga ato që pasqyrohen në dosjet e tyre.

Zyra jonë ka kërkuar shpjegime të hollësishme për çdo rast dhe kemi ndërhyrë me shpejtësi për vënien në vend të të drejtave të këtyre të dënuarve.

9. Ankesa për transferime të padrejta apo nga një burg në tjetrin.

Në 9 raste të dënuarit janë ankuar për transferime të padrejta ose kanë kërkuar të transferohen nga njëri burg në tjetrin. Nga verifikimet tona është vërtetuar se nuk ka patur raste të transferimeve të paligjshme nga njëri burg në tjetrin. Në raste të veçanta, për arsye hasmërie etj, kemi ndërhyrë pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për të bërë transferimet e kërkuara ose të nevojshme.

10. Ka patur ankesa nga të dënuarit që kanë pretenduar se ju kanë shkelur të drejtën që ju njih ligji për dhënien e lejes për të shkuar në shtëpi kur kanë ngjarje të veçanta në familje. Në dy raste ankesat kanë qënë të pabazuara.

11. Ankesa të të dënuarve të ekstraduar nga Greqia që vuajnë dënimin në burgjet Shqiptare.

Me kërkesë të drejtorisë së Burgut të Rrogozhinës për të marrë takim me 16 të dënuar që pretendonin se ju ishin shkelur të drejtat e tyre në

dhënien e vendimeve nga gjykatat greke, një grup i stafit të Avokatit të Popullit mori takim një për një me secilin të dënuar, duke dëgjuar me kujdes ankesat e paraqitura prej tyre. Ata pretendonin se ishin dënuar padrejtësisht.

Ju shpjegua me durim dhe këmbengulje se vendimet e gjykatës janë jashtë juridiksionit të zyrës sonë, duke i sqaruar njëkohësisht se cilat janë rruget që duhet të ndjekin për zgjidhjen e problemeve të tyre. Njëkohësisht ne ju kemi rekomanduar atyre që mund të kundërshtojnë vendimet edhe në gjykatën e të drejtave të njeriut në Strasburg, duke ju dhënë edhe sqarime me shkrim për menyren se si mund t'i drejtohen kësaj gjykatë.

12. Ka patur 4 ankesa të familjarëve të shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin në burgjet e shteteve të tjera.

Ata kanë pretenduar se ndaj të afërmeve të tyre në burgjet në Itali dhe Greqi përdoret dhunë, se ata nuk kanë asnjë dijeni për shkaqet e burgosjes së femijve të tyre etj.

Duke qënë se këto ankesa janë jashtë juridiksionit tonë, ne ja kemi dërguar Drejtorisë Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, që nëpërmjet zyrave tona konsullore në këto shtete, të japin ndihmesën e tyre në baze të ligjit nr.8372, datë 09.07.1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike apo konsullore”. Në ndihmë të këtyre të dënuarve shqiptarë jashtë vendit është edhe angazhimi ynë për realizimin e projektit për të dërguar në bibliotekat e burgjeve jashtë vendit një broshurë në gjuhën shqipe, të titulluar “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve jashtë Shqipërisë”. Tashmë ky botim është realizuar dhe jemi në pritje që Ministria e Drejtësisë të marrë leje nga Ministrinë e Drejtësisë të vendeve të tjera ku ka të burgosur Shqiptarë për ta lejuar këtë botim të futet në bibliotekat e burgjeve të tyre.

Nga analiza e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve që ndodhen në burgje dhe në dhomat e izolimit, të komisariateve të policisë del se gjatë vitit 2003, veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të synojë në realizimin e këtyre rekomandimeve kryesore:

1. Ndjekjen me prioritet të përfundimit të kalimit të dhomave të paraburgimit nga Ministria e Rendit Publik në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, ashtu siç ka urdhëruar Kryeministri që të përfundojë brenda muajit Mars të vitit 2003.

2. Sistemimin në një institut mjekësor të personave për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar, ashtu siç kërkon ligji.

3. Plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8328, dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, me qëllim që të hartohet drafti i

Vendimit të Këshillit të Ministrave, për kriteret e shpërblimit të punës së të dënuarve dhe të dërgohet për miratim në Qeveri.

Për këtë rekomandim më dt.04.09.2002, Ministri i Drejtësisë, zoti Spiro Peçi ka kthyer këtë përgjigje:

“Rekomandimin tuaj e gjejmë të drejtë dhe konformë kërkesave të Konventës Ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave që i nënshtrohen burgimit.

Duke vlerësuar nxitjen tuaj ju njoftojmë se në kuadrin e rishikimit të planeve të punës të Ministrit të Drejtësisë sipas programit të Qeverisë, në vitin 2003 do të përfundojë dhe dërgohet për miratim edhe drafti i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e punës së të dënuarve””.

4. Rekomandim për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të ekzekutimit të vendimeve me burgim, sipas kreut të tretë të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Ky komision ngrihet pranë Ministrit të Drejtësisë, dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë vendin. Komisioni ka për detyrë: Mbi bazën e ankesave ose njoftimeve të paraqitura nga të burgosurit, rekomandon marrjen e masave të menjëherëshme për rivendosjen e ligjit apo të drejtës së shkelur. Sipas nenit 60 të ligjit në fjalë komisioni përbëhet nga 9 anëtarë që caktohen respektivisht nga: 1. Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvëndit Popullor dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave caktojnë si anëtarë nga një person që nuk ka funksione publike. 2. Ministrat që mbulojnë shëndetësinë, ushqimin, ndërtimin dhe kulturën, caktojnë nga një anëtarë prej punonjësve të tyre, me kusht që të jenë specialist në profilet përkatëse. Ministria e Drejtësisë cakton një anëtar, që nuk ka funksione publike, por që ka kushte për të qënë gjyqtar. 3. Një anëtar caktohet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Kryetari dhe zëvendësi i Komisionit zgjidhen nga mbledhja e parë e anëtarëve.

Nga shqyrtimi i çështjes prej zyrës sonë rezultoi se:

Ngritja e këtij komisioni ka mbetur vetëm në letër. Mbasi janë caktuar anëtarët e këtij Komisioni, si dhe është zhvilluar mbledhja e parë e tij në vitin 1999, ku është zgjedhur kryetari dhe zëvendësja e tij, më pas nuk është kryer asnjë lloj veprimtarie.

Ne kemi rekomanduar krijimin e kushteve të nevojshme për të filluar dhe ushtruar veprimtarinë e tij Komisioni Mbikqyrës i ekzekutimit të Vendimeve me burgim, si dhe marrjen e masave për hartimin e draftit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për shpërblimin e anëtarëve të këtij Komisioni dhe dërgimin për miratim në Qeveri. Nuk kemi akoma përgjigje.

Lidhur me rastet e prezantuara gjatë vitit 2002 si plotësimi i ligjit “Për të drejtat e të dënuarve” me vendimin e Qeverisë për shpërblimin e punës së tyre dhe plotësimi i çdo institucioni me rregulloret e veçanta, rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bërë realitet.

b-Ankimet për Zyrat e Përmbaramit

Për Zyrat e Përmbaramit, në institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2002 janë bërë gjithsej **138** ankesa; **39** prej tyre janë mbartur për shqyrtim në vitin 2003, kurse **99** janë marrë në shqyrtim dhe janë përfunduar. Në favor të ankuesve janë zgjidhur pozitivisht **18** ankesa, që zënë rreth **18%**. Në vitin 2001 ka patur 104 ankesa për këto zyra.

Objekti i ankimit për pjesën më të madhe të ankesave ka qënë mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga debitorët që kryesisht janë institucione buxhetore. Problemi i mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga gjyq-humbësit, institucionet buxhetore, po mbartet nga viti në vit jo vetëm pa gjetur zgjidhje, por debiti po shtohet si nga vendimet gjyqësore të reja, ashtu edhe për ato ekzistuese, kur vendimi i gjykatës është edhe për pagimin e interesave ose fitimit të munguar.

Në vitin 2001, Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandim Ministrisë të Financave dhe atij të Drejtësisë, për marrjen e masave për nxjerrjen e udhëzimeve që përcakton VKM nr.335, datë 2.6.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit”. Ky rekomandim është bërë për faktin se vendimi i Këshillit të Ministrave i cituar më lart, parashikon që procedurat e lëvrimit të shumave financiare të përcaktohen në një Udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe të Ministrisë të Drejtësisë. Për fat të keq ky Udhëzim nuk ka dalë as sot e kësaj dite, duke u bërë pengesë serioze për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve. Është vendi për t’u evidentuar se ende nuk po kuptohet dhe zbatohet detyrimi kushtetues, i parashikuar në pikën 3 të nenit 142 të Kushtetutës të Shqipërisë që thotë: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”. Lidhur me këtë problem edhe titullarë të institucioneve të ndryshme buxhetore, janë ankuar dhe kanë kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, sepse janë gjobitur nga përmbaruesit e Zyrave të Përmbaramit me shuma jo të vogla, në zbatim të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile.

Por ka edhe raste kur kombinimi i ndërhyrjes këmbëngulëse të Institucionit tonë me atë të Zyrave e Përmbaramit ndaj Institucionit buxhetor debitor, ka bërë të mundur ekzekutimin e detyrimit, si në rastet e ankuesve G.P. dhe A.Gj. banues në Tiranë, N.C. banues në Burrel, për të

cilët debitorët, që kanë qënë organe të administratës qëndrore dhe vendore, kanë ekzekutuar detyrimet monetare. Tipike është edhe zvarritja e ekzekutimit të vendimit gjyqësor në favor të ankuesit N.M., banues në Fier, për lirim banese. Pengesë ishte një urdher i ish-Prefektit që porosiste Komisariatin e Policisë të mos shkonte në ndihmë të Zyrës së Përmbarrimit në momentin e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor. Ndërhyrja për zbatimin e ligjit procedural realizoi atë që nuk ishte bërë prej kohësh, lirin e banesës. Po kështu rasti i ankuesit Ll.R. nga qyteti i Korçës i cili ishte ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, me të cilin ishte vendosur prishja e vendimit të Gjykatës së faktit Korçë dhe gjykimi i çështjes në fakt, në kundërshtim me procedurat ligjore. Ankuesi ishte ankuar edhe në Gjykatën e Lartë e cila kishte vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, por Zyra e Përmbarrimit Korçë nuk kryente veprimet përkatëse sipas ligjit. Në bazë të rekomandimit tonë u bë e mundur që Zyra e Përmbarrimit Korçë të vendosë ndërprerjen e punimeve, deri sa të shqyrtohet dhe të përfundojë gjykimi i çështjes nga Gjykata e Lartë.

Në disa raste, kemi konstatuar se veprimet e përmbarruesve të veçantë kanë qënë jo të bazuara në dispozitat procedurale civile. Rezultojnë shtyrje pafundësisht të afateve të ekzekutimit vullnetar të detyrimit, ka mosveprime edhe kur detyrimet janë në vlera të vogla sidomos në detyrimet për ushqim. Por me flagrante është fakti se nga kqyrja e dosjeve përmbarrimore gjatë procesit të verifikimit të ankesave, del se vendoset pushimi i ekzekutimit për pamundësi pagimi ose të mos gjetjes të pasurive të debitorit, pa bërë verifikime dhe pa patur asnjë konfirmim zyrtar, nga Zyrat e Takse-Tatimeve, nga Bankat e nivelit të dytë, etj organe nga ku mund të merren të dhëna të sakta për pasurinë e luajtëshme e të paluajtëshme që mund të ketë debitori. Këto mangesi i janë bërë të ditura rast pas rasti edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit në Ministrinë e Drejtësisë, me të cilën kemi patur mirëkuptim e bashkëpunim në nivel të kënaqshëm.

Por është për të nënvizuar edhe fakti tjetër pozitiv se nuk janë të pakta edhe ato Zyra Përmbarrimi që kanë ecuri dhe ndjekje në vazhdimësi të procedurave për ekzekutimin e titujve ekzekutive dhe sugjerimet tona kanë gjetur mbështetje, si p.sh. Zyrat e Përmbarrimit në rrethet Kukës, Mat, Gjirokastrë dhe Berat.

3. Avokati i Popullit dhe marrëdhëniet e tij me gjykatat dhe pushtetin gjyqësor.

1.Sfondi ligjor

Institucioni i Avokatit të Popullit është një institucion i ri për mjedisin e shoqërisë shqiptare, por bashkë me gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Dihet se në kryerjen e funksioneve të tyre gjyqësore, gjyqtarët janë të pavarur në dhënien e vendimeve, por ato nuk janë të pavarur nga ligjet. Kjo pavarësi duhet të zbatohet në të mirë të interesit publik. Vendimet e tyre në asnjë rast nuk mund e nuk duhet të jenë objekt i ndonjë shqyrtimi apo vlerësimi jashtë procedurave gjyqësore nga gjykatat e shkallëve më të larta. Çdo përpjekje e pushteteve të tjera, legjislativit apo të ekzekutivit, për të bërë vlerësimin e drejtësisë apo padrejtësisë së vendimeve të gjykatave, është e rrezikshme për shtetin e së drejtës dhe demokracinë, por në veçanti, janë të rrezikshme për të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve. Në këtë drejtim gjyqësori ka patur dhe do ketë si mbështetje edhe Avokatin e Popullit. Por nga ana tjetër kjo pavarësi nuk duhet keqpërdorur, për të mos zbatuar Kushtetutën dhe ligjet përkatëse dhe aq më tepër në dëm të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Dihet se në Shqipëri duhet të rritet efikasiteti dhe besimi i publikut tek gjyqësori. Ndhimesa e Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për këtë çështje.

Siç kemi njohuri nëpërmjet literaturës, si dhe nga shkëmbimi i legjislacionit dhe i eksperiencave me kolegë nga vende të ndryshme, pushteti i Ombudsmanit në marrëdhëniet me organet gjyqësore është i ndryshëm nga një vend në tjetrin. Kompetenca maksimale ka Ombudsmani parlamentar Suedez, vendi ku ky institucion ka origjinën dhe vepron zyrtarisht qysh prej vitit 1809.

Kushtetuta dhe ligji “Për Avokatin e Popullit” i kanë zgjidhur drejtë marrëdhëniet tona. Juridiksioni ynë në lidhje me gjyqësorin është i tillë që nuk prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në vitin 1998, në nenin 60 të saj përcakton se “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”.

Kurse në pikat 3 dhe 4 të nenit 63 të Kushtetutës thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe informacionet e kërkuara prej tij”.

Ligji Nr.8454, dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” në nenin 25 të tij thekson se: “Janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit” ndër të tjera edhe “c” vendimet e gjykatave. Pa cënuar shkronjën “c” të këtij neni, Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa apo njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe procedurat gjyqësore. Hetimi i Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”.

Po kështu sipas pikës “b” të nenit 18 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit, pas pranimit të ankesës, kërkesës apo njoftimit për shqyrtim ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga organet e administratës, si dhe prokuroria, në rastet e arrestimeve dhe ndalimeve.

Në nenin 19, në pikën “b” thuhet se Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin.

Kurse në pikën “dh” të nenit 21 të këtij ligji thuhet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime: Për shkeljen e të drejtave nga organet e pushtetit gjyqësor, pa ndërhyrë në procedurën që ato zbatojnë, Avokati i Popullit i bën të ditur shkeljet organit kompetent”.

Pra siç shihet nga Kushtetuta dhe nga ligji përkatës, Institucioni ynë ka mjaft mundësi aksesit në organet gjyqësore. Praktika rreth 3 vjeçare tashmë ka treguar se ne kemi patur mirëkuptim me gjyqësorin për këto çështje dhe besoj se do të vazhdojmë të jemi në marrëdhënie korrekte. Kjo sepse të gjithë jemi të interesuar që të realizohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Nuk duhet që gjyqtarët, veç atyre që me dashje shkelin ligjet, të kenë frikë nga fakti që Avokati i Popullit, bën verifikime të ankesave kur ne marrim apo studjojmë dosjet gjyqësore. Aq më tepër që këto dosje janë të hapura për çdo individ (pjesmarrës në çështje apo për avokatët e tyre) dhe natyrisht shqyrtimi i Avokatit të Popullit nuk ka prekur dhe nuk do të prekë në asnjë rast pavarësinë në dhënien e vendimeve apo fuqinë e tyre.

Vendi ynë, si vend ish komunist që po kalon një periudhë tranzicioni ka akoma mjaft të meta dhe mangësi në veprimtarinë për dhënien e drejtësisë nga gjykata. Këto rrjedhin për shkaqe të tilla, duke filluar nga paaftësia e gjyqtarëve, deri tek korrupsioni i tyre.

Për këto arsye, aksesi i Avokatit të Popullit nuk është i vogël. Por jo vetëm Avokati i Popullit, por edhe mjaft institucione prestigjioze në fushën e të drejtave të njeriut mendojnë se kjo është zgjidhje ligjore e mirë për kushtet e Shqipërisë. Bile ka edhe mendime të avancuara nga dhjetra persona që ankohen tek Avokati i Popullit duke kërkuar që të marrë pjesë në gjykimet e çështjeve të tyre, të kundërshtojë vendimet që konsideron të padrejta etj.

Avokati i Popullit ndihmon punën e gjykatave kur njofton Ministrinë e Drejtësisë apo Këshillin e Lartë të Drejtësisë për shkeljet procedurale apo shkeljet e administratave të gjykatave. Avokati i Popullit ndihmon edhe duke kërkuar që administrata shtetërore të zbatojë patjetër vendimet gjyqësore. Në këtë mënyrë rritet edhe autoriteti i gjyqësorit ndaj degës së ekzekutivit, e cila ka treguar dhe vazhdon të tregojë me qëndrimet e saj se e nënvleftëson fuqinë e vendimeve gjyqësore, duke i bërë një dëm të pallogaritshëm (jo ekonomik) shtetit të së drejtës.

2. Ankesat për gjykatat

Në vitin 2000 për 6 muaj që kemi punuar kanë qënë 177 ankesa që zinin rreth 22% të të gjithë ankesave, në vitin 2001 kanë qënë 392 ankesa që zinin 17% të të gjithë ankesave të shqyrtuara për atë vit.

Edhe për vitin 2002 ne kemi patur mjaft ankesa kundër vendimeve gjyqësore dhe procedurave gjyqësore. Janë 405 ankesa, që zenë rreth 13% të të gjithë ankesave të shqyrtuara në vitin 2002.

Një pjesë e madhe e tyre, 269 ankesa kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore, pra jashtë juridiksionit tonë dhe janë refuzuar.

Por, veç 269 ankesave për padrejtësinë e vendimeve, ka patur 136 ankesa për zvarritje të gjykimeve si për çështjet penale, ashtu edhe për çështje civile, si dhe;

- për shkelje në drejtim të procedurave gjyqësore kryesisht sepse nuk janë lejuar që të futen në proces gjyqësor si palë, ndërhyrës kryesor ose dytësor kur kanë patur interesa të ligjshme,

- për veprime arbitrare nga administratat gjyqësore,

- që Avokati i Popullit të marrë pjesë vetë dhe t'i përfaqësojë ato në gjykimin e çështjeve të tyre,

- sepse nuk u jepen vendimet gjyqësore të zbardhura,

- sepse vonohet dërgimi i dosjeve nga Gjykata e Shkallës së Parë në Gjykatat e Apelit e anasjelltas,

- sepse nuk ju pranohen kërkesat për rishikim vendimi nga gjykatat,

-sepse janë në vështirësi ekonomike e familjare dhe nuk kanë mjete financiare për t'u mbrojtur me avokat privat,

- sepse akuzojnë “gjqqtarë të korruptuar” që marrin vendime të padrejta etj.

Gjatë vitit 2002 janë zgjidhur në favor 37 ankesa për shkelje të procedurave gjyqësore dhe shkelje të tjera të kryera nga administratat gjyqësore.

a)Ankesat ndaj Gjykatave të rretheve.

Nga numri i përgjithshëm prej 318 ankesash ndaj gjykatave të rretheve, për çështjet në gjykim janë 110 ankesa.

Duke analizuar ankesat dhe kërkesat ndaj Gjykatave të rrethit del se ato kanë qënë kryesisht për zvarritje të gjykimit të çështjeve nga gjyqtarët, të cilët akuzohen se zvarritjet bëhen prej tyre me qëllim të favorizimit të njëres palë.

Nga verifikimet e ankesave ka dalë se në përgjithësi shkaqet e dokumentuara nëpër dosje për zvarritje kanë qënë mos paraqitja e palëve në gjykim, mos paraqitja e dëshmitarëve apo të ekspertëve, për shkak të vështirësive që vërehen për njoftimet e tyre si dhe si pasojë e lëvizjes së lirë dhe të shpeshtë të njerëzve, pasaktësitë e adresave të tyre etj. Kështu që formalisht shpesh ankuesit nuk kanë patur të drejtë në ankesat e tyre. Por theksojmë se në thelb ata mund të kenë patur të drejtë, sepse gjyqtarët e akuzuar janë “kujdesur” që ligjërisht të mos vërtetohet shkelja e tyre.

Nga ankesat e ardhura për zvarritje gjykimi mund të përmendim edhe disa raste që tregojnë për shkelje apo mangësi organizative për një gjykim të shpejtë nga gjyqtarë të veçantë.

1-Shtetësja E.K. nga qyteti i Korçës ankohej se në një çështje civile në Gjykatën e rrethit Korçë, gjyqtari M.Kuqo ka zvarritur pa shkaqe ligjore gjykimin e saj. Nga verifikimi rezultoi se ky gjyqtar ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes për të bërë një verifikim në Bankën e Kursimeve Korçë, të cilës i ka dërguar edhe një shkresë. Por Banka nuk i ka kthyer përgjigje. Duke shqyrtuar kohën e gjatë, mbi 6 muaj, që kishte kaluar ne konstatoam se kishte qëndrim neglizhent e zvarritje të pajustificuar në zgjidhjen e shpejtë të çështjes. Prandaj ju bë rekomandim Ministrit të Drejtësisë që ndaj gjyqtarit të çështjes të fillonte procedimi disiplinor. Nga ana e Ministrit të Drejtësisë na u kthye përgjigje se shkelja e ngritur në rekomandimin tonë qëndron, por nuk shikohet e arsyeshme që ndaj gjyqtarit të fillojë procedimi disiplinor.

2-Shtetasi S.M. nga qyteti i Shkodrës, është ankuar se me dt.01.05.2001 është arrestuar vajza e tij A.M. nga Prokuroria e rrethit

Tiranë për akuzat e vjedhjes e shkatërrimit të pronës dhe se Gjykata e rrethit Tiranë zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e çështjes.

Nga verifikimi që ju bë kësaj ankese rezultoi se shkaqet e zvarritjes së gjykimit ishin mos paraqitja e dëshmitarëve, të cilët kishin ndërruar adresat e dhëna gjatë hetimeve paraprake. U muar takim me të arrestuarën në burgun 313 Tiranë dhe rezultoi se gjatë kohës së paraburgimit kishte pasur depresion mendor dhe ishte tepër e vështirë të komunikojë me të.

Në këto rrethana nga ana e jonë ju rekomandua Gjykatës së Tiranës që ndaj të pandehurës A.M. të kryhej ekspertim neuropsikiatriko ligjor për të konkluduar për gjendjen mendore të saj dhe nëse ajo është apo jo e përgjegjshme para ligjit për veprat penale të akuzuara.

Në të njëjtën kohë avokati i saj privat përsëriti kërkesën para gjykatës së faktit për ndryshimin e masës së sigurimit të saj, nga arrest në burg, në arrest shtëpie, pra që ajo të gjykohej e lirë. Kjo kërkesë u pranua nga gjykata, duke patur parasysh gjendjen e rënduar neuropsikiatrike të saj.

3-Shtetasi S.L. nga qyteti i Korçës u ankua se gjyqtari i Gjykatës Rrethit Korçë, B.Shehu, kishte pezulluar gjykimin e çështjes civile në vitin 1998 me arsyetim se palët kishin për gjykim një çështje tjetër në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Nga verifikimi rezultoi se në vitin 1998 palët ndërgjyqëse kishin për gjykim një çështje tjetër civile në Gjykatën e rrethit Tiranë. Por pala paditëse, E. C. kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtarës së çështjes dhe dosja ishte dërguar për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo gjykatë, pasi ka gjykuar çështjen, ka vendosur mos pranimin e kërkesës.

Dosja i është dërguar përsëri për gjykim të mëtejshëm gjykatës së faktit Tiranë. Rezultoi se në këtë dosje kanë qënë edhe dy nëndosje të tjera që kishin lidhje me këtë çështje dhe gjatë lëvizjes së dosjeve ato kanë humbur.

Gjykata e Rrethit Tiranë ka lëshuar vërtetim se çështja ndodhet për shqyrtim dhe mbi këtë bazë gjyqtari i çështjes B.Shehu ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes. Kështu çështjet u mbajtën të pezulluara nga viti 1998 e deri në fund të 2002. Edhe gjyqtari i çështjes në gjykatën e faktit Tiranë A.Broci kishte vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes, me arsyetim se dosjet e themelit ndodhen në Gjykatën e Apelit dhe nuk kishin ardhur akoma nga kjo gjykatë, pavarësisht se nuk ishte nevoja e pezullimit.

Në përfundim rezultoi se kanë humbur dy dosje civile, prandaj nga ana e jonë ju bë rekomandim Prokurorisë Rrethit Tiranë që ndaj dy sekretareve gjyqësore të Apelit e të shkallës së Parë Tiranë të fillojë procedimi penal. Tashmë kjo çështje ndodhet në hetim paraprak në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Ndërsa për zvarritjen pa shkaqe të

justifikuara të dy çështjeve civile ju bë rekomandim Ministrit të Drejtësisë, me qëllim që ndaj dy gjyqtarëve të fillojë procedimi disiplinor në bazë të ligjit Nr.8811 dt.17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

4-Shtetasi M.P. nga qyteti i Fierit është ankuar ndaj gjyqtares I.Maneku në Gjykatën e faktit Fier se ajo i ka hequr nga dosja dokumentat shkresore të pronësisë së tij. Nga verifikimi ynë rezultoi se humbja e tyre ka ardhur kryesisht nga veprimet e gjyqtares I.Maneku. Prandaj ju bë rekomandim Ministrit të Drejtësisë që ndaj kësaj gjyqtareje të fillojë procedimi disiplinor. Çështja është në ndjekje.

5-Ankuesit A. e M.S. nga qyteti i Korçës janë ankuar ndaj Gjykatës së Rrethit Korçë për zvarritje të gjykimit të një çështje civile, me objekt pronësie. Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se Gjykata e Rrethit Korçë kishte vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në mungesë të ankuesve. Nga Gjykata e Rrethit u dërgua edhe një kopje vendimi. Ne vumë në dijeni ankuesit dhe i orientuam që të paraqiten në Gjykatën e Rrethit që t’u bëhej komunikimi i vendimit sipas ligjit dhe pastaj ata kanë të drejtë që të ankohen në shkallë të dytë në Gjykatën e Apelit Korçë. Ankuesit vepruan sa sipër dhe Gjykata e Apelit Korçë vendosi prishjen e vendimit të gjykatës së faktit dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Në rigjykim u vendos pranimi i kërkesës së ankuesve.

6-Ankuesi S.S. nga rrethi i Fierit, ankohej ndaj një vendimi të Gjykatës Apelit Vlorë me të cilin ishte vendosur prishja e vendimit të gjykatës së faktit Fier dhe pushimi i gjykimit të çështjes. Nga verifikimi i bërë dhe nga studimi i përmbajtjes së vendimit të Gjykatës Apelit Vlorë rezultonte se gjykata kishte vendosur pushimin e gjykimit të çështjes sepse ankuesi kishte ngritur gabim padinë. Por në këtë vendim ai orientohej që të ngrinte padi të re me tjetër objekt. Mbi këtë bazë nga ana jonë u orientua konkretisht ankuesi. Ai hartoi padinë e re sipas orjentimeve të dhëna dhe vazhdoi gjykimi i çështjes normalisht, duke u zgjidhur kështu ankesa e tij.

7-Ankuesi R.Xh. ka paraqitur ankesë duke akuzuar një gjyqtare të Gjykatës së shkallës së parë në Lezhë për korrupsion në gjykimin e një çështje civile me objekt zgjidhje martese. Për këtë veprim ankuesi pretendoi se i ka dhënë paraprakisht një shumë të hollash gjyqtares së çështjes, e cila i ka marrë por nuk e ka ndihmuar si duhet. Rezultoi se ankuesi nuk kishte bërë kallëzim për këtë gjyqtare në prokurori. Më vonë me anën e një kërkesë tjetër i ka kërkuar Avokatit të Popullit që kjo çështje të mos ndiqet nga institucioni ynë. Prandaj në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.8454, dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” u vendos, arshivimi i

ankesës pasi ankuesi nuk dha pëlqimin që kjo çështje të vazhdonte të ndiqej nga ne.

Ankesa për zvarritje gjykimi kanë ardhur edhe nga shtetasit K.A. nga rrethi i Elbasanit, S.M. nga rrethi i Sarandës, S.Gj. nga rrethi i Lezhës, A.Sh. nga rrethi i Tiranës, H.M. nga rrethi i Shkodrës dhe L.J. nga rrethi i Krujës.

Në disa raste ankesat kanë patur si objekt gjykimet e zhvilluara duke pretenduar për njëanshmëri dhe mungesë objektiviteti dhe është kërkuar ndihma e Avokatit të Popullit që ai t'i përfaqësojë ato në gjykimet e çështjeve para Gjykatës Apelit apo Gjykatës së Lartë.

Në njoftimin e tij shtetasi K.M. avokat privat në qytetin e Sarandës ngrinte disa shkelje të gjyqtarëve të Gjykatës së shkallës së parë në Sarandë. Sipas tij ata me veprimet dhe sjelljet e tyre arbitrare kanë humbur besimin tek njerëzit, argumenton se këta gjyqtarë kanë tendencë të shmangin avokatët nga mbrojtja e çështjeve dhe këtë rol ta kryejnë vetë etj. Ky njoftim ju dërgua për kompetencë Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Duke qënë se nuk kanë patur mundësi financiare për të marrë avokat privat disa ankues kanë kërkuar ndihmën tonë. Nga ne janë bërë sqarimet e nevojshme, duke i orientuar që ata t'i drejtohen shërbimit ligjor falas apo klinikave ligjore të fondacioneve të ndryshme.

Në ankesën e tij shtetasi S.C. nga rrethi i Matit është ankuar se ndonëse ka bërë rekurs ndaj vendimeve gjyqësore të Gjykatës së faktit Tiranë dhe Gjykatës së Apelit në Tiranë dhe e kishte dorëzuar ankimin kundrejt nënshkrimit në sekretarinë e Gjykatës së faktit, nga Gjykata e faktit Tiranë dosja nuk dërgohej prej një kohe të gjatë, rreth 1 vit, për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Pasi u verifikua ankesa në vend, rezultoi se shkaku i vonesës ishte kryerja me vonesë e komunikimit të rekursit të gjitha palëve në proces. Ndërhyrja jonë bëri të mundur që dosja të dërgohej menjëherë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ankesa ka patur edhe ndaj administratës gjyqësore në disa rrethe sepse nuk u jepen palëve vendimet gjyqësore të zbardhura e të arsyetuara. Për rastet e konstatuara është ndërhyrë që t'u jepet vendimi dhe ankesat e tyre janë zgjidhur.

Në disa raste ankuesit duke qënë të mërzhitur e të lodhur nga tejzgjatja e proceseve gjyqësore nga njera shkallë tek tjetra, nuk binden me përgjigjen e dhënë nga ana e jonë, se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë. Për këtë ankuesit këmbëngulin se institucioni ynë duhet të bëjë vlerësimin e vendimeve gjyqësore pasi ato janë të padrejta dhe janë dhënë nga gjyqtarë të korruptuar. Në disa raste ankuesit paraqesin para

nesh dokumenta shkresore apo fakte bindëse se kanë të drejtë dhe pretendojnë se nga gjykata këto prova nuk merren në konsideratë. Këto ankesa tregojnë se në mjaft raste ankuesit kanë humbur besimin tek gjykatat dhe i akuzojnë ato direkt si organe të korruptuara.

Në lidhje me zvarritjet e gjykimeve penale duhet vlerësuar nevoja e ndryshimit të dispozitave të Kodit Procedurës Penale sa i takon ndryshimit të afateve të hetimit dhe gjykimit. Kemi mendimin se me këto afate të zgjatura abuzohet nga punonjës të veçantë si në organet e prokurorisë, ashtu edhe ato të gjykimit. Mendojmë se duhet të studjohet si problem dhe të propozohen afate të reja hetimi e gjykimi të arsyeshme, pasi në vetvete zgjatja e tyre cënon në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Në lidhje me vonesat e zvarritjet e gjykimeve civile, duke ju referuar dispozitave të Kodit Procedurës Civile, del se ato nuk parashikojnë afate gjykimi në shkallët e gjykimit. Duke parë e analizuar numrin e ankesave që bëhen ndaj çështjeve civile kemi mendimin që të studjohet mundësia e parashikimit të afateve për disa lloj çështjesh civile.

Një shkak tjetër që ndikon në zvarritjen e gjykimeve në shkallë të parë si për çështjet penale, ashtu edhe për ato civile është se në mjaft raste ato shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

b) Ankesat ndaj Gjykatave të Apelit.

Gjatë vitit 2002 ndaj Gjykatave të Apelit janë paraqitur 43 ankesa, nga të cilat 10 për çështjet në shqyrtim. Ato kanë qënë kryesisht për shpejtimin e gjykimeve, për prishjen ose ndryshimin e vendimeve të Gjykatave të shkallës së parë, për dhënien e kopjeve të vendimeve gjyqësore pas përfundimit të gjykimit, për vonesat në dërgimin e dosjeve për rastet kur çështjet janë prishur dhe janë dërguar për rigjykim etj. Shumica e ankesave kanë rezultuar të padrejta.

Ankuesi Ll.D. nga rrethit i Fierit është ankuar për zvarritje të gjykimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Vlorë. Nga verifikimi ynë rezultoi se shkak i mos gjykimit ishte se në përbërjen e trupit gjykues do të merrte pjesë një gjyqtar tjetër që do caktohej me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ky është një shkak i shpeshtë pse ndodhin zvarritje në gjykatat e Apelit.

c) Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë.

Dihet se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë, por ne e kemi radhitur në këtë kre për shkak se problemet që

ngrenë shtetasit për këtë Gjykatë janë pothuaj të njëjlojta me ato që ngrenë edhe për gjykatat më të ulta.

Gjatë vitit 2002 ndaj Gjykatës së Lartë kanë ardhur gjithsej 44 ankesa, nga 38 ankesa që kanë ardhur në vitin 2001. Për çështjet në shqyrtim janë 16 ankesa.

Duke i analizuar këto ankesa rezulton se kryesisht ato kanë qënë:

- Për vonesa në gjykimin e çështjeve, është kërkuar pjesmarrja e Avokatit të Popullit në gjykim, nuk jepen kopjet e vendimeve gjyqësore, sepse vendimet nuk arsyetohen në kohë etj.

Shtetasi T. Rr. është ankuar se kolegji civil ka gjykuar një çështje civile dhe kishte kaluar një kohë e gjatë dhe kolegji nuk shpallte vendimin.

Nga verifikimi rezultoi se palët kishin për gjykim edhe një çështje tjetër në kolegjin civil. Prandaj ky kolegji kishte vendosur pezullimin e gjykimit të njëres çështje derisa të përfundonte gjykimi tjetër. Gjithsesi ankuesi nuk ishte sqaruar për këtë fakt.

Në lidhje me ankesat që janë bërë ndaj themelit të vendimeve të Gjykatës së Lartë nga ana jonë janë bërë sqarimet e nevojshme se këto ankesa janë jashtë juridiksionit tonë dhe se, në rast se ankuesit kanë pretendime për një proces jo të rregullt ligjor, në bazë të neneve 42 dhe 134 germa "g" të Kushtetutës janë orientuar t'i drejtohen me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

Po kështu ka patur raste që disa ankues kanë patur pretendime se çështja e tyre nuk është gjykuar drejtë dhe atyre u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore si nga organet e administratës publike shqiptare ashtu edhe nga organet e drejtësisë në të gjitha shkallët e gjykimit. Për këto raste personat janë dëgjuar me vemendje dhe janë orientuar se në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kanë të drejtë që t'i drejtohen Gjykatës së Strasburgut, duke patur parasysh që kjo kërkesë duhet të bëhet në një afat brenda 6-muajsh dhe pasi të kenë konsumuar të gjitha mjetet e ankimit sipas legjislacionit shqiptar.

3. Amicus Curiae (Miku i Gjykatës)

Ky është një rol që nuk njihet në legjislacionin tonë.

Amicus curiae, fjalë për fjalë do të thotë, Miku i Gjykatës. Është një person që ka interes ose pikëpamje të forta mbi çështjen në gjykim, por nuk është palë në gjykim. Ai mund t'i kërkojë leje gjykatës që të paraqesë një dosje, në dukje në emër të një pale, por në fakt për të sugjeruar një arsye themelore në përputhje me pikëpamjet e tij. Këto dosje të Mikut të Gjykatës zakonisht paraqiten në Apel lidhur me çështje me interes shumë të gjerë publik, p.sh. çështjet e të drejtave civile të grave, fëmijëve etj. Këto

dosje mund të paraqiten nga institucione, persona privatë ose nga Qeveria. Në apelet e Gjykatave Amerikane të Apelit, këto dosje mund të paraqiten vetëm nëse janë të shoqëruara me një miratim me shkrim të të gjitha palëve, ose me leje të gjykatës.

Ne në Shqipëri, gjatë punës sonë për shqyrtimin e ankesave të shtetasve, për çështje që janë në gjykim shpesh herë konstatojmë se ka vend për të luajtur këtë rol. Në fakt, në ndonjë rast të veçantë si p.sh. për çështjen civile të prishjes së kullave të ndërтуara nga firma Hawaii, e kemi luajtur këtë rol duke kërkuar zbatimin e afatit 1 mujor të gjykimit e të mos zvarritej çështja. Mund të ketë keqkuptime nga gjyqtarët, sepse mund ta interpretojnë si ndërhyrje në veprimtarinë e tyre. Por, në fakt kur ky rol bëhet për procedurat gjyqësore dhe për çështje madhore, siç janë nevojat e zbatimit të konventave themelore për të drejtat e njeriut. Prandaj mendojmë se duhet luajtur më tepër, duke mos u ndikuar nga keqinterpretimet e mundshme.

4. Prokuroria

Sipas Kushtetutës sonë edhe Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Për vitin 2002 në institucionin tonë 220 shtetas të ndryshëm kanë paraqitur 196 ankesa apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Ankesat apo kërkesat për vitin 2000 kanë qenë 31, kurse për vitin 2001 kanë qenë 100 ankesa. Pra numuri i ankesave të ardhura në vitin 2002, krahasuar me vitin 2001 ka një rritje rreth 100 %.

Nga 196 ankesat për vitin 2002, janë përfunduar 175 kurse 21 prej tyre janë në shqyrtim. Mënyra e përfundimit të ankesave ka qenë: 64 ankesa janë zgjidhur në favor ose 31%, 87 ankesa kanë qenë jashtë kompetence dhe 24 ankesa të pabazuara.

Edhe për vitin 2002 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qenë brenda kompetences sonë Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme: si marrjes së deklarimeve, kqyrjes së dokumenteve, kryerjes së ekspertimeve teknike shkencore apo mjekoligjore me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studjuar dosjet hetimore, për të cilat Prokuroria kishte vendosur pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

Për mjaft ankesa është shkuar në vendbanimin e ankuesit apo kërkuesit, apo janë kryer veprimet në vend, duke marre dhe shpjegimet e nevojshme në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me precedence dhe ankesa të shtetasve apo shoqatave që përfaqësojnë komunitete apo pakica kombetare. Të tilla mund të përmëndim rastin e hetimit të filluar me iniciativen tonë, pas një deklarate të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në maj 2002 për keqtrajtimin nga policia të dy romëve në Ballsh. Dy ditë me radhë ekspertët tanë kanë bërë hetime në organet e policisë e të prokurorisë në Ballsh, Fier, Berat Kuçovë, Lushnjë e në spitalet përkatëse dhe rezultoi se ngjarja nuk ishte e vërtetë dhe deklarata kishte qenë e nxituar.

Gjithashtu mund të përmëndim ankesën e bërë nga Unioni i Romëve të Shqipërisë për vdekjen e një anëtareje të komunitetit rom në spitalin e lindjes në Fier. Për këtë i kemi rekomanduar Prokurorit të rrethit Fier, fillimin e hetimit për veprën penale të “mjekimit të pakujdesshëm”. Apo

rasti i shoqatës “Drushtvo Prespa” për antarin e saj z. S.N, ndaj të cilit Prokuroria kishte filluar çështje penale. Në fakt ankesa e kryetarit të kësaj shoqate rezultoi e pabazuar dhe, për mendimin tonë, e bërë me qëllim dashakeq për të “krijuar imazhin për diskriminim të pakicës maqedonase në Shqipëri”.

Gjatë shqyrtimit të ankesave për Prokurorinë janë konstatuar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të parashikuara nga nenet 28 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (liritë dhe të drejtat vetjake gjatë procesit penal), neni 42 (proces të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm), neni 142/3 (organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore), si edhe nga nenet 5 dhe 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për liri e siguri, dhe e drejta për një proces të rregullt).

Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2002, vihet re se objekti i tyre është i njëjlojtë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit 2001. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë:

1.Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale.

Raste të tilla mund të përmenden ankesat e shtetasve S.M. e P. B. nga Tirana, ankesa e A. S. nga Kolonja, F. R. nga Kavaja, D. D. nga Korça, R.H. nga Puka, J.A. nga Lushnja etj.

2.Për moskryerje të hetimeve të gjithanshme dhe objektive, si psh ankesa e shtetasës M. K. nga Tirana, H. L. nga Elbasani, P. M. nga Korça etj.

3.Për mosvenie në levizje, apo mosvlerësim të kallezimit të shtetasve, si psh ankesat e B. B. nga Komuna Gurra e Madhe Mat, A. H. nga Burreli, Xh. K. nga Lushnja, A. A. nga Tirana etj.

4.Për mosnjoftim apo njoftim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallezimit apo përfundimit të çështjes penale, si psh ankesat e S.N. nga Tirana, Z.D. nga Vlora, H.L. nga Elbasani etj.

5. Për ndalim apo arrestim të padrejtë ose të pabazuar, si psh ankesa e shtetasit A.H. nga Skrapari, D.P. nga Lezha, Sh.T. nga Kavaja etj.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se organi i Prokurorisë në mjaft raste ka vepruar në mënyrë të nxituar dhe të pabazuar në përfundim të hetimit, duke konkluduar si mënyrë zgjidhje të saj pushimin ose pezullimin e hetimeve. Pas studimit nga ana e jonë është venë re se pushimi nuk është rezultat i hetimit të gjithanshëm dhe objektiv e për rrjedhojë, i është rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm ose Kryeprokuroreve në rrethe shfuqizimi i vendimit. Raste të tilla për vitin 2002 janë disa dhe mund të përmëndim çështjen penale Nr.322 të vitit 2001 të Prokurorisë së rrethit Elbasan për veprën penale të “shkeljes së

rregullave të qarkullimit rrugor”, mbi ankesën e shtetasit H.L. nga Elbasani; çështjen penale të Prokurorisë Ushtarake Tiranë për veprën penale të “shkeljes së rregullave të sherbimit të rojes me pasoje vdekjen e shtetasës R. M”, mbi ankesën e shtetasit P.M. nga Korça; çështja e zhdukjes së kosovarit R. H. etj.

A-Nga shqyrtimi i ankesave që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm apo kryeprokurororeve në rrethe 17 rekomandime, nga të cilat 11 janë pranuar dhe 6 rekomandime janë refuzuar. Pra konstatohet se në përgjithësi, rekomandimet e Avokatit të Popullit, përgjithësisht janë pranuar. Por shpesh veprimet përkatëse nga Prokurori i Përgjithshëm apo prokurorët e rretheve janë kryer me disa muaj vonesë, pas insistimit tonë dhe më e keqja është se shpesh nuk kthehet përgjigje për mënyrën e përfundimit të çështjes. Shqetësues është fakti se nga 6 raste kur është kërkuar marrje e masave disiplinore për shkelje të kryera nga Prokurorë apo oficerë të policisë gjyqësore, është kthyer përgjigje nga Prokurori i Përgjithshëm se “nuk shihet e arsyeshme marrja e masave disiplinore ndaj tyre”. Mendojmë se kjo përgjigje nuk është korrekte, sepse jo vetëm nuk ka sqaruar faktin nëse rekomandimi ynë ka qenë i bazuar ose jo, por dhe nuk argumentohet pse nuk shihet e arsyeshme mosmarrja e masave disiplinore. Raste të tilla janë :

1. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e hetimit për veprën penale të “Shpërdorimit të detyres” dhe pezullim nga detyra të Prokurorit të rrethit Kolonjë z.A. Prifti. Ky nuk ka marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit penal për heqjen nga dhomat e izolimit të shtetasit R.Ç. dhe dergimin e tij në një institucion mjekësor. Për pasojë ai ka qendruar padrejtësisht rreth 1 vit në paraburgim.

- 2 Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për fillimin e hetimit ndaj Prokurorit të Prokurorisë së rrethit Lezhë z.B. Çiçi për veprën penale “të mosmarrjes së masave për të nderprere gjendjen e paligjshme”, parashikuar nga neni 251 e Kodit Penal. Prokurori i çështjes duhet të urdhëronte lirimin e menjëherëshëm të ndaluareve D.P. dhe Gj.P. Pas dergimit të çështjes në gjyq nga prokuroria, Gjykata e faktit Lezhe deklaroi të pafajshëm të tre vellezerit Pergjini, për akuzën e “kundershtimit të punonjësit të policisë së rendit”. Ky vendim u la në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Shkodër.

3. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për marrje mase disiplinore ndaj ish kryeprokurorit ushtarak z. A. Goga. Nga ana e tij në procedimin penal Nr.233 të vitit 1998 për veprën penale të “krimeve kunder njerëzimit” me të pandehur S.M etj, jo vetëm nuk janë zhvilluar

seanca të pyetjeve me të, nuk i janë njoftuar vendimet për zgjatjen e afatit të hetimit të pandehurve, por dhe vendimi i pushimit i është komunikuar me shtatë muaj vonesë, duke i hequr kështu mundësinë e ankimit në kohë në gjykatë dhe lënë padrejtësisht nën ankthin e qënies nën hetim.

4.Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për marrje masë disiplinore ndaj Prokurorit të rrethit Gjirokastrë z.A. Xholi, i cili në çështjen penale në ngarkim të Sh.T, D.T. dhe Q.B. të akuzuar për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikeve” duhet të zbatonte nenin 257 të Kodit të Procedurës Penale, duke urdhëruar lirim të menjëhershëm të shtetasit Sh.T, i cili prej dy ditësh mbahej i izoluar pa dokumentet përkatëse nga policia. Mandej për këtë të pandehur nga ky prokuror është kërkuar padrejtësisht si masë sigurimi “arresti në burg pa afat”. Gjykata e faktit e liroi nga arresti me masë detyrim për paraqitje, vendim që u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Ky prokuror vazhdon ta mbajë ankuesin nën ankthin e qënies nën hetim edhe pas rekomandimit tone.

5. Rekomandimi i Prokurorit të Përgjithshëm për marrje masa disiplinore ndaj Prokurorit të Prokurorisë Tropoje z.M. Laska, për zvarritje të theksuara në hetimin e procedimit penal Nr.12 datë 21.01.2001, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” ndaj shtetasit A.H. qysh me datën 21.06.2002. Procedimi penal është në fazën e hetimit dhe ende nuk ka përfunduar.

6.Rekomandimi drejtuar Prokurorit të rrethit Kukës për marrje masa disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore z. I. Muçmataj, qysh me datën 12.06.2002, për arsye se në procedimin penal në ngarkim të pandehurit E.I. nga Kukesi, akuzuar për veprën penale të “mashttrimit”, kishte shkelje proceduriale që lidhen me mosnjohjen e të pandehurit me materialet e çështjes në përfundim të hetimi. Ishin administruar dy proces verbale njohje të çështjes, ku në njërin ishte hedhur firma e të pandehurit, ndersa në tjetrin ishte shkruar refuzon firmën. Pra në fakt mund të flitet për falsifikim të akteve zyrtare.

B. Gjatë shqyrtimit të çështjeve që kemi paraqitur për keqtrajttime apo veprime arbitrare të organeve të policisë ndaj qytetarëve themi me fakte se ka një tendencë të organit të prokurorisë për “mbylljen”, pushimin apo pezullimin e çështjeve në rastet e kryerjes së veprave penale të dukshme nga punonjës policie. Kjo ka ndodhur në disa raste kur nga ana e Avokatit të Popullit është rekomanduar fillimi i hetimit për “kryerje të veprimeve arbitrare” apo “shpërdorim të detyres” etj, apo kur është kërkuar rihapja e hetimeve.

Përmëdim disa nga rastet më të dukshme dhe flagrante:

1-Është klasik rasti i keqtrajtimit të të miturit Ergest Shele në policinë e Sarandës në vitin 2000, për të cilin prokuroria e Sarandës pushoi hetimet. Ato u rihapën pas 7 muajsh nga ish Prokurori i Përgjithshëm Arben Rakipi jo me dëshirën apo bindjen e tij, por vetëm pasi Avokati i Popullit e bëri këtë çështje problem tek ish Presidenti i Republikës. Më në fund çështja e ish oficerit të Policisë Rrapo Xhavarra u gjykua nga gjykata e Sarandës dhe ai u dënua me kusht, por policët që torturuan të miturin nuk u zbuluan kurrë nga prokuroria e Sarandës.

2-Po kështu keqtrajtimi nga policia e Komisarariatit të Policisë Nr.2 Tiranë të shtetasit B.K. për të cilin, me porosi të Prokurorit të Përgjithshëm, rekomandimin ja dhamë në dorë prokurorit të rrethit Tiranë z.Vexhi Muçmata. Ky filloi procedimin penal, por u bënë vetëm disa veprime hetimore të përcipta dhe me vonesë. Në përfundim prokuroria në mënyrë të padrejtë, duke u bërë “ortak” me policët, vendosi pezullimin e hetimit me arsyetimin për “mosnjohje të autorëve të veprës penale”. Pastaj dosja e pezulluar është dërguar për gjetje të autorëve në policinë kriminale të Komisarariatit të Policisë Nr.2, ku edhe është kryer vepra penale. (Çfarë absurdi, policia kriminale e Rajonit Nr.2 merr dosjen e pezulluar për të zbuluar autorët e keqtrajtimit, që janë po punonjësit e policisë kriminale të Rajonit Nr.2). Në muajin shkurt 2003, Prokuroria e Përgjithshme bëri shfuqizimin e vendimit të pezullimit të hetimit, por duke shmangur studimin e kesaj dosje nga ndihmësi i Avokatit të Popullit.

3-Shtetasi A. Sh. nga Shenmeria e Kukësit ka bërë ankesë për keqtrajtim të vëllait të tij B. Sh. nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Puke. I dëmtuari B.Sh. është shtruar në urgjencën e Spitalit Puke, ku ka qëndruar një javë dhe mandej rreth 6 javë edhe në spitalin e Burgut Tiranë, ku është kuruar për azotemi në veshka. Megjithatë prokuroria Ushtarake e Shkodrës filloi procedimin penal Nr.72 datë 25.04.2002, në ngarkim të disa punonjësve të policisë të Komisariateve Kukës dhe Puke, në përfundim ka vendosur pushimin e çështjes penale, pa ndëshkuar policët ndonëse në këtë rast jeta e të demtuarit B.Sh. është shpëtuar vetëm si rezultat i ndihmes së shpejtë e të kualifikuar të mjekeve kurues.

4-Të njëjtë janë edhe rastet e ankesës së shtetasit D.P. nga Lezha për keqtrajtim nga policia e Komisarariatit të Lezhës, dhe të oficerit të Policisë Ervin Hado në Tiranë, raste të cilat i kemi përmendur me hollësi në pjesën ku flasim për policinë. Prokurori i Përgjithshëm, në përgjigjen e tij, për çështjen e Lezhës shkruan: “Materialet në ngarkim të punonjësve të policisë janë veçuar dhe nga hetimi është provuar që është ushtruar dhunë ndonëse, nuk është bërë i mundur identifikimi i autorëve. Kurse, në gjendjen që paraqiten aktet nuk mund të konkludohet për të filluar

procedimin penal ndaj punonjësve të prokurorisë sipas rekomandimeve tuaja, por i mirkuptojme ato në kuadrin e bashkepunimit për të luftuar krimin”.

Konkluzionin e mësipërm për mungesën e dëshirës apo ngadalësisë për të bërë hetime të shpejta dhe objektive nga prokuroria në rastet kur akuzohen policët, e konstatoam edhe në rastin e vdekjes nga dhuna policore të shtetasit G.Tahirllari në janar 2003, i cili tashmë është bërë tepër i njohur për gjithë publikun, institucionet shtetërore dhe ato ndërkombëtare.

C.Nga praktika e punës rreth 3 vjeçare me organet e Prokurorisë konstatojmë se ka tendencë dhe praktika të paligjshme të saj, duke mos zbatuar Kushtetutën dhe ligjet përkatëse në marrëdhëniet e Prokurorisë me Institucionin e Avokatit të Popullit. Prokuroria është nga të paktit organe që ka patur dhe vazhdon të ketë “rezistencë” ndaj aksesit dhe veprimtarisë së Institucionit tone. Ky qëndrim ka qenë me hope dhe për raste të caktuara nga ish Prokurori i Përgjithshëm, zoti Arben Rakipi. Por të tilla qëndrime i ka shprehur kohët e fundit edhe Prokurori i Përgjithshëm, zoti Theodhori Sollaku.

Avokati i Popullit ka biseduar disa herë me Prokurorin e Përgjithshëm, zotin Sollaku për këto qëndrime të gabuara, të cilat në thelb ne i konsiderojmë shfaqje të nënvleftësimit të të drejtave të njeriut nga organi që ai drejton. Por prokurorët e rretheve kanë vijuar të mos jenë korrekt me rekomandimet tona, të mos japin shpjegime të hollësishme për ankesat që ne ju kemi kërkuar dhe çfarë është më negative, nuk kanë pranuar të na dërgojnë disa dosje për të cilat janë pushuar hetimet prej tyre, por për të cilat ka patur ankesa nga shtetasit. Këto qëndrime i kanë justifikuar se “kanë marrë porosi nga Prokurori i Përgjithshëm” për të vepruar në këtë mënyrë refuzuese për bashkëpunim. Refuzimi nga prokurorët për mos dhënie dokumentash ose të shpjegimeve të kërkuara nga Avokati i Popullit argumentohet me pretendimin se, të drejta të tilla nuk i parashikon Kodi i Proçedurës Penale, ndërkohë që dihet se ky Kod është i vitit 1995. Prokurorët nuk duan e nuk zbatojnë nenin 63, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar në vitin 1998, që thotë se: “Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”. Po kështu nuk zbatojnë dhe nenet 19 dhe 20 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku është shprehur qartë e në mënyrë taksative që, Avokati i Popullit kur shqyrton ankesën ka të drejtë të kërkojë e të marrë çdo lloj dokumenti, përfshirë dhe ato që janë sekret shtetëror, pa marrë ndonjë pëlqim paraprak të organit që i disponon dokumentet.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit qe normon punën tonë dhe ligjit procedural penal. Qëndrimi ynë është se duke konstatuar shkeljet reale të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve që janë subjekte në procesin penal, ato duhet t’i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës nga prokuroria dhe ngritjen e saj në nivelet bashkëkohore. Por duke analizuar qëndrimet e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili vlerëson se nuk duhet të merren masa disiplinore ndaj prokurorëve që kanë bërë shkelje të rënda e flagrante të të drejtave të njeriut; që nuk i përmend fare shkeljet e të drejtave të njeriut nga prokuroria as në Raportin e tij në analizën e Prokurorisë së Përgjithshme në datën 7 shkurt 2003 apo që refuzon hapur dhe me shkrim që prokurorët t’i dërgojnë Avokatit të Popullit dosje penale të pushuara, del se ka një koncept të gabuar ndaj nevojës së respektimit në radhë të parë të të drejtave të njeriut si dhe institucionit të Avokatit të Popullit, duke refuzuar bashkëpunimin e plotë me ne.

Me këtë rast përmëdim edhe se Presidenti i Republikës, zoti Alfred Moisiu, në fjalën e tij në analizën e Prokurorisë së Përgjithshme në datën 7 shkurt 2003, ndër të tjera porositi: “Sa e rëndësishme është lufta kundër krimit dhe vënia para përgjegjësisë e fajtorëve, po aq e rëndësishme është dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë gjithë procedimit penal apo gjatë kohës që fajtorët vuajnë dënimin. Nuk kanë munguar shkeljet edhe në këtë drejtim prandaj, përveç punës tuaj, edhe bashkëpunimi me Avokatin e Popullit duhet të jetë real, duke krijuar të gjitha lehtësitë për marrjen e informacionit, shpjegimeve apo dosjeve si dhe duhen vlerësuar rekomandimet që Avokati i Popullit bën në zbatim të detyrës së tij kushtetuese”.

Duke përfunduar le të shpresojmë se Prokurori i Përgjithshëm do të reagojë pozitivisht si për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit, por edhe të porosive të mësipërme të Presidentit të Republikës.

5. Ministria e Rendit Publik

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga detyrat tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elemente të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korrumpuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e policisë gjatë vitit 2002 kanë ardhur gjithsej 283 ankesa, kërkesa apo njoftime. Nga këto 107 prej tyre janë bërë nga banorë të Tiranës, ndërsa 176 nga banorë të rretheve të ndryshme të vendit. Kanë përfunduar 197 ankesa si vijon: 62 ose rreth 32 % janë zgjidhur në favor, 29 kanë qënë jashtë juridiksionit, kurse 106 kanë qënë të padrejta. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2003, 86 ankesa.

Gjithashtu gjatë vitit 2002 është punuar edhe për ndjekjen e 42 ankesave të mbartura nga viti 2001. Nga ato janë përfunduar 40, ndërsa 2 prej tyre janë mbartur për shqyrtim në vitin 2003. Mënyra e përfundimit të tyre është: 18 janë zgjidhur në favor, 4 janë nxjerë jashtë juridiksionit dhe 18 kanë qënë të padrejta.

Ankesat trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:

I. Ankesat për keqtrajtim të shtetasve:

Këto ankesa vlerësohen më tepër sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, është një shqetësim i madh fakti se këtë vit ato kanë qënë në rritje në krahasim me vitin e kaluar. Duke parë këtë tendencë rritje që në muajin shtator 2002 ne bëmë një studim për këto lloj ankesash dhe ja ngritëm zyrtarisht shqetësimin Ministrit të Rendit e Kryeministrit. Për fat të keq më 3 janar 2003 ndodhi ngjarja e rrahjes nga policët e Korçës që solli si pasojë vdekjen e shtetasit G.Tahirllari, e cila

tashmë dihet publikisht por që do të trajtohet hollësisht në Raportin vjetor 2003.

Në institucionin tonë janë bërë 70 ankesa për keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit. Nga këto janë përfunduar 50 dhe mënyra e zgjidhjes së tyre është: 15 janë vlerësuar të drejta, 11 kanë qënë jashtë juridiksionit, 24 të pa bazuara dhe 20 ankesa janë në shqyrtim.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime organeve përkatëse. Gjatë këtij viti, vetëm për rastet e keqtrajtimeve, janë bërë 21 rekomandime, nga të cilat 10 i janë drejtuar organeve të Policisë dhe 11 organit të Prokurorisë. Duhet të theksohet se të gjitha rekomandimet tona janë pranuar dhe mbi bazën e tyre janë ndëshkuar me masa disiplinore 12 punonjës policie, 8 të rolit të mesëm (oficere) dhe 4 të rolit bazë (policë). Gjithashtu mbi bazën e rekomandimeve tona organi i Prokurorisë ka filluar hetimet për 24 punonjës policie, nga të cilët 8 oficere dhe 16 policë.

Si raste të vërtetimit të ankesave për keqtrajtime të shtetasve mund të përmendim:

1- Ankesën e shtetasve Xh.Ç., S.Ç. dhe E.S. ndaj oficerit të policisë kriminale të Komisarriatit nr. 1 Tiranë, z. Ervin Hodo, i cili me veprimet e tij të kundraligjshme ju kishte shkelur të drejtat kushtetuese të paprekshmërisë së banesës dhe atë të personit.

Sipas ankuesit Xh. Ç., Ervini në dt. 24.12.2001, pa patur asnjë shkak ligjor dhe vendim gjyqësor kishte bërë kontrollin e banesës së tij. Ndërsa ankuesit S. Ç. dhe E. S. pretendonin për shoqërim të padrejtë dhe për keqtrajtimin që ju ka bërë Ervini në dt. 24.11.2001 dhe në dt. 30.11.2001.

Nga verifikimi që i bëmë këtyre ankesave u provua se oficeri i Policisë kriminale z. Ervin Hodo me veprimet e tij të kundraligjshme kishte shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të ankuesve dhe konkretisht:

1. Paprekshmërinë e banesës, të garantuar nga neni 37 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 202 i K.Pr.Penale.

2. Të ndalimit të tortures, dënimit apo trajtimit mizor, çnjërzor apo poshtëruar të garantuar nga neni 25 i Kushtetutes.

3. Gjithashtu shoqërimi i tyre në polici tej afatit ligjor, deri në dhjetë orë, përbënte shkelje të nenit 45 të ligjit Nr. 8553 , dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Për këto veprime të kundraligjshme, i rekomanduam Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimin e procedimit penal ndaj oficerit të Policisë kriminale Ervin Hodo, për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i K.Penal. Gjithashtu i rekomanduam Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që të jepte ndaj tij masën disiplinore “pezullim nga detyra”. Të dy rekomandimet tona u pranuan nga organet e mësipërme. Më vonë nga prokuroria na erdhi përgjigjia se çështja u pushua për arsye se gjatë hetimeve ankuesit hoqën dorë nga ankimi. Theksojmë se pushimi i çështjes me arsyetimin e mësipërm nuk është i mbështetur në ligj sepse sipas K.Pr.Penale, hetimi për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare nuk fillon dhe nuk pushon në bazë të kërkesës së të dëmtuarit.

2- Ankesa e shtetasit Xh. S., i cili pretendonte se në datën 22.01.2002, rreth orës 6.45 i kanë shkuar në banesën e tij, në fshatin Gurrë, katër punonjës policie të Komisarariatit Librazhd, me në krye inspektorin e Policisë së rendit të zonës Astrit Koja. Pa patur asnjë shkak ligjor, ai me urdhër të Astritit është lidhur me pranga dhe është shoqëruar në Postën e Policisë Qukës. Sapo është çuar në postë është futur në një dhomë dhe është lidhur përseri me pranga, një pjesë e pranges në dorë dhe tjetra në hekurat e dritares së saj, e cila ndodhet në lartësi mbi dy metra. I ndodhur në këto kushte tepër të vështira, ankuesi i ka kërkuar ndihmë punonjësit të policisë Gezim Skënderaj, i cili i ka afruar një bllok betoni nën këmbë për t’i lehtësuar dhimbjet e shkaktuara nga kjo gjëndje, i varur nga dora. Sipas ankuesit, ai është marrë disa herë në zyrë nga Astriti dhe është rrahur prej tij, duke u goditur me shkop gome, grushta dhe shqelma. Gjithashtu, ankuesi pretendonte se punonjësi i Policisë Astrit Koja i ka kërkuar atij që t’i sillte të nesërmen 25.000 lekë, por ai nuk ja ka çuar ato. Pasi ka dalë nga policia ankuesi ka bërë disa fotografi, në të cilat pasqyrohen shënjat e dhunës, që sipas tij, është ushtruar nga Astrit Koja.

Nga verifikimet që kemi bërë rreth ankesës, u vërtetua se punonjësit e Policisë të përmendur më sipër, kanë shkuar në banesën e ankuesit dhe i kanë kërkuar të shkonte në polici për ta pyetur rreth një konflikti, shkaktim dëmi (thyer tre xhama makinë), që ai ka patur me një shtetas tjetër. Megjithëse ankuesi nuk ka kundërshtuar urdhërin e tyre, ai me urdhër të z. Astritit është lidhur me pranga dhe shoqëruar në Postën e Policisë Qukes. Aty është mbajtur në një dhomë shoqërimi të mbyllur me çelës dhe është pyetur rreth konfliktit të përmendur më sipër.

Këto veprime, si lidhja me pranga dhe mbajtja mbyllur me çelës për katër orë, përbejnë shkelje të hapura të të drejtave themelore Kushtetuese të shtetasit Xh. S. të garantuara nga neni 25 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë. Njëkohësisht veprimet e tij janë bërë në kundërshtim edhe me nenin 46 të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 ”Për Policinë e Shtetit”, në të cilin parashikohen rastet për përdorimin e forcës nga punonjësi i Policisë.

Në përfundim të këtij hetimi, konkluduar se veprimet e punonjësit të Policisë Astrit Koja janë të kundraligjshme dhe përmbajnë elementët e

figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare. Mbi këtë bazë i rekomandua Prokurorisë se rrethit Librazhd fillimin e ndjekjes penale. Rekomandimi u pranua dhe ndaj tij filloi procedimi penal. I rekomandua Drejtorisë së Policisë së qarkut Elbasan të jepte ndaj tij edhe masën disiplinore "pezullim nga detyra", e cila ju dha menjëherë. Pas përfundimit të hetimeve çështja penale i kaloi gjykatës dhe aktualisht është në gjykim.

3- Ankesat e shtetasve A. C., K. C. dhe L. C., të cilët pretendonin për shkeljen e të drejtave të tyre nga veprimet e paligjshme të punonjësve të Policisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër dhe konkretisht:

Ankuesit K. C. dhe A. C. pretendonin se në dt. 20.02.2002, rreth orës 18.00-18.30, duke udhëtuar me një makinë së bashku me shtetasit R.Sh. dhe F.D. janë ndaluar në afërsi të shtëpisë së tyre nga disa punonjës policie, në krye të të cilëve kanë qënë Shefi i Seksionit të Policisë me Unifome z. Valentin Florini dhe Shefi i Policisë Rrugore z. Fatmir Lleshi. Pasi janë ndaluar, ata janë urdhëruar të zbrisnin nga makina dhe i janë nënshtruar kontrollit fizik dhe të automjetit, por nuk ju është gjetur asgjë e kundraligjshme. Pas këtij kontrolli ata janë keqtrajtuar, duke u goditur me grushta, shqelma, shkopinj gome dhe qytë automatiku nga z. Fatmir Lleshi dhe punonjës të tjerë policie. Më pas, me urdhër të z. Valentin Florini, ata janë shoqëruar e mbajtur në organin e Policisë deri në orën 11.00 të ditës pasardhëse. Gjithashtu ata pretendonin se janë keqtrajtuar edhe gjatë shoqërimit për në polici.

Nga hetimi i bërë nga ana jonë, rezultoi se pretendimet e tyre për keqtrajtim nga punonjësit e Policisë dhe mbajtja e tyre të shoqëruar në organin e Policisë, tej afatit ligjor të parashikuar në nenin 45 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" ishin të vërteta.

Veç sa sipër, ankuesi L. C. pretendonte se në dt. 23.03.2002, rreth orës 19.00, duke udhëtuar me makinë me dy shokët e tij, A. dhe Sh. M., janë ndaluar nga disa punonjës policie të drejtuar nga z. Valentin Florini dhe Fatmir Lleshi. Ata janë urdhëruar prej tyre që të dilnin jashtë makinës dhe ju është bërë kontroll fizik dhe kontroll i automjetit me të cilin udhëtonin. Gjatë kohës së kontrollit, i dëmtuari L. C. është goditur me grushta nga Fatmir Lleshi dhe me shqelma nga një punonjës tjetër policie dhe si pasojë i janë shaktuar dy fraktura në kërcirin e këmbës së majtë të tij. Mbas ankesave të tij për dhimbje të këmbës, ai është shoqëruar nga punonjësit e Policisë në spitalin rajonal të qytetit për t'i dhënë ndihme mjekësore dhe mbasi i është bërë grafia i është vendosur këmba në allçi nga mjeku specialist.

Këto pretendime u provuan nga pyetja e dëshmitarëve si dhe e mjekut specialist ortoped-traumatolog.

Me qënë se nga hetimi i këtyre ankesave rezultoi se nga punonjësit e Policisë, oficerët Fatmir Lleshi dhe Valentin Florini janë kryer veprime dhe dhënë urdhëra arbitrare, duke konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, parashikuar nga neni 250 i K.Penal, i rekomanduam Prokurorisë së rrethit Shkodër fillimin e procedimit penal ndaj tyre. Gjithashtu, i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhënien ndaj tyre të masës disiplinore “Pezullim nga detyra”. Rekomandimet u pranuan dhe ndaj tyre organi i Prokurorisë filloi ndjekjen penale, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ju dha edhe masën disiplinore “Vrejte”. Pas disa muajsh nga Prokuroria Ushtarake e qarkut Shkodër u njoftuam se hetimet për këtë çështje penale u pezulluan, për shkak se ankuesit nuk u paraqitën për tu pyetur, megjithse ishin njoftuar disa herë nga organi i Prokurorisë. Në fakt pezullimi i hetimeve për shkakun e përmendur më sipër, nuk është i bazuar në dispozitat e K.Pr.Penale.

4- Ankesa e shtetasit E. M., i cili pretendonte se në dt. 09.08.2002 rreth orës 19.30, është shoqëruar padrejhtësisht në Komisarriatin e Policisë Berat dhe është liruar në dt. 10.08.2002 në orën 11.00. Gjithashtu ai pretendonte se gjatë kohës që e kanë mbajtur të shoqëruar në Komisarriat, është keqtrajtuar barbarisht nga disa punonjës policie, të cilët e kanë goditur me pëllëmbë, grushta, shqelma, shkop gome dhe binarë druri në pjesë të ndryshme të trupit. Nga këto goditje atij i janë shkaktuar dëmtime të ndryshme trupore, dhe një çarje në kërcirin e këmbës së djathtë. Këto dëmtime ai i provonte me aktin e konstatimit të dëmtimeve nr. 108 dt. 12.08.2002, i përpiluar nga eksperti mjeko ligjor. Sipas ankuesit, nga goditjet e forta, në një moment ai ka humbur ndjenjat. Pasi është përmendur, për t'i shpëtuar keqtrajtimit të punonjësve të Policisë, ai ka tentuar të hidhej nga dritarja e katit të dytë, por nuk është lejur nga punonjësit e Policisë. Pas këtij veprimi, nga shqetësimi i krijuar, ka goditur me kokë tavolinën duke e çarë kokën dhe për pasojë ka patur edhe hemoragji. Me qënë se gjëndja shëndetsore e tij nuk ishte e mirë, ai është shoqëruar në spital për mjekim nga punonjësit e Policisë.

Nga verifikimi në vend që i bëmë kësaj ankesë rezultoi se ankuesi E. M. është shoqëruar në polici, nga oficeri i Policisë kriminale Ilia Gogo dhe policët Hamdi Nezha dhe Vasillaq Bano me urdhër të oficerit të Policisë kriminale Fatmir Varfi, sepse ishte person i dyshuar i vjedhjes së një banesë, ndodhur atë ditë në qytetin e Beratit. Në fakt, punonjësit e Policisë nuk kishin asnjë provë që të konfirmonin dyshimet ndaj tij për vjedhjen e banesës. Në Komisarriat ai është pyetur nga punonjësit e Policisë të cituar më sipër rreth vjedhjes së banesës, por nuk është provuar që ai të

ishte autori i saj. Nga pyetja e punonjësve të Policisë rezultoi se kur ankuesi është shoqëruar në polici ata nuk kanë konstatuar shënja dhunë në trupin e tij. Ata nuk pranuan që ta kishin keqtrajtuar atë, por dëmtimet trupore të tij i justifikuan se ai i kishte shkaktuar vetë, se gjatë kohës që ata e pyesnin, ai i binte tavolinës me kokë, se përplasej nëpër karrige e në dysheme etj.

Këto shpjegime nuk ishin bindëse për arsye se nuk përputheshin plotësisht midis tyre, por njëkohësisht nuk ishin bindëse edhe për dëmtimet e shkaktuara, si pjesët trupore në të cilat ishin shkaktuar, formën dhe madhësinë e tyre. Por edhe sikur ta marim të mirqënë faktin se ai i ka shkaktuar vetë dëmtimet, atëhere punonjësit e Policisë kanë përgjegjësi ligjore, sepse nuk duhet ta lejonin atë që të dëmtonte shëndetin në polici dhe në prezencën e tyre.

Shoqërimi i ankuesit në organin e Policisë ishte bërë në kundërshtim me nenin 45 të ligjit nr. 8553 dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe 27 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë që thote se: "Liria e personit mund të kufizohet, ... kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ...". Nga kqyrja e librit të shoqërimit të personave në organin e Policisë si dhe nga pyetja e tyre u provua se ankuesi ishte mbajtur i shoqëruar tej afatit ligjor të parashikuar nga neni 45 i ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit". Gjithashtu ushtrimi i dhunës ndaj tij u provua edhe nga akti i ekzaminimit mjeko-ligjor, kqyrja e fotografive, të bëra pas lirimit nga policia, të cilat ankuesi na i kishte sjellë së bashku me ankesën.

Me qënë se nga hetimi i kësaj ankesë rezultoi se nga punonjësit e Policisë të cituar më larte janë kryer veprime të kundërligjshme, duke konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i K.Penal, i rekomanduar Prokurorisë së rrethit Berat fillimin e procedimit penal ndaj oficerëve të Policisë Ilia Gogo dhe Fatmir Varfi si dhe ndaj policëve Hamdi Nezha dhe Vasillaq Bano. Rekomandimi u pranua dhe aktualisht çështja është në hetim nga Prokuroria Ushtarake e qarkut Vlorë.

5- Ankesa e shtetasve Z. I. dhe I. I., të cilët pretendonin se në dt. 01.10.2002, mbasdite, kanë qënë duke udhëtuar në unazë me makinën e tyre tip mikrobus. Në afërsi të Hotel "Mondial" ata janë goditur padrejtësisht nga një veturë Benz, me targë TR 2856 E. Pas përplasjes, shoferi i veturës ka dalë nga makina dhe pa ju prezantuar ka fyer ankuesit dhe ju ka kërkuar dokumentet. Me qënë se nuk e kanë njohur atë, ata nuk ja kanë dhënë dokumentet. Shoferi i veturës njoftoi me radio policinë, e cila erdhi aty pas pak minutash. Ankuesit i kanë thënë punonjësve të Policisë që

aty të vinin ekspertët e Policisë rrugore e të bënin kqyrjen e vendit të ngjarjes. Me urdhërin e drejtuesit të Benzit, që më pas ata mësuan se quhej Ervis Elezaj, me detyrë inspektor i Policisë kriminale në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë, janë shoqëruar në Komisaratin e Policisë nr. 2 Tiranë së bashku me automjetin e tyre. Ata pretendonin se në vendin ku ndodhi aksidenti janë fyer e goditur nga oficeri i Policisë Ervin Elezaj. Gjithashtu ata pretendonin se, në ambjentet e Policisë janë goditur prej tij me pëllëmbë, grushta e shqelma në pjesë të ndryshme të trupit. Sipas tyre, ai ka urdhëruar edhe policët që i shoqëruan për t'i goditur ata dhe dy prej tyre kanë goditur vetëm Zenelin.

Nga verifikimet që bëme rreth ankesës rezultoi se pretendimet e tyre për keqtrajtim u provuan edhe nga deklaratimet e dëshmitarëve okulare.

Me qënë se nga hetimi i kësaj ankesë rezultoi se nga punonjësi i Policisë Ervis Elezaj janë kryer veprime të kundërligjshme, duke konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i K.Penal, i rekomanduam Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimin e procedimit penal ndaj tij. Rekomandimi u pranua dhe çështja është në hetim.

6 - Ankesa e shtetasit A. P., i cili pretendonte se në datën 18.04.2002 është goditur me shqelma dhe pëllëmbë nga oficeri i Gardes së Republikës z. Besim Hasani.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë rezultoi se në dt. 18.04.2002 rreth orës 10.30 – 11.00 ankuesi së bashku me disa persona të tjerë, përfaqesues të Shoqatës së Paraplegjikëve kanë shkuar për të sqaruar një problem të shoqatës me Ministrin e Punës dhe të Çështjeve Sociale. Fillimisht ata kanë kontaktuar policin e shërbimit, i cili i ka orjentuar të takohen me punonjësen e dezhurnit të kësaj ministrie. Ata janë takuar me dezhurnin, të ciles i kanë njohur problemin që kishin. Ajo ju ka thënë që të prisnin në oborrin e Ministrisë se do të dilte një person për t'i sqaruar rreth problemit që kishin. Pas pak del nga godina e kësaj ministrie oficeri i Gardes së Republikës z. Besim Hasani. Ai ju drejtua atyre me kërcënime dhe fyerje të ndryshme nga nderi i familjeve dhe pa patur asnjë shkak ligjor ka qëlluar me pëllëmbë dhe shqelma ankuesin A. P.

Me qënë se nga hetimi i kësaj ankesë rezultoi se z. Besim Hasani me veprimet e tij kishte konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare të parashikuar nga neni 250 i K.Penal, i rekomanduam Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimin e hetimeve ndaj tij. Rekomandimi u pranua dhe më pas çështja i ka kaluar Gjykatës së rrethit Tiranë për gjykim.

7- Ankesa e shtetases M. K., banuese në qytetin e Tiranës, e cila pretendonte se në datën 03.09.2002 ora 20.30 punonjësit e policisë kanë kryer kontroll banesë dhe kanë shoqëruar në Komisarariat e Policisë nr. 2, bashkëshortin e saj B. K., duke e akuzuar për vjedhje të pasurisë (makina). Pas marrjes nga policia, ajo ka shkuar në mëngjez në polici dhe ka takuar bashkëshortin, të cilin e ka parë në gjëndje shumë të rëndë shëndetësore si rezultat i keqtrajtimit.

Duke vlerësuar me seriozitet këtë ankesë nga ana jonë në datën 05.09.2002 u takua dhe u pyet hollësisht i arrestuari, i cili ndërmjet të tjerave shpjegoi se:

Nga momenti që ai është futur në mjediset e Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë është rrahur në koridor dhe tek një zyrë nga pesë punonjës të Policisë të cilët ishin civile, kryesisht të moshes së re. Njëri prej tyre ishte me moshe mbi 50 vjeç dhe me mustaqe si edhe një tjetër me moshe rreth 35 vjeç, të cilët shokët i thonin "Rrushi". Gjatë gjithë kohës që punonjësit e Policisë e kanë keqtrajtuar të arrestuarin nuk përdornin emrat e tyre. I dëmtuari B. K. ju kishte kërkuar që të mos e keqtrajtonin, duke ju thënë se i mbante mend mirë fytyrat e tyre.

Punonjësit e Policisë e kanë qëlluar në pjesë të ndryshme të trupit, ku të mundnin jo vetëm me grushta e shqelma, por edhe me dru, bisht karrike. Gjatë natës, ai është mbajtur në korridorin e katit të parë pranë derës së dhomës së shoqërimit, në këmbë me një dorë në pranga dhe pjesa tjetër e prangave lidhur tek hekuri i derës.

Shtetasi B. K. ankohej edhe për faktin se, nga ana e punonjësve të Policisë është sugjestionuar për akuzën e vjedhjes dhe mbasi është shkruar prej tyre proces verbali përkatës, i është kërkuar ta firmose atë. Ai ju ka kërkuar që ta lexojë e pastaj ta firmoste, por është kërcënuar dhe qëlluar me grushta. në këto rrethana, i ndodhur nën presionin psikologjik dhe të dhunës fizike, ai e ka nënshkruar procesverbalin.

Gjithashtu ai pretendoi se, edhe proces verbali për kontrollin e banesës dhe dokumente të tjera që lidhen në marrjen dhe bllokimin e mjeteve, janë përpiluar në zyrat e Komisarariatit të Policisë.

Gjatë marrjes së deklarimeve nga ana jonë, i arrestuari B. K. ka demonstruar dëmtimet trupore, duke hequr teshat që mbante veshur. Në trupin e tij dalloheshin qartë shënja të nxira nga përdorimi i dhunës kryesisht në pjesët e prapme të trupit, në të dy shpatullat, në pjesët e këmbëve përpara, sidomos tek kofshët si edhe tek kyçet dhe shputat e këmbëve.

Duke analizuar në tërësi materialin e administruar, u konkludua se ish-in shkelur rregullat proceduriale nga punonjësit e Policisë dhe konkretisht:

Kërkesat e parashikuara në nenet 202 dhe 206 të Kodit të Proçedurës Penale, në të cilat përcaktohet qartë kushtet dhe koha për kryerjen e kontrollit të banesës.

Përdorimi i dhunës psikike dhe fizike, përbën shkelje të nenit 25 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë dhe figurën e veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare.

Për këto arsye i rekomanduam Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimin e hetimit ndaj punonjësve të policisë kriminale të Komisarariatit të Policisë nr.2 Tiranë, për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal. Rekomandimi u pranua, por padrejtësisht prokuroria e pezulloi hetimin me arsyetimin se “nuk njihen autorët” dhe e çoi dosjen për zbulim të autorëve po tek punonjësit e policisë kriminale të Komisarariatit të Policisë nr. 2 Tiranë. Pasi ky veprim u diktua nga Avokati i Popullit, Prokurori i Përgjithshëm e ka rifilluar hetimin, por shpresat për vënien para përgjegjesisë të fajtorëve janë të pakta.

8- Ankesa e 4 shtetasve G. B., etj, persona të dënuar, të cilët pretendonin se gjatë transportimit të tyre në datën 22.04.2002 nga Komisariami i Policisë Durrës në drejtim të Burgut 302 Tiranë, janë keqtrajtuar nga punonjësit e Policisë që i kanë shoqëruar.

Nga verifikimet që u bënë nga ana jonë rezultoi se:

Në datën 18.04.2002 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka lëshuar urdhërin e transferimit të 4 të dënuarve G. B. etj, nga Burgu Tepelenë për në Burgun 302 Tiranë, për arsye sigurie. Në Burgun 302 Tiranë, të dënuarit kanë qëndruar 2 ditë dhe pas kësaj me urdhër të Drejtorisë së Hetimit të Prokurorisë së Përgjithshme, janë transportuar për në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Durrës, për nevoja të hetimit.

Në Komisariatin e Policisë Durrës të 4 të dënuarit kanë qëndruar një natë dhe në ditën e nesërme janë transportuar në Burgun 302 Tiranë. Transporti i 4 të dënuarve nga Burgu i Tepelenës në drejtim të Burgut 302 Tiranë, dhe nga Komisariami i Policisë Durrës në Burgun 302 Tiranë, është realizuar me mjete dhe forca të Policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ndërsa transporti i tyre nga Komisariami i Policisë Durrës në Burgun 302 Tiranë është kryer me mjete dhe forca të Policisë së Shtetit, repartit ”R.E.N.E.A.”

Në deklaratimet e tyre, të katër të dënuarit sqaruan se, gjatë transportit, janë trajtuar në mënyrë korrekte nga ana e punonjësve të Policisë së Drejtorisë së Burgjeve.

Shqetësimi dhe ankesa e të dënuarve ishte ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë transportimit të tyre nga Komisariati i Policisë Durrës në drejtim të Burgut 302 Tiranë, në datën 22.04.2002. në këtë datë forcat e Policisë, 4 të dënuarit i kanë hipur në dy mjete tip "furgon" dhe konkretisht E. Y. dhe T. B. në një mjet, kurse G. B. dhe V. Y. në një mjet tjetër. Në çdo mjet ka patur deri në 6 policë, të cilët kanë qënë me maska e për rrjedhojë nuk u identifikuan nga të dëmtuarit, aq më tepër që të dëmtuarit i kishin sytë e zënë.

Sipas shpjegimeve të të katër të dënuarve, punonjësit e Policisë, ushtrimin e dhunës psikike dhe fizike e kanë filluar qysh në momentin e hipjes në automjete. Ata ju kanë vendosur secilit prej të dënuarve kokore në kokë, dhe me bluza të errëta ju kanë mbyllur sytë dhe më pas përdorur fjalë fyese në cënim të nderit të familjes dhe ushtruar dhunë fizike, duke qëlluar në pjesë të ndryshme të trupit me mjete të forta që mbanin në duar si, shkopinj druri dhe sende metalike. Dhuna ndaj tyre ka vazhduar për gjatë gjithë rrugës nga Durrësi në Tiranë, bile në momente të caktuara policët kanë ndaluar automjetet duke provokuar të dënuarit që të largoheshin, mbase me mendimin për të ndërmarre veprime asgjësuese ndaj tyre, me preteksin e "tentatives për të ikur".

Të dënuarit gjatë marrjes së shpjegimeve kanë demonstruar dhe treguar shënjat e dhunës të pasqyruara në pjesë të ndryshme të trupit, dhe në këto rrethana u kërkua kryerja e ekspertimit mjeko ligjor nga ekspertë specialistë të Mjekësisë Ligjore Tiranë.

Në konkluzionin e akt dëshmime mjekoligjore provohej përdorimi i dhunës ndaj ankuesve.

Në përfundim të hetimeve të bëra, rezultoi se nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët kanë realizuar transportin e të dënuarve nga Komisariati i Policisë Durrës për në Burgun 302 Tiranë, gjatë kryerjes së detyrës është ushtruar dhunë psikike dhe fizike duke prekur lirinë e shtetasve, veprime këto që formojne elementët e veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrarë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal. Mbi këtë bazë i rekomanduam Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimin e hetimeve për punonjësit e Policisë që bënë shoqërimin e ankuesve. Rekomandimi u pranua, por hetimet janë pushuar me arsyetimin se sipas nenit 4 të ligjit nr. 8292, dt. 25.02.1998 "Për forcat speciale dhe ato të ndërhyrjes së shpejtë" çdo pjestari të këtyre forcave i garantohet fshehtësia e identitetit personal, gjatë kryerjes së detyrës. Prandaj nga ana

jonë i është rekomanduar Komisionit parlamentar të të drejtave të njeriut të marrë inisjativën legjislative për përmirësimin e kësaj dispozitë, që të mos pengohet prokuroria për zhvillimin e hetimeve dhe vënien para përgjegjësisë të çdo polici që shkel ligjin dhe të drejtat e njeriut.

9- Ankesa e shtetasit D. P. me banim në Lezhë, i cili pretendonte për keqtrajtim nga punonjësit e Policisë të Komisarariatit Lezhë. Gjithashtu, për këtë rast u vume në dijeni edhe nga ana e Z. Pjeter Arbnori, Sekretar i Komisionit parlamentar i të drejtave të njeriut. Nga verifikimet në vend, që u bënë nga ana jonë rezultoi se:

Me datën 05.04.2002, rreth orës 22.00 Policia e Komisarariatit Lezhë kishte ndaluar shtetasin Z. P. për armë-mbajtje pa leje të organeve kompetente shtetërore. Këtij të fundit policia i kishte gjetur një pistolette TT me vete në momentin që po pinte kafe në një lokal. Mbas një orë policia kishte ndaluar edhe dy vëllezerit e tij, D. P. dhe G. P.

Nga kontaktimi dhe pyetja e të arrestuarëve Z. P. dhe D. P., ish të ndaluarit Gj. P., oficerit të Policisë gjyqësore, kqyrja e rregjistrit të dhomave të izolimit dhe atij të vizitave të mjekut të dhomave të izolimit, si dhe nga studimi i materialeve që ndodheshin në dosjen hetimore, u konstatua se ndaj të tre vëllezerve të sipërcituar ishte përdorur dhunë. Deri në datën 25.04.2002, ata nuk ishin ekzaminuar nga mjeku-ligjor dhe as nuk ishin vizituar nga ndonjë mjek tjetër, megjithëse e kishin kërkuar një gjë të tillë.

Raporti i shërbimit që mbante datën 05.04.2002 i nenshkruar nga pesë punonjës të Policisë dhe që kishte shërbyer si bazë për ndalimin e shtetasit D. P. dhe më pas si provë në gjykatë për të përligjur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, nuk pasqyrore të vërtetën. Në këtë raport theksohej se: “D. P. ishte shoqëruar në komisariatit të Policisë, për kundërshtim dhe kanosje të forcave të Policisë”. Faktikisht i ndaluarit dhe më pas i arrestuari D. P. nuk ishte kapur në flagrance, në kryerje e sipër të veprës penale, ose menjëherë mbas kryerjes së saj. Ai kishte shkuar vetë në komisariatit të Policisë për t’u interesuar se kush ishte shkaku i ndalimit të vëllait të tij. Kjo vajtje vullnetarisht është shfrytëzuar nga policia, e cila jo vetëm që e mbajti në komisariat, por e keqtrajtoi dhe më pas edhe e ndaloi atë.

Ne konstatuam se në këtë rast ishin shkelur rëndë liritë dhe të drejtat e tyre themelore, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare. Mbi këtë bazë i bëmë dy rekomandime Prokurorisë së Përgjithshme, duke sugjeruar që për D. dhe Gj. P., të mbahej qëndrim ligjor, duke ndërprere shkeljen e ligjit ndaj tyre, që të fitonin lirinë e humbur në mënyrë të paligjshme, pasi akuza në

ngarkim të tyre, për kundërshtim të forcave të rendit në bashkëpunim, nuk kishte asnjë bazë dhe mbështetje ligjore. Ndërsa për punonjësit e Policisë që kishin ushtruar dhunë dhe ata që kishin përpiluar raportin e shërbimit fiktiv të datën 05.04.2002, i rekomanduam të fillonte procedimin penal, për veprat penale të kryerjes së veprimeve arbitrare dhe kallzim të rremë, parashikuar si krime nga nenet 250 e 305 të Kodit Penal.

Njëkohësisht u rekomandua që të fillonte procedimi penal ndaj oficerit të policisë gjyqësore z. Martin Dona për veprën penale “te mosmarrjes së masave për të ndërprere gjëndjen e paligjshme”, parashikuar si krim nga neni 251 K.Penal, sepse ky ishte në dijeni të plotë se shtetasi D. P. ishte paraqitur vetë në komisariat dhe se nuk ishte kapur në flagrance. Ndjekje penale për të njëjten vepër penale, u kërkua edhe ndaj prokurorit të çështjes z. Bujar Cici, i cili u vu në dijeni dhe i pa shënjat e dhunës në trupin e të tre të ndaluarve, të cilat ata ja bënë prezent që në momentin që ai i mori me cilësinë e të pandehurit, si dhe në seancën gjyqësore të caktimit të masave të sigurimit në gjykatë. Si prokurori ashtu edhe gjyqtari nuk kanë mbajtur qëndrim ligjor për të ndërprere gjëndjen e paligjshme, konform nenit 257 të K.Pr.Penale, për të liruar menjëherë të ndaluarit dhe të arrestuarit e cituar më sipër.

Rekomandimi për fillimin e procedimit penal ndaj punonjësve të Policisë u pranua, ndërsa ai për fillimin e procedimit penal ndaj prokurorit u refuzua padrejtësisht.

Duhet të theksojmë se me vendim gjyqësor të formës së prere, të Gjykatës së Apelit Shkodër, të arrestuarit për akuzën e kundërshtimit me dhunë në bashkëpunim ndaj forcave të rendit, u deklaruan të pafajshëm.

II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme nga policia

Kanë qënë 87 ankesa për veprime arbitrare, të punonjësve të policisë si kontrole banesë, lokale dhe fizike, sende të sekuestruara nga policia, arrestime, ndalime dhe shoqërime të paligjshme, etj. Si raste të vërtetimit të ankesave mund të përmëndim:

1- Ankesat e shtetasve P. T. dhe R. Gj., të cilët pretendonin se fëmijët e tyre, të quajtur E. T. dhe N. Gj., ishin marrë padrejtësisht nga policia në dt. 07.01.2002 dhe pasi ishin keqtrajtuar nga punonjësit e Policisë të Komisarariatit Vlorë, Vladimir Zani dhe Muço Aliaj, ishin arrestuar.

Nga verifikimet që i bëmë këtyre ankesave, nuk mundem të provojmë pretendimet e ankuesve për keqtrajtimin e fëmijëve të tyre, por nga kqyrja e librit të shoqërimit të shtetasve në organin e Policisë Vlorë rezultoi se:

Në faqen nr. 67 të tij, me numër rendor 7, në dt. 07.01.2002, ora 21.50, figuron i rregjistruar shtetasi N. Gj., i cili është ndaluar në dt. 08.01.2002, ora 18.55. në po këtë faqe të librit, me numër rendor 8, në dt. 07.01.2002, ora 21.55, figuron i rregjistruar shtetasi E. T., i cili është ndaluar në dt. 08.01.2002, ora 18.55. në libër rezulton se me të ndaluarit kanë punuar oficeri i Policisë Vladimir Zani dhe inspektori i Policisë së rendit Muço Aliaj. Pra, nga kqyrja e librit provohet se, të dyshuarit për vjedhje janë mbajtur të shoqëruar tej afatit ligjor të parashikuar në nenin 45 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

Për këtë shkelje ligjore të bërë nga punonjësit e Policisë Vladimir Zani dhe Muço Aliaj në dëm të shtetasve E. T. dhe N. Gj. i rekomanduar Drejtorit të Policisë të qarkut Vlorë dhënien e masës disiplinore "vrejtje me paralajmerin" ndaj tyre dhe komunikimin e saj para efektivit me qëllim parandalimin e shkeljeve të tilla në të ardhmen. Rekomandimi u pranua.

2- Ankesa e shtetasit minoren, 13 vjeçar, J. S., i cili pretendonte se në dt. 08.03.2002, ishte kapur duke vjedhur disa çelësa makine në teritorin e shkolles pedagogjike dhe më pas ishte shoqëruar në Komisarariat e Policisë nr. 1 Tiranë. në komisarariat ishte shoqëruar rreth orës 11.30 nga një grup policësh me në krye inspektorin e Policisë kriminale z. Ergys Lala. Ankuesi pretendonte se pasi ishte shoqëruar në polici ishte pyetur nga z. Ergys. gjatë pyetjes ai ishte fyer prej tij, ishte goditur dhe më pas ishte mbajtur në një dhomë të mbyllur me kyç me disa persona të tjerë madhorë. Mbase në polici kanë ardhur prindërit e tij, në prezencë të tyre ishte mbajtur procesverbali me shkrim dhe rreth orës 20 ishte liruar.

Nga verifikimet që i bëmë kësaj ankesë, rezultoi se shtetasi minoren, J. S., i datëlindjes 23.03.1989 ishte kapur rreth orës 11.00, të dt. 08.03.2002 duke vjedhur së bashku me tre fëmijë të tjerë disa vegla në një makine në territorin e shkolles pedagogjike. Pasi ishte kapur nga roja, ai ishte pyetur nga drejtoresha e konviktit të kësaj shkolle, e cila më pas ka njoftuar Policinë. për të marrë atë ka shkuar grupi i gatshëm i Policisë me makine dhe vetë inspektori i Policisë kriminale të zones z. Ergys Lala, i cili ka sekuestruar provat materiale dhe ka bërë shoqërimin e Jurfjonit në polici. Sapo ka mbërritur në polici, e ka marrë në zyrën e tij dhe e ka pyetur verbalisht për gjeneralitetet dhe për ngjarjen e ndodhur. Pasi i ka marrë gjeneralitetet dhe adresen është vene në kërkim të prindërve të tij, duke i telefonuar e shkuar në banesë. Me qënë se nuk i ka gjetur ata, ai i ka lënë porosi komshinjëve të tij, që menjëherë sapo të vinin prindërit e Jurfjonit, t'i njoftonin se ai ishte në polici dhe të paraqiteshin në Komisarariat e Policisë nr. 1. Kur ata kanë ardhur në banesë, në orët e mbasdites, janë njoftuar nga komshinjtë dhe kanë shkuar në polici. Ata janë takuar me z.

Ergys dhe në prezence të tyre është mbajtur edhe procesverbali i pyetjes me shkrim të djalit dhe më pas në orën 19.00 ai është lënë i lirë, duke jua dorëzuar atë prindërve të tij.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankesë konstatoam se veprimet e oficerit të Policisë Ergys Lala ishin të kundraligjshme sepse:

1. Marja, pyetja dhe mbajtja në organin e Policisë të ankuesit nga ora 11.00 deri në orën 19.00 është e paligjshme, mbasi ai është minoren dhe nuk mund të mbahet në polici.

2. Pyetja e tij, në momentet e para, pa praninë e një familjari ose të një specialisti të fushës së edukimit të fëmijëve, përbën shkelje të pikës 5 të nenit 361 të K.Pr.Penale, që parashikon se, pyetja e dëshmitarëve të mitur behet në prani të një familjari të te miturit ose të një specialisti të fushës së edukimit të fëmijëve.

3. Gjithashtu, mbajtja në një dhomë të mbyllur me çelës dhe se bashku me dy persona madhorë, ndonese për 20 minuta, përbën shkelje të rëndë ligjore dhe konkretisht të pikave 1 dhe 3 të nenit 54 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Fëmijët, të rinjtë, ... kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi...” dhe të pikës 2 të nenit 27 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, që thote se: “Gjatë përmbushjes së detyrës punonjësit të Policisë nuk i lejohet të kryejë ndaj individëve veprime të pabazuara në ligj, ndeshkime ose trajtime çnjerëzore apo denigruese si dhe çdo lloj torture”.

Mbi këtë bazë i rekomandoam Drejtorit të Policisë së qarkut Tiranë, që ndaj oficerit Ergys Lala të jepte masë disiplinore dhe ajo t'i komunikohet para efektivit. Rekomandimi u pranua.

3- Ankesa e shtetasit A. D., i cili pretendonte se është mbajtur padrejtësisht katër ditë në Komisariatit e Policisë Durrës nga dt. 17.04.2002 deri në dt. 21.04.2002.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë rezultoi se ai është shoqëruar në organin e Policisë me urdhër të Shefit të Zyrës së Krimeve të Renda në Drejtorinë e Policisë së qarkut Durrës z. Dajlan Canaj si i dyshuar në bashkëpunim për vrasjen e një shtetasi ndodhur në dt. 16.04.2002 në Katund Sukth të rrethit Durrës. Më pas është qartësuar pozicioni i tij dhe është pyetur me cilesinë e dëshmitarit dhe në dt. 21.04.2002 është bërë edhe sigurimi i provës në Gjykatën e rrethit Durrës. Megjithëse nga ana jonë nuk mundem të vertetonim pretendimin e ankuesit për mbajtjen katër ditë në organin e Policisë. Konstatoam se gjatë veprimeve me ankuesin, nga ana e oficerit Dajlan Canaj është shkelur pika 4 e nenit 45 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 ”Për Policinë e Shtetit” si dhe pika 5 e udhëzimit nr.

168, dt. 20.10.1993 të Ministrit të Rendit Publik “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në komisariate, reparte, posta policie dhe zyra të tjera të tyre”, sepse ankuesi nuk ishte rregjistruar në librin e personave të shoqëruar.

Duke patur parasysh edhe vlerësimin pozitiv të mëparshëm të punës së z. Dajlan Canaj, për shkeljen ligjore të kryer, i rekomanduam Drejtorisë së Policisë së qarkut Durrës dhënien e masës disiplinore ndaj tij dhe komunikimin e saj para efektivit. Rekomandimi u pranua.

4- Ankesa e shtetasit P. O. banor i fshatit Belorta të rrethit Korçe. Ai pretendonte se nga fundi i vitit 1999 ose fillimi i vitit 2000 inspektori i Policisë së rendit të Komisarariatit të Policisë Korçe Njazi Xite i ka shoqëruar djalin e tij të mitur, të quajtur S. O., në polici. Shoqërimit e kishte bërë sepse ai ishte zënë me një djalë tjetër, bashkëmoshatar të tij. Ankuesi për t’u interesuar për djalin kishte shkuar në shtëpinë e punonjësit të Policisë Rajmondi Duro, me të cilin kishin “miqësi” dhe të dy së bashku kanë shkuar dhe kanë takuar inspektorin Njazi Xite. Rajmondi dhe Njaziu pasi hyne në Komisarariat dolën dhe Rajmondi i ka thënë ankuesit se, që të mbyllet kjo punë duheshin 1.200.000 (një milion e dyqindë mijë) dhrahmi. Ankuesi i ka thënë atij se janë shumë dhe nuk kam ku t’i gjej ato. Pas kësaj, Rajmondi i ka thënë, se për ty do ta mbyllem me 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) dhrahmi. Rajmondi e ka pyetur atë në se kishte lekë me vete, por ai i ka thënë se nuk kishte. Pastaj Rajmondi i ka thënë që të shkonte në shtëpinë e tij dhe t’i merrte nënës së Rajmondit 200.000 (dyqindë mijë) lekë të vjetra borxh, sepse do të duheshin për të mjeku ligjor. Ankuesi ka shkuar tek shtëpia e Rajmondit dhe i mori nënës së tij 200.000 lekë të vjetra, borxh me prerje 1 x 5000 dhe 30 x 500. Ai së bashku me të dy punonjësit e Policisë, Njaziun dhe Rajmondin kanë shkuar tek mjeku ligjor. Rugës Rajmondi i ka thënë që jepi 100.000 (njëqindë mijë) lekë Njaziut, por Njaziu i ka thënë se bolla janë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Ankuesi dhe Njaziu kanë hyre të dy së bashku tek mjeku ligjor, por aty ka mësuar se tek ai nuk kishte ardhur ndonjë dokument apo ankesë për djalin e tij. Në këto momente Njaziu i ka bërë shënjë me sy dhe me kokë ankuesit që të dilte jashtë. Ai ka dalë dhe ka shkuar në makine tek Rajmondi. Më pas ka ardhur Njaziu, i cili ju ka thënë se ja hodha në sirtar lekët mjekut. Në darke Njaziu ka shkuar në shtëpinë e ankuesit dhe i ka çuar djalin, të cilin e kishte marrë një ditë më parë. Sapo ka shkuar atje, Njaziu e ka pyetur ankuesin se kush ishte në shtëpi. Me qënë se ka mësuar se aty kishte një rrez të tjerë, i ka thënë që të hynin në dhomën tjetër dhe mos t’i thoshte njeriu. Pasi kanë hyre në dhomë, ka ardhur gruaja e ankuesit për ta qerasur, por Njaziu i ka thënë se po e priste Rajmondi tek ura në Belorta, prandaj për ta mbyllur këtë punë, hetuesi donte 80.000 (tetëdhjetë mijë) dhrahmi,

ndërsa për atë të jepte sa të donte. Ankuesi e ka pyetur në se çështja do të mbyllej komplet, ndërsa Njaziu i ka thënë që të mos e diskutonte me këtë problem. Ankuesi së bashku me gruan e tij kanë nxjerë 80.000 dhrami "për hetuesin" dhe 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë të vjetra për atë dhe ja ka dhënë Njaziut. Pasi mori lekët, Njazinë e ka përcjellë djali i ankuesit. Të nesërmen ankuesi ka shkuar në shtëpinë e Rajmondit dhe i ka dhënë të jëmës së tij 200.000 lekët e mara borxh dhe 50.000 lekë të vjetra për Rajmondin për "nderin" që i kishte bërë. Më pas ankuesi ka punuar në shtëpinë e Rajmondit për dy javë pa lekë, duke menduar që i kishte bërë "nder" për lëshimin e djalit dhe mbylljen e problemit të tij.

Pas disa muajve, Njaziu ka takuar ankuesin dhe i ka thënë se e kërkon prokuroria për problemin e djalit. P. O. është irrituar dhe i është përgjigjur se, "ju kam dhënë 500.000 – 600.000 lekë dhe nuk ma mbyllët problemin e tij". Pas kësaj bisede, ai ka shkuar në prokurori dhe pasi ka mësuar se problemi i djalit nuk ishte mbyllur, ka shkuar në Drejtorinë e Policisë Korçe dhe ka bërë ankim tek Shefi i Rendit zoti Refat Shkëmbi. Zoti Refat ka bërë ballafaqimin midis punonjësve të Policisë dhe ankuesit, i cili jua ka thënë në sy të gjitha pretendimet e mësipërme, por ata nuk kanë pranuar. Pas dy-tre muajsh ankuesi është thirrur në zyrë nga Refati, i cili i ka kthyer atij 80.000 dhrahmite, ndërsa për 150.000 lekë të vjetra i ka thënë se do t'ja jepte më vone, por në fakt nuk ja ka dhënë ato. Me qënë se ankuesi nuk i mori lekët ai ka bërë ankesë tek ish Drejtori i Policisë së qarkut z. Pellumb Molla.

Pas ankesës tek Drejtori i Policisë, është bërë një analizë e saj, por në mënyrë të përcipte. Megjithëse është arritur në konkluzionin se nga punonjësit e Policisë është ulur figura morale, në përfundim është vendosur të shkarkonin nga detyra dy punonjësit e Policisë, duke i emëruar ata si punonjës të thjeshtë policie. Pas kësaj dy policët kanë vazhduar ta shqetësonin ankuesin, aq sa ai në letrën drejtuar Avokatit të Popullit shprehej se "Ose do vriste policët ose do vriste veten". Ankesa e tij u vlerësua maksimalisht dhe nga verifikimet që kemi bërë në vend rreth kësaj ankesë dhe pyetja e personave që lidhen me të rezultoi se:

Punonjësi i Policisë Njazi Xite nuk pranon të këtë shkuar në shtëpinë e ankuesit për rastin e përmendur më sipër, të këtë marrë para për mbylljen e problemit, si dhe t'i këtë dhënë dhrahmi Shefit të Rendit për t'ja kthyer ankuesit.

Punonjësi i Policisë Rajmondi Duro pranon faktin se është interesuar në polici së bashku me ankuesin për problemin e mësipërm. Sipas tij, pas dy orësh ankuesi e ka takuar atë dhe i ka thënë atij, se për të nxjerë djalin nga policia i duhen 200.000 lekë të vjetra, por nuk kishte me vete.

Rajmondi i ka thënë ankuesit që të shkonte në shtëpinë e tij dhe t'i merte nënës së tij lekë borxh. Ankuesi ka shkuar në shtëpinë e Rajmondit dhe i ka marrë lekët. Gjithashtu ai ka shpjeguar se, me qënë se ankuesi ishte ankuar në polici, atë e kishin levizuar nga detyra. për këtë ai e ka kallzuar P. për shpifje për shkak të detyrës dhe në përfundim të gjykimit është vendosur "Deklarimi fajtor i P. O. dhe dënimi i tij me 50.000 gjobe".

Ish Shefi i Policisë së Rendit, aktualisht Shefi i Policisë me Uniformë në Drejtorinë e Policisë Korçe z. Refat Shkëmbi ka shpjeguar se ai e njihte problemin dhe se për këtë ka thirrur ish inspektorin e Policisë së rendit Njazi Xite. Njaziu i ka pranuar atij se i ka marrë dhrahmite, jo si rushfet, por ja ka marrë borxh ankuesit dhe se akoma nuk ja kishte kthyer, sepse nuk i kishte siguruar ato. Pas disa ditësh Njaziu i ka dhënë atij 80.000 dhrahmi, të cilat ai ja ka kthyer ankuesit P. O. për këtë problem, ulje të figurës morale të punonjësit të Policisë, emërtesa e drejtorisë ka vendosur shkarkimin nga detyra të Njazi Xites, duke e kaluar atë në punonjës të thjeshtë policie.

Fakti që z. Njazi Xite ka shkuar në shtëpinë e ankuesit dhe ka marrë para, dhrahmi dhe lekë, për mitmarrje, u provua edhe nga procesverbalet e pyetjes e shtetasve D. O. dhe S. L.

Megjithëse Rajmondi Duro e kishte kallzuar ankuesin për shpifje dhe gjykata e ka dënuar atë, ai nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia disiplinore dhe penale. Kjo, për faktin se nga shpjegimet që Rajmondi na ka dhënë, provohet në mënyrë të plotë, se në kundërshtim me detyrën e tij, ai e ka nxitur dhe ndihmuar ankuesin që të jepte mite për mbylljen e problemit të djalit të ankuesit.

Me qënë se nga hetimi i kësaj ankesë, rezultoi se nga punonjësit e Policisë Njazi Xite dhe Rajmondi Duro janë kryer veprime të kundërligjshme, duke konsumuar elementët e veprës penale të marrjes së mites, të parashikuar nga neni 260 i K.Penal, i rekomanduar Prokurorisë së rrethit Korçe fillimin e procedimit penal ndaj z. Njazi Xite, i cili u pranua dhe mbas përfundimit të hetimeve çështja i ka kaluar gjykatës për gjykim. Gjithashtu i rekomanduar Drejtorisë së Policisë së qarkut Korçe të përjashtonte ata nga Policia e Shtetit për shkelje të betimit, duke kryer veprime të kundërligjshme dhe në kundërshtim me nenin 26, pika 1 e ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe me rregullin 6, pika 4 të Rregullores së Disiplinës të Policisë së Shtetit. Ky rekomandim u pranua pjesërisht, vetëm duke pezulluar nga detyra z. Njazi Xite. Pas kësaj përgjigjeje, i kemi rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të marrë masat e duhura për zbatimin e tij.

5- Ankesa e shtetasit Sh. T., president i shoqërisë anonime “Klajda” SHA, me arsim të lartë, me profesion inxhiner ndërtimi, i cili pretendonte se më datën 26.02.2002, nga rreth 30 policë i ishte kontrolluar banesa, dhe nga kjo datë deri në datën 03.03.2002, në mënyrë të paligjshme ishte mbajtur i izoluar në Drejtorinë e Prefekturës Tiranë, si dhe në Komisariatin e Policisë Gjirokaster. Njëkohësisht pa asnjë bazë ligjore ishte marrë i pandehur nga Prokuroria e rrethit Gjirokaster, duke u akuzuar për prodhim dhe tregtim të lëndëve narkotike. Si shkak për këto akuza kishte shërbyer bllokimi në pikën kufitare doganore greke të Kakavijes, i automjetit me targë KJ 3548 A, në të cilin ishte gjetur një sasi lende narkotike. Sipas tij, këtë automjet e kishte shitur para një viti dhe se nuk kishte asnjë lidhje me të, si dhe nuk mbante asnjë përgjegjësi për veprimet që mund të kryheshin me të, pasi qysh para një viti kishte denoncuar zyrtarisht në Komisariatin e Policisë Kavajë dhe doganen e Kakavijes që ky automjet të bllokohej se qarkullonte me dokumente dhe pronësi jo reale. Kërkesën e fundit për ta bllokuar këtë automjet e kishte përseritur në organet kompetente shtetërore edhe në datën 22.05.2001, kur ishte vene në dijeni se ky automjet kishte bërë aksident në Greqi, në datën 09.04.2001. Rreth pronësisë së tij, ishin kërkuar sqarime në Degen e INSG-ut Kavajë dhe zyrën e kartonit jeshil Tiranë, të cilat ai i kishte sqaruar se ky automjet nuk i përkiste shtetasit Sh. T. por i ishte shitur shtetasit A. A. me banim në Gjirokaster.

Nga studimi i materialeve që ndodheshin në dosjen hetimore, si dhe nga dokumentat e grumbulluara, dilte plotësisht e qartë dhe e dokumentuar se ankuesi Sh. T. nuk kishte asnjë lidhje me automjetin e bllokuar me lende narkotike dhe as me drejtuesin e tij. Ky automjet ishte shitur realisht prej tij, para një viti. Nga ana e tij, ishin bërë kërkesa zyrtare prane organeve shtetërore para një viti, të cilat i dispononte Komisarjati i Policisë Kavajë dhe Gjirokaster. Në to, ai i kërkonte këtyre organe që ky automjet të bllokohej, pasi bleresi i ishte shmangur në mënyrë të qëllimshme, bërjes së dokumentave të shitjes. Nga ana e ankuesit, nuk ishte kryer ndonjë veprë penale, por vetëm se ishte ngatërruar padrejtësisht emri i tij, me qënë se bleresi nuk e kishte ndryshuar pronësinë dhe targën, gjë që dilte plotësisht e sqaruar dhe dokumentuar.

Në këto rrethana kur çdo gjë ishte plotësisht e qartë, prokurori i rrethit Gjirokaster z. Adnan Xholi, duhet të kishte zbatuar nenin 257 të K.Pr.Penale duke urdhëruar lirimin e menjëhershëm të ankuesit, aq më tepër që prej dy ditësh mbahej i izoluar pa dokumenta. Prokurori jo vetëm që nuk bëri këtë, por urdhëroi ndalimin zyrtar të tij, më datën 28.02.2002, për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve në bashkëpunim, të parashikuar si krim nga neni 283 dhe 25 K.Penal. në datën 02.03.2002 e

kishte derguar në Gjykatën e rrethit Gjirokaster, për caktimin e masës së sigurimit, duke kërkuar arrest në burg pa afat.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Gjirokaster, me vendimin Nr 17 datë 03.03.2002, kishte vendosur si masë sigurimi ” Detyrim për paraqitje në Policinë gjyqësore, çdo të hene ora 10.00, duke arsyetuar në vendim: ”Nga të gjitha aktet e grumbulluara nga organi i Prokurorisë, vërtetohen plotësisht pretendimet e të pandehurit për faktin, që ky i pandehur nuk ka asnjë lidhje me veprën penale që pretendohet nga prokurori. Pra, mbi këtë të pandehur nuk ekziston asnjë dyshim ligjor që të bazohet ndonjë provë e cila të jetë provë sipas përcaktimit të Kodit të Proçedures Penale, si dhe të jetë marrë si provë në një nga format e parashikuara në K.Pr.Penale.”

Kundër këtij vendimi, prokurori i rrethit kishte bërë kërkesë ankimore në Gjykatën e Apelit Gjirokaster, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së rrethit dhe caktimin si masë sigurimi për të pandehurin Sh. T., ”arrest në burg pa afat”.

Ne datën 10.07.2002, Gjykata e Apelit mori në shqyrtim çështjen e mësipërme dhe në këtë seance prokurori i Apelit e terhoqi kërkesën ankimore të bërë nga Prokurori i rrethit, e për rrjedhojë mbeti në fuqi vendimi i Gjykatës Rrethit.

Duhet theksuar se në dosjen e Prokurorisë edhe pas tre muajsh hetimi, në korrik 2002 nuk u gjend e dokumentuar ndonjë kërkesë e bërë nga ana e saj, për Komisaratin e Policisë Kavajë dhe atë të Gjirokastres, për të verifikuar në se qëndronin pretendimet e Sh. T., të deklaruara që në datën 26.02.2002. Ai kishte kërkuar prane këtyre organeve rreth një vit më parë, bllokimin e këtij automjeti, dhe kopjet e kërkesave i dispononte dhe jua kishte paraqitur drejtuesit të komisarimit Kavajë dhe zëvendës drejtorit të Drejtorisë së Policisë qarkut Tiranë z. Sokol Bizhga, si dhe drejtuesit të Prokurorisë së rrethit Gjirokaster, para se të behej ndalimi i tij. Njëkohësisht në dosjen hetimore nuk u gjend e administruar, kërkesa e derguar nga Komisarati i Policisë Kavaje, në Komisaratin e Policisë Gjirokaster, me Nr 834 datë 23.05.2001, që bënte fjalë për sa u fol më lart. Nga verifikimi që u bë nga ana jonë, rezultoi se kjo shkresë ndodhej prane Komisarimit të Policisë Gjirokaster, me këtë përmbajtje: ”Ne bazë të kërkesës së ardhur nga firma ”Klajda” SHPK me ane të përfaqesuesit të saj z. Sh. T., e cila ka patur në pronësi të saj një automjet autobot gazi, të markes Fiat Iveko, me targë KJ 3548 A. Këtë automjet ja ka shitur qytetarit A. A. nga rrethi i Gjirokastres dhe në mirbesim ju la që të bënin aktin e shitblerjes dhe ndërrimin e targave, por kjo gjë nuk ishte bërë e mundur. për këtë problem firma ”Klajda” SHPK në datë 08.02.2001 i ka bërë një kërkesë pikës së kalimit kufitar Kakavijë për bllokimin e këtij mjete deri në

nderrimin e pronësisë dhe targave, por deri më sot nuk ka marrë asnjë përgjigje. për këtë arsye ju kërkujme që të behet bllokimi i automjetit deri sa të behen veprimet e duhura”.

Mos administrimi në dosje i një dokumenti të tillë, që ishte deçiziv për çështjen penale dhe për qëndrimin që duhej të mbahej ndaj Sh. T., në momentin para se të ndalohej, dhe pas ndalimit e marrjes si të pandehur, megjithëse kishin kaluar disa muaj nga fillimi i procedimit penal, nuk tregonte aspak qëndrim objektiv dhe ligjor nga Policia dhe Prokurori i Gjirokastrës, por këmbëngulje të qëllimshme për ta mbajtur nën presion atë dhe persona të tjerë, gjë e cila dukej edhe me kërkesën ankimore të bërë në Gjykatën e Apelit që me çdo kusht ndaj Sh. T. të caktohej si masë sigurimi ajo e arrestit në burg pa afat. Këtë e përforconte edhe fakti, që përveç ankuesit, për këtë problem ishte ndaluar dhe marrë me cilesine e të pandehurit për të njëjten akuzë edhe vëllai i tij, D. T., i cili shkoi vetë në Drejtorinë e Policisë së qarkut Tiranë, për t’i derguar ushqime të vëllait, si dhe ndalimi dhe marrja i pandehur i shtetasit Q. B., i cili kishte dy vjet që ishte larguar nga firma ”Klajda”, tek e cila kishte punuar në detyrën e shoferit, gjë e cila u ishte bërë e qartë dhe dokumentuar, para se këtë të fundit ta ndalonin.

Njëkohësisht duhet theksuar, se drejtuesit e Policisë të Komisarariatit Kavaje, ata të Drejtorisë së Policisë së qarkut Tiranë si dhe ata të Komisarariatit të Policisë Gjirokastrës, e kishin plotësisht të qartë dhe të dokumentuar se Sh. T. nuk kishte asnjë lidhje me makinën e bllokuar në doganen greke. Ishte neglizhenca e tyre që nuk e kishin bllokuar këtë makine që para një viti se të ndodhte ngjarja, megjithëse kishin kërkesë zyrtare për një gjë të tillë. Këtë ndalim të paligjshëm e trumbetuan si sukses të Policisë, ku në gazetën ”Korieri” të datës 28.02.2002 shkruhej me germa të medha: ”Prangosen katër pronaret e vërtetë të droges të kapur në doganen greke të Kakavijes. Vëllezerit D. T dhe Sh. T. si dhe Q. B. e A. M. janë kapur pas një aksioni perfekt të një grupi hetimor të Drejtorisë së Policisë Gjirokastrës”.

Nga sa u trajtua më lart, në rastin e ndalimit të shtetasve, Sh. e D. T. dhe Q. B., nuk ekzistonin asnjë nga kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal, të parashikuara nga neni 228 i K.Pr.Penale. për rrjedhojë ndalimi i tyre ishte i paligjshëm, dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 253 të K.Pr.Penale.

Edhe fillimi i ndjekjes penale ndaj tyre dhe mbajtja me cilesine e të pandehurit edhe sot e kësaj ditë, është e paligjshme dhe shkelje e rëndë e lirive dhe të drejtave të tyre themelore, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet nderkombetare.

Për sa më sipër, ju rekomandua Prokurorit të Përgjithshëm, që ndaj prokurorit të çështjes z. Adnan Xholi, të merrej masë disiplinore, pasi nuk kishte mbajtur qëndrim ligjor për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme, për të liruar menjëherë të ndaluarit pa prova, Sh. e D. T. dhe Q. B., konform nenit 257 të K.Pr.Penale dhe për fillim të paligjshëm të procedimit penal që kishte bërë ndaj tyre. Ndersa për të pandehurit e lartpërmendur ju sugjerua që nepërmjet zbatimit të kompetencave ligjore, të bënte të mundur ndërprerjen e shkeljes së ligjit ndaj tyre, duke u pushuar akuzën, në bazë të nenit 328 germa "dh" të K.Pr.Penale.

Megjithë interesimin tonë të herpashershem, na është kthyer përgjigje në shkurt 2003 nga Prokurori i Përgjithshëm, se nuk e gjykon të arsyeshme të marrë masa ndaj prokurorit Adnan Xholi.

6- Ankesa e shtetasit Gj. B., banor i qytetit Durrës, i cili ankohej lidhur me mos shpërblimin e dëmit material nga ana e Komisarariatit të Policisë Burrel. Sipas tij, më dt. 30.09.1999 duke qënë për punë në qytetin e Burrelit me automjetin e tij, në orën 22.30 është marrë me forcë nga ana e Policisë dhe është vene në dispozicion të saj për të kapur një bande kriminelesh. Mbasi ka udhëtuar për rreth 15 kilometra së bashku me disa policë me kamionin e tij, ata janë goditur me bresheri armësh nga banda dhe për pasojë kanë ngelur të plagosur dy policë dhe një civil që ishte me ta. Nga këto goditje, makines së tij i është shkaktuar dëm material. Midis të tjerash i është thyer edhe xhami i parël i makines, zëvendesimi i të cilit i ka kushtuar 180.000 lekë. Si rezultat i dëmit të shkaktuar, makina ndodhet jashtë gjëndjes për punë. për të shpërblyer dëmin e shkaktuar si rezultat i vënies në dispozicionin e Policisë, ai i është drejtuar disa herë me kërkesa Komisarariatit të Policisë Burrel dhe institucioneve të tjera qëndrore, por nuk ka mundur që ta zgjidhe këtë problem.

Sipas përgjigjeve të datave 21.02.2000 dhe 28.02.2000, që i janë kthyer ankuesit, rezulton se policia e konfirmon faktin që e ka marrë atë së bashku me automjetin për nevoja punë të komisarariatit dhe se e njeh dëmshpërblimin, por i thone se kur të zbulohen autorët do ta dëmshpërblejne ose për ndryshe t'i drejtohet organeve të drejtësisë. Ndersa nga përgjigjia e dt. 16.05.2000 që i është dhënë nga Shefi i Sektorit të Policisë Rrugore të M.R.Publik z. Gezim Liçaj, i është thënë se nga ana Komisarariatit të Policisë Mat duhet të çohet dosja e kompletuar e operacionit të zhvilluar prej tij në M.R.Publik, me qëllim që të miratohet një fond i veçantë për dëmshpërblimin e tij.

Ne gjykojmë se përgjigja e Shefit të Komisarariatit të Policisë Burrel, "se do ta dëmshpërblejne kur të zbulohen autorët ose për ndryshe të shkojë në organet e drejtësisë", nuk është korrekte dhe ligjore sepse: së pari, ai

është dëmtuar duke u vene në shërbim të Policisë; së dyti, kompesimin në bazë të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" e bën Policia dhe jo të tretet; së treti, kompesimi i tij nuk përfshin vetëm dëmin e shkaktuar, por edhe punën dhe shpenzimet që ai ka bërë gjatë vënies në dispozicion të Policisë, si dhe fitimin e munguar; së katërti, nuk është dinjitoze për organin e Policisë që të sorollatë shtetasit që kontribuojnë për të.

Për të realizuar të drejtën e ankuesit i rekomandua Komisarariatit të Policisë Burrel dhe Drejtorisë së Policisë së qarkut Dibër që të plotësonin sa më shpejtë praktiken që lidhet me këtë problem, t'ja dergonin atë M.R.Publik, duke bërë edhe kërkesë për çeljen e fondit për dëmshpërblimin e ankuesit. Rekomandimi u pranua dhe problemi është drejt zgjidhjes.

7- Ankesa e shtetasit I. D., i cili pretendonte se nga ana Drejtorisë së Policisë të qarkut Tiranë, në dt. 21.11.2002 i është sekuestruar automjeti që ai ka në përdorim, tip Audi A 6, me targë M-W 1770. Sipas tij, makina është pronë e një firme gjermane në të cilën ai është i punësuar dhe se ajo e ka dokumentacionin plotësisht të rregullt. Gjithashtu ai pretendonte se nuk ka kryer asnjë shkelje të dispozitave të Kodit Rrugor apo të Kodit Penal, të cilat parashikojne masa të tilla. Së bashku me ankesën ai na kishte sjellë edhe fotokopje të procesverbalit të sekuestrimit të makines.

Nga procesverbali i sekuestrimit rezultonte se ajo ishte sekuestruar nga oficeri i Policisë gjyqësore Edmond Shqau, efektiv i Drejtorisë së Policisë së qarkut Tiranë, me vendimin e dt. 21.11.2002. Sipas procesverbalit të sekuestrimit rezulton se shkaku i tij, është sepse makina dyshohet si e vjedhur.

Nga pyetja në dt. 22.11.2002 e oficerit të Policisë gjyqësore Edmond Shqau dhe verifikimi në vend nga ana jonë i kësaj ankesë, rezultoi se sekuestrimi i automjetit nuk ishte i bazuar në dispozitat e K.Pr.Penale dhe konkretisht në nenin 208 të tij, sepse automjeti i sekuestruar nuk lidhej me kryerjen e ndonjë veprë penale.

Me qënë se nga hetimi i kësaj ankesë rezultoi se sekuestrimi i automjetit të përshkruar më sipër, është bërë në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale, i rekomandua Drejtorisë së Policisë të qarkut Tiranë revokimin e vendimit të sekuestrimit të automjetit tip Audi A6, me targë M-W 1770, dhe dorëzimin e automjetit ankuesit. Rekomandimi u pranua menjëherë. Theksojmë se kjo makinë ishte sekuestruar në zbatim të operacionit të Policisë të koduar "Liqeni" për kapjen e makinave luksoze të vjedhura që qarkullojnë me dokumenta të rregullta në Shqipëri. Për këtë qëllim u organizua një takim urgjent me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotin Bajram Ibraj dhe nga ana e tij u dhanë menjëherë

porosite që gjatë operacionit të zbatoheshin ligjet dhe të mos tejkaloheshin kompetencat e Policisë. Në të njëjtën ditë Ministri i Rendit Publik, zoti Luan Rama u kërkoi falje publike në televizionin publik kombëtar gjithë shtetasve ndaj të cilëve policia kishte abuzuar për bllokimin e makinave.

8 - Ankesa e shtetasit Y. D. banor i qytetit Durrës. Ai na shkruante se është në një konflikt pronësie me komshinjtë e tij H. B. e I. B. për zgjidhjen e këtij konflikti ankuesi është ankuar në organet përkatëse shtetërore. Mirëpo ai pretendonte se është kërcënuar disa herë nga polici Isuf Balla, i cili është nipi dhe kushuriri i parë i personave me të cilët ai është në konflikt. Qëllimi i këtij kërcënimi ishte që ankuesi të hiqte dorë nga ankimet. Rastet e fundit të kërcënimeve i përkisnin datave 11.06.2002 në territorin e Repartit të Policisë Durrës, kur ai kishte shkuar të bënte kallzim për plagosjen që i kishte bërë komshiu Ilmi Balla dhe më 06.07.2002, kur ankuesi ndodhej në oborrin e shtëpisë së tij.

Për të verifikuar pretendimet e ankuesit nga ana jonë u bënë hetimet përkatëse, duke u pyetur edhe dëshmitare të pranishëm. Në përfundim rezultoi se pretendimet e ankuesit ishin të vërteta dhe se punonjësi i Policisë Isuf Balla kishte vepruar në kundërshtim me nenin 26, pika 1 e ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", me Kodin Etik të Policisë dhe me Rregulloren e Disiplinës të Policisë së Shtetit, rregullin 6, pikat 1 dhe 2.

Mbi këtë bazë i rekomanduam Shefit të Komisarariatit të Policisë Durrës dhënien e masës disiplinore ndaj policit Isuf Balla, për kryerje të veprimeve të cilat ulin dinjitetin e punonjësit të Policisë. Gjithashtu rekomanduam që masa e dhënë t'i komunikohet para efektivit të Policisë, me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen. Rekomandimi u pranua.

9- Ankesa e shtetasve B. e L. G. banues në qytetin e Fierit, të cilët ankoheshin ndaj Policisë për moslejimin të martesës zyrtare të vajzes së tyre, A. G. me shtetasin A. M., person i cili ishte dënuar me 13.5 vjet burgim për veprën penale "te rrembimit të personit". I dënuari ndodhej në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Fier.

Ankuesit ndërmjet të tjerave na sqaruan se: Gjatë vitit 2001, vajza e tyre A. G., jashtë dijenisë së prinderve ka patur lidhje me shtetasin A. M. nga Fieri, dhe në muajin shtator të po atij viti, të dy bashkë janë larguar dhe kanë shkuar tek një i afërm i djalit në qytetin e Vlorës, duke realizuar martesën faktike. Po sipas tyre, me qënë se gjatë hetimit nuk u be e mundur të realizohej martesë zyrtare, u kërkua edhe pas dhënies së vendimit nga gjykata dhe dënimit të pandehurit A. M. Por përseri nuk u lejua martesë zyrtare nga policia e Fierit.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi nga ana jonë ju kërkuan shpjegime Komisarariatit të Policisë Fier.

Në përgjigjen e komisarariatit jepeshin sqarimet se rregullorja e dhomave të paraburgimit nuk parashikon një rast të tillë, prandaj dhe nuk ishte lejuar kryerja e këtij veprimi.

Por ne arritëm në konkluzionin, se në ankesën e shtetasve B. e L. G. shihej dëshira e vajzes së tyre, për të realizuar martesën zyrtare me shtetasin A. M., në rrethanat në të cilat ai ndodhej, i arrestuar dhe i dënuar. Megjithëse rregullorja e dhomave të paraburgimit nuk e parashikon një veprim të tillë, konstatoam nderkohë se ajo nuk e ndalon kryerjen e këtij akti. Nga ana e jonë lidhja e martesës në këto kushte u konsiderua e drejtë, sepse e drejta e shtetasve për t'u martuar dhe për të patur familje është një e drejtë kushtetuese, e parashikuar në nenin 53 të Kushtetutes së Republikës të Shqipërisë. Sipas nenit 11 të ligjit nr. 5840 datë 20.02.1979 “për rregjistrimin e akteve të gjëndjes civile”, celebrimi realizohet nga punonjësi i Zyrës së Gjëndjes Civile në Bashkinë e Fierit, të cilit i duhen krijuar kushtet e nevojshme, në mjediset e Komisarariatit të Policisë. në bazë të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21 germa “c” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i rekomanduam Komisarariatit të Policisë Fier të merrte masat e nevojshme për realizimin e së drejtës së lidhjes së martesës, ndërmjet shtetasve A. G. dhe shtetasit të dënuar A. M. Rekomandimi u mirëprit nga policia, por për konçidence ato ditë i dënuari mori pafajësinë dhe u lirua nga dhomat e paraburgimit.

10 - Ankesat e shumë shtetasve shqiptarë me banim jashtë shtetit, të cilët pretendonin se nga përfaqesite tona diplomatike dhe konsullore jashtë vendit nuk pranoheshin kërkesat dhe aplikimet e tyre për t'u pajisur me pasaporta. Sipas tyre, mos pajisja me pasaporta ju sillte shqetësime serioze për rinovimin e dokumenteve të qëndrimit dhe të punësimit në shtetet ku ata ndodheshin.

Nga verifikimet e ankesave dhe të akteve normative në fuqi, rezultonte se Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Rendit Publik kishin nxjerë Udhëzimin e Përbashkët “Për procedurat e pajisjes me pasaporta të shtetasve shqiptarë me banim jashtë shtetit”, por ai nuk ishte vene në zbatim.

Për zgjidhjen e këtij problemi nga ana jonë ju kërkuan shpjegime M.P.Jashtme dhe M.R.Publik si dhe u bënë takime të drejtpërdrejta me titullarët përkatës. Rrjedhojë e këtij bashkëpunimi ishte nxjerrja e Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Punëve të Jashtme nr.7677, dt. 03.12.2002, Ministrisë të Rendit Publik nr. 4478, dt. 02.12.2002 dhe

Ministrit të Financave nr. 8249, dt. 09.12.2002 “Për procedurat e pajisjes me pasaporte të shtetasve shqiptarë me banim jashtë shtetit”. Ky udhëzim, i cili doli si rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë dhe transparent, sidomos i sektorit të pasaportave dhe të huajve në M.R.Publik me institucionin tonë, ju jep mundesine e pajisjes me pasaporte të gjithë shtetasve shqiptarë që janë me banim jashtë shtetit, duke aplikuar në përfaqesite diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin ku ata janë rezident ose në përfaqësitë që mbulojnë shërbimet konsullore për vendin ku ata janë vendosur me banim. Në bazë të këtij udhëzimi ata mund të aplikojne edhe në Komisaritet e Policisë në vendin tonë, në juridiksionin e të cilëve ndodhet zyra e gjëndjes civile ku ata gjënden të rregjistruar. Duhet theksuar se atyre ju jepet mundesia që të aplikojne edhe nepërmjet përfaqësuesve të tyre të pajisur me prokure të posaçme. Gjithashtu nga ministrite përkatëse u njoftuam se filloi puna për zbatimin e këtij udhëzimi.

III. Ankesat për largime nga puna, nga shkolla apo për ulje në detyrë në organet e Policisë së Shtetit

Në Institucionin tonë kanë paraqitur ankesa 33 oficerë dhe policë për largime të padrejta nga puna, si dhe ulje në detyrë jashtë kriterëve ligjore. Në disa raste ankuesve nuk ju është komunikuar motivacioni dhe shkaqet ligjore të uljes në detyrë apo të largimit nga puna. Si shembuj të zgjidhjes pozitive në favor të ankuesve mund të përmëndim:

1 - Ankesa e shtetas K. A., ish studente në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, e cila pretendonte se me urdhërin Nr. 731/9, dt. 04.12.2001 ishte përjashtuar padrejtësisht nga kjo Akademi. Sipas saj, ajo ishte njohur me një djalë, me të cilin ka lidhur martesë dhe me qënë se ngeli shtatzane, i kishte bërë kërkesë Drejtorisë së Akademisë për të ndërprerë studimet për vitin mësimor 2001-2002 për arsye shëndetsore. Kjo kërkesë nuk u muar në konsideratë nga Drejtoria, por u vendos përjashtimi i saj nga Akademia në bazë të nenit 87 të Rregullores së Brëndëshme të Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e ankesës i kërkua shpjegime Drejtorisë së Akademisë. Ajo me shkresën Nr. 84 Prot. dt. 06.02.2002 na informoi se ish studentja K. A. më dt. 27.11.2001 i është drejtuar Drejtorit të kësaj Akademie me një kërkesë për të ndërprerë një vit studimet pasi ishte shtatzane dhe nuk përballonte dot ngarkesën. Sipas Drejtorisë, për vetë specifikën dhe statusin që ka Akademia e Policisë si shkolle, ku nuk njihet ndërprerja e studimeve për çfare do lloj shkak, Këshilli Emërues i Akademisë së Policisë i propozoi Drejtorit të Akademisë që bazuar në nenin 87, paragrafi 8 të Rregullores së Brëndëshme të Akademisë me Nr. 342, dt. 31.10.2001 të përjashtojë nga shkolla studenten K. A.

Nga informacioni dhe nga praktika që na dergoi Akademia e Policisë konstatuam se:

1. Përjashtimi nga shkolla i studentes K. A. ishte bërë në kundërshtim me kërkesën e saj, e cila ka qënë për të ndërprerë studimet për një vit dhe jo për përjashtim nga shkolla, siç është bërë në fakt.

2. Përjashtimi ishte bërë në kundërshtim edhe me vete Rregulloren e Brendshme në të cilën ishte bazuar urdhëri, sepse paragrafi 8 i nenit 87 të saj parashikonte rastin e përjashtimit nga shkolla me kërkesën e vet, nderkohë që në rastin konkret nuk e kemi atë. Nga ana tjetër vlen të theksohet se kërkesa për nderprerje të studimeve për një vit nuk duhej interpretuar si kërkesë për përjashtim nga shkolla, pavaresisht se Rregullorja nuk e ka parashikuar ndërprerjen e studimeve. në këtë kuadër, në bazë të parimit të përgjithshëm të së drejtës “një gjë që nuk ndalohet nga akti normativ, lejohet”.

3. Duke u përjashtuar nga shkolla, ish studentes K. A. i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara nga neni 53, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të krijojë familje”, neni 54, pika 1 ku thuhet se: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti”, si dhe neni 57 ku thuhet se: “Kushdo ka të drejtën për arsimim”.

4. Përjashtimi i saj nga shkolla është bërë në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 2, germa “a” të “Deklaratës mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave” shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 07.11.1967, ku thuhet se: “Gruaja do të këtë një lloj si burri të drejta për të zgjedhur lirisht bashkëshortin e vet dhe për t’u martuar vetëm me vullnetin e saj të lirë e të plotë” dhe nenin 9, ku thuhet se: “Duhet të merren të gjitha masat e përshtatshme për t’u siguruar vajzave dhe grave, të martuara ose të pamartuara, të drejta të barabarta me burrat në fushën e arsimit të të gjitha kategorive, përfshirë universitetet dhe shkollat profesionale e teknike”.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur ankueses K. A., si dhe për të garantuar të drejtat kushtetuese të parashikuara nga nenet 53, 54 dhe 57 të saj, në bazë të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutes, të nenit 2, germa “dh” të “Konventes mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj Nr. 34/180 të 18 dhjetorit 1979 ku thuhet se: “Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të vazhdojnë me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë me pikësynimin eliminimin e diskriminimit kundrejt grave dhe për

këtë qëllim zotohen: të marrin të gjitha masat e përshtatshme, përfshirë dispozitat legislative, për të ndryshuar ose anuluar çdo ligj, dispozitë, rregullore, zakon ose praktike që përbën diskriminim ndaj gruas”, si dhe të gërmës “b” të ligjit Nr. 8454, dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i rekomanduam Drejtorisë së Akademisë së Policisë të ndryshonte Rregulloren e Brëndëshme të Akademisë dhe të parashikonte edhe të drejtën e ndërprerjes së studimeve për një vit nga studentët për arsye objektive dhe madhorë. Gjithashtu i rekomanduam të revokonte urdhërin Nr.731/9, dt. 04.12.2001 dhe të ripranonte në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” ankuesen K. A. Rekomandimet u pranuan.

2- Ankesa e shtetasit M. P., ish polic në Komisaratin e Policisë Fier, i cili ankohej për përjashtim të padrejtë nga detyra me motivacionin ”Për thyerje të rëndë të rregullave të shërbimit duke mos zbatuar urdhërin e eprorit për nxjerjen e personave nga dhjetë orëshi”. Gjithashtu ankuesi pretendonte se motivacioni i lirimt nuk qëndronte. Sipas tij, ai kishte zbatuar me korrektësi urdhërin e dhënë prej titullarëve lidhur me dy personat e shoqëruar në Komisaratin në dt. 12.06.2002. Me ta kishte punuar oficeri i Policisë kriminale Sh. B. dhe mbasi ka mbaruar punë, i ka lënë të lirë ata, ka urdhëruar ankuesin që t’ju japë sendet personale dhe ndërkohë ka firmosur në librin e shoqërimit për nxjerjen e tyre. Për të qënë korrekte me urdhërin e drejtuesve, ankuesi e ka pyetur oficerin Sh.B. në se kishte komunikuar me titullarët për lirimt e tyre. Prej tij ka marrë përgjigjen se kishte komunikuar.

Veç sa sipër, ai na shkruante se gjatë gjithë periudhës kohore prej 25 vjetësh që punonte në polici nuk ka marrë asnjë masë disiplinore dhe se një masë e tillë është në kundërshtim me ligjin ”Për Policinë e Shtetit” dhe me Rregulloren e Disiplinës.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e ankesës nga ana jonë ju kërkuan shpjegime Drejtorisë së Policisë së qarkut Fier për shkaqet dhe motivet e e përjashtimit nga policia të ankuesit.

Nga përgjigjia e ardhur me shkresen nr. 834 prot. dt. 14.08.2002 rezultonte se n/oficeri i rojes M. P. është urdhëruar nga ana titullarit të Policisë që me personat e shoqëruar E. Rr. etj, do të punonte policia kriminale dhe pikërisht zv/drejtori dhe shefi i krimeve të renda. Ai duke shkelur procedurat e shoqërimit të personave dhe pikërisht me urdhër të inspektorit të Policisë kriminale Sh. B. ka bërë lirimt e tij, duke mos marrë konfirmimin e titullarëve. Duke qënë përballe kësaj shkeljeje ligjore, në bazë të ligjit “Për Policinë e Shtetit” kanë bërë pezullimin nga detyra të oficerit Sh. B. dhe të policit M. P. Më pas kanë bërë lirimt nga policia të M. P. dhe duke qënë përballë kryerjes së një vepre penale e kanë

shoqëruar atë në ambjentet e komisariatit dhe ndërkohë i kanë kërkuar organit të Prokurorisë së rrethit Fier ndalimin e tij. Prokuroria vendosi që ai të ndiqej në gjëndje të lirë dhe procedimi penal vazhdon akoma. Gjithashtu, na informonte se të njëjtat veprime janë bërë edhe për oficerin Sh. B. duke e marrë në përgjegjësi penale dhe duke ja kaluar materialet Prokurorisë së rrethit Fier.

Nga verikimet që bëmë ne, lidhur me këtë ankesë, në Prokurorinë e rrethit Fier, rezultoi se ky organ ka filluar çështjen penale nr. 332 të vitit 2002 në ngarkim të shtetasit Sh. B. për veprën penale të shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. në materialin kallzues ai është i dyshuar për disa raste të shkeljes së ligjit në kohë të ndryshme, ku midis tyre është edhe rasti i lirit nga dhoma e shoqërimit të shtetasit E. Rr. etj. në përfundim të hetimeve organi i Prokurorisë me vendimin e dt. 10.07.2002 ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. 332 në bazë të pikës 1, germa "a" të nenit 328 të K.Kr. Penale (kur del qartë se fakti nuk ekziston).

Nga hetimi kësaj çështjeje nga organi i Prokurorisë ka rezultuar gjithashtu, se Drejtori i Policisë i ka thënë n/oficerit të rojes M. P. se me këta persona do të punoje policia kriminale dhe se nëqoftëse nuk do të kene probleme do të dalin, por pa i thënë konkretisht se cili nga inspektorët e Policisë kriminale do të punonte me ta. Me personat e shoqëruar ka punuar Sh. B., i cili pasi ka konstatuar se nuk kishin probleme, ka bërë e lirim e tyre, duke firmosur në librin e shoqërimit.

Gjithashtu nga shkresa nr. 1689 prot. dt. 12.09.2002 e Prokurorisë së rrethit Fier, marrë nga ana jonë rezulton se në këtë organ nuk është depozituar ndonjë kallzim në ngarkim të punonjësit të Policisë M. P. dhe për rrjedhojë ajo nuk ka filluar ndonjë procedim penal në ngarkim të tij. Pra e kundërta e asaj që pasqyrohet në përgjigjen e Drejtorisë së Policisë së qarkut Fier.

Nga hetimi i ngjarjes për të cilën është bërë përjashtimi nga Policia e Shtetit e ankuesit M. P., nuk ka rezultuar që të ndodhemi përballë kryerjes së një vepre penale, jo vetëm nga ankuesi për të cilin siç shpjeguam më sipër nuk është bërë ndonjë kallzim, por as edhe për oficerin e Policisë që në rastin konkret ka përgjegjësinë më të madhe dhe vazhdonte të ishte e jetë në detyrë.

Ne përfundim të verifikimeve tona konkluduar se përjashtimi nga policia i ankuesit është bërë i nxituar, pa u analizuar me objektivitet shkelja konkrete. për atë mund të ishin dhënë masa të tjera disiplinore, në mënyrë të shkallezuar, të parashikuara nga neni 29 i ligjit "Për Policinë e Shtetit" dhe jo përjashtimi nga policia, e cila është masa e fundit disiplinore.

Gjithashtu nuk është mbajtur parasysh edhe eksperiencia prej 25 vjetësh e tij në polici si dhe fakti që ai nuk ka marrë asnjë masë disiplinore gjatë gjithë punës së tij.

Për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur ankuesit M. P., i rekomandua Drejtorisë së Policisë të qarkut Fier revokimin e urdhërit për përjashtimin nga Policia e Shtetit dhe rikthimin e tij në punë. Rekomandimi u mirëprit dhe na u premtua zyrtarisht edhe me shkresë së ai do të zbatohet. Por megjithëse kaluan disa muaj, zbatimi i tij po zvarritet. Çështja do të ndiqet në instancat eprore të Policisë, derisa ankuesi të rikthehet në punë.

3 - Ankesa e oficerës së Policisë K. N., me detyrë K/Llogaritare në Zyrën e Finances e Buxhetit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër. Ajo pretendonte se ka qënë në detyrën e Shefes së Zyrës së Buxhet Finances në këtë drejtori dhe se gjatë lejes së lindjes është levizur padrejtësisht nga kjo detyrë, duke u emëruar në detyrën e K/Llogaritares. Këtë levizje e ka konsideruar të paligjshme dhe për këtë padrejtësi ka bërë edhe ankesë në rrugë administrative, por ajo nuk është marrë në konsideratë nga strukturat përkatëse.

Për të bërë të mundur sqarimin dhe zgjidhjen e kësaj ankese i kërkua shpjegime Drejtorisë së Policisë së qarkut Shkodër, e cila me shkresën e saj nr. 640 Prot. dt. 13.04.2002 na informoi se: "Ankuesja K. N. është levizur nga detyra e Shefes së Zyrës të Buxhet Finances, me motivacionin "Për ndryshime të strukture organike" dhe është emëruar K/Llogaritare në Zyrën e Finances e Buxhetit në Drejtorinë e Policisë së qarkut Shkodër me Urdhërin Nr.1793/1, dt. 12.12.2001. Levizja është bërë me propozim të Këshillit Emërues dhe me miratim të Drejtorit të Policisë së qarkut Shkodër, për arsye se funksioni i Shefit të Buxhet Finances në Drejtorite e Policisë së Qarqeve, me strukturën e re organike është i vetëm dhe i pazëvendësueshem. në kuadrin e ndryshimeve strukturore, si dhe përballimit të volumit të madh të punës, është gjykuar se me qënë se ankuesja ishte me leje lindje dhe koha e lejes ishte e zgjatur, të behet ndryshimi në vendin e punës, pasi funksioni i K/Llogaritares mbulohet nga Shefi i Zyrës, gjë që po behet aktualisht".

Nga studimi i materialeve që lidhen me këtë ankesë kemi arritur në konkluzionin se levizja në detyrë e ankuses K. N. nuk është e ligjshme për arsye se:

1. Motivacioni "Për ndryshim të strukture organike" nuk qëndron sepse vendi i punës "Shef i Zyrës së Buxhet Finances" në Drejtorinë e Policisë së qarkut Shkodër ishte më parë dhe është aktualisht, pra ai nuk është suprimuar në organiken e re.

2. Për të përballuar volumin e madh të punës gjatë kohës që ankuesja ishte me leje lindje, në vendin e saj mund të komandohej ose punësohej një person tjetër.

3. Ajo është bërë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 107 të Kodit të Punës, i cili thote se: “Është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës e njoftuar nga punëdhënësi në periudhën gjatë së ciles gruaja pretendon për të fituar të ardhura nga Sigurimet Shoqërore në rast lindjeje ose birësimi”.

Lëvizja e ankueses nga detyra është bërë në kundërshtim edhe me aktet ndërkombetare në të cilat aderon vendi yne si:

a) “Deklaratën mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave”, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 7 nëntor 1967 dhe konkretisht me pikën 2 të nenit 10 të saj ku thuhet se: “Me qëllim që të ndalohet diskriminimi ndaj grave për shkaqe martesë apo lindjeje dhe për t’u siguruar atyre të drejtën efektive për punë, duhen marrë masa për të mos lejuar pushimin e tyre nga puna në raste martesë apo lindjeje fëmijësh. Po ashtu të parashikohën për ato lejet e lindjes të paguara, të shoqëruara me garancine e kthimit në vendin e punës që kanë pasur”.

b) “Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën e saj 34/180 të 18 dhjetorit 1979 dhe konkretisht me nenin 11, pikën 2/b ku thuhet se: ”Për të parandaluar diskriminimin ndaj gruas për shkak martesë ose materniteti, ose dhe për të garantuar të drejtën e saj efektive për punë, Shtetet palë zotohen të marrin masa të përshtatshme që të kenë për efekt: Vendosijen e akordimit të lejes së barrës të paguar ose të së drejtës për të përfituar ndihma sociale të krahasueshme, të shoqëruara me garancinë e ruajtjes së vendit të punës të mëparshëm ...”.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur shtetases K. N., i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit revokimin e urdhërit nr. 1793/1, dt. 12.12.2001 dhe rikthimin e saj në vendin e meparshëm të punës, në detyrën e Shefes së Zyrës së Buxhet Financës në Drejtorinë e Policisë së qarkut Shkodër. Rekomandimi nuk është pranuar, por ne kemi kërkuar rishqyrtimin e çështjes dhe do të insistojmë deri në fund që ankuesja të fitojë të drejtat e saj.

IV. Ankesat për mos përfitimin ekonomik e financiar të punonjësve të Policisë të vrarë ose të plagosur për shkak të detyrës

Ankesat e ardhura për këtë problem kanë qënë në qëndër të vemendjes të veprimtarisë tonë. Janë 8 ankesa, të cilat janë bërë nga individë dhe nga grupe të medhenj individësh. Kryesisht ato janë bërë nga familjaret (prindër ose bashkëshortet) e punonjësve të Policisë të vrarë si

dhe nga vetë policët e plagosur gjatë viteve 1991-1998, të cilët nuk janë trajtuar nga ana ekonomike e financiare.

Ata kanë ankesa për mos përfitim nga Vendimi i K.M nr. 552, dt. 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të Policisë, që humbin jeten ose plagosen për shkak të detyrës”.

Në ankesat e tyre, midis të tjerave, ata na drejtojnë pyetjen prekëse: “Mos vallë jeta dhe gjaku ynë janë më pak të vlefshëm se e kolegëve tanë të vrarë apo plagosur më pas nesh e për të njëjtin shtet dhe ata përfitojne kurse ne jo”.

Nga studimi i këtij vendimi dhe verifikimi i ankesave të qytetarëve të ndryshëm në këtë drejtim, rezulton se ai i shtrin efektet e tij që nga dt. 01 janar 1999, duke ja mohuar të drejtën e trajtimit familjarëve të punonjësve të Policisë të vrarë ose të plagosur para kësaj datë, që nga viti 1991 deri më 1998.

Nga ballafaqimi me aktet ndërkombetare të te drejtave të njeriut, ne konstatuam se vendimi i mësipërm nuk është nxjerë në përputhje me to dhe konkretisht:

1. Me nenin 1 të “Deklaratës universale të te drejtave të njeriut”, miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 217 A të 10 dhjetorit 1948, në të cilën përcaktohet se: “Te gjitha qeniet njëzëzore lindin të lira e të barabarta nga pikpamja e dinjitetit dhe e të drejtave”.

2. Ndërkohë, ai vjen në kundërshtim me nenin 7, germa “a” të “Paktit ndërkombetar lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën e saj 2200 A të 16 dhjetorit 1966, në të cilën përcaktohet se: “Shtetet palë në këtë Pakt njohin të drejtën që ka çdo person për të gezuar kushte punë të drejta e të favorshme, të cilat të sigurojnë në mënyrë të veçantë: ... Një pagë të drejtë dhe një shpërblim të barabartë për një punë të barabarte, pa kurrfare dallimi,...”.

Gjithashtu, vendimi vjen në kundërshtim edhe me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin përcaktohet se: “Të gjithë janë të barabartë para ligjit”, si dhe me nenin 59, germa “f” të saj, në të cilin përcaktohet se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: ...riaftësimin shendetesor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të te paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.

Për ta bërë më të qartë këtë problem, ne u interesuam në M.R.Publik ku u informuam se nga evidencat që ata disponojne, gjatë viteve 1991-

1998 kanë të evidentuar 135 punonjës policie të vrarë për shkak të detyrës. Këta kanë lënë pas 475 pjestare të familjeve që bashkëjetonin me ta. Për shpërblimin e tyre, sipas vendimit të mësipërm, duhen 142.500.000 lekë.

Te plagosur në krye të detyrës, gjatë viteve 1991-1998 janë 140 punonjës policie, të cilët bashkëjetojnë me 469 persona. Sipas përlllogaritjeve për shpërblimin e tyre duhen 70.350.000 lekë.

Shuma vetëm për shpërblimin e familjeve të policëve të vrarë dhe të plagosur për shkak të detyrës, gjatë viteve 1991-1998, të cilët kanë plotësuar dokumentacionin përkatës, është 212.850.000 lekë.

Nga studimi që M.R.Publik ka bërë për këtë qëllim, rezulton se gjatë viteve 1991-1998 janë edhe 32 punonjës policie të vrarë dhe 104 punonjës policie të plagosur që nuk kanë sjellë dokumentet e nevojshme për përfitimin e shpërblimit. Për këtë kategori është llogaritur se duhet shuma prej 80.00.000 lekë.

Shuma totale për trajtimin e gjithë kategorisë së policëve të vrarë e plagosur në vitet 1991-1998 është 292.850.000 lekë.

Ne konkluduar se Vendimi i K.M nr. 552, dt. 27.11.1999 është bërë shkak për shkeljen e të drejtave për trajtim të barabartë të personave të përmendur më sipër. Për të rivendosur në vënd këtë të drejtë të tyre, i propozuam Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë ndryshimin dhe përmirësimin e Vendimit të K.M nr. 552, datë 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të Policisë të vrarë apo plagosur për shkak të detyrës”, për t’i shtrire efektet e zbatimit të tij nga 01 janari 1991. Njëkohësisht i rekomanduam Ministrit të Rendit Publik që t’i propozonte Këshillit të Ministrave ndryshimin dhe përmirësimin e tij, si dhe kemi vene në dijeni Kryetarin e Komisionit Parlamentar të Rendit dhe SHISH-in. Ditët e fundit u informuam se propozimi dhe rekomandimi janë marrë në shqyrtim dhe aktualisht po punohet për zgjidhjen e problemit.

V. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë

Ky problem tashmë është i njohur dhe i pranishëm pothuajse në të gjitha organet e administratës publike shqiptare. Prandaj ankesat në këtë fushë kanë qënë të shumta edhe për Ministrinë e Rendit Publik dhe institucionet apo organet e tjera në varësi të saj. Kështu për vitin 2002 janë bërë 18 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore për kthimin në punë, për mosdëmshpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë, mosdhënien e pagesës kalimtare për largimet nga puna si dhe mosshlyerjen e detyrimeve kontraktore të M.R.Publik ndaj personave të tretë fizikë dhe juridik. Si rast të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1- Ankesa e shtetasit L. B., ish oficer i M.R.Publik, i cili pretendonte se nga ana e Ministrisë Rendit Publik nuk po ekzekutohej vendimi nr. 390 datë 01.06.2001 i Gjykatës së Rrethit Gjirokaster. Në këtë vendim, i cili kishte marrë formë të prere, ishte vendosur anulimi i urdhërit nr. 1739 datë 16.10.2000 të Ministrit të Rendit Publik, duke e rikthyer ankuesin në detyrën e tij, si shef i sektorit llogjistik, në Komisaratin e Policisë Tepelenë. Nga ana jonë, ju kërkuan shpjegime M.R.Publik për shkaqet e mos zbatimit të vendimit gjyqësor. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë na u kthye përgjigje negative, duke theksuar se: "Kërkesa e ankuesit për rimarrje dhe emërim në detyrë është shqyrtuar në Këshillin Qëndror Emërues të Drejtorisë Përgjithshme të Policisë më dt. 20.02.2002, por nuk është miratuar nga ky këshill." Duke konstatuar se përgjigjia nuk ishte korrekte dhe ligjore, i rekomanduam Ministrit të Rendit Publik që të ekzekutohej vendimi gjyqësor në favor të ankuesit. Rekomandimi u pranua dhe ankuesi u rikthye në detyrë.

2- Ankesa e shtetasit Z. P., ish oficer i M.R.Publik, i cili pretendonte se M.R.Publik nuk ekzekutonte vendimin nr. 1811 dt. 17.05.2001 të Gjykatës së rrethit Tiranë, në të cilin ishte vendosur: "Anullimi i urdhrit të M.R.Publik nr. 1512, dt. 30.08.2000 ...". Vendimi ishte lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë. Me qënë se vendimi ishte i formës së prere, ankuesi kishte kërkuar ekzekutimin e tij, por megjithëse kishte bërë disa kërkesa ai nuk po rikthehej në detyrë.

Duke e vlerësuar të drejtë ankesën e tij, e cila bazohej në nenin 142/3 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, i kërkua shpjegime M.R.Publik për shkaqet e mos ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Njëkohësisht i rekomanduam ekzekutimin e tij në favor të ankuesit, duke e rikthyer atë në detyrë. Rekomandimi u pranua nga Ministri i Rendit dhe ankuesi u rikthye në punë.

3- Ankesa e shtetasit P. Q., i liruar nga detyra.

Ankuesi problemin e liritimit, e kishte bërë konflikt gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin Nr.997, dt. 21.03.2001 ka vendosur: "Anullimin e urdhërit administrativ Nr. 985/2 dt. 16.05.2000; kthimin e paditësit në detyrën e meparshme si shef i shtabit në rep. 752 F.N.SH. Bërat; si dhe pagimin e pageses për kohën e qëndrimit në lirim deri në ekzekutimin e këtij vendimi..."

Ky vendim kishte marrë formë të prere, pasi është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin Nr. 569, dt. 29.05.2001, por nuk zbatohet nga M.R.Publik. Nga ana jonë ju kërkua shpjegime M.R.Publik për shkaqet e mos ekzekutimit të tij. Përgjigjen na e ktheu Drejtoria Juridike dhe Përfaqesimit Ligjor, duke u shprehur se: "vendimi nuk

zbatohet sepse është bërë ankim në Gjykatën e Larte”. Kjo përgjigje nuk ishte korrekte dhe ligjore sepse:

Sipas nenit 451/ç të K.Pr.Civile vendimet e Gjykatës së Apelit janë të formës së prere dhe pezullimi i ekzekutimit, sipas nenit 479 të K.Pr. Civile, bëhet vetëm nga Gjykata e Larte. Në kushtet kur nuk ka një vendim pezullimi nga Gjykata e Larte, vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të zbatohet, sepse në rrethanat e mësipërme, gjëndemi në kushtet e pikës 3 të nenit 142 të Kushtetutes së R.SH, ku thuhet se: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Duke hetuar çështjen në kompleks, si dhe për rrethanat që sipërpërmendëm, i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor të cituar më sipër

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me shkresën nr. 205/5-P prot. dt. 12.09.2002 na ktheu përgjigje se: “Bazuar në motivacionin e lirimt “Cënim të figurës së ushtarakut”, në nenin 16, pika 3, kreu IV i ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në mungesë të arsimit profesional (policor), nuk mund të rimerret në strukturat e Policisë së Shtetit”. Së bashku me përgjigjen na dergoi edhe propozimin e Drejtorit të F.S & N.SH për lirimt e ankuesit nga detyra, për arsye se: “shoqërohet, mban në makinë, u jep armatimin e tij, si dhe pajis me dokument policie persona që janë kontigjente të Policisë Kriminale”.

Gjithashtu nga verifikimet që bëmë ne, rezultoi se Prokuroria Ushtarake Vlorë kishte filluar një proçedim penal në ngarkim të tij, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës nga ushtaraku e rebelimit, të kryera këto në bashkëpunim, si dhe për veprën penale të fallsifikimit të dokumenteve zyrtare. Në përfundim të hetimit, organi i Prokurorisë me vendimin e dt. 19.02.2000 kishte vendosur pushimin e proçedimit penal në ngarkim të tij.

Pretendimet e mësipërme për shpërdorim detyrë dhe cënim të figurës së ushtarakut nga ankuesi, janë ngritur nga përfaqesuesi i M.R.Publike edhe gjatë proçesit gjyqësor. Gjykata i ka trajtuar e analizuar ato dhe nuk i ka marrë në konsideratë, sepse nuk ishin paraqitur prova për vërtetimin e tyre.

Duhet theksuar edhe fakti, se në rastin konkret nuk ndodhemi në kushtet e nenit 16, pika 3 e ligjit “Për Policinë e Shtetit”, siç citohet në përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, sepse s’kemi të bëjmë me pranim të ri në Polici, ku kërkohet kualifikim policor.

Me qënë se nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nuk u zbatua rekomandimi ynë, i rekomanduam Ministrit të Rendit Publik marrjen e masave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të mësipërm. Rekomandimi u pranua dhe na erdhi përgjigjia se së shpejti ankuesi do të

rimeret në punë. Çështja do të ndiqet nga ne derisa ankuesi të rikthehet në punë.

4- Ankesa e shtetasit N. P., ish oficer i Gardes së Republikës, i cili pretendonte se nga ana e M.R.Publik nuk po ekzekutohet vendimi Nr. 3681, dt. 21.11.2000 i Gjykatës së Rrethit Tiranë. Me këtë vendim është vendosur anulimi i urdhërit Nr.877/1, dt. 25.08.2000 i Ministrit të Rendit Publik dhe rikthimi ankuesit në detyrën e meparshme. Vendimi kishte marrë formë të prerë dhe për të është lëshuar edhe urdhëri i ekzekutimit.

Lidhur me këtë ankesë i kemi kërkuar shpjegime Drejtorisë së Burimeve Njëzëzore të M.R.Publik. Sekretari i Përgjithshëm i M.R.Publik na përgjigjet se kërkesa e tij për rikthim në strukturat e M.R.Publik na duket kontradiktore. Kjo përgjigje e tij, bazohet në kërkesën për të dalë në reformë, që ankuesi i ka bërë Komandes së Gardes, e cila i ka bërë propozim Ministrit të Rendit Publik. Ministri i R.Publik ka nxjerre urdhërin e lirimit të tij Nr. 877/1, dt. 25.08.2000, me motivacionin “me kërkesën e tij”.

Nga studimi i dokumentave lidhur me këtë ankesë rezultoi se ankuesi ka bërë kërkesë për të dalë në reformë dhe të përfitonte të drejtat financiare që i jep ligji, por ai nuk ka kërkuar të dalë në lirim, siç është vendosur në fakt në urdhërin e lirimit. Megjithatë kjo çështje është trajtuar nga gjykata gjatë gjyqimit dhe tashmë ndodhemi para një vendimi të formës së prere, zbatimi i të cilit përbën detyrim kushtetues të sanksionuar nga neni 142/3 i Kushtetutes tonë, ku thuhet se: “Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”,

Për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur ankuesit, i rekomanduar M.R.Publik ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe rimarjen e ankuesit në punë. Ministri e ka mirëpritur rekomandimin dhe ankuesi është në procesin e riemërimit.

VI. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga policia

Në raportin e vitit 2001 kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykuan se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga policia. Megjithëse ato ja dërguam Ministrisë së Rendit Publik edhe posaçërisht konstatojmë se edhe pas një viti, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmendim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të

drejtën që këta persona kanë për t'u egzaminuar nëse ata dëshirojnë nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj gjithashtu duhet që:

- Të gjitha egzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej policisë duhet të jenë larg dëgjimit, dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo egzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej policisë, nuk u dorëzohen formulare ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formulare duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerë udhëzimi (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seancave dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohët të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluarit gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shembull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga policia për qëllime administrative. Në disa raste kemi konstatuar se “shoqërimi në polici” përdoret ndaj personave të dyshuar për një veprë penale. Pra shoqërimi përdoret për të sqaruar veprime administrative me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së “shoqërimit” behen veprime proceduriale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmëndim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nuk është nxjerë nga autoritetet policore qarkorja që të sqarojë se koha e mbajtjes së personit, për arsye administrative ose gjyqësore duhet të llogaritet brenda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më tepër se 48 orë. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qënë tej afatit ligjor.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me rregjistrat e rregjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambjentet e policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që shenimet në këto rregjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk rregjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi jo të prangosur ose në dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Po kështu nuk ka ambiente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të jenë me kushte të përshtatshme higjienosanitare dhe të pajisura me karrige e tavolina.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluareve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambjentet e policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe
- të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmendje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Nuk u mundësua akoma kalimi i dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga vartesia e Ministrisë së Rendit Publik në atë të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo do të krijonte mundësinë për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.96 datë 09.03.2000.

Për veç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, atë të mbrojtjes së ushtrimit të lirive dhe të drejtave të personit. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të policisë të të gjitha gradave dhe

kategorive. Në këto programe duhet të zërë një vend të rëndësishëm edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe aftësia komunikuese të jenë kritere përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritje në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha niveleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që dënojnë rrepte keqtrajtimit nga policia. Kjo duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e policisë. Kjo në veçanti t'u theksohet punonjësve të policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria.

3. Në analizën apo raportet që bëhen në Ministrinë e Rendit apo në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit t'i kushtohet vend edhe bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Faktikisht bashkëpunimi ka qënë i mire, por në raportin e punës për vitin 2002 nuk përmendej fare bashkëpunimi ynë, i cili faktikisht zë një volum jo të vogël pune për të dy institucionet tona.

6. Ministria e Mbrojtjes

Për vitin 2002, kundër strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë 236 ankesa dhe prej tyre janë përfunduar 188 ankesa. Duke shtuar edhe 23 ankesa të mbartura nga viti 2001, janë përfunduar gjithsej 211 ankesa.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2002 rezulton se 116 ose rreth 55% e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Ky është një tregues mjaft i kënaqshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa rreth 30% ose 65 nga këto ankesa, kanë qenë jashtë kompetencës sonë dhe 30 ose 15 % e tyre kanë qenë ankesa të pabazuara. Nga 236 ankesat e ardhura gjatë vitit 2002 janë në shqyrtim 48 prej tyre.

Duke shqyrtuar shifrat e mësipërme mund të pohojmë se puna me ankesat që lidhen me Ministrinë e Mbrojtjes ka qenë e suksesshme. Por, këtë konkluzion nuk e nxjerrim vetëm nga shifrat e mësipërme. Është kënaqësi të raportojmë se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku ne gjithmonë, qysh në fillim të veprimtarisë sonë në vitin 2000 kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale në interes të zgjidhjes së problemeve të ushtarakëve. Kështu në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, pas një pune të kujdesshme përgatitore, me datën 19 Nëntor 2002 organizuam dhe zhvilluam Tryezën e rrumbullakët me temë: “Të drejtat e ushtarakëve dhe reforma në Forcat e Armatosura”.

Në këtë aktivitet, së bashku me drejtuesit kryesorë dhe kuadrot e lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, diskutuam dhe ballafaquam opinionet tona në lidhje me problemet kryesore që kanë dalë rast pas rasti dhe në përgjithësi për respektimin e të drejtave të subjekteve ushtarake, shqetësimet e të cilëve ishin bërë objekt i punës së Avokatit të Popullit.

Një diskutim i tillë i hapur dhe transparent edhe për median jo vetëm shërbeu në stimulimin e opinionit pozitiv në lidhje me respektimin e të drejtave të ligjshme të ushtarakëve, por ndikoi si në ridimensionimin e punës së Institucionit tonë, por dhe në rritjen e përgjegjësisë së strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes për të trajtuar më me kujdes problemet dhe për të respektuar të drejtat e ligjshme të ushtarakëve.

Kjo formë bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes shikohet nga ana jonë si arritje e suksesshme në realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut dhe kemi planifikuar që një eksperiencë të tillë t’u shtrijmë në të ardhmen me dikastere të tjera.

Gjithashtu, vlen te theksohet fakti, se për herë të parë gjatë punës afro tre-vjeçare të Institucionit tonë, u arrit që direkt nëpërmjet Parlamentit, të arrihej rivendosja e të drejtave të një grupi të konsiderueshëm ish-ushtarakësh, duke bërë ndryshime në ligj në lidhje me përfitimet e pensionit të parakohshëm si ushtarakë.

Më datën 03.10.2002, në seancë plenare, Kuvendi i Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi në parim dhe nen për nen pa asnjë votë kundër Projekt-Ligjin e paraqitur nga një grup deputetësh të Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, pas Rekomandimit tonë, “për një ndryshim në Ligjin nr 8087 datë 13.03.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të Ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”.

Neni 19/1 i ligjit në fjalë kishte këtë përmbajtje:

“Nga ky ligj nuk përfitojnë ushtarakët e nxjerrë në lirim për braktisje detyre, si dhe ata që janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë për krime ushtarake”. Duke u bazuar në këtë dispozitë, rreth 70 ushtarakë, në motivacionin e largimit të tyre nga puna në Ushtri kanë patur shkakun: “për braktisje detyre”. Kjo kishte bërë që ata të humbisnin të drejtën e përfitimit nga ky ligj, edhe pse ata kishin qenë 15-20 e deri dhe 30 vjet në punë si ushtarakë aktivë. Mjaft nga këta persona janë ankuar tek Institucioni ynë qysh në vitin 2000.

Pas hetimit rast pas rasti dhe në tërësi të këtij fakti, u arrit në konkluzionin se veç kontradiktës që ka brenda dispozitës, vetë përmbajtja e nenit 19/1 të ligjit që kemi sipërcituar, krijonte premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga neni 30-të i Kushtetutës sonë. Kjo sepse, shprehja “braktisje detyre”, në kuptimin e anës objektive dhe subjektive si veprim apo mosveprim, nuk parashikohet në asnjë nga dispozitat e Kodit Penal Ushtarak, në të cilin janë vlerësuar si vepra penale çdo veprim apo mosveprim i ushtarakëve që veprojnë në kundërshtim me detyrat e tyre.

Nga ana tjetër, për një veprim të tillë, shumë nga ankuesit tanë, as janë kallzuar e as janë ndjekur penalisht. Pra fajësia e tyre nuk është gjykuar dhe nuk është provuar, në një kohë kur apriori quheshin të fajshëm dhe vuanin saksionin përkatës njëlloj si ata, të cilët “janë dënuar me vendim të formës së prerë me burg për krime ushtarake”.

Ndryshimi që është bërë në ligj mbi bazën e Rekomandimit tonë është si vijon: “Nga ky ligj nuk përfitojnë ushtarakët e nxjerrë në lirim për shkak se janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë për krime ushtarake”. Pra, ky nen nuk favorizon ata, të cilët bie fjala janë gjykuar për veprimin e tyre, por vetëm ata, të cilët janë ndëshkuar “pa iu

nënshtuar asnjë procedimi penal dhe pa u bazuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Në emër të Institucionit, falenderojmë Kryetarin e Komisionit, deputetin Dashamir Shehi dhe grupin e deputetëve të Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes, si dhe mbështetjen e Komisioneve Parlamentare të Ekonomisë dhe të Ligjeve për rivendosjen e të drejtave të këtij grupi ushtarakësh, si dhe për faktin se njëherësh u eliminuan premiset për shkelje të të drejtave të këtyre subjekteve në të ardhmen.

Për të ardhur deri këtu u deshën rreth 2 vjet dhe ka patur dhe ndeshje të mendimeve të kundërta, debat dhe opsione të ndryshme, por e rëndësishme është që më në fund u zgjidhën ankesat e rreth 70 individëve që ishin ndëshkuar padrejtësisht nga vetë ligji.

Miratimin e këtij Rekomandimi me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë ne e konsiderojmë njëherësh shprehje të mbështetjes së fuqishme, jo vetëm për subjektet e Forcave të Armatosura, por edhe për Institucionin e Avokatit të Popullit. Tashmë, ligji i ndryshuar nr.8948, datë 3.10.2002 ka hyrë në fuqi dhe subjektet përkatëse kanë përfituar dhe vazhdojnë të përfitojnë të drejtat që ju ishin mohuar më parë.

Duke u shqyrtuar problemet kryesore të cilat na janë bërë prezent nëpërmjet ankesave të subjekteve ushtarake del që vendin kryesor e zënë ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën, apo e kanë ndërprerë atë kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura, qysh nga viti 1992 e në vazhdim.

Është për tëu përmendur fakti, se pak nga këta subjekte kundërshtojnë daljen në rezervë pasi, për një gjë të tillë, në përkrahje të reformave në Forcat e Armatosura, ato janë ndërgjegjësuar. Por ankesat e tyre kanë të bëjnë me mospërfitimet e të drejtave që ju siguron atyre ligji nr 8087 datë 13.3.1996 dhe ndryshimet përkatëse të mëvonshme të këtij ligji. Jo në çdo rast nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe disa komanda ushtarake është vepruar me korrektesë, drejt dhe në kohë, në mënyrë që këta ushtarakë, pas ndërprerjes së karrierës të përfitojnë atë çfarë ju takon me ligj.

Nga përgjithësimi i këtyre rasteve, nga të cilët rreth 45 veta janë vetëm në garnizonin e Korçës, ne kemi arritur në konkluzionin se gjatë zbatimit të reformës së vitit 2001, ku ndërprejnë karrierën më shumë se 100 ushtarakë, në mënyrën se si është vepruar ka patur shkelje të të drejtave të tyre. Ankesat e tyre janë bërë prezent tek ne gjatë vitit 2002 dhe kanë përbërë një pjesë të rëndësishme të punës sonë. Konkretisht, pas hetimit tonë për këto ankesa doli se Ministria e Mbrojtjes pas përcaktimit të kriterëve të reformës si mosha, profesionalizmi dhe përkushtimi në detyrë,

në muajin mars të vitit 2001, filloi procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të karrierës së oficerëve aktivë të planifikuar për t'u larguar.

Por këto procedura, nuk u kryen gjithmonë konformë ligjit dhe akteve nënligjore, por u veprua në mënyrë të tillë, që solli hapur shkeljen e të drejtave të këtyre ushtarakëve aktivë në tre aspekte:

Së pari: Disa nga ushtarakët e sipërpërmendur u lanë "ushtarakë aktivë" pa pagesë (në dispozicion për muaj të tërë, nga marsi deri në dhjetor të vitit 2001.

Pas periudhës prej dy muajsh, ata nuk janë trajtuar me asnjë lloj page, deri më 26 dhjetor të vitit 2001, kur ka dalë urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes për nxjerrjen e tyre në rezervë. Pra, ato kanë qëndruar rreth 8 (tetë) muaj, pa asnjë lloj pagese dhe atyre ju është dhënë më pas, vetëm masa e pagesës kalimtare. Në pikën 5 të urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr 727 datë 17.01.2000 "Për mbajtjen në dispozicion të oficerëve aktivë dhe për afatin e mbylljes së veprimtarisë ekonomiko-financiare në strukturat e F.A. që suprimohen" thuhet se: "Për ata oficerë aktivë që pas përfundimit të afatit të qëndrimit në dispozicion nuk ka dalë urdhëri i Ministrit për të nxjerrë në lirim apo rezervë, automatikisht ndërpresin trajtimin me pagë dhe shtesë page". Por për këtë pika 4 e po të njëjtit urdhër parashikon nxjerrjen e tyre në rezervë brenda afatit të kohës në dispozicion.

Meqenëse kjo nuk ka ndodhur, statusi i tyre mbetet oficer aktiv dhe si të tillë, ata nuk kanë patur të drejtë të punësohen në sektorë civilë, nuk mund të largoheshin jashtë garnizonit ushtarak të tyre pa leje etj, pasi një gjë e tillë, do të binte ndesh me nenin 4, pikat 3 dhe 4 të Ligjit nr. 7496 datë 03.07.1991, "Për Statusin e Ushtarakut" ku thuhet shprehimisht se;

"Ushtarakëve u ndalohet të punësohen në kohën e tyre të lirë pranë personave juridikë a fizikë vendas dhe të huaj, brenda ose jashtë shtetit.

Ushtarakut, si person i kufizohet liria e zgjedhjes së vendbanimit dhe qarkullimit pa leje jashtë territorit që është nën juridiksionin e garnizonit ushtarak përkatës".

Në rastin konkret, pavarësisht se për çfarë arsyesh është vepruar gabimisht, veprimi i pasqyruar në dokumentacionin përkatës, bie ndesh me të drejtat e njeriut dhe konkretisht me nenin 10 të Ligjit 8087 datë 13.03.1996, ku pikërisht, për të mos krijuar probleme sociale të ushtarakëve që dalin në rezervë është parashikuar, "shpërblimi i tyre i menjëhershëm me daljen në rezervë, me dy paga bazë mujore dhe pas kësaj, trajtimi me pagesën kalimtare"... dhe jo lënia e tyre për disa muaj rrjesht pa asnjë të ardhur.

Së dyti, rezulton se pjesa më e madhe e urdhërave mbi bazën e të cilëve ky grup ushtarakësh do të ndërpriste marrëdhëniet financiare janë

firmosur nga Ministri i Mbrojtjes së asaj kohe pas datës 01.03.2001 dhe pikërisht me datë 4.03.2001; 08.03.01; 09.03.01. etj. Njoftimi i të interesuarve, deri në repartet në bazë, kuptohet se është bërë edhe pas disa ditësh të tjera. Në të gjitha këto urdhëra për dalje në dispozicion të ushtarakut përkatës thuhet se: “marrëdhëniet financiare ndërpriten me datën 01.03.01”, pra disa ditë përpara firmosjes së urdhërit, pa bërë fjalë këtu për kohën e komunikimit të tij.

Siç kuptohet, edhe pse oficerët kanë qenë në punë gjatë këtyre ditëve, mund të kenë qenë dhe me shërbim 24 orësh apo të kenë zhvilluar stërvitje me trupat, etj, ata për këto ditë nuk paguhen. Kjo është një shkelje mjaft e rëndë e të drejtave të tyre kushtetuese, parashikuar drejtëpërdrejtë në nenin 49 të Kushtetutës, si e drejtë e përfitimit të mjeteve të jetesës me punë të ligjshme.

Normalisht duhej të veprohej krejt ndryshe. Në këtë rast oficerit pas komunikimit të urdhërit për dorëzim të detyrës, duhej të lihej koha e duhur në dispozicion, sepse një gjë e tillë parashikohet edhe në Rregulloren e Jetës së Brendshme të Ushtrisë në paragrafet 64 dhe 71, ku thuhet shprehimisht se; “Afati i marrjes e i dorëzimit të detyrës dhe mbajtja në punë me pagesë e dorëzuesit dhe e marrësit në dorëzim është 3-10 ditë. Për ata që administrojnë vlerat materiale e monetare, afati mund të zgjatet deri në 15 ditë. Në raste të veçanta, ky afat me urdhër të komandantit të njësisë, mund të zgjatet deri në 2 muaj”.

I njëjti problem ka ndodhur edhe me ushtarakët që munden të risistemohen në detyrë, pas disa muajsh ndërprerje të karrierës.

Për të gjithë kohën e qëndrimit në dispozicion të tyre prej rreth 6 ose 7 muajsh, përveç dy muajve të parë, ata nuk u paguan me asnjë lloj page edhe pse ishin “oficerë aktivë” dhe kishin ato kufizime që ua diktonte ligji për “Statusin e Ushtarakut” që kemi përmendur dhe më sipër.

Këtyre oficerëve, që përbëjnë një grup prej 30 vetësh, paga u filloi në momentin e risistemimit në detyrë, sikur ata, deri në atë kohë të kishin punuar në ndonjë sektor tjetër dhe nuk kishin qenë ushtarakë aktivë. Madje, këta nuk u trajtuan as me pagesë kalimtare për kohën që ishin në dispozicion prej rreth 6 ose 7 muajsh.

Në këtë rast, ligji është mjaft i qartë dhe pasoja ka ardhur për shkak të mosrespektimit të tij. Është e vërtetë që kërkohet koha e nevojshme për të përgatitur urdhërat, bërë zëvendësimet, etj, por për këtë është llogaritur, siç e theksuam edhe më sipër një periudhë 2-mujore dhe brenda saj, duhet të kenë përfunduar të tëra procedurat e nevojshme që ushtarakët që kanë dalë në dispozicion, të nxirren në rezervë (lirim) ose të risistemohen në detyra të tjera.

Mosrespektimi i këtyre afateve, jo për faj të këtyre ushtarakëve ka shkaktuar pasoja për ta, pasi ata vetë dhe familjet e tyre duhet të ushqehen dhe ligjvënësi e ka patur parasysh këtë. Prandaj ka parashikuar që për tëju ardhur në ndihmë këtyre subjekteve, për shkak të vonesave në procedurat e plotësimit të dokumenteve për tërheqjen e pagesës kalimtare (neni 10 i Ligjit nr 8087) në momentin e daljes në rezervë, ushtarakut i jepet një shpërblim i menjëhershëm prej dy pagash mujore. Pra në këtë rast, nuk ka boshllëk ligjor por moszbatimi i ligjit me korrektesë ka sjellë pasoja mjaft të rënda në shkeljen e të drejtave të këtyre ushtarakëve.

Për të ndrequr këto të meta dhe rekomandimi ynë konsistoi në pasqyrimin e rrugës ligjore. Kemi marrë përgjigje pozitive nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes se po punohet për plotësimin e të drejtave të ligjshme të këtyre subjekteve.

Kjo çështje u diskutua gjerësisht edhe në tryezën e rrumbullakët të organizuar me Ministrinë e Mbrojtjes, për të cilën kemi folur më sipër. Aty u shfaqën dhe mendime nga Drejtoria e Plan-Financës së Ministrisë së Mbrojtjes se zgjidhja e ankesave konkrete të kalojë nëpërmjet gjykatës. Sipas tyre, subjektet tëi drejtohen gjykatës dhe nëpërmjet saj të rifitojnë të drejtën e pretenduar. Kjo do të ishte një tregues tjetër për një administratë jo korrekte. Kjo tregon edhe se nuk e kanë kuptuar misionin e Avokatit të Popullit që ndër të tjera është që kur njerëzit kanë të drejtë, të mos ju drejtohen gjykatave, por atij, sepse do të shtoheshin shpenzimet gjyqësore për palët, do të shpenzohej koha e përfaqësuesve të dikasterit nëpër gjyqe, do të shtoheshin numri i çështjeve të humbura në gjykatë, duke fryrë më tej konceptin, se "fajin e ka gjykata kur palë është shteti" etj.

Problemet e mësipërme nëpërmjet Rekomandimit tonë tashmë janë në vëmendje të Ministrit të Mbrojtjes z.Pandeli Majko. Ai është angazhuar personalisht jo vetëm për rivendosjen e të drejtave të këtyre ushtarakëve por dhe për të monitoruar sa më mirë, me masat e nevojshme tekniko-organizative, që shkurtime organike që po bëhen aktualisht e në vazhdim në kuadrin e procesit të riorganizimit dhe modernizimit të ushtrisë, të mos sjellin pasoja të tilla të shkeljes së të drejtave të këtyre subjekteve.

Një problem tjetër që ka të bëjë me rreth 60 ankesa të paraqitura në Institucionin tonë nga ushtarakët në Tiranë, Durrës, Kavajë etj, ka të bëjë me mosprivatizimin e objekteve të dhëna nga Ministria e Mbrojtjes për strehimin e rreth 200 ushtarakëve.

Por, ky fenomen ndodh për mjaft objekte ushtarake, në shumë garnizone të vendit, për të cilat ushtarakët që kanë marrë autorizimet nuk i disponojnë këto objekte si banesa pasi është penguar procesi i privatizimit.

Nga hetimi i këtyre ankesave nga ana jonë rezultoi se privatizimi në favor të ushtarakëve nuk është bërë sepse pengesë kryesore janë bashkitë e qyteteve, të cilat nuk marrin vendimet për tëi kthyer këto objekte në fond banese. Këtë gjë që e kërkon V.K.M. 379 datë 26.06.1995 i cili thotë se: “Privatizimi i këtyre banesave do të bëhet nga Enti Kombëtar i Banesave kundrejt listave dhe autorizimeve përkatëse që do tëi dërgojnë Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik për lidhjen e kontratave të shitjes. Këto dikastere do të dërgojnë në Entin Kombëtar të Banesave edhe planimetrinë e përshtatjes, gentplanin dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme”...

“Bashkitë ose këshillat e rretheve tëi kthejnë këto objekte në fond banese sipas listave që do tëu dërgojnë Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik”.

Është fakt se nëpërmjet kësaj praktike, deri tani kanë përfituar strehim rreth 3500 familje ushtarakësh por aktualisht janë bllokuar rreth 200 autorizime të lëshuara nga dikasteri i Ministrisë së Mbrojtjes për strehimin e ushtarakëve në objekte të ndryshme ish reparte e institucione ushtarake.

Konkretisht, problemi pengohet në Bashkinë e qytetit Himarë, e cila që prej gati 3 vjetëve, nuk e mer vendimin për kthim në fond banese të disa objekteve, ish reparte ushtarake në Qafën e Leres, të cilat u janë dhënë për strehim 12 familjeve të ushtarakëve. Po kështu ndodh edhe me Bashkinë e qytetit të Kavajës, ku ish Shtëpia e Oficerëve u është dhënë për strehim 10 familjeve të ushtarakëve, të cilët janë pajisur me autorizim nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, por nuk posedohet prej tyre, pasi është zënë nga njerëz të ndryshëm, pa asnjë lloj autorizimi nga ndonjë autoritet publik.

Këshillat Bashkiakë të këtyre qyteteve, nuk marrin vendim për kthim të këtyre objekteve në fond banese, kështu që nuk procedohet më tej për privatizimin e këtyre banesave sipas autorizimeve të dhëna me arsytetime nga më të ndryshmet si: “Këtë godinë e duam për zyra”... “krijohen probleme sociale me ata që janë futur brenda” etj, duke mos vlerësuar faktin, se objektet prej shumë vjetësh janë zënë forcërisht nga njerëz të ndryshëm dhe ushtarakët, të cilët janë pajisur me autorizim për tëu strehuar aty, qëndrojnë të pastrehë.

Për këtë çështje, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes jemi përpjekur, duke organizuar edhe takime me bashkitë Himarë, Tiranë, Durrës, Kavajë etj, por problemi nuk ka marrë zgjidhje.

Duke patur parasysh pengesat për zbatimin në praktikë të VKM nr. 379, datë, 26.06.1995, kemi konkluduar se është e domosdoshme që Këshilli i Ministrave të ndryshojë këtë vendim për lehtësimin e

procedurave të privatizimit të objekteve në fjalë, duke mos parashikuar nevojën e marrjes më parë të vendimit të bashkive për kthim të tyre në fond banese, siç është praktikuar deri tani.

Duke patur parasysh problematikën e rëndë të strehimit që ekziston për familjet e ushtarakëve, si dhe të situatës së krijuar, ne kemi bërë rekomandimin përkatës në Ministrinë e Mbrojtjes për marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin e mundshëm të VKM nr. 379, si një vendim i cili, në mënyrën se si është konceptuar dhe zbatuar në praktikë, ka krijuar dhe krijon premisa për shkeljen e të drejtave të subjekteve ushtarake dhe familjeve të tyre. Për një gjë të tillë po punohet me ekspertët e institucioneve tona, por është Këshilli i Ministrave që do të vendosë për këtë çështje.

Një problem tjetër, i cili ka qenë objekt i rëndësishëm i punës së Avokatit të Popullit, janë ankesat e ushtarakëve aktivë në lidhje me pagesën e shërbimit 24 orësh dhe punën jashtë orarit.

Këtë çështje, ne e kemi trajtuar gjerësisht në raportin e vitit të kaluar, ku kemi parashtruar përfundimet tona dhe angazhimin e Ministrisë së Mbrojtjes për studimin dhe rregullimin ligjor të këtij problemi. Për rekomandimin, ne kemi marrë përgjigje pozitive në parim, por akoma nuk është arritur në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kjo çështje vazhdon të mbetet në vëmendjen tonë dhe për këtë do të vazhdojmë të kërkojmë përsheptim të punës nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes për zgjidhjen e problemit.

Në ankesat e ardhura gjatë vitit 2002 për Ministrinë e Mbrojtjes, mund të veçojmë dhe ankesat e ardhura nga veteranë të ndryshëm ndaj veprimtarisë së stafit teknik të sektorit të Veteranëve në këtë Ministri.

Në sajë të një bashkëpunimi të mirë me këtë sektor, këto ankesa, në përgjithësi janë zgjidhur korrekt. Por ka raste si i ankuesit J.Tego nga Korça, i cili vetëm për një gabim teknik të bërë në dosjen si veteran, kish humbur të drejtën e marrjes së shpërblimit në masën e duhur. Për këtë ish sorollatur për rreth dy vjet, deri sa problemin e bëri prezent tek Kryetari i Kuvendit, zoti Servet Pëllumbi. Pasi u angazhuan edhe ekspertët tanë, u bë e mundur rivendosja e të drejtave të shtetasit në fjalë.

Gjithashtu mbetet problem mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore, ku palë është Ministria e Mbrojtjes. Nga ky dikaster janë ekzekutuar vendimet gjyqësore për 30% të rasteve të trajtuara nga ne.

Me vend është të përmendim dhe faktin e rritjes së përgjegjësisë së strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe komandave të njëjësive e reparteve për vlerësimin e problemeve që Institucioni ynë ka ngritur.

Vitin e kaluar përmendëm rastet e A.H. dhe H.Ç. të cilët kanë hezituuar t'u përgjigjen me korrektesë kërkesave të Avokatit të Popullit. Tani vlen të bëjmë shembull pozitiv për korrektesë të njëjtin person, siç është komandanti i njësisë ushtarake në Fier H.Ç. Për çështjet që ja kemi bërë prezent, jo vetëm është përgjigjur në kohë, por i ka ndjekur hap pas hapi problemet, duke informuar periodikisht, deri në realizimin e plotë të drejtave të subjekteve përkatës.

Si konkluzion, e gjithë kjo pjesë e punës sonë me këto subjekte ka shërbyer mjaft pozitivisht për realizimin e objektivit kryesor të punës të Institucionit tonë, për të mbrojtur dhe zhvilluar të drejtat e njeriut, duke ndikuar kështu në mirëadministrimin e pushtetit dhe mirëqeverisjen edhe në Forcat e Armatosura.

7. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Për vitin 2002 Institucioni ynë ka ndjekur 21 ankesa me këtë Ministri, nga të cilat 8 prej tyre kanë përfunduar, 1 është arshivuar dhe 12 ankesa janë ende në shqyrtim e sipër. Nga 8 ankesat që kanë përfunduar, 7 prej tyre janë jashtë juridiksionit dhe 1 ankesë është e pa bazuar. Problematika e ankesave ka qënë kryesisht mos përfitimi i ndihmës nga shteti në raste fatkeqësish që kanë ndodhur nga forcat madhore, si zjarre, shpërthime eksplozivi apo nga përmbytjet, shembje banesash nga rrëshqitjet e tokave, etj. Edhe për këtë vit problemet janë po ato që janë bërë prezent edhe në Raportin e vitit 2001, sidomos për moszgjidhjen e ankesave për mungesën e fondeve buxhetore. Në Drejtorinë përkatëse të kësaj Ministrie janë evidentuar edhe shumë ankesa të tjera të bëra direkt nga shtetasit me të njëjtin objekt, por që nuk janë zgjidhur po për mungesë fondesh, të cilat duhet të jepen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Edhe në Raportin e këtij viti, do të bëjme të ditur të njëjtin problem që kemi paraqitur edhe në vitin e kaluar dhe që lidhet me ankesat e banorëve të zonave kufitare Kukës, Has, Tropojë, të cilat u dëmtuan nga bombardimet serbe në kufi. Për këtë çështje paraqitëm rekomandimet përkatëse në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe më pas Zv/Kryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme Z.Meta. Në përgjigje të këtyre rekomandimeve Zv/Kryeministri dhe Ministër i Punëve të Jashtme, ka gjykuar së në kushtet e zhvillimeve aktuale kërkesa e qeverisë tonë, si kundrejt bashkësisë ndërkombëtare dhe sidomos BE-së, ashtu dhe ndaj shtetit fqinj, mund të mos gjejë pritjen e favorshme dhe të mos sjellë rezultate pozitive. Në këto kushte është sugjeruar që të ndërmerret iniciativa për paraqitjen e projektvendimit të Këshillit të Ministrave nga ana e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Këto janë institucionet kompetente që mund të shqyrtojnë të gjitha mundësitë financiare dhe ligjore për zgjidhjen e kësaj çështje nga Qeveria shqiptare. Pas kësaj përgjigjeje i jemi drejtuar përsëri këtyre dikastereve që të përgatitin projekt vendimin e Qeverisë.

Kemi edhe grupin e ankesave të tjera që kanë të bëjnë me përfitimin e një të drejte, pra kërkojnë zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.206 date 26.03.1998 "Për pjesëmarrjen e shtetit në raste fatkeqësish". Për këto ankesa përgjigjet janë standarte se me sigurimin e fondeve, do të zgjidhen edhe shqetësimet e qytetareve. Por kjo ka sjellë vetëm mbartjen e tyre nga viti në vit. Nga shqyrtimi i ankesave ka rezultuar se kërkimet e shtetasve janë të drejta dhe burojnë nga vetë aktet ligjore dhe nënligjore,

por zgjidhja e tyre në favor të ankuesve paraqitet e pamundur për pamundësi financiare të mbulimit nga buxheti i shtetit.

Për ankesat me objekt përfitimin e ndihmës nga shteti për dëmtime jemi informuar nga Ministria e Pushtetit Vendor se që nga viti 1998 e më parë janë paraqitur shumë kërkesa. Prej këtyre 300 familje kanë dokumentacion të plotë dhe për plotësimin e tyre kërkohet një fond prej rreth 200.000.000 lekë për shlyerjen këtyre dëmeve. Kësaj shume tashmë i janë shtuar dhe shumë raste të tjera, të cilat kanë ndodhur në vijimësi në vitin 2002, sidomos nga përmbytjet e fundit që ndodhën në zonat veriore të vendit, dëmtimet e shtëpive muzeale të qytetit të Gjirokastrës, apo banesa tejet të amortizuara, por me vlera historike të cilat nga mungesa e trajtimit me fonde të veçanta rrezikojnë shembjen dhe humbjen e vlerave kulturore.

Duke qënë se fondet për ndihmë jepen nga fondi rezerve i Këshillit të Ministrave, me vendime të veçanta të qeverisë dhe shteti mund të japë ndihmë financiare të pjesshme apo të plotë, sipas pikës 1 të VKM-së Nr.206 datë 26.03.1998, është e nevojshme që duke njohur detyrimet e mbartura në vite për këto raste, të mund të parashikohen edhe mënyrat e zgjidhjeve hap pas hapi që në projekt buxhetin që miratohet çdo fillim viti.

Sidoqoftë ne mendojmë se strukturat përkatëse të kësaj Ministrie në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor nuk duhet të qëndrojnë pasive vetëm duke grumbulluar ankesat. Ato për çdo rast të njoftojnë ankuesit, por edhe të ndjekin se çfare mënyre tjetër mund të kete apo ka përdorur ankuesi për të zgjidhur problemin e tij, i cili natyrisht nuk mund të qëndrojë në pritje për disa vjet.

Ankesë specifike që është trajtuar me Ministrinë e Pushtetit Vendor është dhe ajo e banorëve të një pallati në qytetin e Korçës, i cili në vitin 1997 u rrezikua nga shëmbja. Nga ana e qeverisë kanë dalë dy vendime që merrnin përsipër detyrimin për të rregulluar pasojat e kësaj shtate. Në këto vendime, të cilat dolën në afate të ndryshme kohore është konstatuar pabarazi në trajtimin e qytetarëve, sepse disave ju fal shuma e akorduar, ndërsa disave ju dha në formë kredie me afat të gjatë shlyerje. Për këtë çështje zyra jonë i paraqiti rekomandim Bashkisë së Korçës, e cila mbështeti pozitivisht kërkesën tonë. Më pas çështjen ia kemi bërë prezent Ministrisë së Pushtetit Vendor, duke rikërkuar prej saj rivlerësimin e problemit dhe gjetjen e hapësirave ligjore për të rregulluar trajtimin e qytetarëve me barazi para ligjit.

Është vërejtur gjatë shqyrtimit të ankesave se ka zvarritje procedurash administrative dhe ky fakt është evident në të gjitha strukturat. Këto zvarritje vijnë për shkaqe neglizhence, por edhe mos njohje të ligjit dhe të afateve që përcaktojnë procedurat administrative. Vlen të

përmendim këtu rastin e qytetarit R.M nga qyteti i Korçës, i cili në VKM Nr.712 datë 27.12.2001 nuk figuron në listën emërore të përfitimeve, sepse në këtë vendim është shënuar gabimisht dy herë emri i dy familjeve. Korrigjimi i këtij gabimi material, sipas nenit 120 të K.Pr.Administrative realizohet nga vetë organi që ka nxjerrë aktin dhe që vihet në lëvizje me kërkesën e Ministrisë që ka përgatitur projekt vendimin. Bashkia e Korçës i është drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe ka kërkuar prej saj të ndermarrë iniciativën për rregullimin e kësaj gjëndje, sepse qytetarit i shkelen të drejtat nga moszbatimi i vendimit të Qeverisë. Në trajtimin e kësaj çështje vërehen zvarritje të pajustificuara nga ana e Ministrisë, e cila ende nuk e ka zgjidhur problemin në fjalë.

Për sa i përket ankesave të qytetarëve të ardhur nga zonat e përmbytura nga ndërtimi i basenit të Bovillës, Institucioni ynë paraqiti rekomandimet përkatëse në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit. Të dyja këto dikastere kalonin përgjegjësinë e zgjidhjes së problemit tek njëra tjetra. Çështja tashmë i ka kaluar për zgjidhje Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, që ka ndermarrë dhe hapa konkrete.

Ankesat për organet e pushtetit vendor (Komunat, Bashkitë, dhe Prefekturat)

Gjatë vitit 2002 kemi patur 457 ankesa, problematika e të cilave lidhet me subjektet e mësipërme.

a. Ankesa për komunat

Nga 22 ankesa që kemi shqyrtuar me Komunat, kryesisht problematika është e njëjtë, sikurse për ankesat që janë ndjekur pranë Prefekturave. Por për komunat mund të veçojmë disa çështje, të cilat vlejné të parashtrihen. Duke qenë se qeverisja e tyre realizohet në komunitete, në të cilat infrastruktura ende nuk është në standartet e kërkuara, edhe ankesat që shfaqen janë nga më të ndryshmet, si mos sigurimi i ujit të pishëm, apo për vaditje, hapje te rrugeve, ankesa për mos përfitimin e ndihmave si familje me probleme, mos përfitimin e përkrahjes sociale, mos shqyrtimin e kërkesave të banoreve për dhenien e statusit të pastreheve, si dhe shume ankesa të cilat lidhen me ligjin për të drejtën e informimit. Nga mos njohja e ligjit komunat jo vetëm që nuk shqyrtojnë dhe zgjidhin probleme, por nuk kthejnë as përgjigje ankuesve për sa kërkojnë, duke i sorollatur nëpër dyer të administratës së tyre vendore për shumë kohë. Detyrimet që rrjedhin nga ky ligj ose nuk njihen ose nuk zbatohen e zvarriten për shkaqe të

pajustificuara. Kodi i Procedurës Administrative është një ligj pak i njohur, kështu dhe detyrimet që burojnë nga ligji për këto organe nuk zbatohen gjatë procedimeve administrative. Është vënë re se aktet administrative apo shkallët e ankimit administrativ, nuk njihen ose ndërmerren veprime nga kryetarët e komunave që kapërcejnë kompetencat e tyre. Në ndonjë rast marrin përsipër edhe kompetencat e pushtetit gjyqësor. Kështu është rasti i Kryetarit të Komunes Mollaj, i cili ka nxjerrë një vendim administrativ duke përcaktuar përgjegjesinë civile dhe dëmin pasuror të vlerësuar në lek, në ngarkim të ankuesit R.Sh si dhe ka urdhëruar njëkohësisht dhe ekzekutimin e vendimit. Për këtë çështje kemi paraqitur rekomandimin përkatës për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, por ende nuk ka asnjë përgjigje nga Kryetari i Komunës. Gjithashtu është verejtur nga shqyrtimi i ankesave se të drejtat e të punësuarve pranë Komunave nuk njihen dhe niveli profesional i veprimtarisë administrative që ushtrojnë drejtuesit le për të dëshiruar. Kjo ndodh edhe sepse në strukturën organike të Komunës mungon pozicioni i juristit, i nevojshëm për ndërgjegjësimin dhe zbatimin e mendimit juridik në aktivitetin dhe ushtrimin e veprimtarisë administrative të komunave. Kështu nga mosnjohja e akteve juridike që rregullojnë këto marrëdhënie të punës, largimet nga puna bëhen në mënyre abusive.

Veçojmë rastin e largimit nga puna të R.D nga ana e kryetarit të Komunës Bubq të rrethit Krujë, i cili pa shkaqe të arsyeshme dhe pa asnjë dokumentacion shkresor ka larguar nga puna ankuesin. Çështja është ende në shqyrtim, sepse Kryetari i Komunes ka shfaqur zvaritje dhe neglizhencë në trajtimin e kësaj ankese, duke mos i kthyer asnjë përgjigje Institucionit të Avokatit të Popullit. Duke qenë se niveli i varfërisë në zonat rurale është i dukshëm dhe vendet publike të punës me paga të garantuara janë të pamjaftueshme, ndodhin shpesh abuzime me pushtetin nga Kryetarët e Komunave. Këta e konsiderojnë vehten të mbrojtur për faktin se janë të mandatuara politikisht me afat të përcaktuar nga ligji dhe shpesh bëhen burim konfliktesh, pikërisht nga mozbatimi i ligjit, nga mos njohja apo dhe shpërdorimi i postit për përfitime të ngushta personale.

Nga gama e gjerë e ankesave me Komunitat janë verejtur edhe probleme që lidhen me mosekzekutimin e vendimeve të Komisioneve të Kthimit të Pronave, duke shkelur kështu parimin kushtetues për mbrojtjen dhe garantimin e pronës private.

Bëhet evident edhe rasti i 26 familjeve të fshatit Libonik të Korçës, të cilët ankohen për moszbatim të një vendimi gjyqësor të vitit 1994, i cili i njeh të drejtën këtyre banorëve për likuidimin e një detyrimi monetar, detyrim i cili duhet të përmbushet nga Këshilli i Qarkut Korçë. Kjo çështje

e mbartur nga viti 2001, është ende në shqyrtim nga zyra jonë. Kryetari i këtij Këshilli, megjithëse problemi është prezantuar në të gjitha instancat më të larta të shtetit shqiptar, asnjëherë nuk i ka kthyer përgjigje Institucionit tonë, duke shkelur haptazi detyrimin ligjor që i buron nga Kushtetuta dhe ligji “Për Avokatin e Popullit”, si dhe duke injoruar detyrimin kushtetues për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore nga të gjitha organet e shtetit shqiptar.

b. Ankesat për bashkitë

Gjatë vitit 2002 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë mbërritur edhe 367 ankesa kundrejt Bashkive. Problematika e çështjeve është po ajo e prezantuar edhe në Raportin e vitit 2001 dhe shumica e këtyre ankesave janë mbartur nga viti, për shkak se për çështjet e strehimit ende nuk ka asnjë strategji që të zgjidhë problemin. Kështu evidente janë ankesat e të pastreheve nga rënia e skemave piramidale, të cilët për mungesë transparence asnjëherë nuk janë informuar se çfarë është arritur dhe praktikisht kur mund të zgjidhet problemi. Edhe për këtë vit nuk është zgjidhur ankesa e kontigjentit të të pastreheve të cilët kanë akt marrëveshje të pazbatuara me pushtetin lokal dhe që sipas kriterëve ligjore përfshihen në kategorinë prioritare për t’u trajtuar. Kërkesa dhe sugjerimi jonë për zgjidhjen e problemit të strehimit ka qenë hartimi i një strategjie mbarë kombëtare me objektiva të qarta për mënyrën e zgjidhjes, kontigjenti që duhet të mbulohet, sigurimi i kushteve për arritjen e rezultateve të dukshme si dhe sigurimi i fondeve për këtë qëllim. Problemi i strehimit është një objektiv social, emergjent, i shtruar për zgjidhje. Por nga mos zgjidhja në kohë sjell shtimin e kontigjentit dhe pamundesitë e zgjidhjes shtohen nga viti në vit. Nga shumë ankesa të mbërritura gjatë këtij viti në Institucionin e Avokatit të Popullit, del se në të gjitha Bashkitë, edhe pse përfitohet statusi i të pastrehëve, mungon transparenca në vendimmarrje për radhën e trajtimit të qytetarëve, të cilët shpesh kanë rezerva për vonesat. Në këtë drejtim duhet të rritet transparenca nga organet e pushtetit vendor, për t’i bërë të njohur taksapaguesve dhe zgjedhësve të tyre punën e tyre për zgjidhjen e këtij problemi madhor, si dhe strategjitë përkatëse. Këto organe, duke qenë se ushtrojnë veprimtarinë mbi bazen e parimit të autonomise dhe vetqeverisjes, duhet që të rritin bashkepunimin me komunitetin për tërheqjen e mendimit të tyre, për alternativat dhe kohën e zgjidhjes etj. Ligji Nr.8030, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” dhe aktet e tjera nënligjore ngarkojnë për zbatimin e tij organet e pushtetit vendor dhe Entin Kombëtar të Banesave. Për gjithë këtë proces qytetarët janë krejtësisht të pa informuar, ka përshtjellim, i cili ka sjellë sorollatje pa fund.

Pikërisht kjo mungesë informimi e qytetareve ka qenë nxitje për Bashkinë e Tiranës në projektin e kësaj të fundit, për ngritjen e zyrës së informacionit, nismë e cila është përshëndetur si një mjet efikas në mirëqeverisje.

Në ankesat që kemi shqyrtuar lidhur me çështjen e strehimit duhet të bëjmë evident faktin se shpesh nga ana e Bashkive nuk shfrytëzohen mjetet ligjore për procedimin administrativ të ankesave. Ata hezitojnë në nxjerrjen e urdhërave administrative, sikundër është rasti i qytetarit Q.SH nga qyteti i Durrësit. Bashkia i tregon qytetarit rrugën gjyqësore, ndërkohë që sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore”, bashkitë kanë të drejtë të ndermarrin procedime të tilla, duke marre në shqyrtim dhe vendosur edhe për ankimet administrative.

Në disa raste nga ana e Bashkive nxirren urdhëra administrative për lirim banesash, duke ja kaluar për ekzekutim organeve të policisë, kur kjo detyrë funksionale nuk i takon organeve të policisë. Me ligjin Nr.8553, datë 25.11.1999 “Për policingë e shtetit”, policia vetëm merr pjesë gjatë ekzekutimit të urdhërave administrative, me qëllim ruajtjen e rendit dhe qetësitë publike.

c. Ankesat për prefekturat

Kanë qenë 44 ankesa për prefekturat.

Nga shqyrtimi i tyre janë evidentuar probleme që kryesisht lidhen me largimet nga puna, moszekutim të vendimeve gjyqësore apo të vendimeve të Komisionit të Sherbimit Civil, me mos zbatimin e ligjit Nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit me dokumenta zyrtare”, si dhe problemet që kanë dale nga veprimet apo mosveprimet e Komisioneve të Tokave. Vërehet se shumë shkelje të të drejtave kanë ardhur nga moszbatimi i procedurave administrative në procedimet e ndryshme që ndërmarin këto organe për zgjidhjen e problemeve me komunitetin, apo dhe në raport me nëpunësit e tyre.

Gjatë këtij viti në Institucionin tonë janë adresuar shume ankesa nga punonjes të Prefekturave Lezhë, Tiranë dhe Durrës. Nga shqyrtimi i tyre rezultoi se ka paqartësi nga vetë prefektët në trajtimin e punonjësve të tyre, të cilët në disa raste i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës dhe në disa raste të tjera me ligjin “Për nëpunësin civil”. Në të gjitha rastet procedurat që duhen ndjekur dhe që garantojnë të drejtat e tyre anashkalohen. Kjo situatë ndodhi për shkak se në të gjitha Prefekturat me urdhër të Kryeministrit u përcaktuan strukturat e reja organike si pasojë e ristrukturimit. Duke qenë se urdhëri dërgohej bashkangjitur me pasqyrat e organigramës dhe respektivisht numrin e punonjësve, më tej drejtuesit

localë nuk bënë përcaktimin e kriterëve për punonjësit që do të shkurtoheshin dhe përshkrimet e vendeve të punës, por iu la hapësirë eprorve në përzgjedhjet e tyre.

Ky problem me shtrirje të gjerë në pothuajse gjithë Prefekturat, pati trajtime të ndryshme jo vetëm nga ana e Prefekteve të Qarqeve, por edhe nga ana e Komisionit të Shërbimit Civil. Kështu vlen të përmendet rasti i punonjëses E.T, inspektore në Drejtorinë e Kontrollit Financiar në Prefekturën e Qarkut të Tiranës. Ankesa e saj u pranua nga Komisioni i Shërbimit Civil, u shqyrtua dhe u pranua si i drejtë pretendimi i saj, duke marrë vendim për rikthim në vendin e punës. Ndërsa ankesa e 2 punonjësve me të njëjtën detyrë po të njëjtën Drejtori, (Drejtorja e Kontrollit Financiar) në Prefekturën e Qarkut Durrës, nuk u pranua për shqyrtim nga ana e Komisionit, duke deklaruar inkompetencën. Në rastin e parë Institucioni ynë i rekomandoi Prefektit të Tiranës zbatimin e vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil, bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”. Prefektura refuzonte ekzekutimin duke hezituar në përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji. Pas rekomandimit kemi marrë përgjigje se ankesa tashmë është zgjidhur në favor të ankueses.

Për ankesat me Prefekturat do të veçonim si raste specifike ankesën e një grupi banorësh të fshatit Dushnik të Komunës Otlak të rrethit Berat. Ata kishin konflikte lidhur me pronësinë e tokës bujqësore me ish pronarët, të cilët mbanin forcërisht në përdorim prej 5-6 vitesh këto sipërfaqe. Me ndërhyrjen energjike të Institucionit tonë pranë organeve të pushtetit vendor, (pasi banorët kishin filluar dhe një grevë urie), u arrit ç’vleftësimi i akteve të marrjes së tokës në pronësi për sipërfaqet e zëna nga ish pronarët dhe plotësimi me tokë nga ish-NB Ushtarake pranë fushës së Aviacionit, duke arritur mbrojtjen e të drejtave të ankuesve.

Ankesa e banorëve të fshatit Mertiraj, rrethi Vlorë, për mos zbatim të VKM Nr.56, datë 11.02.1993 “Për financimin e shpërnguljen e fshatit Mertiraj-Vlorë”, u zgjidh pozitivisht në favor të banorëve të shpërngulur, duke u vendosur ndarja e 156 apartamenteve në Vlorë. Procesi po zbatohet nga organet e qeverisjes vendore të Vlorës.

Veçojmë ankesën e banorëve të lagjes Nr.15 në Portoromano, Durrës përsa i përket rihapjes dhe vënies në punë të fabrikës së lëkurës një shtetas Italian që nuk zbatonte kërkesat lidhur me infrastrukturën e ambientit në këto zona. U arrit me ndermjetësi që të dy palët të bien në marrëveshje për sa i përket kushteve që duhen plotësuar nga shtetasi italian, për të mundësuar më pas rihapjen ose jo të fabrikës së lëkurës.

Me Prefekturën e Korçës, kemi ndjekur edhe ankesën e disa inspektorëve të MCR-së, të cilët kërkonin zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore për dhënien e pagesës shtesë për vështirësi funksioni. Për zgjidhjen e kësaj çështje paraqitëm rekomandim, i cili pas shumë hezitimesh u pranua dhe ankesa u zgjidh në favor të ankuesve.

Nga shqyrtimi i ankesave, ka dalë se nga organet e qeverisjes vendore të të gjitha niveleve, ka raste që ka keqadministrim fondesh, kapërcim të radhës së shpërndarjes së tyre, mosakordim ndihmash apo fondesh për dëmshpërblime nga shteti, mungesë transparence dhe mbi të gjitha mungojnë strategjitë apo alternativat e konkretizuara në planet afat gjatë dhe afat shkurtëra për zgjidhjen e këtyre problemeve sociale të prekshme dhe të mprehta për qytetarët.

Veçojmë për organet e pushtetit vendor edhe problematiken e mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, problem i cili është evident në të gjitha organet qendrore dhe vendore, i pasqyruar edhe në Raportin e vitit 2001. Ka qëndrime jo të drejta dhe ligjore për sa i përket vendimeve gjyqësore, sepse ka edhe drejtues të pushtetit vendor, që marrin përsipër shqyrtimin e themelit të çështjes dhe interpretimin e vendimeve gjyqësore. Shpesh mosekzekutimi justifikohet me mungesë fondesh, por ekzistenca e këtij shkakut si pengesë për ekzekutim të vendimeve gjyqësore jo vetëm që nuk zgjidh problemin, por vetëm shton numrin e tyre duke i mbartur detyrimet për çdo vit.

Nga gjithë sa parashtruar më lart konkludojmë se duhet të rritet kontrolli mbi administrimin dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor në të gjitha hallkat e tij, si nga ana e të qeverisurës, ndaj të cilëve duhet të sigurohet besimi për votën e dhënë, ashtu dhe nga të gjitha hallkat kontrolluese të pushtetit qendror dhe drejtoritë përkatëse në Këshillin e Ministrave.

Rol më të madh duhet të luajnë edhe Prefekturat, të cilët duhet të kontrollojnë bazueshmerinë ligjore të akteve të organeve të pushtetit vendor. Rëndësi të dorës së parë ka dhe rritja e nivelit të nëpunësve në përvetësimin e akteve ligjore që kanë të bëjnë me mirëqeverisjen, siç janë Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji “Për të drejtën e informimit me dokumenta zyrtare”. Gjithashtu roli i juristëve në organet e Pushtetit Vendor duhet të rritet ndjeshëm, duke hapur vende pune për ta. S’ka kuptim që tashmë në kohën e demokracisë, në vitin 2003, të mos arrijmë një standart që ishte i detyrueshëm për organet e pushtetit vendor para vitit 1990, që çdo këshillë i bashkuar fshati apo komitet ekzekutiv i çdo qyteti të kishte juristin e tij.

8- Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale

Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë lidhur me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale si dhe të institucioneve në varësi të saj, Institutin e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, Administratën e Përgjithshme të Ndhmës dhe Përkrahjes Sociale dhe filialet e tyre në rrethe ka qenë 290. Problematika e ankesave të trajtuara ka qenë thuajse e njëjtë me ato të vitit të kaluar. Më poshtë do të paraqiten të specifikuarat problemet sipas objektit të tyre.

Ajo që është vënë re pas trajtimit të ankesave lidhur me shërbimin social është se mundësitë e vendit për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë janë kompromentuar nga infrastruktura e dobët, lëvizjet e mëdha demografike, mungesat e përkohshme të stabilitetit të brendshëm dhe rajonal, kapacitetet e dobta teknike të strukturave përkatëse. Ristrukturimi dhe reformimi i shërbimeve sociale bazë është një element prioritar në uljen e varfërisë.

a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shtetërore

Gjatë vitit 2002 ankesa të drejtuara ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore kanë qenë 174. Nga këto ankesa janë përfunduar 131 prej tyre dhe kemi akoma në proces shqyrtimi 43.

Konstatohet se problematika e tyre është pothuajse e njëjtë me vitet paraardhëse 2000-2002. Kështu qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, për masën e përfitimit të pensionit të invaliditetit, të masës së pensionit familjar, mospërfitimin e statusit të invalidit, mospërfitim të shtesave mbi pension, mospranim dokumentacioni etj.

Përgjithësisht nga këto ankesa kemi evidentuar se shpesh here ankuesit nuk kanë konsumuar shkallët e ankimit administrativ brenda strukturave të ISSH-së, pra nuk ankohen në shkallët e Apelit për pretendimet e tyre.

Në këto raste ndërhyrja jonë ka qenë e favorshme duke i dhënë mundësinë qytetarit të qartësohet për problemin e tij, pa i hyrë procedurave të zgjatura administrative nëpërmjet komisioneve. Këtë veprim i kemi orientuar ta kryejnë në një moment të dytë, në qoftë se nuk mbeten të kënaqur dhe t'i drejtohen komisioneve përkatëse të Apelit.

Sikundër dhe e kemi prezantuar në Raportin Vjetor 2001, edhe në vitin 2002, patëm ankesa të tilla ku qytetarët ngrenë thjesht problemin e mosqarimit dhe moskthimit të një përgjigje zyrtare për çështjet e tyre nga organet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në rrethe e rajone.

Mbi këtë bazë në shumë raste ndërhyrja jonë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore ka konsistuar në faktin që, ky organ ka detyrimin për shqyrtimin e çështjes së qytetarit t'a informojë atë mbi procedurat e ndjekura, dokumentacionin përkatës zyrtar, si dhe t'i shpjegojë në përgjigjen e tij zyrtare drejtuar individit, arsyet e mospërfitimit të një të drejte të pretenduar, konformë dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

E reja e këtij viti ka qenë nisma e ndërmarrë nga Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale për ngritjen e një grupi pune, i cili studjoi mundësinë e rishikimit të ligjit për sigurimet shoqërore, me qëllim përmirësimin cilësor të tij si dhe përfundimi i një studimi tjetër që lidhet me strategjinë afatgjatë të sistemit të sigurimeve shoqërore deri në vitin 2020.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit e ka parë punën e tij të orientuar drejt informimit të qytetarëve për zhvillimet e herë pas herë lidhur me ecurinë e kësaj nisme dhe mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të tyre për fazat e rishikimit të këtij legjisllacioni.

Sikundër është bërë tashmë publike në muajin Prill të këtij viti Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr.8889, datë 25.04.2002 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703 datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Në vijim ka dalë dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.489 datë 16.10.2002, për ndryshimin e masës së pensioneve të një kategorie të caktuar përfituesish me tendencë rritjen e tyre në masën 25%. Këto zhvillime në fushën e legjisllacionit për sigurimet shoqërore nuk kanë kaluar pa reagime të publikut, të cilat janë përcjelle dhe në ankesat që i janë drejtuar Institucionit tonë. Në këto ndryshime kemi të bëjmë me politika që vetë shteti ndjek në këtë fushë dhe ato dalin jashtë juridiksionit të veprimtarisë tonë.

Një moment tjetër i evidentuar në ankesat e trajtuara nga ana jonë, por që është evidentuar vazhdimisht dhe nga Mediat, është ai që lidhet me mospagimin e kontribucioneve të detyrueshme ndaj Sigurimeve Shoqërore.

Është e kuptueshme që në rastin e marrëdhënies së punësimit ndërmjet individit dhe një subjekti privat, problemi mund të trajtohet thjesht në parim, pasi një çështje e tillë është jashtë juridiksionit tonë.

Megjithatë është evidentuar në disa ankesa që individët punojnë në këto subjekte private pa kontrata pune, ose edhe kur kanë kontrata këto subjekte nuk paguajnë për të punësuarit, kontribucionin e detyrueshëm për sigurimet shoqërore. Në bazë të këtij konstatimi, të paktën nga praktika e deritanishme e punës tonë është arritur në konkluzionin se megjithëse baza

ligjore ekziston dhe megjithëse organet përkatëse ekzistojnë, duke nënkuptuar këtu ISSH-ne dhe Inspektoriatin Shteteror te Punes si organe kompetente për evidentimin dhe penalizimin e këtyre rasteve, mungon veprimi konkret fillimisht nga Inspektoriati Shteteror i Punës dhe në të njëjtën kohë bashkëpunimi i duhur ndërmjet këtyre organeve. Rasti i fundit i punëtorëve të Fabrikës së Tullave “Fabiona” në Vorë tregon se si punëdhënësi i fabrikës ka rreth 7 vjet që mashtron punëtorët duke mbajtur paratë e siguracionit për vete. Shtrohet pyetja: Çfarë ka bërë këto 7 vjet Inspektoriati i Punës, dega e Sigurimeve Shoqërore apo dega e Tatimeve në Tiranë që i ka dhënë çdo vit liçensën këtij punëdhënësi?

Problemi në fjalë lidhur me mospagimin e kontribucioneve të detyrueshme për sigurimet shoqërore ekziston edhe në një sërë ndërmarrjesh publike apo dhe institucionesh shtetërore.

Rast konkret është ai i punëtorëve të Kantjerit Detar në Durrës. Është trajtuar nga ana jonë dhe ka rezultuar që edhe pse p.sh. në këtë ndërmarrje gjysëm shtetërore punonjësve u janë mbajtur nga pagesa kontribucioni për sigurimet shoqërore në përputhje me parashikimet ligjore. Këto pagesa për sistemin e sigurimeve shoqërore nuk janë derdhur nga ana e punëdhënësit, duke krijuar probleme që lidhen me përfitimet nga ky sistem.

Ka edhe mjaft punëdhënës shtetërore që në shumicën e rasteve nxjerrin si pretekst për mospagim mospasjen e aftësise financiare për të kryer një veprim të tillë, qe ne vetvete nënkupton nje shkelje te dyfishtë ligjore;

-së pari; shkelje te së drejtës të punësuarit për t’u paguar në sistemin e sigurimeve shoqërore në përqindjen e përcaktuar nga ana e punëdhënësit;

-së dyti; mospërmbushjen e detyrimit ligjor nga ana e punëdhënësit ndaj sigurimeve shoqërore sipas parashikimeve te Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i cili pasohet edhe nga një mosveprim i mundshëm i vetë organit te ISSH-së per detyrimin e këtyre subjekteve për pagesë apo edhe për penalizimin e tyre.

Kështu në nenin 18 të këtij ligji, përcaktohet shprehimisht se;

“Pagesat e kontributeve gëzojnë përparësi në raport me taksat dhe borxhet. Për kontributet e paderdhura nga subjektet brenda afatit organet e sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të nxjerrin akt detyrimin, i cili është titull ekzekutiv”.

Më poshtë janë paraqitur disa çështje të përfunduara gjatë vitit 2002, të cilat kanë rezultuar te zgjidhura pozitivisht.

1. Qytetari I.Q. banor i qytetit të Fierit, u ankua për mosekzekutimin e Vendimit Administrativ të Komisionit Qendror të Apelit për caktimin e

pensionit që nga data 31.08.1975 duke llogaritur diferencat deri në vitin 1982.

Lidhur me këtë çështje nga zyra jonë u hetua pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe rezultoi se pretendimi i qytetarit ishte plotësisht i drejtë. Në bazë të ndërhyrjes dhe ndërmjetësimit direkt tek titullari i ISSH-së dhe interesimit të vazhdueshëm për zgjidhjen e kësaj çështje së fundmi nëpërmjet korrespondencës zyrtare për këtë rast na është konfirmuar nga ISSH-ja se nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe teknike për të bërë të mundur përfitimin e pagesës të pretenduar nga ankuesi duke dhënë dhe orientimin që ky i fundit të paraqitej për të marrë këtë pagesë.

Në përfundim, duke konsideruar se çështja kishte marrë rrugën e zgjidhjes pozitive, ankuesi u orientua nga ana jonë që t'i drejtohej Drejtorise Rajonale Fier për marrjen e kësaj shume lekësh pasi ne na ishte konfirmuar paraprakisht se fondet për çështjen e tij ishin lëvruar.

2. Qytetarja F.Sh. banore e qytetit Pogradec, ankohet për komisionimin pranë KMCAp-së (Komisionit të Caktimit të Aftësisë për punë) Korçë.

Nga hetimi i zyrës sonë rezultoi se qytetarja nuk kishte marrë dijeni për datën e komisionimit pranë KMCAp-së Epror edhe pse ajo ishte interesuar në mënyrë të vazhdueshme pranë DRSSH-së përkatëse për këtë fakt.

Pra ndodheshim në kushtet kur organi përkatës i administratës nuk kishte informuar shtetasen në fjalë në lidhje me një të dhënë zyrtare e cila me ligj nuk ka pengesa për t'u bërë aksesibël për publikun.

Ndërhyrja e Institucionit tonë ka konsistuar në komunikimin dhe sqarimin e trajtimit ligjor të këtij rasti ndaj DRSSH-Korçë, nga ku u bë e mundur jo vetëm saktësimi i datës së komisionimit, por dhe dhënia e orientimeve të domosdoshme ligjore për trajtimin sa më të saktë të rastit të saj.

Në këto kushte, ankuesja u vu në dijeni të faktit të ndërhyrjes tonë për të mundësuar dhënien e informacionit të kërkuar nga ajo, duke ju dhënë orientimi që të interesohej personalisht pranë Agjensisë së Sigurimeve Shoqërore Pogradec, për datën dhe për domosdoshmërinë e paraqitjes së saj pranë organit kompetent, brenda datës së caktuar për komisionim.

3. Qytetari B.P. banues në qytetin e Kavajës, ankohet për mospërfitimin e pensionit familjar të cilin duhet t'a përfitonte ligjërisht pas vrasjes së djalit të tij, ish efektiv i Komisarariatit të Policisë Kavajë.

Nga hetimet që zyra jonë ndërmori për këtë çështje pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore ajo u zgjidh në mënyrë pozitive për qytetarin, duke

iu bërë lidhja e pensionit dhe duke ju mundësuar kështu përfitimi i një pensioni që i takonte ligjërisht.

4. Qytetari I.K. banor i qytetit të Tiranës, u ankua për mospranim dokumentacioni nga KMCAP-ja për përfitimin e pagesës në bazë të cilësimit si invalid në grupin përkatës.

Nga ana jonë u kërkuan shpjegime të hollësishme, për trajtimin e këtij rasti nga KMCAP-ja pranë DRSSH-së Tiranë. Kjo bëri që veprimi i parregullt i kësaj administrate të korrigjohej, duke mundësuar pranimin e dokumentacionit të paraqitur nga ankuesi.

Pra si përfundim, ankuesit ju bë e mundur zgjidhja e ankesës si dhe mundësimi i procedurave të tjera ligjore, të cilat mund të kenë rezultuar me përfitimin e pagesës përkatëse nga ana e Sigurimeve Shoqërore.

Përveç sa më sipër, një tregues pozitiv është dhe fakti se gjatë hetimit të ankesave individuale të qytetarëve, shqyrtimi i legjislacionit përkatës i ka dhënë Institucionit të Avokatit të Popullit, mundësinë e paraqitjes së rekomandimeve për plotësim dhe ndryshim legjislacioni.

Më konkretisht zyra jonë i është drejtuar me rekomandim Ministrisë së Mbrojtjes për marrjen e inisiativës për një plotësim në VKM nr.381, datë 20.05.1996 që ka dalë për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, duke marrë shkas nga ankesa e disa qytetarëve, për sa vijon më poshtë:

Gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak të detyrueshëm, këta individë kanë pësuar aksidente, të cilat i kanë sjellë si pasojë invaliditet të cilësuar në grupe të ndryshme sipas shkallës së dëmtimit të aftësisë për punë.

Këta individë si pasojë e aksidentit të pësuar në kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në kohë dhe kushte të ndryshme nga njeri-tjetri, sot në bazë të vendimeve të KMCAP-ve përkatëse trajtohen si invalidë dhe përfitojnë vetëm pagesën e pensionit të invaliditetit. Ata kërkojnë dhe një shtesë të veçantë pensioni për shkakun se janë aksidentuar gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak, njëlloj si personat e tjerë që janë aksidentuar gjatë punës në sektorin shtetëror.

Po ashtu edhe në Ligjin Nr.8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, neni 7, thuhet shprehimisht se: “Vjetërsia në shërbimin ushtarak e ushtarakut të Forcave të Armatosura, për efekt page, sigurimi shoqëror (përveç gradës), llogaritet nga data e hyrjes në Forcat e Armatosura si ushtar, kursant (nënoficer) dhe student në shkollat e larta ushtarake”.

Duke qenë se të dyja këto grupime të konstatuara si më lart, janë në të njëjtat kushte, (pavarësisht se në rastin e të aksidentuarve gjatë shërbimit të detyrueshëm ushtarak, detyrimi i shtetit është me direkt), vetë përmbajtja

e VKM-së nr.381, datë 20.05.1996, përbën një mungesë, ose vakum ligjor që shërben si premisë për shkeljen e të drejtave të këtij grupimi individësh.

Kjo gjë bëhet më e kuptueshme, nga përmbajtja e pikës 1, të nenit 52 të Kushtetutës ku thuhet shprehimisht se:

“Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.

Në përputhje me sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka propozuar Ministrit të Mbrojtjes realizimin e inisiativës legjislative për përgatitjen e një projekt-vendimi, në lidhje me një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.381 datë 20.05.1996 “Për zbatimin e Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”. Kjo do të mundësojë përfitimin e një shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit për të gjithë të aksidentuarit gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas kushteve të invaliditetit të përcaktuara në këtë vendim. Akoma kjo çështje është në fazën e shqyrtimit.

Si konkluzion, nga shqyrtimi i çështjeve dhe nga bashkëpunimi me strukturat e sigurimeve shoqërore, në një aspekt krahasues, numri i ankesave vjen gjithmonë e më shumë në rritje. Kemi parasysh që në raportin vjetor të vitit 2001 janë raportuar 118 ankesa për këtë organ, kurse këtë vit janë 174 ankesa dhe kërkesa.

Bashkëpunimi me administratën lokale e qendrore të sigurimeve shoqërore ka qenë rezultativ, duke vërejtur një përgjegjshmëri në rritje të saj, si kundrejt qytetarit dhe kundrejt Institucionit të Avokatit të Popullit.

Vlen të theksojmë se ne i qëndrojmë po të njëjtit mendim, sikundër dhe në raportet e mëparshme, lidhur me administratën e këtij institucioni, e cila paraqitet në nivele të kënaqshme përsa i përket respektimit të ligjit dhe mirëadministrimit në punën e saj.

b) Ndihma dhe Përkujdesi Shoqëror

Shërbimi Social Shtetëror është një pjesë e veprimtarisë së administratës publike, shërbim i cili synon në aplikimin e politikave shtetërore të asistencës sociale ose me para në dorë ose në shërbimet sociale, për grupimin e familjeve të cilësuara të “varfra”, i cili aktualisht përbën 1/5 e numrit të përgjithshëm të familjeve.

Ankesa të lidhura me këtë fushë të drejtuar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2002 janë 116. Nga këto janë përfunduar 50 prej tyre dhe janë akoma në proces shqyrtimi 66 të tjerat.

Kryesisht këto ankesa kanë konsistuar në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, mospërfitim nga e drejta e kujdestarisë. Kështu nga shifrat zyrtare të marra pranë Shërbimit Social Shtetëror del se numri i familjeve përfituese është

reduktuar në 8500 raste, sepse janë vërejtur pas kontrolleve të ushtruara, parregullsi në dokumentacion apo dhe abuzime.

Reduktimi i numrit të përfituesve, për shkaqet e mësipërme, ka përbërë një nga objektet e ankesave. Por ka dhe ankesa të tjera nga qytetarët, duke mos qenë dakort me kriteret e vendosura me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 31.3.2002 “Për ndihmën ekonomike”, i cili ka sjellë si pasojë ndërprerjen e ndihmës ekonomike për persona që merrnin vite me rradhë.

Pas aplikimit të këtij vendimi nga organet e administratës shtetërore të ndihmës sociale ka patur pretendime nga qytetarët për shkelje të të drejtave të tyre, duke kërkuar të caktohen dhe kriteret me të vërtetë objektive për përcaktimin e grupit të personave që duhet të përfitojnë.

Në vijimësi të këtyre konkluzioneve, po ju prezantojmë disa nga ankesat tipike të trajtuara në këtë fushë:

1. Qytetari A.B. banor i qytetit Tiranë, ankohet për mospërfitimin e ndihmës ekonomike dhe me arsyetimin e dhënë nga Njësia Bashkiake përkatëse.

Pas marrjes në shqyrtim të kësaj çështje u bënë verifikimet përkatëse pranë Njesisë Bashkiake, nga ku rezultoi se mospërfitimi i ndihmës ekonomike, ankuesit i ishte privuar pa të drejtë.

Pas ndërhyrjes sonë Njësia Bashkiake ka kryer veprimet për dhënien e pagesës ankuesit, duke u zgjidhur problemi i tij në mënyrë pozitive.

2. Qytetari S.D. banor i qytetit të Pogradecit u ankua pranë zyrës sonë për ndërprerje pa të drejtë të pagesës së ndihmës si kujdestar i vëllait të tij, i cilësuar invalid me Statusin e të Verbrit nga Komuna X.

Pas marrjes në shqyrtim të çështjes komuna u vu në lëvizje me anë të një kërkese nga Institucioni ynë, duke organizuar një takim me ankuesin dhe duke verifikuar problemin.

Në fund nga organi ndaj të cilit drejtohej ankesa u konkludua se pas kontrollit përfundimtar nga Zyra Rajonale e Ndihmës Ekonomike, pagesa i ishte ndërprerë pa të drejtë ankuesit, i cili duhej të paguhej për kujdestarinë. Pra me anë të ndërmjetësimit tonë ky problem mori rrugën e zgjidhjes pozitive, duke gëzuar ankuesi përfitimin e pagesës së kujdestarisë.

3. Duke marrë shkas nga njoftimet publike të Mediave për ngjarjen e ndodhur në Shtëpinë e Foshnjes Durrës, Institucioni i Avokatit të Popullit me iniciativë, ndërmori veprimet e para duke shkuar në vend dhe verifikuar informacionet publike mbi ngjarjen.

Në këtë rast bëhej fjalë për keqtrajttime të fëmijëve të kësaj shtëpie nga ana e kujdestarëve të tyre, keqtrajtim i shprehur në veprime konkrete të dhunshme ndaj këtyre të fundit.

Për nevojat e shqyrtimit të çështjes është kontaktuar me drejtoren e këtij institucioni dhe Prokurorinë e Rrethit Durrës. U informuam se fëmijëve u ishte bërë dhe ekspertiza nga mjekët ligjorë, prandaj nuk u kërkua kryerja e këtij veprimi nga ana jonë.

Kjo çështje ishte në hapat e parë të shqyrtimit edhe nga Prokuroria. Ne gjuqum se kujdestarët e këtij institucioni kishin një përgjegjësi solidare për sa i përket heshtjes dhe moskonstatimeve në kohë të shenjave që kishin fëmijët, pasi ato merren sistematikisht dhe direkt me kujdesin e përditshëm të tyre. Arsytet që ato paraqesin për këtë pakujdesi apo neglizhencë nuk ishin bindëse.

Duke qenë se interesi i fëmijëve është një konsideratë mbizotëruese për të gjitha autoritetet administrative, organet legjislativë apo të drejtësisë, (neni 3 i Konventës “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”), ne i rekomanduam drejtoreshës së institucionit të merreshin masa të përkohshme administrative për pezullimin nga puna të kujdestarëve të Shtëpisë së Foshnjes Durrës, për një kohë të pacaktuar derisa organet e drejtësisë të japin vendimin e tyre. Kjo me qëllim që fëmijët të jenë të qetë psikologjikisht dhe jashtë ndikimit të kujdestarëve, të cilat mund të ndikonin në vijimësi mbi fëmijët, gjatë përkujdesjes së përditshme.

Ky rekomandim është pranuar dhe ndaj personelit të sipërcituar janë marrë masat administrative të kërkua.

Gjatë shqyrtimit të legjislacionit përkatës për ndihmën sociale kanë dalë në pah dhe mangësi ligjore, të cilat krijojnë premisa për shkelje të të drejtave të individit.

Në këtë kuadër janë përgatitur dhe rekomandimet që paraqiten si më poshtë;

1. Qytetari B.I. u ankua lidhur me një vendim të seksionit përkatës të Mbrojtjes Shoqërore, i cili nuk i njeh të drejtën e përfitimit të pagesës së kujdestarisë asnjë prej anëtarëve të familjes së tij, edhe pse ky i fundit e kishte të nevojshme përkujdesjen ndaj djalit të tij, i cili është cilësuar invalid i grupit të parë.

Ky vendim bazohej në VKM-në Nr.605, dt.30.10.1995, “Për kriteret e vlerësimit të ndihmës ekonomike” dhe VKM-në Nr.457, dt.21.08.1995, “Për përfitimin e paaftësisë”, si dhe në Urdhërin Nr.2132, dt.23.09.1998 të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale. Në Urdhërin Nr.2132, dt.23.09.1998, pika 9-të, përcaktohet se:

“Kujdestaria do t’i takojë vetëm familjeve që janë në skemën e ndihmës ekonomike. Me “familje në nevojë”, duhet të kuptojmë familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike”.

Duke ju referuar legjislacionit, nga ana jonë është arritur në konkluzionin se përfitimi i kujdestarisë nuk duhet dhe s'ka pse lidhet me skemën e ndihmës ekonomike. Kështu që kemi rekomanduar pranë Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, shfuqizimin e pikës 9-të, të Urdhërit Nr.2132, dt 23. 09.1998 të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, sepse është në kundërshtim me ligjin në zbatim të të cilit ajo ka dalë.

Pas interesimit tonë të vazhdueshëm, ky projekt vendim, nga procesi i shqyrtimit nga ana e Ministrisë përkatëse, është në pritje të miratimit të tij nga ana e Qeverisë.

2.Nisur nga ankesa e qytetarit B.I. por dhe nga ankesa të tjera është konstatuar një mangësi e Ligjit nr.7710 datë 18.05.1993 “Për Ndihmën dhe Përkujdesjen Shoqërore”, lidhur me mosparashikimin e saktë të rrugës dhe shkallëve të ankimit administrativ nga ana e individëve.

Kështu sipas formulimit të nenit 16, pika 4, gërma “b” dhe nenit 29 të Ligjit nr.7710 datë 18.05.1993 të sipërcituar, rruga e ankimit administrativ del jo e qartë, duke krijuar premisa të moszgjidhjes së problemeve paraprakisht në kuadrin administrative hierarkik korrespondues, por të përfundimit të tyre direkt në gjykatë.

Kërkesa për këtë plotësim lidhet pikërisht me të drejtën e ankimit të individit në rast të mosaprovimit të ndihmës ekonomike, me qëllim të krijimit të një sistemi apelimi pranë Këshillave të Komunës dhe Bashkive dhe pranë Shërbimit Social Shtetëror.

Rekomandimi ynë është pranuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, por është përgjigjur se ky plotësim do të paraqitet në kuadrin e ndryshimeve të tjera që kërkohen të bëhen për Ligjin nr.7710, datë 18.05.1993 “Për Ndihmën dhe Përkrahjen Shoqërore”.

9. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit

a-Ankesa të ndryshme për Ministrinë

Për vetë Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, institucioni i Avokatit të Popullit gjate vitit 2002 ka shqyrtuar 26 ankesa, nga këto 6 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 9 kanë qënë të pabazuara, kurse 11 janë në shqyrtim.

Problematika e ankesave ka qënë kryesisht për shpronësimet për interesa publike dhe problemet që kanë dalë gjatë këtij procesi, mos përfitimi i kompensimeve apo ankesa përkundrejt masës së

kompensimeve, mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore, etj. Kjo problematikë është e njëjtë me atë të prezantuar edhe në Raportin e vitit 2001.

Ka patur dhe ankesa të cilat lidhen me procedurat e privatizimit të banesave nga ana e Entit Kombëtar të Banesave dhe degëve në rrethe. Gjithashtu do të veçonim edhe ankesa që lidhen me mos zbatimin e ligjit Nr.8503, date 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, të cilat në të gjitha rastet pas ndërhyrjes tonë institucionale janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Ankesat e shtetasve që lidhen me moszbatimin e VKM-së Nr.85, datë 2.03.1994 “Për vënien në dispozicion të zonave të banimit për familjet që shpërngulen nga Ujëmbledhësi i Bovillës dhe ato që kanë ndërtuar pa leje, përreth qytetit të Tiranës”, si dhe të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, u paraqitën edhe vitin e kaluar. Gjatë shqyrtimit në vijimësi të këtij problemi, pas rekomandimeve tona mendojmë se çështja është vënë drejt rrugës së zgjidhjes, me hartimin e projekt vendimit nga ana e Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit. Kjo Ministri ka propozuar që për shpronësimet për interes publik dhe kompensimet e kurores së Bovilles, larg zonës së liqenit të përfshihen edhe familjet të cilat nuk e përfituan këtë të drejtë me daljen e VKM-së Nr.85, datë 2.03.1994, por me vendime gjyqësore. Duke besuar në këtë angazhim të dikasterit në fjalë, besojmë edhe në zgjidhjen e këtij problemi sa të drejtë aq dhe të ligjshëm.

Si problem shumë specifik që do të veçonim gjatë këtij viti dhe që është në ndjekje që prej vitit 2001, është propozimi që i kemi paraqitur në vijimësi të gjithë titullarve të këtij dikasteri. Ky ka të bëjë me propozimin për ndryshimin e ligjit Nr.7665, date 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”.

Ligji i mësipërm dhe përkatësisht nenet 7/c dhe 13 të tij janë bërë objekt i ankesave dhe rezulton se këto nene janë në kundërshtim dhe me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Përmbajtja e nenit 13 të këtij ligji shpreh se: “Për çështjet që trajton ky ligj do të zbatohen dispozitat e tij, pavarësisht se ç’parashikojnë dispozitat e tjera ligjore”. Ky ligj me këtë formulim neglizhon ligjin themeltar të shtetit Kushtetutën, e cila njih dhe garanton të drejtën e pacënueshme të pronës private dhe parashikon kufizime të ushtrimit të kësaj të drejte, vetëm për interesa publike, duke i lejuar këto kufizime ose shpronësime kundrejt një shpërblimi të drejtë. Kjo ka sjellë mos gëzim të pronës nga pronarët që kanë toka në zonat turistike, por edhe shpërdorim të asaj që vazhdon të jetë pronë shtetërore. Në kushtet si më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi të merret

iniciativa ligjvënëse për shfuqizimin e tyre. Gjatë vitit 2002, ju bë ndryshim ligjit Nr.7665, date 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi Turizmin”, por ky ndryshim preku vetëm ëmërtimin e autoritetit përgjëgjës, nga Ministria e Punëve Publike në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit. Ndërsa rregullimi në thelb i çështjes, ndryshimi i neneve që prekin interesat e ligjshme të pronarëve, nuk u mor në konsideratë. Për këtë shkak çështja është ende evidente dhe ankesat e shtetasve kanë mbetur pa zgjidhje, duke e mbartur problemin edhe për vitin 2003.

Një çështje tjetër që vlen të bëhet prezent në këtë raport, është dhe çështja e 640 familjeve, banorë të qytetit të Durrësit të cilët janë strehuar në shtesat e kateve apo shtesa anësore mbi pronat e ish pronarëve, të cilët kanë rifituar të drejtën e pronësisë me Vendime të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Pranë Institucionit tonë ankesa është paraqitur nga Shoqata e të pastrehëve të kësaj kategorie në qytetin e Durrësit, por shtrirja e problematikës është në të gjitha qytetet e vendit. Kjo për arsye se neni 13 i ligjit Nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”, cënon parimin kushtetues të barazisë para ligjit. Ky nen injoron hapur pronësinë dhe bashkëpronësinë e banesave për pjesët e shtesave të kateve dhe shtesave anësore të pronave të ish pronarëve, shtesa të cilat janë ndërtuar me kontribut vullnetar me fondet e shtetit para viteve 1990. Neni 13 i ligjit të mësipërm përcakton se: “Kur në objektet ish prone private janë kryer nga shteti apo pronari shpenzime për ndryshime në strukturë, shtesa anësore apo shtesa kati, etj objekti i kthehet ish pronarit pa kundërshpërblim, kur vlefata e shpenzimeve përben deri në 20 % të vlerës së objektit dhe kur kjo vlerë është deri në 50 %, ai mund t’i kalojë në pronësi ish pronarit, pasi të jetë shlyer nga ana e tij kundërvlefata e mësipërm. Kur vlefata e shpenzimeve është mbi 50 % të vleftës së objektit, objekti mbetet në bashkëpronësi”. Sipas këtij neni ish pronarët janë bërë pronarë edhe mbi rreth 640 apartamente të tjera, vetëm në Durrës që shteti ka shtuar mbi pronat e tyre, kundrejt shpërblimeve simbolike. Këto familje që konsiderohen të pastreha jetojnë prej 30 vitesh në këto shtesa katesh dhe u mohohet mundi dhe djersa e tyre për ndërtimin që ata kanë bërë me kontribut vullnetar. Njëkohësisht trajtimi në këtë mënyrë i banesave të tyre, rëndon shumë shtetin, duke shtuar numrin e kategorisë së të pastrehëve, sepse kanë kaluar 10 vjet dhe nuk po marrin strehim nga banesa të ndërtuara me fonde publike. Kjo çështje është në ndjekje e sipër. Për këtë është marrë dhe një informacion edhe nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

Gjatë shqyrtimit të ankesave me këtë Ministri gjatë vitit 2002 janë evidentuar dhe çështje të tjera të cilat lidhen kryesisht me marredhëniet e punës dhe gjithë problematikat që kanë lindur gjatë zbatimit apo mos zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës. Kështu vlen të përmendet ankesa e një grup punonjësish të Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Ujësjiellësave. Ata të cilët na kanë shprehur shqetësimin e tyre për mos derdhje të kontributeve shoqërore pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore që nga muaji Nëntor i vitit 1997, mos likuidimin e pagës për punën e kryer që nga muaji shkurt i vitit 2002, si dhe çështje të tjera që lidhen me punën organizative në këtë Institut. Kjo çështje sa e rëndësishme, aq dhe ligjore, për të drejtat e punonjësve që burojnë nga vete ligji, është në shqyrtim e sipër nga zyra jonë. Pas kërkesës që i kemi dërguar Ministrisë, ende nuk kemi asnjë përgjigje.

Edhe këtë vit në këtë Ministri, janë konstatuar shkelje të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Si pengesë në çdo rast paraqitet mungesa e fondeve, por nuk shpjegohet se çfarë dikasteri duhet të bëjë për t'i dhënë zgjidhje problemit.

b. Ankesat për ndërtimet pa leje

Planifikimi urban, si në planin njerëzor të lëvizjes së lirë të popullsisë dhe në planin urbanistik të ndërtimeve, tashmë pas një eksperience më shumë se dhjetë vjeçare, ka dalë si një nga prioritetet e zhvillimit të vendit, për përballimin e sfidave të zhvillimit progresiv në shumë drejtime.

Në dallim nga problematika e vitit të shkuar, në lidhje me ndërtimet pa leje, konstatojmë se tashmë është kaluar nga faza e parandalimit të ndërtimeve të reja të kundraligjshme, në fazën e evidentimit të plotë dhe të ekzekutimit të tyre (prishjes), nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit.

Gjatë vitit 2002, për këtë problematikë, rezulton se janë marrë në shqyrtim 126 ankesa, nga të cilat 117 lidhen me veprimtarinë e Policisë të Ndërtimit. Ka një rritje me 47 ankesa, në krahasim me vitin 2001.

Nga këto ankesa, deri në fund të vitit 2002, rezultojnë të përfunduara 71 ankesa dhe akoma në shqyrtim janë 56 ankesa.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara ka rezultuar se: janë zgjidhur në favor 8 çështje, të pabazuara 6 çështje, kurse jashtë juridiksionit dhe kompetencës 57 çështje.

Nuk kanë munguar rastet kur veprimi ka qenë i pjesshëm dhe jo në përputhje me vendimet administrative përkatëse, apo ka qenë i

kundraligjshëm nga ana e Policisë të Ndërtimit. Faktikisht sikurse del edhe nga ankesat e paraqitura, shumica e ndërtimeve pa leje, janë probleme të mbartura nga vite mëparshme dhe lidhen me mosveprimin e organeve vendim-marrëse apo edhe ekzekutive sipas rastit.

Një tregues, i cili është evidentuar edhe në raportin paraardhës është se ka një rënie të dukshme të ngritjes së ndërtimeve pa leje, sidomos nga individët, dukuri kjo që nga fillimi i viteve 90', mori përmasa shumë të mëdha, veçanërisht në qytetet kryesore të vëndit. Problemi shfaqur këtë vit është i mosrespektimit i projekteve të miratuara në lejet e ndërtimit.

Evidentojme se numri i çështjeve të papërfunduara nga ana jonë është rreth 47 %. Arsyeja kryesore për këtë është mungesa e gadishmërisë së organit të Policisë të Ndërtimit, por edhe e KRRT-ve, pranë Bashkive, për kthimin e përgjigjeve të kërkuara prej nesh, për sqarimin e çështjeve të paraqitura.

Më problematike në respektimin e këtij detyrimi ligjor janë Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Vlorë (KRRT-të), ndërsa përsa i përket organit të Policisë të Ndërtimit, problematike shfaqen Degët e Policisë të Ndërtimit, Tiranë, Durrës, Vlorë, por edhe vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit.

Në mënyrë të vazhdueshme nga ana jonë është kontaktuar zyrtarisht me përfaqesues të Bashkive të cituara me lart, si dhe me drejtues të degëve të Policisë të Ndërtimit, në rrethe si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të këtij organi. Një takim i tillë është organizuar më datë 22.06.2002 ndërmjet Avokatit të Popullit, me Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit dhe të gjithë kryetarët e degëve në rrethe. Menjëherë pas këtij takimi ku u parashtruan të gjitha problemet në mënyrë të specifikuar, pati një përmirësim të punës, por aktualisht ndodhemi përseri pothuajse në të njëjtat kushte të mosrespektimit të detyrimeve nga ky organ.

Në të njëjtën kohë jemi të ndërgjegjshëm edhe për vështiresitë që ka në veçanti organi i Policisë të Ndërtimit, për ekzekutimin e vendimeve të ndryshme, vështirësi që vijnë nga mungesa e personelit, e mjeteve, ndërrimi i herë pas herëshëm i personelit drejtues. Por kjo nuk justifikon mosveprimin në vazhdimësi për probleme dhe çështje, për të cilat institucioni ynë ka një periudhe mëse dy vjeçare që është involvuar në shqyrtimin e tyre dhe që rezultojnë me neglizhencë dhe mosveprim të hapur të këtij organi. Jo vetëm kaq, por shpeshherë në trajtimin e shumë ankesave vërehet një "lojë" shkresash zyrtare ndërmjet KRRT-ve me Bashkitë apo me degët e Policive të Ndërtimit në lidhje me vendim-marrjen përkatëse për ndërtime të ndryshme të evidentuara si të kundraligjshme.

Në disa raste është ndërhyrë nga ana jonë me rekomandime për shpjegimin e përkatësisë të procesit të vendim-marrjes, rekomandime të cilat synojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjes dhe vënien në vend të të drejtës së shkelur të individit.

Nje tjetër rast shumë i njohur, është rasti i kullave “Hawai”, i cili megjithëse është akoma në shqyrtim nga ana jonë, rezulton me kapërcim kompetencash në marrjen e vendimit përkatës nga ana e KRRT-se pranë Bashkisë Tiranë (neni 78), dhe mosveprim paraprak me kompetencat që i jep ligji nga Dega e Policisë të Ndërtimit, të Tiranës.

Mosveprimi i organit të Policisë të Ndërtimit, është një problem i cili evidentohet me qartë në ankesat e paraqitura, pasi ekzekutimi i përcaktuar në ligj bëhet në rastet e vendimeve të KRRT-ve që shprehen për prishje objektesh të paligjshme, apo edhe në vetë vendimet që ky organ merr për prishje në bazë të kompetencave që ai ka.

Përsa i përket kësaj pike duhet theksuar se kjo është edhe çështja me e prekur në të gjitha ankesat e paraqitura, pasi ka një mori vendimesh të cilat jo vetëm nuk ekzekutohen, por zvarriten për vite, ose ndodh që nuk zbatohen plotësisht, duke u bërë shkak për pasoja të tjera që ndikojnë në shkeljen e të drejtave të ankuesve, ose nganjëherë edhe me pasoja financiare për vetë shtetin.

Nuk duhen lenë pa u përmendur edhe ankesa të nje grupimi tjetër, por që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Policisë të Ndërtimit në kundërshtim me ligjin, duke prishur objekte të ligjshme. Një numër i caktuar ankesash janë paraqitur për prishje të ndërtimeve të përkohshme (kioskat), të cilat me kalimin e kohës ishin shndërruar në objekte me konstruksion tullash dhe betoni, ndërsa zotëruesit e tyre, kishin mundur të bënin edhe hipotekimin e këtyre objekteve, nëpërmjet vendimeve të dhëna nga proceset gjyqësore me objekt, “vërtetim fakti juridik të pronësisë mbi këto ndërtime”, formë regjistrimi, e cila është e kundraligjshme. Këto raste janë konsideruar nga ana jonë të pabazuara, ose në raste të veçanta ankuesve ju janë dhënë orientime për rruget e mundshme që ata duhet të ndjekin.

Shqyrtimi i disa ankesave, ka nxjerrë në pah edhe probleme që lidhen me legjislacionin apo edhe aktivitetin e organeve të pushtetit vendor, në përmbushje të kompetencave dhe detyrimeve ligjore. Është fakt se në shumë ankesa për ndërtime të kundraligjshme, Policia e Ndërtimit në zbatim të kompetencave bën pezullimin e punimeve në objekt deri në sqarimin e çështjes. Por ndodh rëndom që edhe pse është marrë vendim për pezullim punimesh, firmat e ndërtimit vazhdojnë punën, duke e përfunduar ndërtimin, derisa në momentin final të vendim-marrjes, ai është bërë fakt i

kryer. Kështu që mund të themi se ky vendim pezullimi si mase parandalimi, në formën që ai nxirret, duket se nuk ka forcën e duhur ligjore për të qenë i detyrueshëm për subjektin ndaj të cilit merret. E themi këtë sepse shpesh edhe pse punonjesit e Policisë të Ndërtimit, mund të shkojnë përditë në objektin e pezulluar dhe kërkojnë të mos vazhdojnë punimet, përsëri pasi ata largohen punimet vazhdojnë, madje me ritme me të shpejta. Ndoshta duhet menduar për një formë tjetër ligjore detyruese të këtyre vendimeve pezulluese, sikurse edhe në rastin e faturave të KESH-it për energjinë elektrike.

Nga ana tjetër, shpesh ankesat bëhen sepse studimet urbanistike pjesore apo tërësore në shumë prej Bashkive tona, mungojnë ose i përkasin periudhave të cilat nuk kanë parashikuar një zhvillim të tillë urban si ky që ne kemi aktualisht. Ky mosveprim nga ana e strukturave përkatëse në këto organe të pushtetit lokal, ka sjellë konfuzion në ndërtime, si në ato të ligjshme, ashtu edhe në ato të paligjshme dhe për më tepër, bën shumë herë të diskutueshme edhe kompetencën e KRRT-se për vendim-marrje ndaj ndërtimeve pa leje, në zbatim të nenit 77 të Ligjit “Për urbanistikën”. Prandaj, ka ardhur koha që të veprohet me përparesi e me shpejtësi në këtë drejtim.

Problem i cili është në ndjekje nga ana jonë, është edhe ai i shkeljes së parashikimeve dhe përcaktimeve në vendimet përkatëse të KRRTSH-së, në vendimet e dhëna nga KRRT-të e Bashkisë për leje ndërtimi në zonën e plazhit të Durrësit. Kjo është konsideruar si çështje e rëndësishme sepse në thelb kemi të bëjmë me kundraligjshmëri në dhënien e vendimeve për leje ndërtimi, kur formalisht ato paraqiten si të rregullta.

Nje tjetër problem i cili është evidentuar gjatë kësaj kohe, sidomos gjatë ekzekutimit të vendimeve për prishje nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, për ndërtimet pa leje, është ai i moszbatimit të nenit 84, të Ligjit “Për urbanistikën”, që parashikon se:

“Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet e prishjes, të përcaktuara në këtë ligj, paguhen nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve, nga data e njoftimit të vendimit të organit të Policisë të Ndërtimit, ose nga dita kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 për qind në ditë deri në një muaj. Pas kalimit të këtij afati (një muaj), organet e Policisë së Ndërtimit kërkojnë ekzekutimin e tij në rrugë gjyqësore, sipas ligjeve në fuqi. Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet paguhen në zyren e financës se organit të pushtetit lokal”.

E evidentojme këtë fakt pasi prishja e një ndërtimi pa leje është në favor të një komuniteti të caktuar njerezish, por shpenzimet e këtij veprimi nëse nuk paguhen nga kundravajtësi, rëndojnë në xhepat e këtij komuniteti.

Dhe me sa dijmë në asnjë rast shpenzimet për prishje dhe pastrim të territorit, nuk i janë ngarkuar kundërvajtësit që ka ndërtuar pa leje.

Me poshtë po paraqesim disa nga rastet e shqyrtuara nga ana e zyrës sonë:

1. Ankesa e shtetases V.T (Tiranë)

Shtetësja V.T, ankohet në lidhje me mosveprimin e Policisë të Ndërtimit, dega Durrës, për prishjen e ndërtimeve të paligjshme, të ngritura në truallin pronë e saj, pranë Shkëmbit të Kavajës, nga ana e qytetarëve G.N dhe D.Sh, që kanë ngritur një hotel pa leje.

KRRT-ja pranë Bashkisë Durrës, me vendimin e tij nr.1885 datë 16.09.2001, ka vendosur prishjen e ndërtimeve të paligjshme të ngritura nga qytetaret e sipërcituar, në truallin pronë e ankueses, por dega e Policisë të Ndërtimit nuk ka reaguar për të vepruar, duke nxjerrë pretendime të ndryshme.

Pas pranimit të kësaj ankese për shqyrtim nga ana e Zyres sonë, janë marre kontakte të vazhdueshme me këtë organ, përsa i përket trajtimit që i ishte bërë këtij rasti dhe mundësisë së veprimit të tij, mbi bazën e vendimit të sipërcituar të KRRT-së, pranë Bashkisë Durrës dhe të kompetencave që ka, në përputhje me Ligjin Nr.8408, datë 25.09.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”.

Në baze të këtij komunikimi, organi në fjalë nëpërmjet shkresës nr.64 datë 26.02.2002, na është përgjigjur se në vazhdim të procedurave ligjore për këtë rast, do të ndërhyej për prishjen forcërisht të objekteve të kundraligjshme të ngritura në pronën e V.T, deri në datën 1.03.2002.

Edhe pse ky afat kohor nuk u respektua, gjithmonë në kuadër të mireëunksionimit të organeve të administratës publike dhe të rigorizitetit të komunikimit të vendosur, u ra dakort që përfundimisht të veprohej për sa me sipër deri në datën 13.03.2002. Përseri nuk u ndërmor asnjë veprim konkret nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Durrës.

Edhe pse nga ana e këtij organi jemi venë në dijeni se janë bërë njoftimet paraprake për prishje, asnje shkak, të paktën i njohur deri tani, nuk mund të justifikojë mosndërhyrjen e tij, ndërkohë, që nga nxjerrja e vendimit të lartpërmendur të KRRT-se pranë Bashkisë Durrës kanë kaluar afër 2 vjet.

Mosveprimi i këtij organi ka përbërë shkak për vazhdimin e cënimit të të drejtës së pronës së ankueses, ndërkohë që ky mosveprim përbën edhe shkelje ligjore të mospërbushjes së detyrave funksionale të tij.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, i është rekomanduar nga ana jonë Policisë të Ndërtimit, dega Durrës, ekzekutimi i vendimit të KRRT-seë pranë Bashkisë Durrës, për prishjen e ndërtimeve të paligjshme të ngritura

në pronën e V.T. Të shpresojme që aksioni i ndërmarrë nga Policia Ndërtimore në shkallë Republike, për prishjen e ndërtimeve pa leje, në zonat e plazheve të përfshijë edhe zgjidhjen e ankësës së V.T.

2. Ankesa e paraqitur nga D.R (Durrësi)

Ankesa e paraqitur nga shtetësja D.R, ka të bëjë me një ndërtim (shtese), me sipërfaqe të madhe dhe pa leje ndërtimi, të ngritur ngjitur apartamentit të saj nga shtetasi A.Z.

Sikundër ajo shkruan, në vazhdim të një dyqani të cilin A.Z e ka në pronësi dhe që është ngjitur me apartamentin e ankueses, ai ka bërë ndërtimin pa leje, që i ka bllokuar ajrosjen dhe dritën apartamentit në fjalë. Po në lidhje me këtë ndërtim, në bazë të kërkesës së ankueses së sipërcituar, KRRT-ja pranë Bashkisë Durrës, ka vendosur prishjen e ndërtimit të paligjshëm në fjalë.

Në këtë rast dega e Policisë të Ndërtimit, Durrës, edhe pse është e detyruar ligjërisht të veprojë në zbatim të vendimit të KRRT-së, nuk ka vepruar dhe nuk vepron. Për këto arsye ky rast vazhdon të mbetet në shqyrtim nga ana jonë.

Këto janë dy nga rastet tipike të mosveprimit të Degës së Policisë të Ndërtimit, Durrës, e cila ka treguar një neglizhencë të dukshme jo vetëm në trajtimin e tyre, sipas kompetencave përkatëse ligjore, por edhe në përmbushjen e detyrimeve që ka ligjërisht ndaj kërkesave të drejtuara nga Institucioni ynë, kërkesa të cilave edhe pse të përseritura, sot e kësaj dite, nuk ju është kthyer përgjigje.

3. Ankesa e paraqitur nga shtetasi Y.M (Korçë)

Ankuesi në letrën e tij, shpreh shqetësimin në lidhje me mosveprimin e Policisë të Ndërtimit, dega Korçë, për sa i përket prishjes së një ndërtimi pa leje të ngritur në pronën e tij nga ana e shtetasit E.H.

Sikundër ai shkruan, është pronar i ligjshëm i një dyqani, pronë që e ka trashëguar nga i ati, por shtetasi i sipërcituar, jashtë çdo norme ligjore dhe qytetare, e ka shkatërruar atë dhe ka filluar të ngrëjë një ndërtim pa leje. Për këtë problem ankuesi i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Ndërtimit, Tiranë, si dhe degës së saj të Korçës dhe për pasojë nga ky organ është marrë vendimi për prishjen e këtij ndërtimi të kundraligjshëm.

Megjithatë, deri në kohën që ankesa ka mbërritur në Institucionin tonë ky vendim kishte ngelur në letër, pasi nuk ishte ekzekutuar nga ana e Policisë së Ndërtimit, dega Korçë.

Bazuar në këtë ankesë, me anë të një ndërmjetësimi të drejtëpërdrejtë me drejtuesit e Degës së Policisë të Ndërtimit, Korçë, është rënë dakort që

për ekzekutimin e këtij vendimi të veprohej brenda një kohe të shkurtër, duke përcaktuar edhe datën përkatëse.

Në të njejtën kohë, është komunikuar njeherazi me ankuesin dhe më pas me degën e lartpërmendur, të Policisë të Ndërtimit. Jemi vënë në dijeni se vendimi për prishje të ndërtimit të paligjshëm ishte ekzekutuar, duke realizuar kështu vënien në vend të të drejtës se shkelur të ankuesit.

4. Ankesa e paraqitur nga shtetasi E. P (Tiranë)

Kjo ankesë nuk ka si objekt të saj direkt ndërtimet pa leje, por jepet si një rast veprimi të kundraligjshëm nga ana e Policisë të Ndërtimit, dega Tiranë.

Objekti për të cilin ka dalë një vendim për prishje faktikisht ishte i ligjshëm. Por edhe pas ndjekjes së ankimit administrativ nga ankuesi, nuk respektohen as afatet përkatëse, nuk bëhen as verifikimet e duhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit, bazuar në dokumentacionin e pronësisë të paraqitur nga ankuesi dhe si përfundim, prishet një objekt i cili, është pronë e ligjshme dhe që faktikisht duhet të rendojë mbi organin veprues në formën e shpërblimit të dëmit ndaj pronarit të tij.

Pas ankeses se shtetasit E.P, doli se ndërtimi i ngritur prej tij, në bazë të lejes të dhënë për këtë objekt nga KRRT-ja pranë Bashkisë Tiranë. Ndërtimi ishte ngritur në truallin pronë të ankuesit. Organi i Policisë të Ndërtimit Tiranë, pa përfillur aspak dokumentacionin e pronësisë dhe lejen e ndërtimit, në mënyrë të dhunshme ka realizuar prishjen e objektit, duke i shkaktuar ankuesit një dëm mjaft të madh ekonomik.

Realisht në kushtet e trajtimit të këtij rasti, kemi të bëjmë me një dëm jashtëkontraktor të shkaktuar nga organi i Policisë të Ndërtimit, si pasojë e veprimit të tij, që rezulton të jetë i kundraligjshëm. (Ligji Nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore). Për sa me sipër, i është rekomanduar nga ana jonë Drejtorise se Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit fillimi i procedimit administrativ nga ana e këtij organi, për shpërblimin e dëmit material të shkaktuar ndaj shtetasit E.P.

5. Ankesa e paraqitur nga shtetësja S.Sh. (Tiranë).

Çështja ka të bëjë me pretendimin e ankueses se Policia Bashkiake Tiranë, pa ndonjë vendim të mëparshëm të KRRT-së pranë kësaj bashkie, më datën 19.08.2002, i ka dërguar shtetases, njoftimin për prishje të ndërtimit, që është një përshtatje e një pjese të shtëpise së saj në një lokal.

Nga hetimi i bërë për këtë çështje nga ana jonë rezultoi mes tjerash se ky ndërtim është bërë që në vitin 1993. Përveç kësaj, pretendohet se ndërtimi ishte bërë me leje të organeve kompetente.

Në rastin konkret, doli se kemi të bëjmë me një veprim të parakohshëm të Policisë Bashkiake pasi, nuk kemi të bëjmë me parandalim të një ndërtimi që po ngrihet, apo me një ndërtim të bërë pa leje, pas vitit 1998.

Është pikerisht ligji nr 8405 datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", i cili në nenin 75 paragrafi i dytë parashikon qe: "Vënia e gjobes, prishja e objektit dhe kthimi i truallit në gjendjen e mepareshme, realizohet në baze të urdherit të dhenë nga kryetari i deges se Policise se Ndërtimit në rreth. Ekzekutimi i urdherit behet nga Policia e Ndërtimit (nënvizimi ynë) me ndihmen e organeve dhe subjekteve të specializuara"

Asnje dispozitë e ligjit nr 8224 datë 15.05.1997 "Për organizimin edhe funksionimin e Policise Bashkiake" nuk i jep kesaj të fundit kompetencat e vendimmarrjes për raste të tilla.

Jo vetëm kaq por, për rastin kur kemi të bëjmë me nje ndërtim të bërë para hyrjes në fuqi të ligjit nr 8405 datë, 17.09.1998, sipas nenit 77 të këtij ligji, parashikohet që kompetente për marrjen e vendimit për prishje apo legjitimim të ndërtimit është KRRT-ja përkatëse.

Për rastin konkret ne nuk kemi hetuar dhe nuk kemi dalë në ndonjë përfundim, nëse objekti për të cilin behet fjale është i ligjshëm apo jo, por përfundimi ynë konsiston në faktin se për prishjen e tij, duhet tëi përcillet çështja KRRT-së për të vendosur dhe jo t'i marrë këto attribute "apriori", Policia Bashkiake e Tiranës.

Duke studjuar mbështetjen ligjore mbi të cilen justifikohet veprimi i Policisë Bashkiake të Tiranës, rezultoi se si e tillë nuk mund të shërbejë një urdhër i nxjerrë nga Bashkia me nr. 290, datë 14.08.2002. Kjo për faktin se në rastin konkret, kemi të bëjmë me keqorjentim nga Policia Bashkiake, duke kapërcyer kompetencat që i jep vetë urdheri.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështje i rekomanduam Bashkisë Tiranë, marrjen e masave të nevojshme për respektimin e procedurave ligjore në lidhje me angazhimin e Policisë së saj Bashkiake për prishjen e objektit si dhe analiza dhe përgjithësimi i rastit për nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse, me qëllim për të parandaluar çdo veprim arbitrar në kapërcim të kompetencave dhe në kundërshtim me ligjin, sepse sjellin si pasoje shkeljen e të drejtave të njeriut.

Rekomandimi është pranuar dhe Policia Bashkiake ka pezulluar urdhërin e saj, deri në shprehjen me vendim nga ana e KRRT-së pranë Bashkisë Tiranë në lidhje me këtë ndërtim.

c. Ankesat për Ujësjellës Kanalizimet

Ankesat për këtë shërbim i kemi vendosur bashkë me ato për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për shkak se në këtë dikaster ka një drejtori për këtë shërbim. Gjithsej për problemet që kanë të bëjnë me ujësjellës kanalizime, gjatë vitit 2002 kemi patur 5 ankesa.

Është fakt që për këtë shërbim ka patur një numër të vogël ankesash, por problemet që duhen rregulluar nuk janë të pakta. Cilësia e çdo shërbimi ka si tregues çmimin që paguhet dhe pikërisht që aty nis interesimi ose jo për cilësinë e tij. Dihet se aktualisht ky shërbim jetik ofrohet me një çmim shumë të ulët për kushtet e ekonomisë së tregut, prandaj mund të themi se ndoshta ky çmim e mban peng mungesën e investimeve të rëndësishme në rrjetin e amortizuar, zgjerimin e tij etj. Dihet se nga Entet e Ujësjellës Kanalizimeve si Korçës, Krujës, Fushë Krujës, është arritur që, të dyja palët, si konsumatorët dhe ky Ent, të punojnë së bashku për mirëadministrimin dhe cilësinë e shërbimit. Kjo falë edhe ndihmës gjermane në këto projekte, por edhe konsumatorët janë bërë më të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tyre.

Një bashkëpunim të frytshëm Institucioni ynë ka gjetur me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve të Tiranës, e cila vuri në dispozicion të Avokatit të Popullit jo vetëm praktikën dhe bazën juridike, ku bazohet ky shërbim por kërkoi ndihmën e Institucionit tonë. Doli se ky Ent ka një bazë juridike shumë të mangët. Deri tani ky shërbim bazohet vetëm në një V.K. Ministrave nr.236, datë 10.09.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”, i cili nuk përputhet sot me realitetin, sepse ky shërbim është shndërruar në shoqëri aksionere. Ky akt nënligjor e lë në mënyrë kaotike varësinë e këtij Enti nga strukturat shtetërore. Kjo doli dhe në rastin e përmbytjes së Tiranës në shtator 2002, apo dhe në rastin e qytetit të Laçit, për mospërcaktimin e përgjegjësisë së klorifikimit të ujit. Pikërisht për këto arsye Avokati i Popullit i ka dërguar Kryeministrit të Shqipërisë zotit Fatos Nano, një Rekomandim ku ndër të tjera thuhet: “Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga ankesa të vazhdueshme të konsumatorëve të ndryshëm, si dhe duke bashkëpunuar në vazhdimësi me Ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizimeve të qyteteve kryesore të vendit, ka konkluduar se shërbimi publik i Ujësjellësit dhe Kanalizimeve ka mangësi të theksuara ligjore. Konkretisht:

Ky shërbim, ndryshe nga ai i furnizimit me energji elektrike dhe ai i telekomit, bazohet vetëm në një Vendim të Këshillit të Ministrave me

Nr.236, datë 10.09.1993 “Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë”. Duke e studjuar me kujdes del që, në kushtet e sotme Vendimi i sipërcituar nuk i shtrin më efektet në realitetin ku ndodhet sot sistemi Ujësjiellës Kanalizimeve. Aktualisht ky system është shndërruar dhe në shoqëri aksionere. Në VKM e sipërcituar nuk ka një përshkrim të qartë të objektit të veprimtarisë së Ujësjiellës Kanalizimeve, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve lënë shteg për interpretime, sanksionet penale që janë parashikuar me Dekretin e Presidentit të Republikës me nr.894 datë 21.07.1994 janë të pazbatueshme, varësia e këtij shërbimi nga shumë struktura është i paqartë dhe jo efikas. Këto defekte kanë dalë edhe nga analizat e zhvilluara me rastin e përmbytjes në Tiranë, problemet në Laç etj.

Mbarëvajtja e këtij shërbimi jetik, ndaj të cilit të gjithë jemi të sensibilizuar, pasi njëkohësisht jemi dhe konsumatorë të tij, kërkon me emergjencë hartimin e bazës ligjore bashkëkohore, e cila të jetë bazë jo vetëm për një shërbim më cilësor, por dhe për privatizimin e tij në vazhdimësi, konform procedurave të ekonomisë së tregut.

Në këto kushte, duke qenë se realiteti i mangët ligjor i këtij shërbimi ndikon në shkeljen e të drejtave dhe interesave të të gjithë konsumatorëve, rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e infrastrukturës ligjore të shërbimit publik të Ujësjiellës Kanalizimeve.

Me këtë rast shprehim edhe gatishmërinë tonë për të dhënë ndihmesën për këtë fushë dhe vënien në dispozicion të ekspertëve tanë.

Besojmë se nga ana e Qeverisë do t’i kushtohet vëmendja e duhur çështjes së mësipërme”.

10. Ministria e Ekonomisë

Rezultojnë vetëm 9 ankesa ndaj Ministrisë së Ekonomisë, nga të cilat 4 kanë rezultuar jashtë juridiksioni, 2 janë zgjidhur në favor dhe 3 të tjera janë në proces shqyrtimi. Kryesisht subjektet ankues kanë qenë punonjës të shoqërive aksionere, një pjesë e kapitalit të të cilave është shtetëror, ndërsa objekt i këtyre ankesave kanë qenë kryesisht probleme të marrëdhënieve të punës në këto sh.a.

-Shtetasi Ll.Ç. ka paraqitur një ankesë, ku kërkon rregjistrimin e kapitalit aksioner në “Prodhim material ndërtimi” sh.a. Elbasan në Gjykatën e Tiranës si pronar truall, pasi 51% të kësaj shoqërie e ka blerë firma 2K. Kjo e fundit nuk ka lejuar transferimin e aksioneve, sepse i ka rregjistruar të gjitha në emër të firmës së tij. Këtë problem ankuesi e kishte

paraqitur pranë Ministrisë së Ekonomisë, dhe meqenëse nuk i është kthyer asnjë përgjigje, na është drejtuar me ankesë.

Nga verifikimi që i bëmë ankesës, pranë Ministrisë së Ekonomisë u sqaruam, se fillimisht ky problem është trajtuar nga AKP, ku ankuesi duhej të paraqiste dokumentat për të marrë pjesë në ankandin e zhvilluar, si pronar trualli. Prandaj për zgjidhjen e kësaj ankese, Zyra jonë ndërmjetësoi pranë Drejtorisë së Privatizimit të Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla (SME) të Ministrisë së Ekonomisë, në mënyrë që të vihej në rrugën e zgjidhjes problemi i parashtruar.

Ankesa e I.B., ish punonjëse e ndërmarrjes “Fu-Farma”, me detyrën e përgjegjëses së Repartit Laborator lëndë djegëse etj., detyrë të cilën e ka kryer nga viti 1978 deri në datën 23.07.1998, kohë në të cilën ka dalë në pension, lidhet me disa përfitime që i rrjedhin nga kontrata kolektive e punës me shoqërinë në të cilën ka qenë e punësuar. Në bazë të kontratës kolektive të punës, të gjithë punonjësit e kësaj Sh.A., në të cilën ka qenë e punësuar dhe ankuesja, kanë marrë 4 paga shtesë, kur kanë dalë në pension kurse ankuesja ka përfituar vetëm një pagë. Gjithashtu si punonjëse e kësaj shoqërie, ajo pretendon se duhet të marrë dhe një pagë shpërblim nga Sindikata, por kjo e drejtë i është mohuar deri tani.

Duke qenë se zgjidhja e këtij problemi nuk është bërë e mundur, ankuesja ka kërkuar nga Avokati i Popullit që të ndërmjetësojë për të përfituar këto të drejta. Doli se detyrimet kanë ardhur si rezultat i shkeljeve të administratës së Shoqërisë “Fu-Farma”, si dhe nga mospërbushja e detyrimit të kësaj shoqërie që t’i likuideojë 30% shtesë të pagës mujore ankuseses, për periudhën shkurt-korrik 1998 si vështirësi në punë. Kjo pasi ankuesja ka punuar në repartin e helmeve, reagenteve dhe shkalla e vështirësisë është përcaktuar në bazë të matjeve të kryera nga Qendra Sanitare Tiranë dhe mbi këtë bazë punonjësit e këtij reparti, duhet të përfitonin nga shtesat e vështirësisë mbi pagë.

Pas ndërhyrjes tonë, Drejtoria e Shoqërisë “Fu-Farma”, i përmbushi të gjitha detyrimet e lartpërmendura, pra ankesa u zgjidh në favor.

Bashkëpunimi institucional i Avokatit të Popullit me Ministrinë e Ekonomisë, gjatë vitit 2002 është shprehur dhe në përgatitjen e projektligjit “Për Mbrojtjen e Konsumatorit”. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e shëndetit, mjedisit, sigurisë së jetës dhe interesave ekonomike të konsumatorit. Është kristalizuar ideja se legjislacioni shqiptar ka nevojë për një ligj bashkëkohor, për të mbrojtur realisht konsumatorin nga palët e tjera në marrëdhëniet që krijohen. Pas diskutimeve të përbashkëta me përfaqësues të kësaj Ministrie është konkluduar që neni 73 i këtij Projektligji të ketë këtë përmbajtje:

Avokati i Popullit

“Konsumatorët apo shoqatat e tyre, që kanë pretendime se ju janë shkelur të drejtat nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Avokatit të Popullit”. Natyrisht do të jetë Kuvendi i Shqipërisë ai që do të vendosë në lidhje me këtë projektligj.

11. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit

Gjatë vitit 2002 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit si dhe për Institucione ose organizma që kanë si objekt veprimtarinë e problemet e bujqësisë dhe ushqimit janë gjithsej **79** ankesa e kërkesa, ndaj **59** të vitit 2001.

a) Ankesa për çështje të ligjit “Për Tokën”

Ankesat, që për objekt të tyre kanë patur veprimtarinë e komisioneve të dhenies së tokave bujqësore në pronësi, në zbatim të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, në nivel fshati, komune, bashkie dhe qarqe, janë ankesat më të mprehta, më shqetësueset dhe që për zgjidhjen e të cilave me gjithë përpjekjet tona, që për hir të së vërtetës nuk kanë qenë të pakta, rezultatet nuk kanë qenë ato që kemi dëshiruar. Dhe kjo jo për fajin tonë, por për vetë mënyrën dhe praktikën se si është ndarë dhe po ndahet toka bujqësore. Konstatojmë me keqardhje se problematika dhe shqetësimet për procesin e ndarjes së tokës bujqësore vazhdojnë të jenë ato të viteve paraardhës, pa u evidentuar ndonjë arritje që t’ja vlejë të përmendet.

Gjithsej kanë qenë **64** ankesa të kësaj natyre për vitin 2002. Janë përfunduar gjithsej **34** çështje dhe janë në procesin e shqyrtimit edhe **29** të tjera, vetëm për shkakun e mos-kthimit të përgjigjeve në kohë nga Komisionet e Tokave të fshatrave, deri te ato të qarqeve. Pozitivisht është zgjidhur vetëm **1** ankese.

Në shumicën e tyre këto ankesa janë të drejta, pak prej tyre kanë rezultuar si të pabazuara. Për secilen ankesë që e kemi vlerësuar si të drejtë, ju kemi derguar rekomandime komisioneve të tokave të të gjitha niveleve, për dhenien e tokës bujqësore në pronësi dhe rivendosjen në vend të se drejtës se shkelur. Fatkeqësisht, asnjë rekomandim nuk është zbatuar, pavaresisht se pranohet fakti që ankuesi ka patur të drejtë. Përgjigja nga Komisionet e Tokave të disa Komunave të rretheve Tiranë, Durrës, Kurbin dhe Lezhe, është standarte : “ Nuk ka me tokë, ajo është ndare.” Familjet që kanë mbetur pa tokë janë kryesisht ato që nuk janë autoktone në fshatra dhe ish anëtarët themelues të NB-ve. Probleme ka në të tëra rrethet, me përjashtim të zonave veri-lindore që e kanë ndare tokën sipas pronësisë dhe kufinjve të vjetër. Në shumë njësi administrative të pushtetit vendor komisionet e tokave nuk funksionojnë, duke u bërë keshtu pengese për gjetjen e partnerit ligjor dhe të bashkepunimit në verifikimin e zgjidhjen e ankesave konkrete. P.sh. pas me shumë se një vit e gjysem të mos

funksionimit të Komisionit të Tokës pranë Bashkise Kavaje, me nderhyrjet dhe rekomandimet tona dhe kontributin e titullarit të kësaj bashkie dhe të Këshillit të Qarkut Tiranë, u arrit me në fund ringritja e tij.

Shumë akte të marrjes së Tokës në Pronësi janë fiktive, në shumë raste nuk plotësojnë kushtet e një akti administrative të mirefilltë, duke ju munguar ekstremitetet, si vula ose firma. Si të tilla nuk njihen nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme për t'u regjistruar. Të tjera akte nuk pranohen që të leshohen nga komisionet përkatëse. Duke shtuar edhe Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi që në shumë raste janë lëshuar për toka që u janë dhënë më parë të tjerëve, krijohet një tablo e zyrtë, por e qartë e situatës konkrete.

Asnjë nuk e di dhe nuk jep shifra se sa është numri në total i familjeve që nuk kanë marrë tokë bujqësore në pronësi. Nga ankesat e paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, mund të themi, p.sh me saktësi, se vetëm në fshatin Marqinet të Vorës janë mbi 30 familje që nuk kanë marrë në pronësi asnjë metër katror tokë bujqësore.

Komisionet e Tokave në Qarqe nuk pranojnë të zgjidhin mosmarrëveshjet që kanë lindur midis individeve dhe komisioneve të tokës në fshat, komunë apo bashki, detyrim i përcaktuar shumë qartë në VKM nr.230, datë 22.7.1991 "Për krijimin e komisioneve të tokave". Në të gjitha rastet kur ju kemi sugjeruar ose rekomanduar Komisioneve të Qarqeve zgjidhjen e ankimit konkret, përgjigja ka qenë se ja kemi deleguar problemin komisionit të fshatit ose të komunës. Është absurditet të delegosh zgjidhjen e një konflikti një organi që e refuzon zgjidhjen në vazhdimësi, aq më tepër që ligjvënësi e ka patur parasysh këtë non-sens, prandaj autorizon organin me të lartë hierarkik, për të shqyrtuar e zgjidhur konfliktet në procesin e ndarjes së tokave. Konstatimi ynë është se edhe Komisioni Qeveritar i Tokës duhet të lozë me mire rolin e tij drejtues për rritjen e efektivitetit dhe përgjegjësisë në veprimtarinë e piramidës së komisioneve, nëpërmjet organizimit, bashkërendimit dhe kontrollit në praktike për zbatimin e ligjit për tokën, dhe në rastet kur ka zvarritje në ndarjen e saj, kur ka shkelje të përseritura në zbatimin e kriterëve që kanë krijuar mosmarrëveshje, kur nuk zbatohen kompetencat e caktuara të komisioneve t'i propozonte Këshillit të Ministrave marrjen e masave deri në shkarkim të drejtuesve të pushtetit vendor dhe të komisioneve të tokës.

Ndërkaq një dukuri tjetër që po gjen shtrirje në relacion me kohën, është se shumë toka bujqësore të pandara janë zenë dhe zihen nga shtetas të ndryshëm, duke ndertuar banesa, me pretendimet se toka ka qenë pronë e të parëve, se e kanë blere, etj. Kjo ka sjelle konflikte të shumta sociale, pakenaqësira dhe zvoglimin e fondit të tokës për administrimin dhe ndarjen

e saj nga Komisionet. Sa për ato familje bujqësore që nuk janë plotësuar me sasinë e ndare sipas frymeve, as që mund të behet fjale se ato mund të kompletohen. Asnjë nuk merit më me këtë punë, askush, nga ato institucione që janë ngarkuar nga ligji për menaxhimin e procesit të ndarjes se tokës bujqësore, nuk e merr përgjegjesinë për zgjidhjen e kaosit të krijuar. Gjithçka i është lënë spontanitetit, vetëgjyqësise, hareses, berjes se të paditurit dhe konceptit se kjo plage do mbyllet me kalimin e kohës. Mungon vullneti për zgjidhjen e këtij problemi që është futur në një rreth vicioz. Toka, në rastet për të cilat ne kemi ankesa ndahet e merret nga kush të doje dhe sa të doje. Pushtimet e tokës kanë marre statusin e normalitetit.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndarjen e tokës në zbatim të VKM, nr.452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndermarjeve bujqësore”. Mungesa e dokumentacionit të ish-N.B.-ve, zhdukja ose djegja e tyre, e ka vështiresuar shumë përcaktimin e saktë të ish-punonjësve që përfitojnë tokë në pronësi. Abuzimet në këtë drejtim kanë bërë të detyrueshme ringritjen e komisioneve të reja, si në Korçe, Vlore, etj, që rishikojnë vendimet e marra nga komisionet e mëparshme, disa i lënë në fuqi, disa i anullojnë, ju jepet tokë të tjerëve, duke vazhduar të prodhojë konflikte të ashpra.

Tashme është bërë i njohur fakti që ligji “Për Tokën” është kontestuar nga të gjithë pronaret, si një ligj që ju ka mohuar të drejtën e kthimit të pronës. Disa nga këto shoqata si në Himare, Korçe, Pogradec, etj, kanë paraqitur ankesa dhe peticione pranë Avokatit të Popullit, me të cilat kërkohet të behen rishikime në aktet ligjore dhe nënligjore, të shikohet mundësia e kthimit të plotë të pronës aty ku objektivisht është e realizueshme dhe të eliminohet kompesimi me letra me vlere. Institucioni ynë edhe në drejtim të përmiresimit të legjislacionit që trajton tokën bujqësore, ka dhenë ndihmesen e tij me rekomandime për përmiresimin e tyre, në funksion të realizimit sa të jetë e mundur me shumë, të të drejtës se pakontestueshme të ish-pronareve të saj, si dhe për kompesimin sa me pranueshem me realitetin e krijuar.

b) Ankesa për pasurinë e ish-kooperativave bujqësore

Gjithsej janë 3 kërkesa. Është një problem që ka të beje me marrjen e kontributit në të holla nga pasuria e vlerësuar e ish-kooperativave bujqësore, nga anëtarët e tyre. Për shkak të përfundimit të afatit kohor limit për realizimin e kësaj të drejtë, i cili ka skaduar që në datën 1 Shtator 1996, ankesat tashme konsiderohen nga administrata e Këshillave të Bashkive dhe Komunave, si të parashkuara. Për zgjidhjen e këtij problemi, afati i të

cilit ka përfunduar jo për faj të ankuesve por për mos veprime në kohë të Këshillave përkatës, për t'i derguar vendimet e tyre për ekzekutim në Zyrat e Përmbartimit, shoqëruar me mos-pagimin e takses përmbartimore në masën 7%, dhe të mos reagojë të Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit dhe Ministrisë së Financave ndaj rekomandimit për marrjen e nismes ligjvënës për përmirësime, duke zgjatur afatet e përfundimit të procesit në fjale, në ligjin nr.7745, datë 26.7.1993 “Për vlerësimin dhe rishpërndarjen në vlerë të ish-kooperativave bujqësore” dhe të VKM nr.450, datë 16.9.1993 dale në zbatim të tij, ju kemi sugjeruar ankuesve zgjidhjen gjyqësive të këtij problemi, duke kërkuar rivendosjen paraprakisht të afatit të ankimit.

c) Probleme për pyjet

Ankesa për Drejtorinë e Sherbimit Pyjor kanë qenë gjithsej 5, dy prej të cilave janë konsideruar të pabazuara, ndërsa 3 të tjerat janë në shqyrtim. Janë pak ankesa, por menyrja e konceptimit dhe të trajtimit të tyre nga administrata e sherbimit pyjor, është tërësisht anti-ligjore. Kjo ka të bëjë me hezitimin e Drejtorive në rrethe për të dorëzuar sipërfaqet pyjore të njohura dhe kthyer fizikisht trashëgimtareve të ish-pronareve me vendim të KKK të Pronave, detyrim që rrjedh nga pika 11 e VKM nr.560, datë 16.10.1995, “Për masat për zbatimin e ligjit nr. 7699, datë 21.4.1993 “Për kompesimin në vlerë të ish-pronareve të tokave bujqësore”. I konsiderojmë plotësisht të papajtueshme me frymen e ligjit, dhe cenim të rëndë të të drejtës së pronësisë, qëndrimet e këtyre drejtorive, që marrin përsipër të gjykojnë për vlefshmerinë ose jo të vendimeve të KKK të Pronave duke mos i ekzekutuar, kur këtë të drejtë e ka vetëm pushteti gjyqësor që shqyrton, mbi bazën e ankimit pavlefshmerinë, e tyre. Konkretisht ju kemi drejtuar rekomandime të tilla Drejtorive të Sherbimit Pyjor të rretheve Lushnjë e Devoll për ankesat e shtetasve B.Xh. dhe H.B.për të cilat jemi në pritje të reagojëve. Këtyre organeve ju është bërë disa here e qartë se në se kanë kundërshtime për vendime konkrete të KKK të Pronave, duhet t'i drejtohen rrugës gjyqësore për ndryshimin e tyre. Ky problem i është bërë evident disa here edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve, por veme re një apati të theksuar dhe mungesën e nderhyrjes energjike për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur shtetasve që ju është kthyer prona. Është e pakuptueshme se si mund të veprohet në menyrë kaq arbitrare nga organet shtetërore që merren me drejtimin dhe administrimin e fondit të pyjekullotave Akoma ato nuk e kanë të qartë se kështu si veprojnë, faktikisht janë posedues të paligjshëm të pronës private që nga momenti që janë venë

në dijeni për vendimin e KKK të Pronave, dhe për pasoje, përveç të tjerave mbajnë edhe përgjegjesi civile.

d) Probleme për cilesinë e ushqimeve

Një ankese interesante, që është edhe e vetme për sa i takon problemit të cilesise se ushqimeve dhe mbrojtjes se konsumatorit, është ajo e shtetasit B.P. banues në Tiranë, i cili është ankuar për prodhimin dhe tregtimin e ujit mineral natyral të amballazhuar, në kundërshtim me normat higjeno-sanitare dhe të cilesise.

Prodhimi dhe tregtimi i ujit të amballazhuar u rrit ndjeshem përpara disa kohësh, e kondicionuar nga shfaqja e shijes se keqe dhe eres se rende të ujit në impiantin e Bovilles, ç'ka beri që mjaft subjekte tregtare të hapin shumë pika prodhimi dhe amballazhimi të ujit, duke u zgjeruar masivisht kjo veprimtari.

Shtimi i kësaj veprimtarie tregtare si nevojë e kërkesave të shumta të popullit të Tiranës, beri që uji i pijshem industrial i amballazhuar në shishe plastike (1,5 litërshe dhe 5 litërshe) të tregtohet në mase në pikat e shumices, në diell e në pluhur, jashtë kushteve dhe temperaturave që duhen për të ruajtur vlerat e tij fiziko-kimike e baktoreologjike.

Pas vleresimit të problemit si mjaft serioz, me nismen e Avokatit të Popullit, u ngrit një grup punë, përfshire edhe ekspertë të fushes përkatëse. Pas verifikimeve e analizave rezultoi se shqetësimi qytetar ishte plotësisht i drejtë e i bazuar, pasi u konstatuan shkelje mjaft të renda e me pasoja për shendetin e njeriut, duke filluar që nga menyra e prodhimit, amballazhimit dhe deri te tregtimi i ujit mineral natyral.

Institucioni i Avokatit të Popullit beri verifikime në katër subjekte tregtare, të prodhimit dhe amballazhimit të ujit mineral natyral të vendburimit të Selitës dhe Shen Merise në malin e Dajtit, Tiranë, nga ku rezultuan shkelje të Ligjit Nr. 7941, datë 31.05.1995 "Për ushqimin" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 609 datë 17.11.2000, të tilla si :

Nuk ishin marre parasysh nga subjektet prodhuese tregtare dhe as nga organet e ngarkuara për kontroll, kërkesat tekniko-teknologjike që duhet të plotësojnë objektet ushqimore.

Nuk ishte marre parasysh Rregullorja Nr.1, datë 9.03.1998, e Ministrise se Bujqësisë dhe Ushqimit, ku thuhet se:

"Çdo objekt të ketë mjediset e nevojshme dhe sipërfaqet e mjaftueshme për realizimin e teknologjise se prodhimit si ambjentin e prodhimit, magazinat etj".

Nga katër objektet që u testuan, dy prej tyre nuk i plotësonin kriteret e mesipërme.

Po kështu asnjë nga të katër objektet nuk i përgjigjej kërkesave të pikës 16, germa “b” të rregullores së mesipërme që përcakton se:

“Mjediset ku manipulohen, përgatiten, përpunohen dhe ruhen produktet ushqimore duhet të kenë mure të sheshta, të lyera, të veshura me pllaka qeramike etj”. Ndersa në objektin e një subjekti prodhues, punohej në një ambjent ku tavani ishte i shqyer dhe veç pluhurit prezent në mjedi, tavani mund të rrezohej në çdo moment. Në kundërshtim me rregullat, u konstatua se me përjashtim të punonjësve të një firme prodhuese, punonjësit e tre subjekteve të tjera nuk ishin të veshur me rroba punë (përparëse të bardha). Një problem kryesor dhe që konstatohet lehtësisht, ishte mbushja dhe mbyllja në menyre primitive, me dore, e shisheve nga punëtorët e të katër subjekteve prodhuese, ç’ka ishte premise për mundësinë e ndotjes së ujit që tregtohej për konsumatorët.

Mosplotësimi i kërkesave tekniko teknologjike në industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale dhe kushteve higjieno sanitare që janë të përcaktuara qartë në ligjet “Për Ushqimin”, “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror”, “Për Mbrojtjen e Konsumatoreve”, VKM Nr. 609, datë 17.1.2000, Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë Nr.1, datë 9.03.1998, dhe udhëzimeve të dalura në zbatim të tyre, kanë krijuar një situatë të papranueshme dhe për mendimin tonë alarmantë në industrializimin dhe tregtimin e ujit mineral natyral.

Në veshtrim të Ligjit dhe akteve të tjera nënligjore, cilesia e prodhimit dhe tregtimit të mallrave ushqimore është përgjegjesi e subjektit, ndërsa siguria e konsumatoreve dhe mbrojtja e shëndetit të tyre është përgjegjesi jo vetëm e subjektit prodhues e tregtues, por mbi të gjitha e shtetit.

Situata aspak normale që ne konstatojmë në subjektet e industrializimit dhe tregtimit të ujit mineral natyral jo vetëm në ato të kontrolluara nga ne, por pothuajse në gjithë objektet e ngritura për këtë qëllim, mendojmë se duhet vlerësuar me gjithë shqetësimin dhe seriozitetin e nevojshëm për marrjen e masave parandaluese dhe ndaluese të prodhimit e tregtimit.

Nga informacionet që patëm, gjykojmë që ndërhyrja e organeve të kontrollit jo vetëm për sa ne kemi konstatuar, por dhe me gjerë e në shumë objekte që prodhojnë, përpunojnë, ruajnë e shpërndajnë produkte ushqimore duhet të bëhet periodike dhe e organizuar në grupe kontrolli, në bashkëpunim me shoqatën e konsumatorit, sidomos në periudhën e nxehtë, me qëllim që të mbrohet shëndeti dhe interesat e konsumatorëve.

E gjetëm me vend dhe sugjeruam, se liçensimi dhe kontrolli i objekteve që prodhojnë e tregtojnë produkte ushqimore, duhet të behet vetëm nga një organ, dhe jo tre të tilla, siç parashikon ligji, pasi kjo çon në uljen e ndjenjës së përgjegjesinë, duke lënë shteg për abuzime.

Është pare me shqetësim informacioni që kanë përcjellë ekspertët e Institucionit tonë, se në kontaktet që kanë pasur me drejtues e specialistë të organeve shtetërore të kontrollit, evidentohet se ka zenë vend dhe shprehet koncepti “se duhet të hanë të gjithë nga pak”. Ky mentalitet jashtë kohë, justifikon mangesitë që janë konstatuar dhe që disa prej tyre u përmenden me lart. Është kjo arsyeja që organet e kontrollit e justifikojnë mungesën e mekanizimit të prodhimit dhe të ambalazhimit të produktit duke lejuar mbushjen dhe mbylljen e shisheve me dore kur dihet që kjo është një kërkese e domosdoshme dhe elementare për të shmangur ndotjen e ujit siç u konstatua në katër subjektet e kontrolluara.

Ministrise së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë ju vu në dispozicion me këtë rast, një kasetë ku janë filmuar subjektet e kontrolluara nga grupi i punës i Zyres së Avokatit të Popullit dhe një subjekt pozitiv në një rreth jugor, për të nxjerre vetë konkluzionet.

Avokati i Popullit kërkoi nga Ministrat përkatës që nëpërmjet organeve të kontrollit të vartësise se tyre të behen verifikime serioze përse u konstatua dhe u rekomandoi që të merren masa të menjëhershme për parandalimin e kësaj situatë alarmante, aspak normale deri në bllokimin e këtyre aktiviteteve prodhuese e tregtare kur nuk plotësojnë standartet e domosdoshme për prodhimin, ambalazhimin dhe tregtimin e ujit mineral natyral.

Njëkohësisht mendojme se duhet një studim i plotë i situatës dhe bazuar në standartet e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për Ushqimin dhe aktet ligjore e nënligjore që kemi në dispozicion, të përcaktohen kritere dhe standarte të specifikuar qartë për liçensimin apo rilçensimin e subjekteve prodhuese dhe tregtuese të ujit mineral natyral dhe atyre ushqimore në përgjithësi.

Lidhur me këto shqetësime dhe në mbështetje të rekomandimit drejtuar Ministrave të Shëndetësisë, së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Mjedisit, Kryeministri nxorri aktin administrativ me anë të e të cilit urdheroi ngritjen e një grupi nderministerial me përfaqësues të të gjitha ministrive dhe organeve të përfshira në këtë proces për rishikimin dhe zbatimin e legjislacionit i cili përcakton parametrat ligjore të standarteve të ujit të pishem mineral natyral.

e) Ankesa për Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethe

Kemi patur 7 ankime, nga të cilat 2 për nderprerjen e maredhenieve të punës me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, të tjerat për Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethe, që kanë rezultuar jashtë juridiksionit. Në favor janë zgjidhur 2 ankime, ajo e shtetasit N.G. banues në Tiranë, që u rikthye në punë me ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor të formes se prere, dhe tjetra i takon ankuesit F.H. banues po në Tiranë, që ju mundesua marrja e informacionit për dokumentacionin zyrtar nga Drejtoria e Bujqësisë Tiranë.

12. Ministria e Financave

Ankesat, kërkesat dhe njoftimet drejtuar Avokatit të Popullit me pretendimet e shtetasve dhe subjekteve tregtare për shkeljen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të tyre nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve financiare si, vetë Ministria e Financave, por edhe për doganat dhe tatim-taksat për vitin 2002 janë 35, kurse për vitin 2001 kanë qenë 40.

Këto ankesa vazhdojnë të jenë për moszbatimin e nenit 142/3 të Kushtetutës; të Ligjit nr.8435 dt. 28.12.1998 “Për sistemin e taksave” me ndryshimet përkatëse; të Ligjit nr. 8449 dt. 27.01.1999 “Për Kodin doganor”; të Ligjit nr. 8379, dt. 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”; të V.K.M. nr. 205, dt. 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”; të V.K.M. nr. 335, dt. 02.06.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore”; të Udhëzimit nr. 2, dt.02.02.2001 “Për zbatimin e buxhetit të shtetit”; nga organet e mësipërme. Më poshtë do të përmendim si pozitive disa Rekomandime që kemi bërë në fushën financiare, miratimi i të cilave po sjell miradministrim të punëve edhe në këtë fushë:

1) Rekomandimi drejtuar Ministrit të Financave për botimin në Fletoren Zyrtare të V.K.M. nr. 205, dt. 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, që nuk është botuar në Fletoren Zyrtare.

Realizimin e botimit të këtij vendimi në një Fletore Zyrtare të vitit 2002 e kemi parë edhe si një obligim ndaj këtij Parlamenti, pasi në Raportet Vjetore të vitit 2000 2001 e kemi trajtuar si problem.

Kërkesa jonë këmbëngulëse për botimin në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi Qeverie shumë të rëndësishëm, lidhet dhe me pasojat që rrjedhin

nga zbatimi i tij në praktikë pa pasur fuqinë juridike, sepse përbën një shkelje flagrante dhe me pasoja të pallogaritshme financiare për vetë shtetin, nese subjektet juridike të interesuara do të godisnin në gjykatë vendimet e organeve doganore që mbështeten në dispozitat e këtij vendimi të Qeverisë që nuk ka qenë i botuar.

Veç sa sipër botimi i këtij vendimi i shërben transparencës shumë të nevojshme për Qeverinë dhe biznesin, shmangies së korrupsionit dhe njohjes së personave të interesuar me rregullat dhe procedurat që parashikohen në të.

Tani kemi kënaqësinë t'u vemë në dijeni se u arrit të bindet Qeveria për nevojën e realizimit të kësaj detyre kushtetuese. Përgjigjen pozitive dhe angazhimin për realizimin e kësaj kërkesë e morëm nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, pas Rekomandimit tonë të përsëritur dhe jo nga ish-Ministri i Financave, të cilit ja kishim Rekomanduar shumë kohë më parë.

2) Kemi vazhduar të kërkojmë që të zbatohet rekomandimi drejtuar Ministrin të Drejtësisë dhe Ministrin të Financave, për marrjen e masave për nxjerrjen e udhëzimeve që përcaktohen në pikat 1 dhe 4 të V.K.M. nr. 335, dt. 02.06.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit". Nga mosveprimi i patolerueshëm i këtyre dy ministrive, për zbatimin e Kushtetutës dhe akteve ligjore, siç është edhe ky vendim Qeverie, vlerësojmë se pa këto udhëzime, vendimet e formës së prerë të gjykatave vazhdojnë të mbeten në letër e të pazbatueshëm. Mosplotësimi i kërkesave të vendimit të sipërcituar, ka vënë përpara një përgjegjësi të madhe organet drejtuese të pushtetit lokal në gjithë vendin, përballë banorëve të njërive të tyre vendore. Atyre nuk u krijohen mundësi reale për përmbushjen e detyrimit kushtetues që parashikon neni 142, pika 3 e Kushtetutës, që të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Vendimi i Qeverisë ngarkon në radhë të parë Ministrin e Financave, Ministrin e Drejtësisë dhe Institutin e Integritetit të të Përndjekurve Politikë për nxjerrjen e udhëzimeve brenda vitit 1998, detyrë që s'është kryer akoma deri sot.

Është e patolerueshme dhe nuk mund të justifikohet me asnjë arsye, fakti që vendimi i Këshillit të Ministrave nr.335, dt.2.06.1998, nga 4 pika që përmban, 3 i ka të pazbatueshme sepse nuk janë nxjerrë udhëzimet nga institucionet që përmenda më lart. Për pasojë jo vetëm vendimi i Qeverisë bëhet i pazbatueshëm e diskretitues nga pikëpamja praktike, por nuk lejon që të zbatohen kërkesat e nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me institucionet e financës mund të themi se për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, shpesh duke mos pasur argumenta ligjore për të kundërshtuar Rekomandimet tona, gjejnë rrugën e moskthimit të përgjigjes. Janë jo të pakta edhe rastet kur nuk e njohin sa dhe si duhet Kushtetutën, ligjet dhe vendimet e qeverisë e për pasojë janë kthyer përgjigje të pabazuara në ligj. Në ato raste që na kanë ardhur përgjigje të tilla të paargumentuara, ne i kemi drejtuar përsëri me shkrim dhe kemi bërë të qartë se kërkojmë vetëm zbatimin e Kushtetutës e ligjeve, duke ju argumentuar më hollësisht qëndrimin tonë, e duke bërë dhe interpretimet e duhura. Si pasojë kemi arritur të zgjidhim disa nga ankesat, apo t'i vëmë në rrugën e zgjidhjes, por kemi edhe pa përgjigje.

Fondet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, të caktuara nga Buxheti i Shtetit kanë patur rritje. Kështu ndërsa për vitin 2001 kanë qenë caktuar 100 milion lekë, në vitin 2002 u caktuan 185 milion lekë. Ndërsa për vitin 2003 janë caktuar 150 milion lekë.

Por, ndërsa në vitin 2001 fondi është shpenzuar rreth 60%, gjatë vitit 2002 ky fond është shpenzuar totalisht.

Në përgjigjen zyrtare të Ministrisë së Financave që kemi marrë për këtë problem thuhet se: “Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit, ju informojmë se fondi i planifikuar për vitin 2002, ka qënë 185 milion lekë, nga të cilët janë shpenzuar 184 milion lekë, për ekzekutimin e 185 vendimeve gjyqësore.

Nga ankesat e vazhdueshme ndaj degëve të tatim taksave del se vjelja e Tatim-Fitimit, nga personat fizikë apo juridikë bëhet në fillim të vitit sipas një parashikimi. Edhe kur subjektet paraqesin bilancet dhe argumenta se është realizuar një fitim ndryshe nga parashikimi, është e pamundur t'u rimbursohen shumat e marra, pasi gjenden lloj-lloj mënyrash e bëhen lloj-lloj kontrollesh e presionesh nga tatim-taksat. Këtë e ilustruam me ankesën shoqërisë “Infosoft systems” sh.a., e cila u ankua se ajo ka parapaguar tatim fitimin, të parashikuar nga dega e tatim taksave Tiranë, të mbështetur në bilancin kontabël të vitit 2000, të verifikuar dhe miratuar dhe nga ekspertët kontabël ligjor, si edhe bazuar në nenin 39/c të ligjit nr.8560, dt.22.12.1999. Rezultoi se kjo shoqëri ka parapaguar tepër dhe kërkon t'i kthehet kjo shumë. Megjithëse i ka bërë kërkesë për verifikimin e situatës degës së tatim taksave Tiranë, kaluan mbi 1 vit dhe nuk i jepej asnjë përgjigje, qoftë pozitive apo negative. Pas ndërhyrjeve tona, nga mesi i vitit 2002 ankesa u zgjidh në favor të kësaj shoqërie.

Ne mendojmë se në Dogana mungon transparencja. Nga kjo mungesë transparence ndodh që në ç'doganimet e mallrave të veprohet në shumë raste direkt me çmimet e referencës, kur në Ligjin “Për Kodin Doganor”,

çmimi i referencës parashikohet të përdoret në ato raste kur nuk plotësohen kriteret për format e tjera të ç'doganimit. Ne mendojmë se këto çmime reference duhet t'i ketë kompetencë t'i caktojë Këshilli i Ministrave dhe ato duhen publikuar për një periudhë kohe të mjaftueshme para se të aplikohen, me qëllim që të interesuarit të marin dijeni me kohë.

Ndër shkaqet për këtë gjendje jo të mire në administratën publike të sektorit të Financës mendojmë se janë mosnjohja e Kushtetutës, ligjit "Për informim", Kodit të Procedurave Administrative, dhe ligjit "Për Avokatin e Popullit" që vendosin rregulla për detyrimin e administratës në kthimin e përgjigjeve ndaj ankuesve. Mungesa e kërkesës së llogarisë nga ana e drejtuesve ndaj nëpunësve të kësaj administrate për të bërë detyrën që u ngarkon ligji, që të ushtrojnë kontrolle të programuara e jo të gjejnë rrugën më të lehtë nëpërmjet qëndrimeve arrogante, duke e konsideruar biznesin jo si partner, por si vartës të tyre. Këto veprime, së bashku me mungesën e transparencës, çojnë në mënyrë të pashmangshme në abuzime dhe në qëndrime korruptive e diskretituese për administratën shtetërore.

Në përfundim mund të themi se Ministria e Financave dhe organet vartëse të saj ka raste që veprojnë me metoda pune të vjetra, vetëm me qëllimin për të grumbulluar paratë e planifikuara. Pra, vjelja e parave me çdo kusht, pa respektuar Kushtetutën dhe ligjin, ka bërë që të ketë raste që shkelen rëndë të drejtat e qytetarëve si dhe dëmtohen rëndë bizneset e perspektiva e tyre, për të cilat ka aq shumë nevojë zhvillimi i vëndit tonë.

13- Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Gjatë vitit 2002 rezultojnë 78 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 20 ankesa. Në favor janë zgjidhur 10 ankesa apo kërkesa, jashtë juridiksionit 33 ankesa, kurse të pabazuara kanë qenë 15 ankesa. Ndërsa, në vitin 2001 kanë qenë 26 ankesat, nga të cilat 2 janë zgjidhur në favor.

1-Pas zhvillimit të konkurseve për pranimin në shkollat e larta në të gjitha Fakultetet e Universitetit për vitin akademik 2002-2003, janë paraqitur mjaft ankesa, me këto problematika: Mungesë transparence dhe informacioni lidhur me të drejtën e vetëvlerësimit dhe të ballafaqimit me testin e konkursit; mungesë informacioni për konkurentët lidhur me të drejtat dhe detyrimet pas konkurimit; kohëzgjatja jo e mjaftueshme e afateve të përcaktuara për rregjistrimin e fituesve. Baza ligjore, mbi të cilën u mbështet ndërhyrja jonë në të gjitha Fakultetet e Universiteteve tona, të cilat nuk pranonin rikontrollin dhe ballafaqimin e testeve me studentët konkurues që kishin ankesa për vlerësimin, ishte Ligji nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit”, si dhe Kushtetuta jonë që garanton të drejtën e informimit, në nenin 23 të saj.

- Për të unifikuar praktikën në të gjitha Fakultetet, ndërhyrja e Zyrës sonë gjeti mbështetjen e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Për realizimin e së drejtës së rihapjes dhe rishikimit të testeve, me datën 8.10.2002 nga Ministri i Arsimit, z.Luan Memushi, u nxor shtesa e Udhëzimit nr.4083 “Mbi Rregulloren e Konkursit”, e cila zgjidhi dhe ankesat e studentëve, për rishikimin e rezultateve të konkursit për pranimin në shkollat e larta.

Gjatë kohës që Zyra jonë shqyrtoi me intensitet zgjidhjen sa më shpejt të këtyre ankesave, u kristalizua mendimi ynë, sipas të cilit rregullat, procedura dhe gjithë mënyra se si ishte konceptuar procesi i zhvillimit të konkursit, i sintetizuar dhe në aktet ligjore dhe nënligjore, shënonte një hop cilësor, në vështrim krahasues me vitet e mëparshme. Kjo, si përsa i takon hartimit dhe vlerësimit të testit, ashtu dhe korrigjimit të tyre, proces që kalonte në disa filtra kontrolli, duke minimizuar në maksimum gabimet materiale apo vlerësimet jo objektive të testeve të konkursit. Gjithashtu dhe fakti se në kuotat shtesë, u ndoq rendi i fituesve, sipas grumbullimit të pikëve, është një tjetër arritje mjaft pozitive e Ministrisë së Arsimit, e cila shmangu qëndrimet abuzive e ndërhyrjet pa vend, në dëm të parimit të barazisë së shtetasve. Lidhur me këtë çështje evidentojmë me kënaqësi se në vitin shkollor 2002-2003, për herë të parë u zbatua parimi i barazisë për

pranimet në Universitetet dhe shkollat e larta. Kjo sepse Kryeministri dhe Ministri i Arsimit hoqën me Vendim Qeverie të drejtën që kanë patur dhe zbatuar para vitit 2002 për të urdhëruar rregjistrimin pa konkurs të një numri studentesh. Për këtë çështje, në muajin qershor 2002, ne i drejtuan rekomandime ish Kryeministrit, zotit Majko dhe ministrit, zotit Memushi, të cilët e mirëpritën. Në fakt, realizimi në praktikë i kësaj praktike mbylli në mënyrë institucionale edhe akuzat për hatëre, padrejtësi apo korrupsion, që kanë qenë të përvitshme pas përfundimit të procesit të rregjistrimit të studentëve në tetor të çdo viti.

Ndërsa, përsa i takon Rregullores për pranimin në shkollat e mesme me konkurs, e cila është hartuar para disa viteve, gjykojmë se ka vend për përmirësime, sidomos në pikën 20 të saj, në mënyrë që të parashikohet edhe për këtë kategori nxënësish, që për të përfitur të drejtën e shkollimit në kuotat shtesë, duhet të zbatohet rradha sipas rendit të pikëve të fituara.

2-Nga shqyrtimi i disa ankesave ka dalë problemi që ka të bëjë me kompetencën që kanë Dekanët e Fakulteteve të Universiteteve të Tiranës, për të lidhur kontrata pune dhe prishur ato me personelin akademik shkencor. Proçedura e pranimit dhe e lidhjes së kontratës, shpjegohet në nenin 11 të Rregullores së Universitetit të Tiranës. Në këtë proçedurë duhet rregulluar roli i Departamentit në këtë proçes. Në rastin konkret, Dekani i Fakultetit është në pozitat e një eprori direkt, që ka në kompetencë të lidhë apo të zgjidhë kontratën e punës me personelin mësimor e shkencor. Por, nuk evidentohet në aktet nënligjore, se cilat do të jenë ato struktura, të cilat do të vlerësojnë më pas nivelin akademik të pedagogut. Nga shqyrtimi doli se marrëdhëniet e punës së personelit akademik të shkollave të larta rregullohen pjesërisht me Kodin e Punës dhe pjesërisht në bazë të Ligjit nr.8461 datë 25.02.1999 “Mbi Arsimin e Lartë”. Në bazë të nenit 26 të tij “detyrat dhe të drejtat e personelit të shkollave të larta, që burojnë nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen në statutin e shkollës së lartë dhe në rregulloren e brendshme të njërive përbërëse të shkollës në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi”. Konkretisht, Statuti dhe Rregullorja e Universitetit të Tiranës parashikojnë një proçedure specifike që duhet të respektohet nga organet e Fakultetit për marrjen në punë të personelit të brëndshëm akademik e që i vendos këta të fundit në një pozitë të veçantë në raport me kategoritë e tjera të punëmarrësve, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës. Ndaj dhe proçedura e largimit nga puna nuk mund të kufizohet vetëm në një vlerësim të dekanit në lidhje me punën e bërë nga këta të fundit. Një arsye tjetër, e cila të çon në konkluzionin se duhet të parashikohet një proçedure tjetër para se dekanit të marrë vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ka për qëllim së

pari, respektimin e parimit të barazisë e mosdiskriminimit gjatë procesit të vendimmarrjes nga ana e dekanëve dhe së dyti, rritjen e qëndrueshmërisë së stafit, nisur nga specifika që ka personeli akademik dhe që ndikon drejtëpërsëdrejti në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe ngritjen e tij në nivelet e kërkuara akademike. Një moment tjetër i evidentuar ka të bëjë me faktin se Departamenti i propozon Dekanatit masat për shkeljet e disiplinës në punë nga ana e pedagogëve. Në lidhje me këtë fakt rezultojnë se as në ligj dhe as në statut apo rregullore nuk parashikohen masat që mund të merren në këto raste. Në bazë të nenit 37 të Kodit të Punës masat disiplinore parashikohen vetëm në marrëveshjen kolektive. Në këtë moment evidentojmë se paraqet domosdoshmëri parashikimi i masave disiplinore, me qëllim që vendimi përfundimtar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të jetë rezultat i shkallës së shkeljes dhe të masave disiplinore që punëmarrësi ka marrë më parë. Ky fakt bëhet akoma më i rëndësishëm në kohën kur akoma nuk ekziston një kontratë kolektive midis Ministrisë së Arsimit dhe kësaj kategorie punëmarrësish. Me këtë synim i jemi drejtuar Senatit të Universitetit të Tiranës me një propozim për “Përmirësimin e Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës, duke parashikuar një procedurë paraprake për vlerësimin e punës së personelit të brendshëm akademik përpara marrjes së vendimit përfundimtar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga ana e Dekanit të Fakultetit”. Akoma nuk kemi përgjigje zyrtare, sepse Universiteti ka qene i zënë me zgjedhjet e drejtuesve te tij.

3- Në ankesën e shtetas M.M., ish-asistent pedagoge në Departamentin e Filozofi-Sociologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, kontestohet akti administrativ nr.6 datë 12.03.2001 i Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, që ka vendosur mospërsëritjen e kontratës si asistente pedagoge për shkak të ndryshimit të kushteve të kriterëve të pranimit. Pas shqyrtimit gjyqësor të problemit është vendosur përfundimisht pavlefshmëria e aktit administrativ të mësipërm dhe Fakultetit të Shkencave Sociale i lindi detyrimi për ekzekutimin e këtij vendimi, pra kthimin e ankueses si as/pedagoge pranë këtij fakulteti. Zyra jonë i ka rekomanduar Rektorit të U.T. ushtrimin e kompetencave ligjore e nënligjore për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor. Rekomandimi është i papranuar dhe i pazbatuar nga ana e Rektorit të U.T. dhe Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale. Në fakt është ky zyrtar, i cili me kryeneçesi nuk zbaton nenin 142/3 të Kushtetutës, për kthimin e ankueses në punë, me pretendime të pabazuara për shkelje të autonomisë dhe lirisë akademike, për paaftësi të gjykatave, etj, në një kohë që gjykata ka marrë vendim pozitiv për ish-asistent pedagogen, pikërisht se dekani ka shkelur

procedurat ligjore, që asaj ja garanton legjislacioni ynë. Çështja do t'i referohet Ministrit të Arsimit dhe Rektorit të ri të Universitetit të Tiranës.

4-Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë ankuar dy mjekë, të cilët kanë konkuruar për të fituar specializimin pasuniversitar në Fakultetin e Mjekësisë. Ankuesit pretendojnë se shtesat e akorduara në specialitetin e Dermatologjisë dhe Obstetrikë-Gjinekologjisë nuk janë ndarë konform vlerësimit që konkuruesit kanë marrë.

Çështja është ende në shqyrtim, pasi nga ana e ish Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, nuk na janë vënë ende në dispozicion informacionet e kërkuara, megjithë kërkesat e përsëritura nga ana jonë.

5-Një numër i konsiderueshëm ankesash kanë patur si objekt problemet e largimeve nga puna të mësuesve apo transferimeve nga një vend pune në një tjetër, nga ana e Drejtorive Arsimore në rrethe. Pjesa më e madhe e këtyre ankesave kanë rezultuar të pabazuara.

14. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2002 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj janë bërë gjithsej 25 ankesa. Nga 19 ankesat e përfunduara, 1 është zgjidhur në favor, 8 kanë rezultuar të pabazuara dhe 10 jashtë juridiksionit dhe kompetencës sonë. 6 ankesa vazhdojnë të jenë në shqyrtim.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri kanë qenë kryesisht për largime nga puna, mosekzekutime të vendimeve të gjykatës, keqtrajtim nga ana e personelit mjekësor, si dhe kërkesë për pagesën e orëve të punës shtesë.

Nga ankesat e përfunduara përmendim;

1-Ankesën e shtetasit L.V. në lidhje me keqtrajtimin që i është bërë në repartin e dializës pranë Spitalit Nr.1 Qendra Spitalore "Nënë Tereza" nga një infermiere.

Në lidhje me këtë çështje, i kemi kërkuar shpjegime Drejtorit të Qendrës Spitalore Tiranë, i cili na informoi se si pasojë e ngjarjes së ndodhur, në pavionin e dializës u organizua një analizë pune, ku morën pjesë shefi së bashku dhe me stafin e pavionit dhe në përfundim, infermieres iu dha vërejtje.

Veç rastit në fjalë evidentojmë se nuk ka patur raste të tjera ku të evidentohet keqtrajtim i të sëmurëve nga ana e personelit mjekësor.

2-Ankuesja A.T. ka paraqitur ankesë në emër të farmacistëve që punojnë që prej vitit 1994 dhe aktualisht në farmacinë “Prima Farma”, pranë Librit Universitar në Tiranë.

Ato na prezantojnë një problem që lidhet me përfundimin e procesit të privatizimit të kësaj farmacie sipas VKM-së Nr.192 datë 20.03.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohen dhe procedurat e shitjes”.

Çështja është ende në shqyrtim pasi nuk kemi marrë ende shpjegime nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit në lidhje me faktin se si kanë kaluar mjetet e kapitalit nga Ministria e Arsimit në atë të Shëndetësisë, për t’i hapur rrugë më pas procesit të privatizimit.

Por, konstatohet se, procesi i privatizimit të objekteve nga farmacistët ka qenë në rastet e paraqitura pranë Institucionit tonë shkak i konflikteve me individë të ndryshëm, të cilët pretendojnë pronësinë si ish pronar apo për konflikte dhe me vetë Ministrinë, për faktin se nga kjo e fundit është vlerësuar se objektet e pretenduara nuk mund t’iu nënshtrihen procesit të privatizimit.

Ndërsa, përse i përket largimeve nga puna, ankesat kryesisht kanë të bëjnë me faktin se individët nuk informohen në lidhje me përmbajtjen e vendimit të largimit nga puna nga autoritetet përkatëse, duke shkelur dispozitat e Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Shumica e çështjeve që i përkasin kësaj Ministrie janë nxjerrë jashtë juridiksionit dhe kompetencës për faktin se ankuesit çështjen e tyre e kanë bërë dhe objekt të shqyrtimit gjyqësor.

15- Ministria e Punëve të Jashtme

Gjatë vitit 2002 për Ministrinë e Punëve të Jashtme, ambasadat dhe konsullatat jashtë vendit rezultojnë gjithsej 21 ankesa, nga të cilat 4 janë akoma në shqyrtim. Lidhur me objektin e këtyre ankesave duhet thënë që kryesisht ato kanë patur të bëjnë me veprime apo mosveprime të konsullatave apo sektorëve konsullorë në ambasadat tona në ato vende ku ka mjaft shtetas shqiptarë. Nga ankesat e shqyrtuara 13 rezultojnë të kenë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit. Pjesën më të madhe të këtyre e përbëjnë ankesat për përfaqësitë e huaja në Shqipëri. Kur kanë qenë jashtë juridiksionit, qytetarëve ju është treguar rruga që duhej të ndiqnin në sejcilin rast.

Një nga prioritetet e Ministrisë së Jashtme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, është mbrojtja e interesave jo vetëm të shtetit shqiptar, por dhe të shtetasve shqiptarë që punojnë e jetojnë jashtë vendit. Institucioni i Avokatit të Popullit me ndërhyrjet e tij, pas shqyrtimit të ankesave, ka synuar të ndikojë për mirëqeverisje, jo vetëm tek administrata shqiptare brenda vendit, por edhe tek ajo pjesë e saj që funksionon jashtë Shqipërisë. Institucioni ynë ka nxitur rritjen e vëmendjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme për forcimin e konsullatave apo sektorëve konsullorë në ambasadat tona, sidomos në Greqi, Itali, Gjermani, Angli etj, ku jeton një numër i konsiderueshëm i shtetasve shqiptarë, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit konsullor. Për këtë është sugjeruar në Raportin Vjetor 2001, që numri i personelit konsullor duhet të rritet, pasi është e pamundur që 20-30 punonjës konsullorë që janë gjithsej, të mund t'u përgjigjen si duhet dhe në një kohë sa më të shpejtë, më tepër se gjysëm milion shtetasish shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë vendit. Theksojmë se gjatë kohës që Zëvendëskryeministri, z. Ilir Meta kryen edhe detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme është rritur mjaft bashkëpunimi i institucioneve tona, gjë që ka dhënë efekte mjaft pozitive për trajtimin e ankesave dhe çështjeve të tjera që lidhen me këtë dikaster mjaft të rëndësishëm.

Në funksion të këtij bashkëpunimi në takimet e punës me z. Meta është trajtuar mundësia e krijimit të një sistemi të quajtur “shërbim me një ndalesë”, (“one stop service”) për lehtësimin e procedurave konsullore, e cila mund të bëhet qoftë dhe me një person të caktuar jashtë konsullatës.

“Shërbimi me një ndalesë”, krijon mundësinë e ofrimit të shërbimeve publike nga një zyrë për disa shërbime të ndryshme. Kjo mund të zbatohet në rastin e procedurave që ndjekin qytetarët pranë Ministrisë së Jashtme për probleme të ndryshme që lidhen me ta. Krijimi i këtij shërbimi jashtë shtetit do të rriste mundësinë dhe cilësinë e marrjes së shërbimeve nga shtetasit tanë që punojnë e banojnë jashtë shtetit, me qëllim që ata të paguanin dhe të mos ishte nevoja të vinin fizikisht në Shqipëri për të marrë certifikata, dëshmi etj, ashtu siç është rregulluar problemi i marrjes së pasaportave pranë ambasadave apo konsullatave.

Në kuadrin e rritjes së shërbimit ndaj qytetarëve po shihet me kujdes problemi i legalizimit të dokumenteve për jashtë shtetit. Bëhet fjalë për dokumente të vërtetuara përpara një noteri publik, të cilat duhet më pas të legalizohen dhe në Ministrinë e Jashtme. Ka patur ankesa nga qytetarët që janë te detyruar të ndeshen me radha të gjata e që hasin pengesa të panevojshme, por nga Ministria e Punëve të Jashtme janë marrë masa efektive për t'i eliminuar këto vështirësi. Por ka edhe zgjidhje të tjera, psh.

duhet bërë aderimi në një Konventë për t'u njohur vula e noterit, pa qenë nevoja e legalizimit të dytë nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Gjatë vitit 2002, në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme dhe atë të Drejtësisë u realizua projekti i botimit në shqip të përmbledhjes së instrumentave kryesore juridike ndërkombëtare, lidhur me të drejtat e njeriut dhe rrugët për mbrojtjen e rivendosjen e tyre në institucionet e sistemit penitenciar jashtë vendit, ku vuajnë dënimin rreth 5000 shtetas shqiptarë. Një botim i tillë u bë me qëllim që të ndihmojë të burgosurit shqiptarë jashtë vendit, të cilët janë një grup i veçantë i pambrojtur që nuk kanë mundësi për të patur një rrjet lidhjesh dhe mbështetje, sikundër të burgosurit e tjerë. Kjo bëhet më e theksuar kur i burgosuri nuk lexon e kupton gjuhën e vendit ku është burgosur. Dihet se literatura në gjuhën shqipe në burgjet jashtë vendit për shumë arsye mungon. Rekomadimi nr.89 i Këshillit të Europës, që bën fjalë mbi edukimin në burgje, në pikën 10 të tij përcakton të drejtën e të burgosurve për të pasur një shërbim të bibliotekës të paktën një herë në javë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke parë se kjo e drejtë të burgosurve shqiptarë jashtë vendit pothuajse ju mohohet, në mbështetje të akteve të sipërcituara, duke kërkuar dhe bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme, inicioi projektin për botimin e një përmbledhje të tillë dhe tani po bashkëpunon ngushtësisht me këto ministri për të bërë të mundur shpërndarjen e tyre në burgjet ku vuajnë dënimin shtetasit shqiptarë jashtë vendit.

Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë i jemi drejtuar dhe me një rekomandim tjetër, i cili është pranuar. Rekomandimi kishte të bënte me:

- Zbatimin e procedurës së përgatitjes dhe botimit të teksteve zyrtare në gjuhën shqipe të akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, nga Ministria e Drejtësisë, e cila realizon përkthimin zyrtar të akteve ndërkombëtare të përgatitura për miratim, nga ana e organeve *kompetente*.
- Realizimin e botimit në gjuhën shqipe të teksteve të konventave dhe marrëveshjeve të ratifikuara nga vendi ynë, teksti i të cilave nuk është botuar në Fletoren Zyrtare, me qëllim që të kenë mundësi të gjithë organet që janë të detyruara t'i zbatojnë ato të njihen më parë me to.

Ministrisë së Punëve të Jashtme i jemi drejtuar duke i bërë propozime konkrete edhe në lidhje me Projekt-Protokollin shtesë të “Konventës kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimit Mizor, Jo Njerëzor a Degradues” në këto drejtime:

- Krijimin dhe sensibilizimin e nevojshëm ndaj organizmave përkatës të shtetit shqiptar, për të marrë në konsideratë dhe mbështetur këtë projekt protokoll.
- Ndikimin për ratifikimin e tij në Kuvend, duke përdorur argumenta që kanë lidhje me objektin e veprimtarisë tonë.

Nisur nga fakti se sot realiteti botëror, po ndeshet me një sërë fenomenesh të reja, ku dhuna, trajtimi çnjerëzor, torturat fizike dhe psikologjike) kanë marrë një trajtë të re, duke u gërshetuar me një sërë veprimesh të tjera, të cilat dëmtojnë dhe mohojnë në thelb garancitë e individit, ka dalë si detyrë parësore e shteteve palë të “Konventës kundër Torturës” (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara) për të gjetur mënyra dhe forma të reja për një luftë sa më të ashpër kundër shfaqjeve të tilla degraduese.

Në këtë kuadër, kohët e fundit, në sesionin e 57 të Asamblesë të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (shtator-dhjetor 2002), nisur nga një propozim i mëparshëm i Qeverisë së Kosta Rikës (Shtet Palë i Konventës). Komisioni i të Drejtave të Njeriut ka propozuar një projekt-protokoll shtesë të “Konventës kundër Torturës”, ku ka parashtruar disa forma të reja të kontrollit ndaj këtij fenomeni, të cilat mund të ndikojnë në një parandalim sa më efikas të tij.

Në përgjigje të propozimit tonë, nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme jemi informuar se mbështetur në nenin 5 të Ligjit nr.8371 datë 09.07.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, teksti i protokollit është dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë, si institucion qendror kompetent për ndjekjen e procedurave të nevojshme të nënshkrimit dhe ratifikimit të tij. Problemi do të vazhdojë të ndiqet sepse ka të bëjë me rritjen e garancive shtetasve tanë kundër shkeljeve më të rënda të të drejtave dhe lirive të tyre siç janë torturat, vuajtjet etj.

Nga çështjet e trajtuara gjatë vitit 2002 vlen të veçonim dy; njëra prej të cilave nuk ka përfunduar së shqyrtuari akoma për shkak të vonesave të pajustificuara në kthimin e përgjigjes nga ana e Drejtorisë Konsullore pranë kësaj Ministrie.

1- Shtetasi A. N. është ankuar për rastin e djalit të tij student, i cili ka statusin e rezidentit permanent në USA. Në datën 27.07.2001, ai është ndaluar nga Policia e Imigrimit të Aeroportit “Ataturk” të Stambollit, me pretendimin se pasaporta shqiptare dhe dokumenti i Green Cardi-t

amerikan, janë dokumenta fallso. Më pas, ai është përcjellë në dhomat e izolimit në Stamboll, i është mohuar e drejta për avokat, të telefonojë familjen, ambasadën shqiptare dhe atë amerikane në Stamboll, duke u trajtuar si kriminel. Atë e kanë liruar mbas 96 orëve, por dokumentat e cituara më sipër janë sekuestruar.

Shqetësimin më të madh ankuesi e ka për neglizhencën e Konsullit shqiptar në Stamboll, i cili megjithëse u njoftua nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, nuk ka bërë asnjë veprim për të ndihmuar djaloshin shqiptar konform detyrës funksionale që ka. Sipas ankuesit, përgjigjia e tij ka qenë se nuk e njihte njeri në zyrat e policisë turke.

Gjithashtu ai pretendon se është ankuar edhe në Drejtorinë Konsullore për këtë problem, duke kërkuar njëkohësisht edhe ndërhyrjen e saj për t'i kthyer dokumentat e djalit të sekuestruara nga autoritetet turke, por deri tani nuk ka patur asnjë reagim nga ana e kësaj Drejtorie.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj ankese, nga ana jonë i kemi kërkuar shpjegime rreth kësaj ankese Drejtorisë Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ndonëse çdo afat ligjor për kthimin e përgjigjes ka kaluar, akoma nuk ka ardhur asnjë përgjigje, megjithë interesimin tonë të vazhdueshëm pranë kësaj zyre.

2- Vitin e kaluar u prezantua në Raportin Vjetor 2001, ankesa e 5 ish punonjësve, diplomatë dhe personel ndihmës të Ambasadës Shqiptare në Beograd, të cilët më 5 prill 1999, pasi kishin filluar bombardimet e NATO-s mbi Jugosllavinë, për shkak të krimeve të serbëve në Kosovë, u larguan nga Ambasada, pa arritur të marrin mjaft nga sendet e veshjet e tyre personale. Këto sende atyre ju dogjën e shkatërruan dhe ata me të drejtë kërkojnë dëmshpërblimin përkatës. Për këtë ata paraqitën ankesën e tyre pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila nuk e mori parasysh atë. Më pas ata ju drejtuan Institucionit tonë, i cili pasi e shqyrtoi çështjen arriti në konkluzionin se kërkesa e ankuesve për dëmshpërblim ishte e bazuar. Për këtë i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Jashtme që të mos presë normalizimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe pas zhdëmtimit nga pala jugosllave të bëjë rimbursimin e dëmeve të punonjësve të saj, por duke patur parasysh Ligjin nr. 8510, datë 15.07.1999, "Mbi përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore", të bënte zhdëmtimin e personave të dëmtuar materialisht nga evakuimi i Ambasadës sonë në Beograd. Edhe ish Ministri i Punëve të Jashtme, deputeti Paskal Milo në diskutimin e tij në Kuvend për Raportin tonë të vitit 2001 pranoi se ishte gabuar që nuk ishte marë parasysh ankesa e të dëmtuarve që kur ai ishte ministër. Është konfirmuar se rekomandimi është i drejtë, por po

punohet nga Ministria për zgjidhjen e çështjeve teknike që kanë të bëjnë me problemin.

Ndërsa çështja e mëposhtme tregon për mënyrën se si kemi ndihmuar në përmirësimin e çështjeve administrative në këtë Ministri.

3- Shtetasi A.B. është ankuar pranë Institucionit tonë në lidhje me vendimin për transferimin e tij nga puna si shofer nga një ambasadë në një tjetër jashtë vendit.

Pas hetimeve tona në lidhje me këtë çështje ka rezultuar se, nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të njëanshme të marrëdhënieve të punës, pasi ankuesi është emëruar në të njëjtën ditë në një detyrë tjetër.

Por në këtë rast vlen të përmendet se u konstatua që, marrëdhëniet e punës së stafit teknik të ambasadave tona kërkojnë një rregullim ligjor konform Kodit të Punës dhe legjislacionit të punës në përgjithësi. Doli që ky staf nuk punësohej me kontrata pune, por vetëm mbi bazën e aktit administrativ për caktimin në detyrë.

Rekomandimi ynë për këtë pikë, është konsideruar i drejtë dhe jemi informuar se kjo çështje po gjen zgjidhje. Kemi ofruar bashkëpunimin tonë në planin juridiko-profesional dhe çështjen vazhdojmë ta ndjekim.

16. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

Gjatë vitit 2002, pranë Avokatit të Popullit janë depozituar kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacioneve si dhe organeve në vartësi të saj gjithsej 50 ankesa.

a. Ankesa për vetë Ministrinë

Ka patur 10 për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, nga ku 3 janë ende në shqyrtim, kurse 7 ankesa janë të përfunduara. Nga 7 ankesat e përfunduara, 2 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve, 3 janë jashtë juridiksionit dhe 2 kanë qenë të pabazuara.

Lidhur me rastet në shqyrtim, mund të evidentojmë ankesën e 4 familjeve me banim në Tiranë, të cilët ankohen se Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve si dhe organet e saj në vartësi, nuk kanë pranuar të përfundojnë procesin e shpronësimit për tokat e tyre, nëpër të cilat kalon Unaza e Re e Tiranës. Pasi është verifikuar dokumentacioni i këtyre familjeve, Avokati i Popullit, i ka kërkuar shpjegime Ministrisë së Transporteve dhe çështja vazhdon të jetë ende në shqyrtim. Konflikti i 4 familjeve me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve, përbën

një rast për të ilustruar në tërësi problemet që hasin qytetarët me titull pronësie gjatë momentit kur duhet të shpronësohen për interes publik. Ashtu siç është përmendur edhe në Raportin tonë për vitin 2001, procedurat e tejzgjatura, konfliktet gjyqësore që lindin në kuadrin e këtij procesi, janë një fenomen që ndodh herë pas here dhe që tregon mangësitë që shfaq kuadri ligjor në fuqi për veprimtarinë me efekt shpronësimi për interes publik. Kjo sepse ka pasaktësi në listat dhe të dhënat e tjera nga Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pronarët që shpronësohen për interes publik dhe organizim jo të mirë të punës nga organet kompetente të administratës. Sanksionimi i garancive të të drejtave mbi pronësinë që parashikon neni 41 i Kushtetutës së Shqipërisë, është një detyrim i cili duhet të respektohet nga organet e administratës publike. Në këtë kuadër, shprehim shqetësimin tonë se në realitet, nga ankesat që bëhen prezente pranë Avokatit të Popullit, ky detyrim kushtetues shpesh herë është anashkaluar nga organet e administratës publike, duke i lënë rrugë të hapur konflikteve gjyqësore.

Për këtë qëllim Avokati i Popullit me synimin e rritjes së cilësisë së mirëqeverisjes në administratë, do të vazhdojë të ndërhyjë edhe në të ardhmen për një zgjidhje të konflikteve në rrugë administrative, pasi nga çështjet e shqyrtuara rezulton se ka shumë hapësira, nëpërmjet të cilave qytetarët mund të realizojnë interesat e tyre të ligjshme, pa qenë nevoja që të nisin rrugën e gjatë e të mundimshme gjyqësore. Po përmendim edhe dy raste:

1. Shtetasi N.Ç. me banim në Durrës, është ankuar se ishte shkarkuar në mënyrë të padrejtë nga detyra në Drejtorinë e Hekurudhave Durrës. Pasi u verifikua ankesa dhe doli se ankuesi kishte të drejtë, u bë ndërhyrja jonë përkatëse dhe Drejtoria e Hekurudhave e ka rikthyer në detyrën e mëparshme shtetasin N.Ç.

2. Shtetasi Sh.M. me banim në Tiranë, është ankuar se firma e huaj Turke “Behasse” kontraktuese me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve për ndërtimin e një segmenti rrugor, nuk i kishte shlyer detyrimin për shërbimet e kryera. Pasi u verifikua kjo çështje në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, u konstatua se firma Turke, jo vetëm nuk i kishte shlyer këto detyrime ndaj subjektit privat shqiptar, por kishte konsumuar edhe veprën penale të mashtrimit të shtetasve shqiptarë, duke braktisur punimet. Në këto kushte i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Elbasan fillimin e çështjes penale ndaj drejtuesve të firmës Turke. Ky rekomandim nga Prokuroria Elbasan është pranuar dhe për çështjen në fjalë ka filluar ndjekja penale.

b-Ankesa për Telekomin

Gjatë vitit 2002 pranë nesh janë depozituar 40 ankesa dhe kërkesa për Drejtorinë e Përgjithshme të Telekomit dhe filialet e tij nëpër rrethe. Duhet theksuar që në fillim se ky sektor i komunikimit ka patur rritje të madhe sasiore, duke e zgjeruar mjaft rrjetin e abonentëve në të gjithë vendin. Megjithatë, edhe ky sektor jetik për shërbimet publike ka akoma mjaft probleme, sidomos për të rritur standartet e shërbimeve në nivel bashkëkohor.

Nga studimi i 40 ankesave dhe kërkesave rezulton se pjesa më e madhe e tyre konsistojnë në mostransparencë në faturime, mosrespektim të afateve të ankimeve apo të vendosjes së shërbimit, riparimeve etj.

Është konstatuar që ky Ent, abonentëve të shumtë ju kthente përgjigje shabllone, të fotokopjuara dhe të plotësuara vetëm konform emrit dhe numrit të telefonit, pa bërë verifikimet sipas ankesës. Me rekomandimin tonë kjo mënyrë pune me ankesat është përmirësuar. Është imediate ndërhyrja e strukturave të tjera të kontrollit shtetëror në këtë fushë, për të bërë të mundur një transparencë më të madhe për mënyrën e përcaktimit të faturave dhe konsumit të impulseve, pasi shumë ankesa konsistojnë pikërisht për këtë çështje. Për më tepër kjo duhet bërë sepse Albtelekom ndryshe nga KESH dhe Ujësjiellës aparaturat e matjes i ka në administrim pranë Entit të tij dhe jo pranë apo nën kontroll të abonentëve. Kjo bën të mundur edhe abuzime në dëm të konsumatorëve. Ne jemi munduar të vëmë në lëvizje strukturat përkatëse që duhet të reagojnë si ERT, Shoqata e Konsumatorit, Drejtoria e Konsumatorit që është pjesë e Ministrisë së Ekonomisë si dhe Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacionit.

Një veprim abuziv që u ndesh nga ana e Avokatit të Popullit, ishte shitja me detyrim e Numërorit Telefonik të vitit 2003 nga ana e strukturave të Albtelekomit. Për abonetët që nuk e blinin këtë numëror këta kishin vendosur si kusht ndërprerjen e linjës telefonike. Për këtë arsye ne ju drejtuam Ministrin të Transporteve dhe Telekomunikacionit, z.Spartak Poçi, si vijon:

“Shumë shtetas në rang Republike, janë ankuar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, për shkeljet flagrante që vazhdojnë të kryhen nga Albtelekom SH.A. Këto shkelje konsistojnë në faktin se, nga ana e Zv/Drejtorit Ekonomik, z.Et’hem Shahu, janë lëshuar tre urdhëra administrative, me nr.5562 prot., datë 20.08.2002; nr.5562/1 prot., datë 05.09.2002 dhe nr.5562/3 prot., datë 19.09.2002, me anë të cilave kërkohet detyrimi i abonentëve të paguajnë detyrimisht Librat Telefonike në vlerën

567 lekë, në rast të kundërt do t'ju ndërpritet linja telefonike. Ky akt bie ndesh me Kontratën e Abonimit, që ekziston ndërmjet shtetasve dhe Entit Furnizues, si dhe me të drejtat dhe liritë e tyre.

Mbas një hetimi të kryer nga ana e ekspertëve të Avokatit të Popullit, rezultoi se vlefata e këtij Libri Telefonik është likuaduar nga ana e Albtelekom SH.A. për një afat 5 vjeçar d.m.th. deri në vitin 2006. Gjithashtu morëm dijeni se dy zona të rëndësishme të Albtelekomit, Tirana dhe Durrësi nuk e kanë zbatuar këtë shkresë, pasi e konsiderojnë atë jashtë kompetencave ligjore dhe shkelje të të drejtave të abonentëve, të sanksionuara qartë në Kontratën e Abonimit.

Nisur nga sensibilizimi i gjithanshëm për këtë shkelje, ju vëmë në dijeni dhe rekomandojmë të merren masat përkatëse për shfuqizimin e këtyre urdhërave administrative, duke shmangur kështu precedentët negativë kur vetë Entet Publike (ende me kuota shtetërore) bëhen shkas për shkelje dhe pakënaqësi në masën e gjerë të popullatës”. Kërkesa jonë u pranua dhe urdhërat administrativ të paligjshëm u anuluan.

Aktualisht Avokati i Popullit po bashkëpunon me ekspertë të Albtelekom SH.A. dhe Entin Rregullator të Telekomit për të arritur hartimin e një Kontrate bashkëkohore mes Entit të Albtelekomit dhe abonentëve. Këtë kontratë, paraprakisht po e hartonte Drejtoria Ekonomike e këtij Enti dhe jo Drejtoria Juridike, gjë që nuk ishte normale. Aktualisht në këtë punë u tërhoqën edhe subjekte të tjera të interesuara si Drejtoria e Konsumatorit dhe Shoqata e Konsumatorit.

Besojmë se brenda vitit 2003 edhe abonetit shqiptar të telefonisë fikse do t'i ofrohet një kontratë bashkëkohore ku do të sanksionohen qartë të drejtat dhe detyrimet dypalëshe, në barazi të plotë, konformë Kushtetutës dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Ankesa ka patur edhe për Kompanitë private të telefonisë celulare AMC dhe VODAFON për tarifatat dhe faktin se kartat nuk mbushen mirë. I jemi drejtuar Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, i cili duhet të merret me këto çështje, por ende nuk kemi përgjigje. Çështja është në ndjekje.

17- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2002 kanë ardhur tek ne 12 ankesa. Nga 6 të përfunduara, 1 është zgjidhur në favor, 3 kanë qenë jashtë juridiksionit dhe 2 kanë qenë të pabazuara. Janë në shqyrtim 6 ankesa.

Problematika e ankesave që kanë patur të bëjnë me këtë Ministri ka qenë në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të gjykatës, shkelje të së drejtës së informimit, apo për largime nga puna apo masa disiplinore.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara, mund të përmendim një çështje të zgjidhur pozitivisht nga ana jonë në lidhje me ekzekutimin e një vendimi të Ministrisë së Kulturës për pangesën e një shume të hollash për sponsorizimin e botimit të veprës së ankuesit.

Nga ana e kësaj Ministrie ka patur vonesë në akordimin e fondeve dhe për këtë arsye nga ana jonë ju kërkua shpjegime dhe argumenta në lidhje me këtë vonesë.

Në përfundim, pas ndërhyrjes tonë, Ministria analizoi edhe njëherë procedurat në bazë të të cilave kishte dalë ky urdhër dhe ankuesi arriti të marrë të hollat që nuk i jepeshin pa të drejtë.

Gjithashtu në vitin 2002 u zgjidh pozitivisht edhe ankesa e paraqitur që në vitin 2001 nga punonjësit e Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë për barazimin e pagave të tyre në raport me ato të punonjësve të institucioneve të tjera të të njëjtës shkallë, si institucione kulturore me rëndësi kombëtare.

18. Ministria e Mjedisit

Gjatë vitit 2002 kanë ardhur 15 ankesa me problematikën e ndotjes së mjedisit, në ndryshim nga dy vitet e mëparshme, ku nuk ka patur ankesa nga individë të ndryshëm për këto probleme. Nuk janë përfshirë në këtë Ministri ankesat për ndërtime pa leje. Ndonëse numri nuk është i konsiderueshëm, një fakt i tillë tregon se publiku shqiptar po ndërgjegjësohet për nevojën e një ambjenti të shëndetshëm dhe për menaxhimin më të mirë të tij.

Nga 15 ankesa, 12 prej tyre kanë pasur për objekt “ndotje e rrezikim të ambjentit nga rrezatimet e antenave celulare të ndodhura mbi godinat e banimit”. Fillimisht, mbi bazen e një artikulli të shkruar në gazetën

“Republika” të datës 08.02.2002, me titull “Antenat Celulare, mbetën shurdhë 3 fëmijë të policit, rrezatimi 10 metra larg shtëpisë”, duke parë se ky rast i bërë publik ishte shqetësues, me nismen tonë filluam shqyrtimin e çështjes. Më vonë erdhën edhe ankesat, me të njëjtin objekt, ndaj kompanive celulare AMC dhe Vodafon.

Nga Zyra jonë u ndërmorrën hetime, duke marrë shpjegime personave të ndryshëm, kqyrur vendi i ngjarjes në Librazhd dhe akte të ndryshme, dokumente shkresore si dhe duke pyetur mjekët përkatës.

Për të dhënë një mendim të kualifikuar lidhur me rrezatimet e mundëshme, ne caktuam si ekspert një specialist italian me njohuri të posaçme në këtë fushe, i cili përdori dhe aparatura të posaçme matëse të rrezatimit.

Në konkluzionet e ekspertimit të kryer prej tij, doli se ka të dhëna që nga vendosja e antenave për telefoni celulare, ndotet ajri përmes çlirimit të gazrave dhe lëndëve të tjera toksike radioaktive tej normave të lejuara, të cilat përbejnë rrezik për shëndetin e njerëzve. Gjithashtu nga analiza e shkaqeve që kanë sjellë pasojat e mësipërme, rezultoi se në këtë rast nga ana e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit, dhe agjensitë e saj rajonale, është vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin nr.7664, datë 21.01.1993, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

Kështu sipas nenit 9 të Ligjit Nr.7664 dhe ndryshimeve të bera me vonë (neni 3), Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes së Mjedisit, ka detyrimin ligjor “Të bëjë vlerësimin e ndikimit ndaj mjedisit, para vënies në përdorim të programeve, projekteve dhe tërë veprimtarisë së personave juridikë apo fizikë, që shtrijnë aktivitetin e tyre në këto mjedise”. Po kështu, sipas nenit 10 të ligjit të sipërcituar dhe interpretimeve të bëra në ligjin shtesë, neni 4 “Agjensia e mësipërme ka detyrimin ligjor që të bëjë rivlerësimin e projekteve dhe veprimtarive që ndikojnë ndaj mjedisit, periodikisht me urdher të kryetarit të Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit, por jo më rrallë se një herë në 5 vjet”.

Duke qënë para këtij konkluzioni të ekspertit ne konkluduam se nëse nga ana e kësaj agjensie do të ishte vepruar në konformitet me këto detyrime ligjore, pasojat e ardhura do të ishin mënjeluar. Kjo sepse nga njëra anë kompanitë Vodafon dhe AMC, ose nuk do të ishin lejuar të kryenin veprimtaritë e mësipërme, ose veprimtaria e tyre do të ishte kryer në konformitet me ligjin, duke mos sjellë asnjë pasojë ndaj mjedisit.

Ndaj si përfundim, bazuar në nenin 21/ç të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i rekomanduam Prokurorisë Tiranë fillimin e hetimit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës ndaj punonjësve dhe drejtuesve të ish Agjensisë Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit, (sot Ministria e Mjedisit)

dhe për veprën penale të “Ndotjes së ajrit”, ndaj drejtuesve të Kompanive “Vodafone Albania” sh.a, si dhe “AMC” sh.a.

Çështja është ende në proces hetimi nga Prokuroria e rrethit Tiranë. Materialit tonë kallzues i janë bashkuar edhe mjaft ankesa të tjera dërguar nga qytetarët ku shprehet shqetësimi i tyre për rrezatimin e mundshëm. Evidentojmë se gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave zyrtarët e ngarkuar me detyrën e kontrollit të këtij lloj rrezatimi justifikoheshin se nuk kishin mjete të posaçme matëse, por se ata “kishin bërë kontrolle me mjetet dhe specialistët e dy kompanive dhe niveli i rrezatimit kishte dalë i padëmshëm”. Kuptohet lehtë sa objektive e të besueshëm janë “kontrolle” të tilla, nga njerëz dhe nga mjetet e kompanive që akuzohen.

Veç rekomandimit për fillim e çështjes penale ne ju drejtuam edhe tre Ministrave, të Mjedisit, të Shëndetësisë dhe atij të Transportit dhe të Telekomunikacioneve, si edhe vumë në dijeni Kryeministrin për nevojën e hartimit të Ligjit të posaçëm për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga këto lloj rrezatimesh. Që të tre dikasteret na janë përgjigjur se po punojnë për përgatitjen e projektit përkatës edhe sipas rekomandimit tonë. Çështja vazhdon të ndiqet nga ana jonë.

19. Ministria e Industrisë dhe Energjitikës

Ankesa që kanë lidhje me objektin e punës së kësaj Ministrie rezultojnë gjithsej 80, nga të cilat 16 kanë lidhje direkt me Ministrinë dhe 64 janë ndaj Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare.

a. Ankesa për vetë Ministrinë.

Nga 16 ankesat, 7 prej tyre kanë rezultuar jashtë juridiksionit, 1 e zgjidhur në favor, ndërsa 8 ankesa janë në proces shqyrtimi. Në 6 prej këtyre ankesave objekt ka qënë mosplotësimi i detyrimeve të Këshillit të Ministrave të marra përsipër me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së koncesionit nga Shoqeria italiane Darfo për objektet e Albkromit dhe Albaker për pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve që kanë punuar në keto miniera para dhënies me koncesion. Në bazë të Ligjit nr.8590, datë 23.02.2000, në nenin 4 përcaktohet se: “Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së koncesionit, Këshilli i Ministrave trajton detyrimet ndaj buxhetit të shtetit dhe të tretëve që janë objekti i koncesionit”. Nga shqyrtimi i këtyre ankesave, rezulton se detyrimi i Këshillit të Ministrave ndaj buxhetit të Sigurimeve Shoqërore dhe të tretëve është i madh. Prandaj në këtë moment

rëndësi ka fakti se cilat do të jenë hapat që do të ndërmerren deri në shlyerjen e plotë të këtij detyrimi. Rezulton se nga ana e ish Ministrisë së Ekonomisë Publikës dhe Privatizimit (sot Ministria e Industrisë dhe Energjitikës) i është dërguar në vitin 2001, Ministrisë së Financave shkresa, “Për trajtimin e detyrimeve të objekteve që kalojnë në koncension”, ku vihet theksi për të programuar në buxhetin e shtetit për vitin 2002 shlyerjen e këtyre detyrimeve. Nga Ministria e Financave është dhënë përgjigja që kjo Ministri, pra e Industrisë dhe Energjitikës, duhet të përgatisë një projekt vendim për mënyrën e trajtimit të këtyre detyrimeve dhe jo të paraqesë listën e tyre pranë Ministrisë së Financave. Kjo sepse këto detyrime kapin shifra disa herë më të mëdha se mundësitë financiare që ka buxheti vjetor i shtetit, ndaj duhet studjuar mënyra dhe afatet kohore të shlyerjes së këtyre detyrimeve. Është e qartë se duhet të dalë një vendim nga ana e Këshillit të Ministrave për shlyerjen e detyrimeve, por janë zvarritje burokratike shkëmbimet e shkresave për të sqaruar se cila do të jetë Ministria që duhet të marrë inisiativën për hartimin e projektvendimit, kur dihet se këtë detyrë e ka Ministria e linjës. Veçse koha kalon dhe ankuesve që kanë mbushur moshën për pension nuk u jepet mundësia ta gëzojnë të drejtën e tyre sepse disa nga nëpunësit publike të shtetit nuk kryejnë me korrektesë detyrat e tyre.

b. Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A.

Gjatë vitit 2002 kemi patur 64 ankesa dhe kërkesa kundër KESH-it Tiranë dhe filialeve të tjera në rrethe. Numri më i madh i ankesave kanë ardhur nga Tirana dhe Elbasani. Me poshtë po japim disa nga ankesat me problemet më kryesore në këtë fushë.

1.Pranë Institucionit tonë kanë paraqitur ankesa mjaft shtetas me pretendimin se, ata kanë paguar rregullisht faturat e energjisë elektrike, por nuk marrin energji elektrike për shkak se është ndërprerë energjia që në kabinat apo fidrat përkatës të zonave apo lagjeve.

Nga verifikimet tona ka rezultuar se ankesat e tyre kanë qënë të drejta, pasi u vërtëtua se kishin paguar rregullisht çdo muaj. Por sipas shpjegimeve të Filialit të KESH-it Tiranë, doli se shkak i ndërprerjes se energjisë ishte Urdhëri nr.32, dt.2.04.2001 i Drejtorit të Përgjithshëm të KESH. Kështu në pikën 1 të këtij Urdhëri thuhet se : “Të gjitha kabinat dhe fidrat që rezultojnë me nivel arkëtimi më të vogël se 30 % kundrejt faturimit, t’u ndërpritët energjia elektrike “. Kurse në pikën 6 thuhet “Energjia elektrike do të rilidhet pasi të jetë paguar jo me pak se 70% e energjise elektrike. Prandaj ju drejtuam Drejtorit të Përgjithshëm të KESH-it me rekomandimin si më poshtë:

“Duke shqyrtuar këtë urdher del qartë se ai është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe me kushtet e kontratës së furnizimit me energji elektrike që çdo klient ka lidhur me KESH-in në bazë të Kodit Civil.

Kështu është shkelur pika 1 e nenit 4 të Kushtetutës që përcakton se “E drejta përbën bazën dhe kufinj të veprimtarisë së shtetit”, pika 3 e nenit 11 të Kushtetutës: “Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike” si dhe pika 1 e nenit 42 të Kushtetutës “ Liria, prona dhe të drejtat e njohura me kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”.

Duke mirëkuptuar arsyet (si mungesa e energjisë elektrike dhe mos pagimi i plotë i saj nga të gjithë konsumatorët) që kanë determinuar nxjerrjen e këtij urdhëri që përmban shkeljen e këtyre parimeve Kushtetuese, theksojmë se këto shkelje (kufizimi) nuk mund të bëhen me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të KESH, por veçse me një ligj përkatës, i cili do të merrte parasysh edhe nenin 44 të Kushtetutës për një zhdëmtim të drejtë të dëmit që do t’u shkaktohet klientëve të rregullt.

Në rastin konkret pikat 1 dhe 6 të Urdhërit nr 32, dt.02.04.2001 janë “dënime kolektive “dhe si rrjedhojë janë jo vetëm antikushtetuese, por edhe shkelje të hapura e të rënda të të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve.

Askush nuk mund të ndëshkohet për shkak se fqinjët e tij nuk kanë zbatuar kontratën apo shkelin ligjet. Në çdo rast ky problem duhet të zgjidhet duke i shkëputur energjinë elektrike çdo individ që nuk paguan dhe në asnjë rast asnjë klienti të rregullt. Zbatimi i ligjit nuk sigurohet me arbitraritete, por veçse me kërkesë për zbatim të ligjit nga çdo individ që shkel ligjet”.

Për të gjitha këto arsye i rekomanduam ndryshimin e pikave 1 dhe 6 të Urdhërit të tij nr.32, dt.2.02.2001.

Ne datën 07.05.2002 Drejtori i Përgjithshëm na ktheu përgjigje pozitive për shfuqizimin e pikave të mësipërme të urdhërit të tij.

2. Ka pasur mjaft ankesa në lidhje me faturat afrofe të zbatuara nga KESH ndaj konsumatorëve të cilët nuk kanë sahatë matës. Në shumë raste ato vendosen pa asnjë dallim ose dëshirë të mirë nga ana e KESH-it për të gjetur rrugët dhe mundësitë për kolaudimin e sahatëve ekzistues apo zëvendësimin e tyre etj. Ka shumë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë as mjetet më të domosdoshme dhe as aparatura shtëpiake që të harxhojnë shumë energji dhe, ndërkohë atyre ju zbatohen fatura aforfe në një vlerë të lartë në krahasim me të ardhurat e tyre. Këto ankesa dhe fakte

nuk merren parasysh nga KESH, pavarsisht që është detyrë e këtij Enti vendosja e sahatëve matës.

Shume qytetarë ankohen se kanë shkuar disa herë në zyrat e KESH-it për të kërkuar vendosjen e sahatëve të rinj, por nga ana e Kesh- it ka një zvarritje të pajustificueshme. Si rrjedhim, ata janë të detyruar nga nevoja ekstreme që të paguajnë fatura me vlerë afrofe. Ky veprim është një shkelje e të drejtave të konsumatorit sepse zbatimi në këtë mënyrë i pagesës aforfe nuk është masë e përkohshme, por penalitet (dënim) financiar për ta.

Në 7 zonat ku KESH shtrin aktivitetin në Shqipëri, me ndërhyrjen e Institucionit tonë, konsumatorët të cilët kanë pretenduar se harxhojnë me pak se afrofeja është arritur të kenë prioritet për t'u pajisur me matës të rinj të energjisë elektrike. Përsa i përket qytetarëve që kanë patur matësat e vjetër është arritur që një pjesë të tyre të kolaudohen, në laboratorët e KESH-it dhe të pranohet leximi i këtyre matësive pasi të plotësojnë kushtet teknike.

3. Në mjaft raste shtetasit ankohen se faturat nuk ju vijnë rregullisht në banesat e tyre. Për këtë shqetësim është ndërhyrë pranë strukturave përkatëse të KESH-it dhe në pjesën më të madhe të tyre ky problem është zgjidhur. Ndërkaq duhet vënë në dukje se në mjaft zona banimi për shkak të ndërtimeve të shumta, herë dhe abuzive dhe me probleme urbanistike, konsumatorët nuk kanë adresë të sakta. Në këto raste KESH-i duhet të bashkërendojë më mirë punën me organet e pushtetit vendor.

4. Ankesa të shumta kanë ardhur edhe në drejtim të punonjësve të KESH-it, (faturuesve) të cilët për neglizhencë ose moskorrektësi në kryerjen e detyrës, megjithëse konsumatorët kanë matës të rregullt, ju shënojnë atyre sasi kilovat energji krejt ndryshe nga sa kanë harxhuar konsumatorët realisht. Kjo ndikon në rritjen e vlerës së pagesës së konsumatorit, sepse dihet se çmimi është caktuar edhe mbi sasinë e kilovat energji për çdo muaj. Kalimi i sasisë mbi 300 KW bën që konsumatori të paguajë çmim më të lartë. Në lidhje me këtë problem është komunikuar me personat përkatës të KESH-it, duke ju vënë në dijeni faktet konkrete dhe në shumë raste këto janë verifikuar dhe janë marrë masat kundrejt faturuesve të pandërgjegjshëm.

5. Në raportin e vitit të kaluar ne kemi theksuar me forcë nevojën e vënies në funksion të një kontrate të re tip të furnizimit me energji elektrike. Mund të raportojmë me kënaqësi se tashmë duke bashkëpunuar me KESH-in dhe me asistencën tonë profesionale juridike u arrit që nga Enti Regullator i Energjitikës të miratohet kontrata e re tip, e cila do fillojë të futet në përdorim në muajin prill 2003. Kjo sepse janë rreth 750.000 kontrata të reja që duhen plotësuar. Megjithatë sqarojmë se edhe kjo

kontratë e re tip nuk është e përkryer për të vënë konsumatorin në pozitë plotësisht të barabartë me Entin Publik të KESH, për shkak se pozita e KESH-it është monopol i shtetit dhe akoma nuk mund të themi se janë kushtet për realizimin e marrëdhënieve civile në barazi të plotë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë një punë të madhe për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik për çdo shkelje ligjore ose cenim të interesave të ligjshëm të shtetasve nga ana e KESH. Por edhe kemi kërkuar që qytetarët të plotësojnë detyrimet për pagesën e energjisë elektrike. Detyrë kryesore për vitin në vijim është zbatimi me korrektësi dhe paanshmeri i kontratës së re tip nga të dy palët.

20. Ankesa për Shërbimet Sekrete

Gjatë vitit 2002 pranë Avokatit të Popullit kanë ardhur 11 ankesa, kundër veprimeve ose mosveprimeve të organeve të Shërbimit Informativ Shtetëror. Për shkak të natyrës së këtyre shërbimeve ankesat dhe kërkesat ndaj tyre janë parë me përparësi dhe kujdes të posaçëm. Si rrjedhojë pas shqyrtimit dhe verifikimit të tyre ka rezultuar se 3 kanë qenë të bazuara dhe 5 të pabazuara, 2 janë nxjerrë jashtë juridiksionit dhe 1 është në shqyrtim.

Nga grupimi ankesave del se:

1. Nga 5 ankesa për largim nga puna në këto shërbime asnjëra nuk ka qenë e bazuar.

2. Shtetasi G.P. është ankuar për moszbatimin e një vendimi të gjykatës që e detyronte Shërbimin Informativ të Shtetit që të paguante qiranë prej 2 milion lekë, për shkak se kishte përdorur banesën e ankuesit. Pas ndërmjetësimit të Institucionit tonë ankuesi mori shumë e kërkuar.

3. Sindikata e Pavarur e Ekonomisë së Vogel dhe Zejtarisë të Kosovës është ankuar se në vitin 1995 është rrëmbyer dhe zhdukur nga SHIK-u kryetari saj R.H. Hetimet janë pezulluar nga prokuroria në vitin 1997. Nga ana jonë u studjua dosja penale dhe materiale të Shërbimit informativ, si dhe u bënë verifikime duke pyetur persona që kishin dijeni për çështjen. Në përfundim ju rekomandua Prokurorit të Përgjithshëm rifillimi i hetimeve. Jemi njoftuar se hetimet kanë filluar.

4. Shtetasi Z.K. është ankuar se në vitin 1995 është rrëmbyer dhe torturuar nga ish punonjësit e SHIK-ut të Tiranës. U kryen verifikimet përkatëse dhe pasi u konkludua se kishte bazë për të filluar procedimin penal, ju rekomandua Prokurorit të Përgjithshëm fillimi ndjekjes penale. Jemi njoftuar se hetimet kanë filluar.

5. Është akoma në shqyrtim ankesa e shtetasit A.H. nga Fieri për mbajtjen të izoluar të djalit të tij nga shërbimi informativ në vitin 2001. Pengesë për t'a përfunduar ka qenë fakti se prokuroria e Tiranës në kundërshtim me ligjin, ka refuzuar të na dërgojë për studim dosjen penale përkatëse.

Theksojmë se marrëdhëniet institucionale midis Avokatit të Popullit dhe Sherbimit Informativ Shtetëror kanë qenë ligjore dhe nuk na kanë nxjerrë pengesa në punën tonë. Nga ana e këtij shërbimi gjithmonë janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentat e kërkuara edhe kur ato kanë qenë sekrete, duke zbatuar ligjin. Nga ana e këtij shërbimi pranë Avokatit të Popullit janë dërguar për të dhënë mendim ligji “Për përgjimet e komunikimeve dhe të telekomunikimeve”, si dhe për ligjin e ri të shërbimit, gjë që tregon për kuptim dhe vlerësim të drejtë të Institucionit tonë si garanci për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kemi patur vërejtje ndaj këtij shërbimi për zbatimin e rregullores për masat që merren ndaj punonjësve, sepse disa herë masat e dhëna disiplinore apo largimet nga puna nuk përputheshin me përkufizimin që ka rregullorja aktuale për masat disiplinore. Gjithashtu një e metë tjetër që ju është bërë e ditur ka qenë dokumentacioni i dosjeve të personelit, të shqyrtuara pas ankesave të bëra, i cili nuk pasqyronte sa dhe si duhet punën disa vjeçare të ankuesve, duke mos bërë çdo vit vlerësimin e punës për çdo punonjës. Ndonëse nuk kemi patur ankesa me shkrim, nga punonjësit e këtij shërbimi na janë paraqitur ankime verbale se disa të drejta që parashikon ligji për personelin e këtij shërbimi nuk zbatohen siç duhet, siç janë pagat shumë të ulta, mungesat e strehimit, nuk u jepet shpërblimi i gradave prej disa vjetësh etj. Shumë nga këta punonjës ankohen se nuk gëzojnë statusin e ushtarakut siç e parashikon ligji, gjë që është një shkelje flagrante nga ana e shtetit e të drejtave të dhëna me ligj të posaçëm.

21-Përgjithësime për Marrëdhëniet e Punës

Nga shqyrtimi i ankesave me objekt marrëdhëniet e punës, rezulton se në çdo nivel të administratës publike qëndrore dhe vendore, janë evidentuar probleme që lidhen me zbatimin ose mos zbatimin e legjislacionit që rregullon këtë marrëdhënie.

Numri i ankesave për vitin 2002 është 172, nga të cilat 15 janë në favor të ankuesve. Ndërsa në vitin 2001 kanë qënë gjithsej 150 ankesa. Numri i ankesave është i lidhur ngushtë me numrin e të drejtave të shkelura dhe evidentimi i rasteve të bazuara dhe të pabazuara, na ndihmon që të nxjerrim konkluzione për masën e shkeljes së të drejtave të njeriut, të nxjerrim në pah fenomenet dhe tendencat, në mënyrë që ta kemi më të lehtë të nxjerrim iniciativat ligjvënëse për rregullimet ligjore përkatëse.

Pikërisht ajo çka rezulton nga shqyrtimi i ankesave të Institucionit Avokatit të Popullit, si një mediator midis administratës publike dhe individit, në favor të mirëqeverisjes, shërben si lëndë e parë dhe informacion shumë i vlefshëm për ligjvënësin. Ankesat e trajtuara kanë qënë të ndryshme dhe të larmishme, duke filluar që nga parregullsitë në lidhjen e kontratave të punës, individuale dhe kolektive, aq me tepër që ka akoma mungesa të kontratave individuale, mos zbatim i rregullave të mbarimit të kontratës, mos derdhja e kontributeve shoqërore nga ana e punëdhënësve, si ne sektorët shtetërore ashtu dhe ato privatë, etj.

Të gjitha këto probleme janë bërë prezent edhe ne Raportin që Institucioni i Avokatit të Popullit paraqiti në vitin 2001. Edhe legjislacioni në këtë drejtim nuk ka zhvillime të reja, megjithëse është hartuar një draft. Zhvillimet e reja dhe kushtet ekonomike sociale, kanë vënë në provë vetë Kodin e Punës të miratuar në vitin 1996 dhe kanë nxjerrë në pah papërshtatshmëri dhe probleme, si në marrëdhëniet individuale ashtu dhe ato kolektive, të cilat duhet të merren në konsideratë në ndryshimet që propozohen të bëhen në këtë Kod të ri.

Kështu vërehet se Kodi i Punës që është në fuqi është një bashkim legjislacionesh të vendeve të ndryshme për pjesë të ndryshme të tij. Por ky bashkim nuk ka gjetur sa duhet një përqasje dhe harmonizim me traditën shqiptare, me stadin e zhvillimit social e ekonomik dhe veçoritë që paraqet shoqëria jonë si për sa i takon tregut të punës, ashtu dhe shërbimit të asistencave që ofrohen nga shteti për të papunët. Të gjitha këto janë shumë larg vendeve të zhvilluara që kanë shërbyer si modele për hartimin e këtij legjislacioni.

Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij Kodi, ka dalë se shpesh terminologjia juridike ka sjellë moskuptim për pjese të veçanta të ligjit dhe si rrjedhojë mos zbatim në mënyrë korrekte, si nga ana e pushtetit gjyqësor, i cili ka raste që mban qëndrime të ndryshme për çështje të njëjta, ashtu dhe nga palët që lidhin marrëdhëniet e punës, të cilët shpesh nuk arrijnë të kuptojnë e të formulojnë të drejtat dhe detyrimet që burojnë prej vetë ligjit. Pikërisht këto çoroditje kanë passjellë dhe shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.

Institucioni ynë që ka ndjekur këto problematika ka vërejtur se ka edhe veprime abuzive të subjektive nga ana e punëdhënësve kundrejt punëmarrësve, të cilat rrjedhin jo nga padijenja dhe moskuptimi i ligjit apo nga boshllëqet ligjore, por nga veprime të qëllimta të drejtuesve, të cilët shfrytëzojnë pikërisht këto të meta në legjislacion për të justifikuar abuzimet e tyre.

Në të gjitha degët e administratës qendrore dhe vendore është konstatuar se në shumicën e rasteve nuk bëhen kontrata pune individuale dhe në rastet e kontratave kolektive të nivelit parë me Sindikatat shpesh ato janë formale, pasi nuk gjejnë zbatim në degët e tjera apo nuk kanë përfaqësimin e duhur. Duke anashkaluar pikërisht momentin fillestar të lindjes së marrëdhënies së punës (lidhja e kontratës individuale të punës) edhe detyrimet e tjera reciproke që burojnë nga ky akt midis palëve shpesh janë të pacaktuara, të paqarta, spontane dhe bëhen burim konfliktesh.

Pothuajse në të gjitha ankesat që kemi trajtuar, vihet re se nga ana e punëdhënësit nuk zbatohen dispozitat që përcaktojnë procedurën e largimit nga puna. As punëdhënësit shtetërorë dhe as punëdhënësit privat nuk e zbatojnë këtë procedure. Më tej, as organet gjyqësore në shumicën e rasteve nuk e analizojnë procedurën e largimit nga puna (nenin 144 të Kodit të Punës). Në kushtet shqiptare, për shumë arsye, punëmarrësit nuk i njohin mirë të drejtat e tyre dhe shpesh kjo padijeni e tyre përkundrejt legjislacionit të punës, shfrytëzohet në mënyrë abuzive nga ana e punëdhënësve në institucionet publike, të cilët me qëndrimet subjektive dhe shpesh për interesa të ngushta personale, bëjnë viktimë të postit të tyre punonjës të pambrojtur dhe pa mbështetje.

Gjithashtu shpesh drejtuesit, në cilësinë e punëdhënësit, abuzojnë me shkaqet justifikuese të zgjidhjes së kontratës së punës, duke shfrytëzuar pikërisht hapësirat që jep ligji në fuqi. Edhe masat disiplinore dhe përshkallëzimi i tyre, deri në marrjen e masës ekstreme të largimit nga puna, nuk gjejnë pasqyrim në legjislacionin e punës, duke i lënë vend gjykimeve të pa drejta të drejtuesve, që në çdo rast e çmojnë personalisht ekzistencën e këtyre shkaqeve.

Në problemet e evidentuara gjatë këtij viti lidhur me marrëdhëniet e punës do të veçojmë edhe ato që lidhen me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për të cilat gjykatat kanë vendosur në favor të punëmarrësve për përfitimin e dëmshpërblimit me pagën e një viti.

Shpesh këto ankesa kanë mbetur pa zgjidhje dhe janë mbartur nga viti në vit. Përgjigjet e marra nga të gjitha organet justifikohen me mungesë fondesh. Për këto ankesa, të cilat bëhen objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe vendoset përfitimi i pagës së një viti në favor të punëmarrësit, kur punëdhënësi ka zgjidhur padrejtësisht kontratën e punës, kemi mendimin që ky detyrim duhet patjetër t'i ngarkohet financiarisht vetë punëdhënësit që ka sjelle një gjëndje të tillë. Kjo sepse shteti nuk mund e nuk duhet të rëndojë buxhetin e tij dhe të mbajë përgjegjësi financiare për veprimet abuzive dhe të padrejta të drejtuesve, të cilët shkelin të drejtat e punëmarrësve.

Një alternativë tjetër e cila mbështetet edhe nga sindikatat është sugjerimi se, kur konstatohet që kontrata është zgjidhur në mënyrë abuzive nga punëdhënësi, atëherë dhe zgjidhja e saj të konsiderohet e pavlefshme dhe kontrata të mbetet në fuqi. Kjo zgjidhje bashkohet me alternativën që parashikonte Kodi i mëparshëm, për rikthim në punë të personit të larguar padrejtësisht, ashtu siç ndodh me vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil. Vendimet e tij shfuqizojnë vendimet administrative të eprorve, nga të cilat nëpunësit rifitojnë vendin e tyre të punës me të gjitha të drejtat e tjera. Edhe për këto vendime praktikisht ka mjaft raste që nuk ekzekutohen sepse vendi i punës zëvendësohet menjëherë nga eprori, i cili në këto raste, duhet të bëjë një veprim tjetër, duke e larguar zëvendësuesin nga puna. Edhe kjo duhet parashikuar në ndryshimet e ligjit.

Në ankesat që janë paraqitur kemi evidentuar se në transferimet e punonjësve që bëhen brenda të njëjtit punëdhënës në nivel paralel ose në nivele të ndryshme ka veprime të pajustificuara. Kjo sepse në mjaft struktura shtetërore mungojnë përcaktimet e kriterëve të punësimit dhe përshkrimet e vendeve të punës, (job discription) të cilët do të ishin një barrierë për drejtuesit që me veprimet e tyre abuzive të sjellin shkelje të të drejtave të punonjësve të tyre.

Në fushën e marrëdhënieve të punës krahas ekzistencës së Kodit të Punës ekziston dhe ligji "Për statusin e nëpunësit civil". Përveç punonjësve, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me këto ligje, ka dhe një kategori tjetër të punonjësve që marrëdhëniet e punësimit rregullohen me ligje të veçanta, sikurse janë ligjet për policinë, për gjykatat, për punonjësit doganorë, për ushtarakët, etj.

Në këto ligje specifike rregullohen vetëm disa aspekte të marrëdhënieve të punës, kryesisht lidhja dhe zgjidhja e kontratës, ndërsa shpesh nuk gjejnë trajtim çështje të tilla si siguria në punë, mbrojtja e shëndetit në punë, struktura e pagës, etj. Përveç Ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, i cili parashikon shprehimisht zbatimin e Kodit të Punës për çdo çështje të patrajtuar në atë ligj, ligjet e tjera nuk parashikojnë këtë zgjidhje. Ky boshllëk ligjor ka krijuar situatën që kur ka probleme për këta punonjës, nuk mund të trajtohen me Kodin e Punës, sepse ka ligj të veçantë për ta dhe, nga ana tjetër ligji specifik nuk i trajton rastet.

Për këto raste, në mënyrë që të mos i lihet vend arbitraritetit dhe subjektivizmit, duhet që ose të plotësohen ligjet specifike për këto të meta, ose të pasqyrohen në ndryshimet e propozuara të Kodit të Punës.

Bashkëekzistenca e dy legjislacioneve që rregullojnë marrëdhëniet e punës për dy kategori të ndryshme ka sjellë shpesh keqinterpretime dhe moskuptim të fushës së zbatimit për secilin prej tyre. P.sh në nenin 2 të ligjit 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, përcaktohet se brenda fushës së veprimit janë edhe nëpunësit e bashkive dhe qarqeve. Në këtë drejtim mbahen qëndrime të ndryshme nga Prefektura të ndryshme. Ky qëndrim i ndryshëm është vërejtur dhe nga ana e Komisionit të Shërbimit Civil, i cili shqyrton ankesat e nëpunësve të këtij shërbimi. Në disa raste me vendimet e tij ka qenë kompetent dhe në disa raste ka shpallur inkompetencën, pavarësisht se kategoria e nëpunësve ka qenë e njëjte.

Në të njëjtën kohë vërejmë se edhe gjatë zbatimit të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” ka qëndrime jo të drejta, duke filluar që nga rekrutimi i nëpunësve, të cilët shpesh nga drejtuesit fillimisht punësohen me kontrata pune dhe me pas formalisht u nënshtrohen konkurseve të pranimit. Ky veprim, që është evident në të gjitha organet e administratës, sikurse paraqitet ka një mbulesë ligjore formale, por në thelb është moszbatim i ligjit, pa përjashtuar rastet kur kjo bëhet për nepotizëm, miqësira e krijim tarafi.

Si përfundim nënvizojmë se në ankesat me objekt marrëdhëniet e punës shkeljet e të drejtave kanë ardhur si rezultat i moszbatimit dhe boshllëkut në legjislacion të Kodit të Punës, të Ligjit “Statusi i nëpunësit civil” dhe në shumë raste dhe të ligjit “Për të drejtën e informimit me dokumenta zyrtare”. Plotësimi i kuadrit ligjor në këtë drejtim do të pakësojë shkeljet e të drejtave të punonjësve. Institucioni ynë do të mbështesë çdo iniciativë legjislative dhe do të përcjellë të gjitha sugjerimet që mendon se përmirësojnë mirëqeverisjen dhe funksionimin e shtetit ligjor edhe në këtë fushë të rëndësishme.

22- Konkluzione lidhur me rastet që kanë të bëjnë me administratën publike

Nga ankesat e shqyrtuara nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2002 për veprimtarinë e Administratës Publike Shqiptare, arrijmë në konkluzionin se në veprimtarinë e saj ka mjaft raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Përveç shkeljes së afateve të përcaktuara për zgjidhjen në rrugë administrative të çështjeve në fusha të caktuara, nga shqyrtimi i ankesave del se kryesisht ka mosvlerësim, mosshqyrtim dhe mospërgjegje ndaj ankesave të qytetarëve, refuzim për pranimin e kërkesave, ankesave e aplikimeve të tyre, mohim të së drejtës për të marrë pjesë në procedurat administrative dhe mohim të së drejtës për të marrë apo për t'u njohur me dokumentet zyrtare.

Ne konstatojmë me keqardhje se ndonëse një pjesë e madhe e shërbimeve të Administratës Publike bëhet kundrejt pagesës së qytetarëve, shpesh këto tarifa janë të larta. Ka rradha të gjata dhe humbje të mëdha kohe për të kryer një shërbim për të cilin vetë administrata është e interesuar që klientët t'i kryejnë këto shërbime publike ose pagesa si p.sh. zyrat e rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, pagesat për KESH, Telekom etj. Evitimi i rradhëve të pritjeve apo cfilitjeve të qytetarëve do të bënte që qytetarët t'a ndjenin veten të respektuar, do t'ju kursenin kohën e tyre të çmuar, do të ndjehen të gjithë të barabartë etj. Por mbi të gjitha do të evitonin shfaqjet e korrupsionit "të vogël" që jo rrallë herë shoqëron këto situata. Raporti ynë është plot me përshkrime të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe parregullsi të tjera. Megjithatë, duhet t'a themi se shpesh kemi vënë re një qëndrim të drejtë dhe nivel të pranueshëm të vet korrigjimit të shkeljeve, sidomos nga Administrata Publike e nivelit të lartë në ministritë, në drejtoritë qendrore, apo prefektura. Por kjo nuk ka ndodhur gjithmonë me bashkitë dhe sidomos me komunat apo autoritetet publike të nivelit të ulët.

Përballë sfidave që ka përpara vetes, përveç përmirësimit të efektivitetit dhe kompletimit të sistemit të ri ligjor e administrativ brenda procesit të integritit me Europën e Bashkuar, detyra kryesore për të gjithë Administratën tonë Publike mbeten:

1-Zbatimi i dispozitave të përcaktuara në Ligjin "Për Kodin e Procedurave Administrative dhe në Ligjin "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", në të gjitha fushat dhe nivelet e Administratës Publike.

2-Rritja e kontrollit lëndor për fushën e veprimtarisë konkrete të hallkave të administratës. Në veprimtarinë e administratës të mos kontrollohet vetëm aspekti financiar, por vetë veprimtaria dhe funksioni përshkrues i punës së çdo nëpunësi. Për këtë duhen forcuar si kontrolli i brendshëm, ashtu dhe i jashtëm mbi administratën. Duhet krijuar të reja dhe atje ku ekzistojnë, duhen forcuar hallkat kontrolluese. Roli i Kontrollit të Lartë të Shtetit është i pazëvendësueshëm, veçse rekomandimet e tij duhen zbatuar pa hezitim.

3-Zbatimi i plotë i Ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” dhe që në çdo vend pune të Administratës Publike të ketë një përshkrim të saktë të të drejtave dhe detyrave që ka personi që punon në atë vend pune (job description).

4-Koordinimi më i mirë i punëve brenda ministrive, midis ministrive me njëra-tjetrën e në veçanti në marrëdhëniet e reja të decentralizimit dhe autonomisë me pushtetin vendor.

5.Forcimi i punës së drejtorive apo sektorëve juridikë në dikastere dhe respektimi i sugjerimeve të tyre nga titullarët, si dhe plotësimi me juristë i organeve më të ulta, veçanërisht në pushtetin vendor. Kjo ka ndikuar në nivelin e vendimeve të këtyre organeve, përfshirë këtu edhe raste të marrjes së vendimeve të kundërligjshme apo të parregullta, sepse në mjaft komuna, por edhe nëpër bashki nuk ka juristë.

6.Administrata Publike e të gjitha niveleve duhet të njohë nivelin e saj qeverisë, duke organizuar herë pas here sondazhe në publik për vehten e saj, por edhe të zhvillojë veprimtari promovuese për veprimtaritë e saj dhe çfarë ajo i ofron publikut.

Ne nuk mund të pretendojmë se kjo është një listë e plotë me rekomandime, të cilat do t’a bëjnë punën e Administratës Shqiptare më të mirë ose do të përmirësojnë rrënjësisht menjëherë cilësinë e saj. Qëllimi ynë është modest: mbi bazën e trajtimit të ankesave të paraqitura pranë nesh lidhur me punën e administratës, të japim shkurtimisht vëzhgimet dhe gjetjet tona, pra disa rekomandime që të vlejné.

Ne kemi thënë dhe e përsëritim se puna jonë konkrete me organet e Administratës Publike ka si objekt kryesor: të merremi me rastet, ku ka dhunim të të drejtave të njeriut ose parregullsi të tjera që çojnë në shkeljen e këtyre të drejtave dhe të ndihmojmë qytetarët.

Duke patur parasysh rastet e ankesave dhe kërkesave që kanë ardhur në Institucionin tonë dhe veprimtarinë e Administratës Publike Shqiptare, nuk është e mundur që të japësh një gjykim pozitiv, pa patur kontestime të bazuara për të kundërtën e këtij gjykimi.

KREU I KATERT

1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportet Vjetorë 2000 dhe 2001.

Disa nga rastet (*ankesa, kërkesa apo rekomandime*) që janë prezantuar në Raportet e viteve 2000 dhe 2001 kanë përfunduar dhe gjatë këtij raporti janë pasqyruar në pjesët përkatëse ku trajtohet problematika e tyre. Prandaj në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, vetëm ato raste të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2003.

1. Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale që familjarët e viktimave të veprave penale të kenë të drejtë të marrin pjesë në gjykim për mbrojtjen e interesave të tyre. Ky rekomandim do të përsëritet, duke propozuar edhe ndryshime të tjera që do të duhet t'i bëhen Kodit të Procedurës Penale, si për shkurtim të afateve të hetimeve paraprake etj.

2. Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, në lidhje me pjesëmarrjen e avokatëve të të dyja palëve ndërgjyqëse kur në Gjykatën e Lartë shqyrtohet kërkesa e ndonjërës nga palët për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu edhe për gjykimin e të gjitha çështjeve me një gjyqtar të vetëm në shkallën e parë.

3. Ndryshime në Kodin e Punës. Është pranuar rekomandimi ynë. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale na ka dërguar projektligjin për ndryshimet e këtij Kodi. Çështja do të ndiqet deri në miratimin e këtyre ndryshimeve nga Parlamenti.

4. Miratimi i Kodit të Ri të Familjes. Projekt ligji për Kodin e ri nga Qeveria është paraqitur në Kuvend për miratim.

5. Plotësimi i ligjit "Për të Drejtat e të Dënuarve" me aktet nënligjore për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe ndryshime të rregullores së policisë së burgjeve.

6. Ndryshime në ligjin "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për përfitime të ushtarakëve të aksidentuar në krye të detyrës.

7. Nxjerrja e ligjit për zhdëmtimet, në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës.

8. Për shfuqizimin e nenit 289 të Kodit Doganor është paraqitur kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, është zhvilluar gjykimi, por vendimi nuk është dhënë akoma, megjithëse ka kaluar një vit.

9. Rekomandim për moszbatimimin nga ana e organeve të administratës shtetërore të vendimeve gjyqësore, duke shkelur nenin 142 të Kushtetutës së Shqipërisë. Njëkohësisht për mos plotësimin nga Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë të kërkesave të vendimit të Qeverisë nr. 355, datë 02.06.1998 për këtë qëllim. Është përsëritur rekomandimi dhe problemi vazhdon të jetë në ndjekje.

10 Rekomandimet për masat për zbatimin e të drejtës së informimit për dokumentet zyrtare. U zhvillua Konferenca Kombëtare me këtë temë dhe do të ndiqet realizimi në vazhdimësi i Rekomandimeve të saj.

11 Kalimi i dhomave të izolimit pranë Komisariateve të Policisë në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ka nisur të vihet në zbatim dhe jemi në ndjekje të çështjes deri në zgjidhjen përfundimtare të saj.

12 Ngritja e shërbimit të kontrollit mjeksor të të ndaluarve që mbahen në Rajonet e Policisë. Nuk janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. Jemi në ndjekje të këtij problemi.

13 Ankesat e banorëve të zonave kufitare, të cilat u dëmtuan nga bombardimet serbe në kufi në vitin 1999 gjatë luftës në Kosovë. Rekomandimet nga ana e zyrës tonë janë dërguar dhe jemi në pritje.

14 Ankesat e banorëve të zonës së Bovillës, pronat e të cilëve u përmbytën nga ndërtimi i ujësjellësit të Bovillës, por që ende nuk janë dëmshpërblyer. Është zgjidhur problemi i kompetencës institucionale për marrjen përsipër të zgjidhjes dhe çështja është në ndjekje.

2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit”.

Ankesat e ardhura nga Zyra e OSCE nuk janë konsideruar me iniciativë. Por në të gjitha rastet që ankesat na kanë ardhur nga Zyra e OSCE Tiranë, është filluar shqyrtimi dhe është shkuar në vend për të takuar ankuesit, apo atyre u është kërkuar të paraqiten tek ne, për të dhënë pëlqimin dhe shpjegimet përkatëse. Në përfundim të çdo rasti është njoftuar Zyra e OSCE me shkrim për mënyrën e përfundimit.

- Në total çështje të filluara me iniciativë gjatë vitit 2001 janë:	15
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	11
- Jashtë kompetence ose juriksionit	2
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	1
- Në shqyrtim	1

Informacion më i hollësishëm është pasqyruar në tabelat përkatëse.

**ANKESA OSE PROBLEME TE TRAJTUARA ME INICIATIVE
TE INSTITUCIONIT GJATE VITIT 2001**

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompetencë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
1	Koha Jonë		Kushtët e jetësës të keqija.	Dhoma izolimi Vlore	+			
2	Republika	R. Dega	Të sëmurët rëndë me kancer që kerkojnë me mirë të vdesin në shtëpi.	Spitali i burgut	+			
3	Republika	R.Limani	Të sëmurët rëndë me kancer që kerkojnë me mirë të vdesin në shtëpi.	Spitali i burgut	+			
4	Republika.	I.Gjoni	Të sëmurët rëndë me kancer që kerkojnë me mirë të vdesin në shtëpi.	Spitali i burgut	+			
5	Republika.	H.Lumani	Të sëmurët rëndë me kancer që kerkojnë me mirë të vdesin në shtëpi.	Spitali i burgut	+			
6	Republika	E.Molla	Të sëmurët rëndë me kancer që kerkojnë me mirë të vdesin në shtëpi.	Spitali i burgut	+			
7	Republika	F.Skerma	Të sëmurët rëndë me kancer që kerkojnë me mirë të vdesin në shtëpi.	Spitali i burgut	+			

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompetencë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
8	Republika	B.Karakushi	Të sëmurët rëndë me kancer që kerkojnë më mirë të vdesin në shtëpi.	Spitali i burgut	+			
9	Iniciuar nga Avokati i Popullit		Mosfunksionimi i Komisionit Mbikqyrës për burgjet.	Tiranë	+			
10	Iniciuar nga Avokati i Popullit		Nuk është i plotë ligji nr.8092, datë 03.02.1996, "Për shëndetin mendor".	Tiranë	+			
11	Gazeta Shqiptare e datës 11.05.2002	Reshit Uku	Lirimi i rrëmbyesve të vajzës së tij, nga policia e Kavajës.	Kavajë			+	
12	Gazeta Reportazh e datës 17.09.2002	Spartako Sartiri	Keqtrajtim nga policia e Shkodrës	Shkodër		+		
13	Koha Jonë		Shtetasi Hajdar Mustafa nga Kamenica e Korçës, var veten sepse policia doganore Greke në Kapshticë vendos në pasaportë vule që e ndalon të hyje atje për 5 vjet.	Korçë		+		
14	Republika	A. Braja	Shtetasi A.Braja nga Librazhdi ankohet për mundësinë e rrezatimit nga vendosja e antenës celulare AMC në afërsi të shtëpisë së tij.	Librazhd	+			
15	Gazeta Republika		"Cosmotë" rihedh në treg karta boshe"	Tiranë				+

MBULIMI MEDIATIK 2002
MEDIA E SHKRUAR

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	10.01.2002	REPUBLIKA	AP 2665 ankesa per institucionet e shtetit per vitin 2001	Njoftim
2	10.01.2002	KOHA JONE	AP 20 mije dollare demshperblim nga KFOR-i (ankese)	Prononcim
3	11.01.2002	ZERI I POPULLIT	AP Shembull funksionimi i Institucioneve te reja.	Interviste
4	13.01.2002	REPUBLIKA	AP 35 ushtarake,te "gjunjzuar"nga ligji,pas vendimit .Ushtaraket fituan gjyqin dhe duan vendin e punes.Shpresat jane varur tek nje projektligj,i cili pritet te miratohet kete vit.	Artikull
5	15.01.2002	KOHA JONE	AP Hetim policit qe keqtrajtoi banoret e zones.	Prononcim
6	25.01.2002	REPUBLIKA	Pazaret e Pushtetit Vendor ia derguan institucionit te AP. Ngecin ne Bashki 11 ushtarake.	Prononcim
7	26.01.2002	REPUBLIKA	Zyrat e shtetit nuk i binden AP. Juristet ndjekin rrugen e lutjeve ne vend te zbatimit me rreptesi te ligjit.	Artikull
8	28.01.2002	KOHA JONE	AP. Rikthimi i lekeve te grabitura ne duart e gjykatave.	Artikull
9	01.02.2002	GAZETA SHQIPTARE	Prefekti denoncohet te "Avokati"	Prononcim
10	05.02.2002	ZERI I POPULLIT	AP. Konstatohen mangesira juridike ne kontratat e sherbimit.	Prononcim
11	06.02.2002	GAZETA SHQIPTARE	AP "Shpejt nje ligj i ri"	Prononcim
12	07.02.2002	SHEKULLI	AP kerkon nga homologu grek verifikimin e lajmit të "Antena 1"për Braho Llapin. Magazinieri i SHIK-ut akuzohet per lidhje me Bin Laden nga ANT.	Njoftim
13	14.02.2002	DITA	Shkelet ligji per informimin publik. Dobjani kerkon ndihme nga autoritetet.	Prononcim
14	14.02.2002	GAZETA SHQIPTARE	AP pershendet vendimin e Gjykares Kushtetuese.	Artikull
15	15.02.2002	BALLKAN	AP " Do te hapim hetim per Ilir Hajrullajin"	Prononcim
16	16.02.2002	BALLKAN	AP ankohet per perfaqesuesit e popullit.	Artikull
17	16.02.2002	SHEKULLI	Arrestimi i Hajrullajit te Avokati i Popullit.	Prononcim
18	16.02.2002	DITA	Dy vjet me Avokatin e Popullit. Ankesat me te shumta jane, ndaj organeve te drejtesise si dhe informimit publik.	Interviste

19	16.02.2002	KOHA JONE	Avokati i Popullit mbush dy vjet.	Artikull
20	17.02.2002	KLAN	Sfida e fundit e Ermir Dobjanit: "Ne emer te popullit". Te mposhte KESH-in dhe Ujesjellesin.	Artikull
21	17.02.2002	DITA	Shatri, Dobjanit: Gjykata e Apelit Vlore me vodhi pronen.	Artikull
22	20.02.2002	ZERI I POPULLIT	Te paafet kerkojne ndihmen e Avokatit te Popullit.	Artikull
23	21.02.2002	KOHA JONE	Dobjani: Takim me Perfaqesues te NATO-s	Njoftim
24	23.02.2002	KOHA JONE	Dobjani: "Mos shkelni te drejtat e emigranteve".	Prononcim
25	23.02.2002	KOHA JONE	Vetevrasja e Mustafes, hetim nga Avokati i Populli.	Prononcim
26	26.02.2002	INTERVISTA	Dobjani: Ja harta e abuzimeve te policise. AP tregon per shkeljet e te drejtave te njeriut.	Interviste
27	27.02.2002	REPUBLIKA	Cifti Naumov. Dorezohen te Dobjani provat shkresore te policise.	Artikull
28	03.03.2002	REPUBLIKA	"Zyrtaret shkelin ligjet me te dyja kembet". 190 ankesa kunder Hajdarages ne ministrine e mbrojtjes. AP u jep zgjidhje.	Artikull
29	03.03.2002	DITA	Dobjani ne parlament per ushtrine.	Njoftim
30	08.03.2002	GAZETA SHQIPTARE	Malaj:PS nuk do te lejoje shkarkimet.	Artikull
31	08.02.2002	USHTRIA	Dobjani- Ministrise: " Studioni rregullimin ligjor te ceshtjes".	Njoftim
32	12.03.2002	KOHA JONE	Nje femije nente ore ne qeli. I ati denoncon te AP Pritet penalizimi i uniformave blu.	Prononcim
33	13.03.2002	KOHA JONE	Amnesty International: Hetim policeve qe dhunuan femijen.	Artikull
34	16.03.2002	GAZETA SHQIPTARE	Policet e Cakes leter Avokatit te Popullit.	Njoftim
35	16.03.2002	REPUBLIKA	"Libra shqip edhe ne burgjet tona" Avokati i Popullit nis kerkesen.	Njoftim
36	16.03.2002	REPUBLIKA	Pronaret kerkojne ndihmen e Avokatit te Popullit per zbatimin e ligjeve.	Artikull
37	16.03.2002	SHEKULLI	Misionaret e paqes, projekt per kufizimin e gjakmarrjes.1380 familje te Malesise se Madhe ne referendum per projektin.	Artikull
38	17.03.2002	REPUBLIKA	Avokati i Popullit kerkon ndjekje penale per zyrtaret, qe kane ndare pronat ne Vlore.	Njoftim
39	20.03.2002	DITA	Pas ankesave te shumta, qe kane vajtur te AP, vjen bashkepunimi;Dobjani dhe KESH se bashku nje kontrate per konsumatorin.	Artikull
40	20.03.2002	SHEKULLI	AP Nje kontrate e re KESH-qytetare.	Prononcim
41	23.03.2002	GAZETA SHQIPTARE	AP ne seminarin: Sa respektohen te drejtat nga gjyqesori.	Prononcim
42	23.03.2002	Gazeta "55"	Institucioni i Avokatit te Popullit kerkon perjashtimin e strukturave te korruptuara te qeverise nga hartimi i modialiteteve te privatizimit.	Artikull

43	24.03.2002	REPUBLIKA	Kane regjistruar prona te trasheguara ne emer te personave qe nuk kane asnje lidhje me ta. AP kerkon ndjekje penale.	Prononcim
44	27.03.2002	RILINDJA DEMOKRATIKE	Opozita: Raporti i Dobjanit, demagogjik.	Artikull
45	27.03.2002	REPUBLIKA	Avokati i Popullit "grykohet" ne Kuvend.	Artikull
46	28.03.2002	Gazeta RD	Dobjani, i vonuar ne reagimin ndaj shkeljes se te Drejtave te Njeriut.	Artikull
47	28.03.2002	Gazeta RD	Avokati i Popullit, nje institucion shurdh.	Artikull
48	02.04.2002	GAZETA SHQIPTARE	Ne gjyqet e pronesise nuk eshte zbatuar ligji	Prononcim
49	04.04.2002	REPUBLIKA	Dobjani: "Pas 4 vjetesh publiku ka humbur besimin per parate e firmave".	Prononcim
50	05.04.2002	KOHA JONE	Flet kryeavokati i Suedise, Claes Eklundh:"Avokati i Popullit, nje institucion serioz".	Interviste
51	05.04.2002	REPUBLIKA	Seminar ne Tirane per marrdheniet e Gjyqesorit me AP."Gjykata dhe gjyqtaret duhet te mbikqyren".	Prononcim
52	05.04.2002	SHEKULLI	Dobjani flet per marrdheniet me Gjyqesorin.	Artikull
53	05.04.2002	ALBANIA	Te Avokati i Popullit mos u anko per vendime gjyqesore.	Artikull
54	16.04.2002	REPUBLIKA	Avokati i Popullit "Urgjent hetime"	Artikull
55	21.04.2002	KOHA JONE	Avokati i Popullit, per te drejtat e shqiptareve ne Greqi.	Artikull
56	23.04.2002	Gazeta RD	Leter drejtuar Avokatit te Popullit (Arbnori, Policia masakroi qytetare te pafajshem)	Artikull
57	24.04.2002	Gazeta "55"	Avokati i Popullit, kontroll per torturimin e Gaxhait e grupit te tij	Artikull
58	26.04.2002	KOHA JONE	Avokati i Popullit: I semuri psikik , nga qelia ne spital.	Artikull
59	03.05.2002	EPOKA E RE Kosove	Dobjani: "Ata qe jetojne ne Kosove duhet te zbatojne vetem ligjet e Kosoves".	Artikull
60	03.05.2002	24 Ore Kosovë	Marek Novicki:"Ombudspersonat jane kontrollues te qeverise". Institucioni i Ombudspersonit eshte garanti i demokracise.	Artikull
61	03.05.2002	KOSOVA SOT	Nenkryetari i Parlamentit te Kosoves pret Ermir Dobjanin.	Njoftim
62	03.05.2002	"ZERI" Kosovë	Dobjani:"Te gjitha ata qe jetojne ne Kosove duhet te zbatojne vetem ligjet e saj".	Prononcim
63	04.05.2002	KOSOVA SOT	Projekte per te drejtat e njeriut dhe avancimin e tyre.Konference Shtypi midis Ombudspersonit te Kosoves dhe Avokatit te Popullit te Shqiperise.	Konference shtypi
64	04.05.2002	EPOKA E RE	Novicki- Dobjani, bashkepunim ne fusha te ndryshme.	Artikull
65	04.05.2002	SHEKULLI	"Avokat i Popullit" apo "Avokat i Qeverise"?	Artikull

66	04.05.2002	KOHA JONE	Hetime bodigardit te Gjinushit qe rrahu paraplegjiket. AP i kerkon prokurorise te nise procedimin.	Prononcim
67	04.05.2002	BOTA SOT	Bashkepunim i mire midis Ombudspersonit te Kosoves dhe AP te Shqiperise.	Artikull
68	05.05.2002	REPUBLIKA	Akuzohen Ujesjelles, Telekom dhe KESH. Mungojne kontratat e reja per qytetaret. Ankesat tek Dobjani.	Prononcim
69	05.05.2002	GAZETA "55"	"Avokati i Popullit" nen ndjekje penale. Ermir Dobjani kallezohet penalisht nga Marketin Topallaj ne Prokurorine e Pergjithshme.	Artikull
70	07.05.2002	ATSH,GAZETA SHQIP.	AP pret ankesa ne Kukës.	Njoftim
71	07.05.2002	ATSH	AP beri vizita ne Kosove.	Noftim
72	09.05.2002	SHEKULLI	Avokati i Popullit, ankohen kuksianet. 25 ankesa per 3 dite.	Njoftim
73	09.05.2002	ATSH	Banoret e Korçes, qytetaret qe i drejtohen me shume AP-se.	Njoftim
74	10.05.2002	ALBANIA	Korca qan hallet te Avokati i Popullit.	Artikull
75	10.05.2002	SHEKULLI	Korçaret, brenda dites 60 ankesa te Avokati i Popullit.	Artikull
76	11.05.2002	GAZETA SHQIPTARE	AP, Dobjani: Ne 5 dite takova kreret e Kosoves. Vizite e AP ne Kosove.	Njoftim
77	12.05.2002	KOHA JONE	Shteti, borxhi 6 milione dollare. Te Avokati i Popullit jane ne shqyrtim 104 kerkesa.	Artikull
78	12.05.2002	GAZETA DITA	Dobjani: Polici i FNSH te ndiqet penalisht.	Prononcim
79	14.05.2002	ATSH	Kryeministri Majko diskuton me AP per "problemet mes individit dhe administrates".	Njoftim
80	14.05.2002	GAZETA SHQIPTARE	Ndalohen prerjet masive te dritave. AP fiton betejën me KESH.	Artikull
81	15.05.2002	REPUBLIKA	Majko: Dobjani te me jape denoncimet e FRESH.	Prononcim
82	15.05.2002	Gazeta RD	Zyrtare te larte ndertojne pa leje.	Njoftim
83	15.05.2002	ALBANIA	Majko takon Avokatin e Popullit.	Njoftim
84	15.05.2002	GAZETA "55"	Majko e Dobjani se bashku per spastrimet politike ne administraten shtetere.	Njoftim
85	15.05.2002	ZERI I POPULLIT	Majko: Administrata shtetere ka nevojë per njerez te rinj me energji te reja.	Prononcim
86	16.05.2002	REPUBLIKA	Zbulohet rreziku i madh i rrezatimit. Fundi i nje beteje.	Artikull
87	16.05.2002	REPUBLIKA	Perfundojne matjet, Avokati i Popullit dergon dosjen per hetim.	Njoftim
88	18.05.2002	REPUBLIKA	"Udhezimet" e para i dha shefi i Ekzekutivit, pas sugjerimeve te "Avokatit te Popullit".	Njoftim
89	21.05.2002	SHEKULLI	Minoret keqtrajtohen ne polici. AP: Nuk kallezojne, vetem dy 13-vjecare denoncuan.	Prononcim
90	06.06.2002	REPUBLIKA	Akuzohet ujesjellesi.Peticion ne emer te AP. Shpresa per zgjidhje.	Njoftim

91	06.06.2002	GAZETA DITA	Ministrja e Ekonomise konsultohet me AP.Tani, ligj per konsumatorin.	Njoftim
92	10.06.2002	ATSH	Linje telefonike falas per ankesat e te burgosurve tek AP.	Artikull
93	11.06.2002	GAZETA "55"	AP kunder bandes se tokave.	Artikull
94	11.06.2002	ALBANIA	Avokati i Popullit, "alo" falas per te burgosurit.	Njoftim
95	14.06.2002	GAZETA RD	Nen hetim polici qe torturoi minorenin. Ap rikthen ceshtjen e femijes.	Njoftim
96	14.06.2002	SHEKULLI	Ceshtja e femijes nga Saranda sfumohet nga prokuroria. Nenkomisioneri Hasani: AP ka sjelle prova por nuk ka akuzuar njeri.	Prononcim
97	14.06.2002	GAZETA DITA	E verteta e keqtrajtimet te minorenit nga policia. Publikohen rezultatet e hetimit ne Sarande.	Artikull
98	14.06.2002	KORRIERI	Rihapen hetimet per keqtrajtimin e jetimit te Sarandes.	Njoftim
99	16.06.2002	ALBANIA	Ministria e Ekonomise konsultohet me AP-ne per projektligjin e "Konsumatorit". Kontrata te reja me Telekom, Kesh-in, dhe Ujesjellesin.	Prononcim
100	19.06.2002	KOHA JONE	Tranvestiti, i vetequajtur Nikoleta, ankohet te AP. "Me ngacmojne policet".	Njoftim
101	21.06.2002	GAZETA SHQIPTARE	Kolonel Karaj:Rendi, jo me problem. Shqetesim vetem gjakmarra dhe trafiku i makinave	Artikull
102	21.06.2002	GAZETA SHQIPTARE	Shenohen 8 ankesa te AP	Artikull
103	21.06.2002	KOHA JONE	Shkoder, lume ankesash tek Avokati i Popullit.	Artikull
104	21.06.2002	REPUBLIKA	Mbushet ne rruge dhe shitet i ambalazhuar, si leng natyral.	Njoftim
105	22.06.2002	GAZETA "55"	"Avokati i Popullit" se shpejti ne Shkoder.	Njoftim
106	22.06.2002	GAZETA RD	Avokati i Popullit denoncon procedurat e privatizimit.	Artikull
107	23.06.2002	ZERI I POPULLIT	Paguajne energjine elektrike por u presin energjine per shkak te komshinjve qe nuk paguajne.	Artikull
108	23.06.2002	GAZETA RD	Avokati i Popullit apo I Qeverise?!	Artikull
109	25.06.2002	ATSH	Komisioneret e Avokatit te Popullit mbledhin ankesat e qytetareve ne disa rrethe.	Njoftim
110	26.06.2002	ZERI I POPULLIT	Komisioneret mbledhin ankesat.	Artikull
111	27.06.2002	ATSH	Pellumbi-Takim-Hansen. Kryetari i Kuvendit Pellumbi takon Avokatin e Danimarkes, Hansen.	Njoftim
112	27.06.2002	ZERI I POPULLIT	Uji shperdorohet, por edhe "vidhet" per t'u perpunuar dhe shitur ne treg.	Artikull
113	27.06.2002	ATSH	Avokati i Popullit-Shkoder. Se shpejti ne Shkoder do te hapet zyra e Avokatit te Popullit.	Njoftim
114	28.06.2002	SHEKULLI	Dobjani: Asnje ankim per diskriminim te minoritetit.	Prononcim
115	28.06.2002	ATSH	Tete qytetare tropojane ankohen te Avokati i Popullit per problemet e tyre.	Njoftim

116	29.06.2002	ALBANIA	Tete qytetare tropojane ankohen te Avokati i Popullit.	Njoftim
117	30.06.2002	SHEKULLI	Avokati i Danimarkes takon Dobjanin.	Njoftim
118	30.06.2002	SHEKULLI	Dobjani: Telefon falas per te paraburgosurit ne polici.	Prononcim
119	01.07.2002	GAZETA SHQIPTARE	Flet Ombudsmeni danez: Do ndihmoj per asociimin e Shqiperise ne BE.	Konf.shtypi
120	05.07.2002	R.D.	AP "Gazetaret jane te mirepritur tek ne"	Prononcim
121	07.07.2002	GAZETA SHQIPTARE	Denoncimi te AP: Ja cfare ndodhi me shtesat. Vajza ne depresion: Me vodhen shkollen e larte.	Prononcim
122	08.07.2002	GAZETA SHQIPTARE	AP per listat e shkollave te larta.	Prononcim
123	09.07.2002	SHEKULLI	Avokati i Popullit perballet me ankesa per dhune policore.	Njoftim
124	09.07.2002	GAZETA SHQIPTARE	Elbasan/ Ermir Dobjani pret ankesa.	Njoftim
125	09.07.2002	GAZETA RD	Nje mal ma ankesa per Avokatin e Popullit. 400 viktime te korrupsionit, ne administrate.	Artikull
126	11.07.2002	GAZETA RD	AP pergjigje negative per grevistet e Dyshnikut	Artikull
127	11.07.2002	GAZETA SHQIPTARE	Avokati harton kontraten mes KESH dhe qytetareve. Korporata tani ka dhe detyrime ndaj konsumatoreve.	Artikull
128	11.07.2002	REPUBLIKA	Vazhdon montimi i aparaturave vdekjepruresse.AP ka kerkuar te njihet me te dhenat shkencore ndaj ketij problemi.	Prononcim
129	11.07.2002	SHEKULLI	AP, 30 ankesa nga Gjirokaster.	Njoftim
130	12.07.2002	SHEKULLI	Kontrata e re e energjise elektrike, ne perdorim brenda vitit.	Artikull
131	12.07.2002	SHEKULLI	Librazhd, 30 ankesa tek AP.	Njoftim
132	13.07.2002	ZERI I POPULLIT	Qeveria miraton Planin antikorrupsion 2002-2003.	Njoftim
133	14.07.2002	"DITA JUG "	Avokati i Popullit-porta ku duhet te trokasim	Artikull
134	20.07.2002	TAGBLATT DER SUDTIROLER	Ombudsmeni shqiptar-mik i Ombudsmanit te Bolzanos .	Njoftim
135	26.07.2002	REPUBLIKA	Shefat "e vegjel" ankohen per "te medhenjte": "Na kane shkarkuar pa motiv nga detyra".	Artikull
136	26.07.2002	Tribuna Juridike	Kontestim i pabazuar ndaj nje vendimi	Artikull Y.Hasani
137	08.08.2002	REPUBLIKA	Tek Dobjani : 250 ankesa ne vit per pronat	Artikull
138	10.09.2002	REPUBLIKA	AP "Te pajisen te gjitha me arme dhe te vendosen kushte!"	Artikull
139	13.09.2002	REPUBLIKA	AP Hedh ne gjyq Bashkine per 70 ushtarake te Tiranës qe mbeten pa shtepi.	Artikull

140	15.09.2002	REPUBLIKA	AP Paralajmeron Edi Ramen : "Kujdes, po kalon kompetencat qe ke!	Artikull
141	16.09.2002	A. T. S H .	AP I rekomandon Kryeministrit ndryshimin e ligjit mbi rregjistrimin në gjëndjen civile.	Njoftim
142	17.09.2002	GAZETA DITA	AP I shkruan Presidentit, Kryeministrit, kryetarit te KQZ-se, qe te behen çrregjistrimet nga gjendjet civile.	Njoftim
143	17.09.2002	ALBANIA	AP:Mijera te vdekur, ende te gjalle.Gjendja civile nuk ben çrregjistrimin e te ikurve ne boten tjetere.	Artikull
144	18.09.2002	GAZETA SHQIPTARE	AP zbulon skandalin:Ndryshoni ligjin.	Artikull
145	18.09.2002	REPUBLIKA	AP:NATO te demshperbleje familjen Camema	Prononcim
146	19.09.2002	GAZETA SHQIPTARE	Denoncon ne AP "Policet me masakruan burrin".	Artikull
147	20.09.2002	BALLKAN	AP Te ndryshohet ligji per ushtaraket	Artikull
148	20.09.2002	REPUBLIKA	Avokati "shkrin"Kuvendin per Ushtaraket	Artikull
149	21.09.2002	ALBANIA	AP 3141 ankesa nga populli	Artikull
150	21.09.2002	REPUBLIKA	AP Kërkon per 10 dite ballafaqimin me Qeverine.	Artikull
151	21.09.2002	SHEKULLI	Konkurset, tek Avokati i Popullit.Dobjani, rektoreve : "Publikoni datat e rregjistrimeve per fituesit e shkollave te larta".	Artikull
152	23.09.2002	A. T. S H .	AP 3141 ankesa deri ne muajin shtator	Njoftim
153	23.09.2002	A. T. SH.	AP do te takohet me Ombudsmanin danez	Njoftim
154	24.09.2002	ZERI I POPULLIT	Meta-Dobjani:Lehtesira per levizjen e lire te shtetasve shqiptare	Prononcim
155	24.09.2002	ALBANIA	Danezet, ndihme per Avokatin e Popullit	Artikull
156	24.09.2002	ALBANIA	Ilir Meta dhe Dobjani : Konsullatat, ndihme per emigrantet.	Artikull
157	24.09.2002	REPUBLIKA	AP leter rekomande per Prokurorine e Beratit: "Filloni procedimin penal!"	Artikull
158	24.09.2002	REPUBLIKA	Dobjani-Meta, takim per te zgjidhur problemin e emigracionit.	Artikull
159	28.09.2002	Danimarke Holbek Amts Venstreblad	Ombudsmani shqiptar viziton burgun Juderup	Artikull
160	01.10.2002	A.T.SH.	Avokati Dobjani perfundon viziten zyrtare ne Kopenhagen.	Njoftim
161	02.10.2002	KOHA JONE	E drejta per studim tek Avokati i Popullit	Artikull
162	03.10.2002	SHEKULLI	Konkurset, Dobjani : "Rihapni dosjet e testeve".	Artikull
163	03.10.2002	KOHA JONE	AP nxjerr fajtoret per abuzimin me listat e studenteve.	Artikull
164	03.10.2002	A.T.SH.	AP takon nje grup ekspertesh serbe te Zyres se Avokatit te Kosoves.	Njoftim

165	04.10.2002	Gazeta DITA	Parlamenti miraton projektin e Dobjanit	Artikull
166	04.10.2002	KOHA JONE	AP "Faktet do të nxjerrin fajtorin"	Artikull
167	04.10.2002	PANORAMA	Konkurset, Avokati i Popullit nis hetimet	Artikull
168	04.10.2002	BALLKAN	Ligji i ri, Avokati i Popullit rikthen dinjitetin e ish ushtarakeve.	Artikull
169	04.10.2002	USHTRIA	AP: Nje grup ushtarakesh te liruar rifitojne sigurimin shoqeror suplementar	Artikull
170	05.10.2002	KOHA JONE	Dobjani : "Te rishikohen testet".	Prononcim
171	06.10.2002	REPUBLIKA	AP Kerkon kontroll per ujin mineral ne treg	Artikull
172	06.10.2002	PANORAMA	AP Lista pa vule dhe firme eshte e pavlefshme.	Prononcim
173	08.10.2002	A.T.SH.	AP takon ambasadorin e OSBE-se ne Tirane Lipponen.	Njoftim
174	09.10.2002	SHEKULLI	Dobjani, kallezim penal Ekonomikut	Artikull
175	09.10.2002	ALBANIA	Dhjetera konkurente, ankese tek Avok.Pop.	Artikull
176	09.10.2002	REPUBLIKA	Dobjani:"Ne nuk rrezojme vendimet e Gjykates!"	Prononcim
177	13.10.2002	BALLKAN	Gjykata Kushtetuese dhe Avokati i Popullit kundershtojne Nanon per pronat	Artikull
178	12.10.2002	ALBANIA	AP nderhyn ne konfliktin abonente-Albtelekom per faturat	Njoftim
179	13.10.2002	GAZETA RD	Forumi i Intelektualeve shqiptare i drejtohet Romano Prodit dhe Doris Pack per pronat	Artikull
180	16.10.2002	KOHA JONE	AP rikthen ne shkolle studenten e Akademise se Rendit. Jane shkelur te drejtat e gruas.	Artikull
181	17.10.2002	REPUBLIKA	Familjaret e viktimave ankohen tek Avokati i Popullit : "Duam te jemi pale ne proces!".	Artikull
182	18.10.2002	A.T.SH.	AP po shqyrton bazen ligjore te ndermarrjes se ujesjellesit.	Njoftim
183	19.10.2002	A.T.SH.	Komisioneri i larte per te drejtat e Njeriut ne KE, Gil Robles ne Tirane.	Njoftim
184	20.10.2002	GAZETA "55"	Takim i Avokatit te Popullit me z.Gil-Robles, Komisioner i larte per te Drejtat e Njeriut ne Keshillin e Europes.	Njoftim
185	20.10.2002	A.T.SH.	AP priti Komisionerin e Larte per te drejtat e Njeriut ne KE, Alvaro Gil Robles.	Njoftim
186	21.10.2002	A.T.SH.	Ministri Spiro Peçi takon Komisionerin e Larte per te Drejtat e Njeriut ne KE Gil Robles.	Njoftim
187	21.10.2002	A.T.SH.	Meta : takohet me Komisionerin e KE-se, Alvaro Gil Robles.	Njoftim
188	21.10.2002	A.T.SH.	Ministri Rama takon Komisionerin e Larte per te Drejtat e Njeriut ne KE Gil Robles.	Njoftim
189	22.10.2002	A.T.SH.	Presidenti Moisiu takon Komisionerin e Larte ne KE Gil Robles.	Njoftim
190	22.10.2002	A.T.SH.	Kryeministri Nano takon Komisionerin e Larte ne KE, Gil Robles.	Njoftim

191	22.10.2002	GAZETA SHQIPTARE	Meta takohet me Gil Robles	Artikull
192	23.10.2002	"ZERI POPULLIT"	Moisiu : Shqiperia e vendosur per realizimin e reformave institucionale.	Artikull
193	23.10.2002	GAZETA "55"	Komisioneri i larte ne KE, Gil Robles, shpreh shqetesimin per gjendjen e burgjeve shqiptare. Ketu shkelen te drejtat e grave.	Konf.shtypi
194	23.10.2002	Gazeta "55"	Presidenti Moisiu takohet me Komisionerin e Keshillit te Europes z.Gil Robles."Levizja e lire e njerezve shmang trafiqet".	Artikull
195	24.10.2002	REPUBLIKA	AP premtan te beje te pamunduren.	Prononcim
196	27.10.2002	BALLKAN	AP Hetime gjyqtares Irena Maneku	Artikull
197	30.10.2002	SHEKULLI	Kullat e El Sajedit tek Avokati i Popullit	Artikull
198	05.11.2002	Gazeta Daneze J.Posten	Ombudsmani shqiptar zgjidh 25% te ankesave.	Artikull
199	05.11.2002	PANORAMA	AP Ka kerkuar fillimin e procedimit penal	Artikull
200	06.11.2002	REPUBLIKA	Dobjani dhe Xhefri takim per t'u njohur.	Njoftim
201	06.11.2002	BALLKAN	Dobjani:Si i fshehen dosjet sekretaret e Gjykates	Prononcim
202	07.11.2002	REPUBLIKA	Ekzekutoi bashkeshortin dhe kerkoi ndihmen e Dobjanit per t'i takuar. Dy vjet nena vrasese u vu ne kerkim te femijeve. Ishin pa adrese.	Artikull
203	07.11.2002	GAZETA SOT	AP kerkon barazine e paleve ne procesin Kokaina	Prononcim
204	07.11.2002	KORRIERI	AP gjen me vend pranine e paleve ne pyetjen e Çestarit.	Prononcim
205	07.11.2002	ATSH	Ambasadori i SHBA, Jeffrey vlereson punen e Avokatit te Popullit.	Njoftim
206	08.11.2002	Gazeta RD	Xhefri-Dobjanit : Zgjidhje perfundimtare per pronat.	Artikull
207	08.11.2002	GAZETA SHQIPTARE	Xhefri pergezoi Avokatin e Popullit	Artikull
208	12.11.2002	KOHA JONE	Vendimi i Gjykates Kushtetuese,precedent me pasoja te demshme.	Artikull
209	12.11.2002	REPUBLIKA	AP Zyrtaret lokale tallen me te drejten e qytetarit dhe kerkojne rryshfete.	Prononcim
210	13.11.2002	ALBANIA	AP zbulon mashtrimin qe ish drejtori u kishte bere punonjesve te tij.	Artikull
211	14.11.2002	REPUBLIKA	AP Inertet nuk mund te luftohen me vendime te kundraligjshme nga organet shteterore.	Artikull
212	14.11.2002	REPUBLIKA	Vendimi i KM per inertet eshte kontradiktor	Artikull
213	15.11.2002	KORRIERI	AP Jo mbylljes se firmave inerte	Artikull
214	15.11.2002	KORRIERI	Rekomandimi i Avokatit te Popullit	Njoftim

215	19.11.2002	KOHA JONE	AP Seminar per te drejtat e ushtarakeve.	Njoftim
216	19.11.2002	A.T.SH.	AP Seminar me Ministrine e Mbrojtjes	Njoftim
217	19.11.2002	KOHA JONE	Nje seminar per mbrojtjen e ushtarakeve	Artikull
218	20.11.2002	REPUBLIKA	Debat institucional ne hotel Dajti. Dobjani dhe Majko shpalosin "armet e ligjit".	Artikull
219	20.11.2002	ZERI I POPULLIT	AP Tek ne 500 ankesa nga Forcat e Armatosura.	Prononcim
220	26.11.2002	Tribuna Juridike	Reforma dhe te drejtat e subjekteve ushtarake	Artikull Y.H.
221	27.11.2002	REPUBLIKA	AP kerkon tryeze per ceshtjen e banoreve te kullave "Hawaialb".	Prononcim
222	27.11.2002	A.T.SH.	Kullat Hawai-Dobjani. Banoret e Kullave Hawai duhet ta zgjidhin problemin ne menyre ligjore.	Njoftim
223	28.11.2002	GAZETA "55"	Ermir Dobjani : "Banoret e kullave Hawai duhet ta zgjidhin problemin ne menyre ligjore"	Artikull
224	28.11.2002	BALLKAN	Çeshtja "Hawai", banoret hedhin ne gjyq KRRT-ne.	Artikull
225	28.11.2002	ALBANIA	Banoret e kullave "Hawai"duhet ta zgjidhin problemin ne menyre ligjore.	Artikull
226	28.11.2002	GAZETA RD	AP ne mbrojtje te banoreve te "Hawai":Sipas ligjit, leja quhet e dhene. Dobjani : Rama dhe KRRT shkelen ligjin.	Artikull
227	05.12.2002	NDERTUESI	Leter e Avokatit te Popullit zotit Ermir Dobjani drejtuar kryetarit te Keshillit te Ministrave zotit Fatos Nano.	Artikull
228	11.12.2002	A.T.SH.	"E drejta per informim, e drejte themelore e njeriut". Konference Kombetare e AP-se.	Njoftim
229	11.12.2002	A.T.SH.	AP: E drejta e Informimit-e drejte e njeriut.	Njoftim
230	12.12.2002	A.T.SH.	Presidenti Moisiu ne Konferencen Kombetare mbi te drejten e informimit, organizuar nga Avokati i Popullit.	Njoftim
231	12.12.2002	A.T.SH.	Administrata publike te fokusohet ne zbatimin dhe ruajtjen e standarteve te mireqeverisjes.	Njoftim
232	13.12.2002	REPUBLIKA	Dobjani : Nuk kemi informim.Zbatimi i ligjeve, shqetesimi i nderkombetareve.	Prononcim
233	13.12.2002	Gazeta SHQIPTARE	Moisiu kerkon me shume transparence.	Artikull
234	13.12.2002	ALBANIA	Konferenca Kombetare "E drejta e informimit, e drejte themelore e njeriut".Zyrtaret, transparence kundrejt qytetareve.	Artikull
235	13.12.2002	Gazeta "55"	Moisiu: E drejta e informimit lidhet me nivelin e besimit te opinionit publik te institucionet.	Artikull
236	13.12.2002	Gazeta RD	Transparenca e administrates, pjese e negociatave me BE.	Artikull
237	13.12.2002	Gazeta DITA	AP u kerkon institucioneve te informojne publikun per gjithçka.	Artikull
238	16.12.2002	Gazeta DITA	AP rivendos te drejtat e nje grupi ushtarakesh	Njoftim

239	17.12.2002	KOHA JONE	Gjykata e Tiranës pritet të marrë në shqyrtim kërkesat për tre autore vrasjesh. Të denuar me semundje të pashërueshme. "Duam të vdesim në shtëpi".	Artikull
240	22.12.2002	Gazeta Daneze "Jyllands-Posten"	"Shqipëria ka nevojë për më shumë punë dhe kapitale".	Artikull
241	22.12.2002	KOHA JONE	AP Ermir Dobjani, në Konferencën Kombëtare me temë : "E drejta e informimit, e drejta themelore e njeriut" ka shpjeguar raportet e medias me shtetin. Shteti, media dhe zyrtari.	Artikull
242	22.12.2002	Gazeta Shqiptare	AP "Gjykata duhet ta zgjidhte në 30 dite dosjen "Hawai".	Interviste
243	22.12.2002	BALLKAN	Prishja e një ndërtese në rrugën "4 Shkurti", nderhyn Avokati i Popullit.	Prononcim

MEDIA ELEKTRONIKE

	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI
1	Neser TV	20.01.2002	Dokumentar per Avokatin e Popullit	Ermir Dobjani - Emision
2	Top Channel	06.02.2002	AP "Shteti te lidhe kontrata te drejta me qytetarin"	Ermir Dobjani - Interviste
3	Top Channel	06.02.2002	"AP investigon per ujin e Bovilles"	Ermir Dobjani - Prononcim
4	TV Gjeli	12.02.2002	AP"per te drejten e Informacionit"	Ermir Dobjani - Interviste
5	TVSH	15.02.2002	Konferenca e Strasburgut vlereson AP-ne	Ermir Dobjani - Njoftim
6	TVSH	15.02.2002	"AP Nje dere e hapur per ju"	Ermir Dobjani - Emision
7	Vizion Plus	06.02.2002	"AP ne dy-vjetorin e tij"	Ermir Dobjani - Emision
8	Tv 2000	19.02.2002	AP: Koment mbi ndertimet pa leje	Ermir Dobjani - Interviste
9	Top Channel	26.02.2002	AP per Sherbimet Publike	Ermir Dobjani - Interviste
10	TVSH, Radio Tirana, TV Koha, Top Channel	26.02.2002	AP takon perfaqësuesen e departamentit te shtetit	Ermir Dobjani - Prononcim
11	Vizion Plus	26.02.2002	AP per Sherbimet Publike	Shefi i Kabinetit Artur Lazebeu - Prononcim
12	Vizion plus	2.03.2002	Problematika ne forcat e armatosura	Ymer Hasani - Interviste
13	Radio Tirana	2.03.2002	Rasti i abuzimit me Romet nuk eshte i vertete	Kabineti - Njoftim
14	Shijak TV	4.03.2002	Shteti duhet te lidhe kontrata te rregullta me qytetaret (sherbimet publike)	Kabineti - Prononcim
15	Zeri i Amerikes	5.03.2002	AP mbi Raportin e Departamentit Amerikan te Shtetit	Ermir Dobjani - Interviste
16	Dojce Vele	07.03.2002	AP mbi nivelin e te Drejtave te Njeriut ne Shqiperi	Ermir Dobjani - Interviste
17	Tv Klan	20.03.2002	AP angazhohet te permiresoje punen e administrates	Ermir Dobjani - Interviste
18	Radio Tirana	20.03.2002	Avokati i Popullit pret Mediatorin e Republikes Franceze	Ermir Dobjani - Njoftim

19	ATSH, Top.Channel, TV Klan, TVA, TNSH	21.03.2002	Dobjani bisedon me Mediatorin Francez	Ermir Dobjani - Njoftim
20	TVSH, TNSH, Klan TVA, Top Channel	21.03.2002	AP pret Mediatorin e Frances	Ermir Dobjani - Njoftim
21	TVSH, TNSH, Klan, TVA, Top Channel	21.03.2002	Kryeministri Majko pret Mediatorin e Frances	Kabineti - Njoftim
22	TVSH, TVA, TNSH	22.03.2002	Presidenti Mejdani takon Mediatorin e Frances	Kabineti - Njoftim
23	TVSH	22.03.2002	Nenkryetarja e Parlamentit bisedon me mikun e Avokatit te Popullit	Njoftim
24	Top Channel	22.03.2002	Seminari per proceset e rregullta gjyqesore	Ermir Dobjani - Njoftim
25	Antena Jug Gjirokaster	23.03.2002	AP dhe homologu i tij francez vizitojne Gjirokastren	Ermir Dobjani - Interviste
26	Klan	24.03.2002	Privatizimi t'i lihet Parlamentit	Ermir Dobjani - Njoftim
27	Top Channel	25.03.2002	AP do t'i drejtohet Qeverise per KESH	Ermir Dobjani - Prononcim
28	TVSH, TNSH, TVA, Klan, Shijak TV	25.03.2002	AP paraqet Raportin Vjetor	Ermir Dobjani - Njoftim
29	TVSH, TNSH, TVA, Klan, TV Shijak	26.03.2002	Deputetet vleresojne Raportin e AP-se	Ermir Dobjani - Njoftim
30	Albanian Daily News	26.03.2002	Mediatori i Frances takon homologun Shqiptar	Ermir Dobjani - Njoftim
31	TVSH	03.04.2002	Kryetari i Parlamentit pret Kryeombudsmanin suedez	Njoftim
32	Shijak TV	02.04.2002	AP per ceshtjen e prones	Agron Çaushi - Prononcim

33	TVSH, TNSH, Radio Tirana	04.04.2002	AP dhe sistemi gjyqesor	Njoftim
34	Shijak TV	22.04.2002	Spekter "Mbi te drejtat e njeriut ne Shqiperi"	Ermir Dobjani, Vasil Melo, Pjeter Arbnori - Emision
35	ATN	28.04.2002	AP tek greva e paraplegjikeve	Ermir Dobjani - Prononcim
36	RT Kosova	04.05.2002	Nowicki pret Dobjanin	Konference shtypi
37	RTV 21 Kosove	04.05.2002	Dobjani shpreh pervojën e tij	Interviste
38	RTK; "Blu Sky" Radio Kosova	05.05.2002	AP i Shqiperise pritët nga Kryeministri i Kosoves dhe Nenkryetari i Kuvendit	Njoftim
39	TV Kosova	06.05.2002	AP dhe qytetaret	Emision
40	08.05.2002	08.05.2002	AP ne Korce	Agron Çaushti - Interviste
41	TNSH	09.05.2002	AP per problemet e dhunes	Ermir Dobjani - Emision
42	Kristal+ (Korce)	10.05.2002	AP pret qytetaret korcare	Njoftim
43	Vizion+	10.05.2002	AP ne Diten e Drejtesise	Ermir Dobjani - Emision
44	ARV	10.05.2002	AP ne Pogradec	Agron Çaushti - Interviste
45	TV Amantia Vlore	12.05.2002	AP pret ankesat ne Vlore	Njoftim
46	Top Channel	13.05.2002	Shteti t'u shlyeje borxhin qytetareve	Ermir Dobjani - Interviste
47	Top Channel	13.05.2002	Shteti te lidhe kontrata te rregullta me qytetaret	Ermir Dobjani - Interviste
48	Top Channel	13.05.2002	Rrezatimi i AMC-se mbi normat e lejuara	Ermir Dobjani - Interviste
49	Vizion+, Klan, TVSH,Koha, TVA, TNSH	14.05.2002	Kryeministri Majko nxit bashkepunimin me Avokatin e Popullit	Njoftim
50	Top Albania, BBC	15.05.2002	AP mbi rrezatimin e antenave celulare	Ermir Dobjani - Interviste
51	TNSH	15.05.2002	AP mbi takimin me Kryeministrin Majko	Interviste

52	TV MAT	17.06.2002	AP Dere e Hapur	Emision
53	TV MAT	18.06.2002	AP ne Mat	Gezim Lleshi - Interviste
54	Puka TV	20.06.2002	AP ne Puke	Agron Çausi - Interviste
55	Lezha TV	20.06.2002	AP pret popullin e Lezhes	Agron Çausi - Interviste
56	Zeri i Amerikes	23.05.2002	AP pritet ne Departamentin e Shtetit	Ermir Dobjani - Interviste
57	Zeri i Amerikes	23.05.2002	AP pret ankesat e tropojaneve	Jorgo Dhrami - Interviste
58	TV Kurbin	26.06.2002	AP ne Kurbin	Interviste
59	Top Channel, Tv Koha	26.06.2002	AP per Permbarimin	Ermir Dobjani - Interviste
60	TVSH, TNSH, TV Arberia, TV Klan	01.07.2002	Ombudsmeni Danez pergezoz funksionimin e AP-se	Konference shtypi
61	Radio Tirana, TV Koha, Top Channel, Vizion Plus	23.09.2002	Zv.Kryeministri Meta: Me Avokatin e Popullit do te mbrojme jo vetem interesat e shtetit, por edhe te shtetasve	Njoftim
62	RTK, BLU SKY, Radio Kosova	1.10.2002	"Ekspertë serbë nga Kosova", vizitë studimore prane AP-së	Prononcim
63	TNSH	03.10.2002	Eksperte te AP-se se Kosoves u trajnuan prane AP shqiptar	Prononcim
64	RTK, BLU SKY, Radio Kosova	03.10.2002	Ekspertet serbe te Ombudspersonit te Kosoves ne Tirane	Njoftim
65	Top Chanel	04.10.2002	AP Rekomandon shfuqizimin e akteve administrative të nxjerra nga ALBTELEKOM sh.a.	Brizida Gjickondi - Interviste
66	TVA	04.10.2002	AP Hap testet e studenteve	Agron Çausi, Brizida Gjickondi - Interviste
67	KLAN	07.10.2002	AP kerkon transparencën e testeve te Konkursit	Artur Lazebeu - Interviste

68	KLAN	08.10.2002	Kryetari i OSBE-se takon AP-ne	Njoftim
69	KLAN	08.10.2002	AP Numeratori telefonik te mos shitet me detyrim	Brizida Gjickondi - Interviste
70	TV Shijak	09.10.2002	Dekanatet te zbatojne transparencen	Artur Lazebeu - Interviste
71	TV Klaudiana	09.10.2002	Çfare te pritni nga AP	Artur Lazebeu - Interviste
72	TV Klaudiana	10.10.2002	AP Dite e hapur ne Peqin	Brizida Gjickondi - Interviste
73	Vizion Plus	11.10.2002	AP zbulon skandalin. Te vdekurit ende ne listat e te gjalleve	Prononcim - Ymer Hasani
74	TV Asparag Rrogozhine	16.10.2002	Dite e hapur ne Rrogozhine	Artur Lazebeu - Interviste
75	TVSH, TNSH; Top Channel, TVA;	20.10.2002	Komisioneri i Keshillit te Europes pritet nga Avokati i Popullit	Njoftim
76	TVSH, TNSH; TVA; Top Channel	21.10.2002	Gil Robles dhe Dobjani takohen me Ministrin e Jashtem, te Rendit, te Drejtesise, Punes dhe Çeshtjeve Sociale	Njoftim
77	TVSH, TNSH; TVA, Zeri i Amerikes Top Channel	22.10.2002	Moisiu dhe Nano takojne Gil Robles dhe Dobjanin: Shqiperia ka rruge te gjate perpara	Konferencë Shtypi
78	Radio Tirana	25.10.2002	AP dhe shqiptaret jashte Atdheut	Ervin Karamuçë - Interviste
79	TVSH	30.10.2002	AP dhe plaga e gjakmarrjes	Jorgo Dhrami - Emision
80	TVA; TVSH; TNSH; Vizion+	30.10.2002	AP Raporton ne Komisionin Parlamentar per te Drejtat e Njeriut	Njoftim
81	Radio Tirana	01.11.2002	AP dhe administrata shteterore	Ervin Karamuçë - Interviste
82	TNSH, Top Channel	07.11.2002	Ambasadori Amerikan viziton AP	Njoftim
83	Radio Tirana	08.11.2002	AP dhe ushtaraket	Ymer Hasani - Interviste
84	Radio+2	08.11.2002	AP Gjyqtaret-jo per turizem ne Itali	Ermir Dobjani - Interviste
85	TNSH	11.12.2002	AP organizon Konferencen per Transparencen.	Ermir Dobjani - Interviste

86	TVSH;TVA; TNSH; Real TV; Top Channel etj.	12.12.2002	AP ne Konferencen Kombetaren "E drejta e Informimit, e drejte themelore e Njeriut"	Njoftim
87	BBC	18.12.2002	AP-institucion mirefunksionues ne Shqiperi	Ermir Dobjani - Interviste
88	TVSH,TVA, TNSH; Top Channel, Vizion+, Real TV	19.12.2002	AP dhe Reforma ne ushtri	Njoftim
89	TV Shijak	19.12.2002	AP mbi emigrantet	Emission
90	Top Channel	21.12.2002	AP dhe Zyrat e Hipotekes	Interviste
91	Top Channel	22.12.2002	AP pret Drejtorin e Policisë për ankesat per makinat e ndaluara	Ermir Dobjani - Interviste
92	Vizion Plus	13.12.2002	Per veprimtarine e Avokatit te Popullit ne drejtim te mbrojtjes nga policia	Ermir Dobjani - Interviste
93	News 24	25.12.2002	AP - Personazh	Ermir Dobjani - Interviste

STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK 2002

MEDIA E SHKRUAR

Artikuj	Prononcime	Njoftime	Intervista	Konferencë shtypi	Gjithsej
120	47	68	5	3	243

MEDIA ELEKTRONIKE

Njoftime	Prononcime	Intervista	Emisione	Konferenca shtypi	Gjithsej
27	10	43	10	3	93

Shënim

Problematika e ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit duket edhe nga titujt që është gjykuar të paraqiten në Statistikë. Sidoqoftë veprimtaria e Avokatit të Popullit është edhe me shumëpërfshirëse, pasi ka mjaft çështje të zgjidhura që Avokati i Popullit e ka gjykuar të mos u japë publicitet. Për këtë shihni statistikat sipas seksioneve.

1. Vlerësime të Institucioneve dhe personaliteteve ndërkombëtare për punën e Avokatit të Popullit.

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri është zhvilluar nën monitorimin e afërt të faktorit ndërkombëtar, ku përfshihen institucione të tilla prestigjioze si Këshilli i Europës dhe Komisioni Europian, OSBE dhe ODIHR, Departamenti i Shtetit të SHBA dhe organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjithashtu edhe mjaft homologë të vendeve perëndimore ku ky institucion ka origjinën apo zhvillimin më të madh kanë vizituar zyrën tonë. Kështu që pas vëzhgimeve të situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe veprimtarisë së zyrës tonë qysh nga fillimi i veprimtarisë së saj, përfaqësuesit e tyre në raportet, intervistat apo letrat kanë shprehur vlerësimet e tyre, të cilat në thelb nuk janë mesazhe kortezie, por shprehin situatën reale pozitive të institucionit tonë, në krahasim edhe me zyrat e tyre apo të tjera.

1-Në mbledhjen e 29 janarit 2002, mbajtur në Sarajevo me përfaqësuesit e zyrave të OSBE dhe ODIHR-it të Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi është përcaktuar se: “Avokati i Popullit për periudhën e raportuar ka patur sukses në krijimin e tij si një institucion primar i të drejtave të njeriut në Shqipëri. Duke ndjekur një fushatë të sensibilizimit të publikut, institucioni jo vetëm është i njohur, por edhe ka vendosur një shkallë të lartë autoriteti”

2- Në Raportin e Prezencës së OSBE në Shqipëri për tremujorin Shtator-Dhjetor 2002 thuhet: “Meqënëse reputacioni i Avokatit të Popullit vazhdon të rritet dhe njohja e funksionit të tij nga publiku rritet, pritet që roli i Prezencës si pikë e parë e kontaktit të zvogëlohet më tej. Një pjesë e kësaj rritje mund t’i atribuohet një projekti të jashtëzakonshëm të Avokatit të Popullit për organizimin e orëve të hapura në rrethe të ndryshme të vendit. Rezultatet pozitive të kësaj ndërmarrje e kanë çuar në propozimin për hapjen e zyrave rajonale të përhershme”.

3-Kryetari i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të vendeve frankofone (SHOMF), njëkohësisht edhe Mediatori i Republikës Franceze, zoti Bernard Stasi, pas vizitës së tij në Shqipëri në Mars 2002, pergatiti një Raport të cilin ja dërgoi Këshillit të Europës dhe autoriteteve Shqiptare. Në vlerësimet e tij ka shkruar: “Ky mision na krijoi mundësinë që të konstatojmë zhvillimin me përparësi të institucionit të ri Shqiptar, që për dy vjet, ka arritur të krijojë një zyrë operacionale (funktionale) dhe të

arrirë, të pajisur me një ekip dinamik. Nga takimet me autoritetet shqiptare doli që Avokati i Popullit është marrë me seriozitet dhe që rekomandimet e tij faktikisht janë ndjekur.

Avokati i Popullit ka gjithashtu marrëdhënie shumë të mira me organizatat joqeveritare, si dhe me mediat. Ky bashkëpunim dhe këto shkëmbime informacioni dolën të frytshme, në të mirën e qytetarëve.

Madje, ai ka nënvizuar që: “më 1975, kur Mediatori i Republikës (Franceze) festonte përvjetorin e dytë të tij, ai nuk do e kishte pritur këtë stad zhvillimi. Për më tepër, sot Institucioni Shqiptar, në disa drejtime (fusha), është më kërkuar sesa në Francë: përfshirja në Kushtetutë, numri telefonik në linjë direkte me të burgosurit, komunikimi i përforcuar me mediat dhe me OJQ, etj”

4- Ombudsmani i të drejtave të njeriut të Bosnjë-Hercegovinës, ish Ombudsmani Suedez, zoti Frenk Orton, pas vizitës së tij në Shqipëri, në Korrik 2002 na shkruan: “Mësimet që morëm nga puna juaj në marrëdhëniet me publikun ishin të një vlere të madhe për ne dhe tani po përpiqemi të bëjmë me të mirën që të implementojmë një sërë idesh nga puna juaj. Ne kemi qënë gjithashtu tepër të impresionuar nga mënyra më profesionale me anë të së cilës ju mbanit kontaktet tuaja me autoritetet e larta zyrtare të cilat ne takuam”.

5- Komisar i Lartë për të drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës, ish Ombudsmani i Spanjës, zoti Alvaro Gil Robles, gjatë vizitës së tij në Shqipëri më 21 Tetor 2002 dha një intervistë në Televizionin Telenorba Shqiptare, në të cilën ndër të tjera tha: “Ju them se kam shumë besim në Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili mund të ndihmojë që të ndryshojnë gjërat. Ai ka bërë një punë shumë të madhe dhe jam shumë i sigurtë se do të bëjë një punë edhe më të rëndësishme dhe unë si komisar do të jap gjithë mbështetjen time për këto ndryshime”

Pyetjes së gazetarit se cilat janë raportet tuaja konkrete me Avokatin e Popullit?, - zoti Gil Robles i dha përgjigje “Mund t’ju them se raportet janë raporte institucionale, ne kemi mbledhjet tona ndërkombëtare të Ombudsmanit, të cilat janë në një farë mënyre institucione të ngjashme në të gjithë Europën, ku shkëmbejmë opinione e eksperiencat. Ndërkohë do të mendojmë për gjëra, të cilat mund t’i bëjmë së bashku dhe mos harroni që Avokati i Popullit është një forcë e madhe, sepse është i pavarur, totalisht i pavarur. Komisar nuk ka nevojë të japë këshilla. Ai e di mirë se çfarë duhet të bëjë. Gjëja e vetme që mund të bëjë është të ofroj solidaritetin tim total dhe mbështetjen time ndërkombëtare ndaj punës së tij”.

6- Organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut Human Rights Watch në Raportin e saj Botëror për ngjarjet e vitit 2002 në Shqipëri shkruan: “Avokati i Popullit pati rezultate në drejtim të konsolidimit të këtij institucioni të ri, duke angazhuar degë të ndryshme të qeverisjes në dialog për çështje të të drejtave të njeriut dhe duke e përqëndruar veprimtarinë e tij në promovimin e lirisë së informacionit, të drejtës së jetës private dhe efektivitetit të përmbarimit gjyqësor. Megjithatë, një vendim shqetësues i Gjykatës Kushtetuese (i shpallur në Nëntor 2001) duket se e ka kufizuar në një masë të madhe kompetencën e Avokatit të Popullit për të iniciuar shqyrtimin e kushtetuteshmërisë së legjislacionit”.

2- Letra falenderimi nga qytetarët

Zotit Ermir Dobjani **Avokat i Popullit**

I nderuar zoti Dobjani,

Pranoni, Ju lutem, mirënjohjen time për angazhimin dhe veprimtarinë Tuaj personale dhe të Institucionit të Avokatit të Popullit për rivendosjen e të drejtave të mia ligjore, të shkelura nga organet e policisë. Përfitoj nga rasti për t'i falenderuar nëpërmjet jush edhe zëvendës-Avokatin z.Jorgo Dhrami dhe inspektorin z.Sotiraq për sjelljen e tyre korrekte dhe njerëzore, për përkushtimin, me të cilin ata kane vepruar .

Uroj, që Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen të punojë si organ mbipartiak për vendosjen e marrëdhënieve demokratike në shoqërinë shqiptare.

Me respekt

Lilia Naumova

Tiranë më 27.02.2002

Z Ermir Dobjani **Avokati i Popullit** **Tiranë**

Në përgjigje të shkresës Tuaj Nr. y -8/4, datë 11.04. 2002, ju njoftoj se falë ndërhyrjes Tuaj problemi im u zgjidh. Ndërtimi pa leje, bërë në pronën time, me ndërhyrjen e Policisë Ndërtimore të Përgjithshme Tiranë, u prish.

I nderuar Z. Avokat i Popullit, kësaj letre do doja t'i jepja më tepër nuancat e falenderimit dhe mirënjohjes ndaj Jush dhe ndaj të gjithë punonjësve të administratës shtetërore që me objektivitet dhe drejtësi zgjidhin problemet apo konfliktet e shkaktuara nga njerëz të pandërgjegjshëm.

Me konsiderate dhe sinqerisht

Ylber Merdani

Lagja 7 Pallati "XHAMIA" shk. A/13, Korce .

Tiranë më 29.04.2002

Fondacioni “Qendra Kristiane e Durrësit”

Njoftim

Drejtuar Avokatit të Popullit

Ne duam t’ju falenderojmë dhe t’ju bëjmë të ditur se ne jemi shumë mirënjohës për interesimin dhe punën tuaj, për problemin që Fondacioni “Qendra Kristiane e Durrësit” ju ka paraqitur, më datë 05.04.02.

Ju vemë në dijeni se Dega e Policisë Ndërtimore në Durrës është interesuar për të mos lejuar vazhdimin e punimeve të objektit klinike, pranë kishës, Fondacionit “Qendra Kristiane e Durrësit”. Sot punimet nuk vazhdojnë, por megjithatë problemi qëndron i hapur.

Shpresojmë që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Me respekt

Perfaqësuesi i Fondacionit
Steve Carmichael

Durrës 20.05.2002

Komisionerit të Avokatit të Popullit
Zotit Jorgo Dhrami
Tiranë

E mora përgjigjen e letrës time, me shkresën tuaj nr.K2/S42-2 datë 13.05.2002. Ju falenderojmë për korrektësinë Tuaj. Lutem bëja të ditur Avokatit të Popullit Zotit Dobjani mbasi u takova personalisht me të në Kavajë.

Nderime dhe suksese dhe shëndet

Saliko Myrtaj

Kavajë 26.05.2002

I nderuar Z.Dobjani

Me anë të kësaj letre dua t'Ju shpreh falenderimet dhe konsideratën time lidhur me bashkëpunimin dhe ndihmesën Tuaj në ndjekjen dhe përfundimin me sukses të procedurës sonë ankimore me objekt: "Shkeljet e ligjit nga ana e administratës tatimore lidhur me tatimin mbi fitimin të përlllogaritur paraprakisht nga organi tatimor", dërguar Ju me shkresën e datës 17.01.2002.

Duke shpresuar se ky bashkëpunim i frytshëm do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe duke Ju uruar punë të mbarë dhe suksese, mbetem,

Me respekt

Grigor JOTI
Drejtor i Përgjithshëm i Info Soft System sh.a.

Tiranë më 22.08.2002

Drejtorit të Sektorit të Veçantë z. Jorgo Dhrami

E ndjej për detyrë që me marrjen e letrës tuaj Nr. K2/B 44-2 datë 02.02.2002 t'ju falenderoj për korrektesën dhe për interesimin që po tregoni për zgjidhjen e çështjes për të cilën ju jam drejtuar, çështje e cila padrejtësisht nuk është zgjidhur prej 9 vjetësh nga organet shtetërore.

Me respekt për ju dhe për kolegët Tuaj, dhe me besim në punën Tuaj.
Burhan Ibrahim

Adresa:
Burhan Ibrahim
Via Francesco Dormisch, 3100 Udine, Itali
07.10.2002

Avokatit të Popullit

Z. Ermir DOBJANI

I nderuar z. Avokat!

Ju bëjë me dije se problemi për të cilin unë ju kërkova ndihmë u zgjidh plotësisht.

Nga ana e ime Ju falenderoj Juve personalisht dhe gjithë stafin tuaj për këmbëguljen dhe seriozitetin maksimal që treguat në zgjidhjen e problemit për të cilin ju kërkova ndihmë.

Duke ju falenderuar edhe njëherë ju uroj Juve dhe stafit tuaj suksese në punën Tuaj sa të vështirë dhe fisnike.

Me respekt

Zhaneta Spahiu

Tiranë më 12 Dhjetor 2002

I nderuar zoti Avokat i Popullit.

Unë që po ju shkruaj për së dyti jam nëna e të vrarit Astrit Stambollxhiu, nga kriminelin Arben Ceta. Në përgjigjen e letrës tuaj të datës 13.12.2001, ku ju na njoftuat për dënimin me 20 vjet burg të kriminelit e deri më sot, Gjykata e Apelit nuk ka dhënë vendimin për të. Sot më datë 17.12.2002, të interesuar për vendimin e Gjykatës së Apelit, pyetëm në Gjykatën e Faktit në Elbasan, kryetarin e trupit gjykues dhe na tha se Gjykata e Apelit e ka hedhur poshtë vendimin e Gjykatës së Faktit dhe e ka dënuar, mbas një viti gjykimi të Gjykatës së Elbasanit, kriminelin Arben Ceta me **11** vjet burg, duke ulur dënimin e Gjykatës së Faktit.

I dashur zoti Avokat!

Nga ju jam shumë i kënaqur për korrektesën në letër përgjigjen tuaj, se ishit ju që na informuat për gjykimin e dënimin e kriminelit, kur Gjykata e Faktit thoshte e ka Gjykata e Apelit e nuk na jepte vendimin.

Zoti Avokat i Popullit, ju jam shumë mirënjohës juve dhe për komunikimin me popullin. Më vjen shumë keq në zgjatjen e gjykimit nga ana e Gjykatës së Apelit dhe në uljen e dënimit që kishte dhënë më parë Gjykata e Faktit.

I dashur zoti Avokat, në uljen e dënimit të kriminelit, me keqardhje mund të themi se në Gjykatën e Apelit ka korrupsion, nuk ka gjykim objektiv dhe gjykimi i saj jep shkak për vetëgjyjësi për gjakmarrje.

301

Vendimi i Gjykatës së Apelit shkel mbi gjakun e tim biri, gjykim pa motivim e argumentim, gjykim me keqardhje nisur nga era papërgjegjshmërisë, inkompetencës dhe të rryshfetit. Jemi interesuar në Gjykatën e Apelit dhe na thanë se nuk e merr njeri për gjykim, do merren gjygtare nga Korca për gjykim e të tilla ecejake që korruptojne gjykimin. Ju lutem, zoti Avokat, me kompetencat tuaja, për hir të drejtësisë, për të çuar të drejtën në vend, për ngushëllimin sadopak të nënës e të fëmijëve tanë jetime, pa babë, të cilët janë tre, ju lutem, gjykoni me drejtesi gjykimin e Gjykatës së Apelit, i cili me duket i papërgjegjshëm dhe korruptiv.

Kam besim se me gjykimin tuaj, për të cilin unë kam shumë konsiderate, do të ngushëllojë sadopak mua nënën plakë e tre fëmijët jetime që kërkojnë babën e tyre.

Përgjigja juaj më mban me moral lart.

Paç jetë të gjatë për të mirën e popullit, për të drejtën e gjykimit.

Me konsideratën më të lartë

Nazmije Stambollxhiu

17.12.2002

I nderuar Z. Dobjani

Do t'ju falenderoja shpirtërisht për disa arsye.

1- Si intelektual, me kthyet shpresen dhe besimin që nëpërmjet Institucionit që Ju drejtoni do të kthehet në Shqipëri drejtësia për të cilën kemi nevoje.


2- Institucioni i Avokatit të Popullit, me specialistët që disponon, të cilët i falenderoj për këmbënguljen e drejtë gjatë trajtimit të çështjes time, dhe me Ju në drejtim, megjithese i ri në formim dhe si koncept në Shqipëri, kam besim se do të bëhet një nga Institucionet ku çdo Shqiptari në punën e tij do t'i rriten forcat dhe pasioni për të punuar sepse ka se ku drejtohet nëse i bëhet padrejtësi.

3- Rivlerësimi i punës që kam bërë në sistemin e burgjeve nëpërmjet ndërhyrjes Tuaj më ka ndërgjegjësuar që duhet të vazhdoj të punoj drejt e pastër gjatë gjithë jetës time.


Me respekt
Vojo Tashi

Tiranë më 18.12.2002


**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2002,
pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit
Totali 2496**




Ankesat e trajtuara gjate vitit 2002
Totali 3263



**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda
juridiksionit gjatë vitit 2002
Totali 1396**




Gjendja e ankesave në fund të vitit 2002
Totali 3263




- Ankesa të përfunduara gjatë vitit 2002
- Ankesa që vazhdojnë të jenë në shqyrtim gjatë vitit 2003

**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë
zyrës së pritjes së popullit
Totali 2115**




- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.


Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2002
Totali 4675




**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000, 2001 dhe 2002,
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)
Totali 7876**



Shpërndarja e ankesave sipas degëve të qeverisjes



MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2002

MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2002

